



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I HISTORI - GJEOGRAFI

TEMË DOKTORATURE
FIGURA E DERVISH BEJ BIÇAKUT DHE KONTRIBUTI I TIJ NË HISTORINË
E SHQIPËRISË DHE TË ELBASANIT

Për Gradën Doktor i Shkencave në Albanologji
Fusha: Histori

Disertanti
Msc. Juliana HASEKIU-LLOSHI

Udhëheqës shkencor
Prof. As. Dr. Majlinda PEZA-PERRIU

Elbasan, Maj 2021

DISERTACION
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR I SHKENCAVE”

PËRGATITUR NGA JULIANA HASEKIU

**FIGURA E DERVISH BEJ BIÇAKUT DHE KONTRIBUTI I TIJ NË
HISTORINË**

E SHQIPËRISË DHE TË ELBASANIT

UDHËHEQËS SHKENCOR

Prof.Asoc.dr. Majlinda PEZA-PERRIU

Mbrohet më,

përpara jurisë:

1. ----- (Kryetar)
2. ----- (anëtar)
3. ----- (anëtar)
4. ----- (anëtar)
5. ----- (anëtar)

**FIGURA E DERVISH BEJ BIÇAKUT DHE KONTRIBUTI I TIJ NË
HISTORINË E SHQIPËRISË DHE TË ELBASANIT**

DEKLARATË E VËRTETËSISË SË PUNIMIT

**DEKLAROJ NË PËRGJEGJËSINË TIME TË PLOTË SE KY PUNIM ËSHTË
HARTUAR NGA UNË DHE PËR ÇDO IDE APO INFORMACION , I CILI NUK
ËSHTË IMI, KAM RESPEKTUAR TË GJITHË RREGULLAT E CITIMIT DHE
REFERIMIT.**

DEKLAROJ SE NË KËTË PUNIM NUK KA VËND PLAGJIATURA.

JULIANA HASEKIU

IA KUSHTOJ PRINDËRVE TË MI DHE FAMILJES SIME

FALENDERIME

Në fillim të këtij punimi, dua të falenderoj profesorin tim të nderuar Prof.Dr. Liman Varoshi, i cili më ka mbështetur përgjatë kërkimeve të mia shkencore, mbi zbardhjen e figurës së Dervish Biçakut dhe që pa dyshim do të doja ta kisha sot në krah.

Do të doja gjithashtu të shpreh falenderimet e mia të thella për të gjithë ata që më kanë qëndruar pranë dhe më kanë dhënë këshilla të vyera që nga fillimi i rrugëtimit të këtij punimi.

Falenderime të veçanta shkojnë për udhëheqësen time shkencore, Prof.As.Dr. Majlinda Peza-Perriu e cila më ka ndihmuar në realizimin dhe përfundimin e këtij punimi.

Falenderime dhe mirënjohje të veçantë ndaj të gjithë profesorëve dhe kolegëve të cilët me ndihmën dhe sugjerimet e tyre kanë bërë që ky punim të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Falenderimin më special dua ta bëj për Ajdin që mbetet frymëzimi im.

ABSTRAKT

TEMA: FIGURA E DERVISH BEJ BIÇAKUT DHE KONTRIBUTI I TIJ NË HISTORINË E SHQIPËRISË DHE TË ELBASANIT.

Disertacioni me temë: “Figura e Dervish bej Biçakut dhe kontributi i tij në historinë e Shqipërisë dhe të Elbasanit”, përbën një studim shkencor që synon të hedhë dritë mbi figurën e Dervish bej Biçakut dhe kontributin e tij në veprimtarinë politiko-arsimore në ngjarjet më të rëndësishme të Shqipërisë dhe të Elbasanit në fundin e shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX. Ky punim përpiket ta sjellë sa më të plotë elbasanasin që guxoi të kundërshtojë Portën e Lartë; që guxoi të bëjë bashkë myslimanë e të krishterë në Kongresin e shkollave shqipe duke u ngritur mbi fanatizmin që mbizotëronte në qytet; që dha një kontribut të padiskutueshëm në vitet 1909- 1912 dhe që ishte një nga protagonistët e Shpalljes së Pavarësisë. Këtu pasqyrohet edhe censura që karakterizonte periudhën e koministe, që ka mohuar qëllimisht të gjithë veprimtarinë e Dervishit në funksion të çështjes shqiptare. Është trajtuar përfshirja shumë shpejt e tij në mbështetje të Lëvizjes Uniatiste, pra përpjekjeve të tij për shkollën shqipe dhe kishën kombëtare. Në vijim, shqyrtohet kontributi i tij në krijimin e klubit “Vllaznia”, ku Dervishi u zgjodh kryetar i këtij klubi. Jemi përpjekur të pasqyrojmë edhe veprimtarinë e tij, duke pasur parasysh faktin se ai ka pasur kontakte me emrat më të shquar të kohës. Faktet na kanë nxitur të ndalemi në evidentimin e rolit të tij “si kryemësonjës i komisionit të Normales”, i cili menaxhoi mirëfunksionimin e kësaj shkolle duke e kryer këtë detyrë plot pasion dhe devotshmëri. Kështu kemi analizuar kontributin e tij në Shpalljen e Pavarësisë në Peqin e në Vlorë; rolin i tij në “Pleqësinë e Vlorës” dhe ndihmesën në ditët e para për formimin e Qeverisë së Vlorës. Vitet 1913 – 1914 janë vite që e vendosin Dervish beun herë në konflikt me Aqif Pashën, herë në kahun e mbështetësve të princ Vidit. Përmes burimeve arkivore, jemi përpjekur të evidentojmë arsyet se përse në maj të 1913-ës, Dervishi distancohet nga Ismail Qemali dhe sikurse një pjesë e patriotëve të njohur të asaj kohe, rreshtohet përkrah Esad pashë Toptanit. Ai padyshim mund të ketë problematikat e tij në qëndrimet që ka mbajtur në çështje të ndryshme, por ajo që vlen dhe nuk mund të mohohet dhe mund ta themi pa asnjë mëdyshje është që ai e deshi shumë qytetin e tij, që ishte mbështetës i flaktë i kishës kombëtare, mbështetës me shpirt i gjuhës shqipe dhe shkollës kombëtare, sepse siç ai vetë shkruan, ajo “asht gjallesa e vet kombit”. Dervish Biçaku, në gjithë veprimtarinë e tij gjatë 1912-ës, e shënoi emrin e tij, por edhe të Biçakçinjve në atë plejadë personalitetesh për të cilin çdo elbasanas dhe shqiptar do të ndihej krenar.

Fjalë kyçe: *Dervish bej Biçaku rilindje, patriot, lëvizja uniatiste, perandoria osmane, diplomaci ,klubi Vllaznia, Kongresi Elbasanit, shkolla normale, pavarësi.*

ABSTRACT

TOPIC :THE FIGURE OF DERVISH BEY BIÇAKUT AND HIS CONTRIBUTION TO THE HISTORY OF ALBANIA AND ELBASAN

"The figure of Dervish bey Biçaku and his contribution to the history of Albania and Elbasan" is a scientific study that aims to shed light on the figure of Dervish bey Biçaku and his contribution to the political and educational activity in the most important events of Elbasan and Albania at the end of the nineteenth century and the beginning of the twentieth century. This piece of work tries to thoroughly describe the city of Elbasan that dared to oppose the High Gate; that dared to unite Muslims and Christians in the Congress of Albanian schools by rising above the fanaticism that prevailed in the city; that made an indisputable contribution during 1909 - 1912 and that was one of the protagonist cities of the Declaration of Independence. In almost all the publications we have been able to research, published during the period 1945-1990, there is a lack information regarding the contribution given by Dervish Biçaku in the Congress of Elbasan, as well as in the Declaration of Independence. This also reflects the censorship that characterized the above-mentioned period, which has deliberately denied all of Dervish's activity in function of the Albanian cause. His involvement in support of the Uniatism Movement, i.e., his efforts for the Albanian school and the national church, have been addressed in this piece of work as well. His contribution to the creation of the club "Vllaznia" is examined, where Dervish was even elected president of this club. The facts have prompted us to dwell on the evidence of his role "as the head teacher of the commission of the Normal school", who managed the well-functioning of this school by performing this task full of passion and devotion. Therefore, we have analysed his contribution to the Declaration of Independence in Peqin and Vlora; his role in the "Eldership of Vlora" and assistance in the first days for the formation of the government of Vlora. The years 1913 - 1914, are years that place Dervish bey sometimes in conflict with Aqif Pasha, sometimes on the side of the supporters of Esat Pasha Toptani. Through archival research, we have tried to identify the reasons why in May of 1913, Dervish distanced himself from Ismail Qemali and, similarly to some of the most well-known patriots of that time, he lined up next to Esat Pasha Toptani for pragmatic reasons. He could have had problematic attitudes regarding various issues, but what is valid and cannot be denied and hence, we can say without any hesitation, is that he loved his city very much, he was an ardent supporter of the national church, a staunch supporter of the Albanian language and the national school, because as he himself writes, it "is the lifeblood of the nation itself". Dervish Biçaku, in all his activity during 1912, marked his name, but also that of his family in that constellation of personalities for whom every person from Elbasan and every Albanian would feel proud.

Keywords: Dervish bey Biçaku, Renaissance, Patriot, Pragmatist, Uniatism Movement, Ottoman Empire, Diplomacy, Vllaznia club, Congress of Elbasan, Normal school, Independence.

PASQYRA E LËNDËS

PARATHËNIE	IX
HYRJE	1
 KREU I: VEPRIMTARIA E BIÇAKÇINJVE NË KUADRIN E LËVIZJES KOMBËTARE NË FUND TË SHEK. XIX - FILLIMI SHEK. XX	10
I. 1 Jetëshkrim i shkurtër për Dervish Biçakun	10
I. 2 Përfshirja e Biçakçinjve në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare	15
I. 3 Lëvizja Uniatiste dhe Dervish Biçaku	20
I.4 Fillesat e konfliktit me Aqif Pashë Biçakun	32
I. 5 Veprimtari patriotike e Dervish Biçakut në vitet 1900-1908.....	34
 KREU II: KORRESPONDENCA E DERVISH BIÇAKUT DHE VEPRIMTARIA NË KUADRIN E KLUBEV PATRIOTIKE	39
II.1 Letërkëmbimet me Faik Konicën	39
II.2 Letërkëmbime të Dervish Biçakut përgjatë viteve 1895 - 1914.....	46
II.3 Veprimtaria e Dervish Biçakut në kuadrin klubeve patriotike në Elbasan	57
 KREU III: KONGRESI I ELBASANIT DHE DERVISH BIÇAKU	70
III.1 Përpjekjet e Dervish Biçakut dhe e patriotëve shqiptarë në organizimin e Kongresit të Elbasanit.....	70
III.2 Kongresi i Elbasanit dhe roli i Dervish Biçakut në të.....	75
III.3 Kongresi i Elbasanit në fokusin e studiuesve të huaj.	84
 KREU IV: VEPRIMTARIA E DERVISH BIÇAKUT NË VITET 1910-1940	91
IV.1 Veprimtaria patriotike e Dervish Biçakut në vitet 1910-1911.....	91
IV.2 Roli i Dervish Biçakut në kryengritjen e vitit 1912 në trevën e Elbasanit	99
IV.3 Dervish Biçaku dhe Shpallja e Pavarësisë Kombëtare	105
IV.4 Raporti i Dervish Biçakut me Qeverinë e Vlorës 1913 - 1914	112
IV.5 Dervish Biçaku dhe përfshirja e tij në jetën politike 1920 - 1940	128
 PËRFUNDIME	140
BIBLIOGRAFIA	144
SHTOJCA	147
PËRMBLEDHJE NË ANGLISHT	158

***“Kam krijuar bindjen, se ju keni një zgjuarsi që ndeshet rrallë,
dhe se mendja juaj e çliruar ngrihet mbi shpirtvogëlsinë,
besimet dhe sektet.”***
Faik Konica

PARATHËNIE

Disertacioni me temë: **“FIGURA E DERVISH BEJ BIÇAKUT DHE KONTRIBUTI I TIJ NË HISTORINË E SHQIPËRISË DHE TË ELBASANIT”**, përbën një studim shkencor që synon të hedhë dritë mbi figurën e DERVISH BEJ BIÇAKUT dhe kontributin e tij në veprimtarinë politiko-arsimore në ngjarjet më të rëndësishme të Shqipërisë dhe të Elbasanit. Një figurë që u varros nga pushteti komunist, i etiketuar tradhtar nga historiografia moniste, por që dhe sot thuajse është lënë në harresën e kohës dhe lind si domosdoshmëri zbardhja e kësaj figure, brenda problematikave të kohës që jetoi.

Të trajtosh një figurë si Dervish Biçaku, nuk është e lehtë. Qëndrimet pro dhe kundër, të mbajtura në momente të caktuara, kanë nevojë të trajtohen dhe analizohen në mënyrë më të thelluar dhe ky punim synon të jetë një kontribut në këtë aspekt. Hulumtimi i materialeve të nxjerra për herë të parë nga Arkivi Qendror i Shtetit, hedh dritë më mirë mbi këtë figurë, duke zbardhur disa nga ngjarjet më të rëndësishme ku kontributi i Dervish bej Biçakut ka qenë më se evident. Në këto terma, ky punim përpiqet ta sjellë sa më të plotë elbasanasin që guxoi të kundërshtojë Portën e Lartë; që guxoi të bëjë bashkë myslimanë e të krishterë në kongresin e shkollave shqipe duke u ngritur mbi fanatizmin që mbizotëronte në qytet; që dha një kontribut të padiskutueshëm në vitet 1909- 1912 dhe që ishte një nga protagonistët e Shpalljes së Pavarësisë. Thuajse në të gjitha botimet që kemi mundur të hulumtojmë, të botuara gjatë periudhës 1945-1990, mungon informacioni rreth kontributit të dhënë nga Dervish Biçaku si në Kongresin e Elbasanit, ashtu edhe në Shpalljen e Pavarësisë. Këtu pasqyrohet edhe censura që karakterizonte periudhën e sipërpërmendur, që ka mohuar qëllimisht të gjithë veprimtarinë e Dervishit në funksion të çështjes shqiptare.

Për arsytet e lartpërmendura, ky studim mund të mbushë një boshllëk historiografik që mendojmë se ka ardhur deri më sot, përsa i përket figurës së Dervish bej Biçakut. Për më tepër, ky punim mund të na çojë tek një individualizim më i mirë i motiveve që çuan atë të bëjë disa zgjedhje specifike, të cilat ndikuan në historinë e Elbasanit dhe në historinë tonë kombëtare. Me shpresën se ky punim do të realizojë një rindërtim të përgjithshëm dhe të kujdesshëm të dimensionit politik e historik të Dervish bej Biçakut, hartimin e këtij punimi e kemi mbështetur

në metodologjinë problemore dhe kërkimore duke përdorur kështu, analizën, krahasimin dhe sintezën.

Procesi i grumbullimit të të dhënave është kryer nëpërmjet:

- 1. Hulumtimit shkencor;*
- 2. Sigurimit të të dhënave;*
- 3. Klasifikimit të të dhënave;*
- 4. Përpunimit të të dhënave.*

Duke u mbështetur sa më sipër përmendëm, ky punim synon të arrijë:

- Së pari, të përshkruajë data, figura, ngjarje historike që kanë ndikuar në formimin e figurës së këtij personaliteti.*
- Së dyti, të nxjerrë në pah përpjekjet e këtij atdhetari për konsolidimin e shkollës shqipe, kishës kombëtare, kontributin e padiskutueshëm në Kongresin e Elbasanit dhe gjithashtu në mirëfunksionimin e shkollës Normale.*
- Së treti, përmes respektimit të parimit të objektivitetit, arritjen në përfundimeve të sakta e të paanshme, të mbështetura në fakte historike, mbi veprimtarinë e tij nga 1912 deri në 1940.*
- Së katërti, motivet që e kanë shtyrë këtë personalitet, në momente të caktuara të bëjë disa zgjedhje, të cilat në këndvështrimin e historiografisë zyrtare konsideroheshin kundër rrymës.*

Punimi është organizuar me një parathënie, një hyrje, katër kapituj duke dashur të respektojë një parabolë biografike, por dhe kronologjike të përfshirjes së Dervish Biçakut në lëvizjet politike dhe kulturore të Shqipërisë së viteve 1895-1940.

Në kapitullin e parë të titulluar "Veprimtaria e Biçakçinjve në kuadrin e Lëvizjes Kombëtare në fund të shek. XIX - fillimi shek. XX", jemi përqendruar tek familja e Biçakçinjve, një ndër dyert e mëdha feudale në trevën e Elbasanit dhe përfshirja e përfaqësuesve të saj në zhvillimet më të rëndësishme politike në fund të shek. XIX. Është bërë një përshkrim, duke evidentuar anën më njerëzore të familjes së tij, por edhe për të kuptuar ndikimin e saj në formimin dhe konsolidimin e personalitetit të Dervishit. Është trajtuar formimi i tij intelektual dhe përfshirja shumë shpejt e tij në mbështetje të Lëvizjes Uniatiste, pra përpjekjeve të tij për shkollën shqipe dhe kishën kombëtare. Gjatë gjithë kësaj lëvizjeje, Dervishi, edhe pse muhamedan në besimin e tij, mbështeti popullsinë ortodokse të Shpatit në luftën e saj për konvertimin në katolikë. Një nga qëllimet e kësaj lëvizjeje, ishte lufta për shkollën shqipe. Dervishi nuk bëri kompromis, pavarësisht trysnisë që ushtroi Porta e Lartë, sinodi grek dhe

patriarkana e Stambollit. Në këtë lëvizje ai shihet të ketë përkrah tij jo vetëm Shefqet Vërlacin dhe Aqif pashën, por edhe Murat Toptanin. Kemi trajtuar gjithashtu kontaktet e tij me personalitete të kohës si dhe faktin që ai duke qenë një prej përfaqësuesve të derës së madhe të Biçakçinjve, ka pasur kontakte edhe me diplomacinë e huaj në Shqipëri qoftë italiane, austro-hungareze, sikurse edhe me vetë Portën e Lartë. Po në këtë kapitull, janë trajtuar format e mosbindjes ndaj Portës së Lartë si dhe fillesat e konfliktit me Aqif Pashën për çështje trashëgimie.

Kapitulli i dytë "Korrespondenca e Dervish Biçakut dhe veprimtaria në kuadrin e klubeve patriotike", i është kushtuar letërkëmbimeve për Dervishin dhe nga Dervishi me personalitete të kohës, por jo vetëm, si dhe veprimtarinë e tij në lidhje me aktivitetin pranë klubeve patriotike, fillimisht të klubit Bashkimi, si klubi i parë me karakter patriotik që u krijua në Elbasan pas shpalljes së "Hyrrjetit" dhe gjithashtu në mbledhjen e Kongresit të Manastirit. Në vijim, shqyrtohet kontributi i tij në krijimin e klubit "Vllaznia", ku Dervishi u zgjodh kryetar i këtij klubi. Qëllimi i këtyre klubeve ishte përhapja e kulturës dhe mbi të gjitha e gjuhës shqipe në trevën e Elbasanit, duke dalë në mbrojtje të shkrimit të saj me alfabetin e Manastirit. Jemi përpjekur të pasqyrojmë edhe veprimtarinë e tij, duke pasur parasysh faktin se ai ka pasur kontakte me emrat më të shquar të kohës si: Faik Konica, Ibrahim Temo, Dervish Hima, Luigj Gurakuqi, Jani Vruho, Mit'hat Frashëri, Ismail Qemali, Lef Nosi, Ahmet Dakli, Shefqet Vërlaci, Esat pashë Toptani, Murat dhe Fuat Toptani, Nikolla Naço, Mit'hat Frashëri etj. Në këtë kapitull kemi shpalosur Dervishin në një plan shumë të gjerë; na shfaqet djaloshi që shumë herët përfshihet në Lëvizjen Kombëtare, që udhëton pa fund nga Stambolli në Shqipëri, nga Shqipëria në Itali, e më tej në Bukuresht e sërish në Stamboll me qëllimin e vetëm për të siguruar libra që aq shumë mungonin. Po ashtu, na shfaqet Dervishi i cili mbështet financiarisht disa nga gazetat e kohës, përvijohet figura e personalitetit që pati një ndikim të jashtëzakonshëm në historinë jo vetëm të Elbasanit, por edhe të Shqipërisë në fillimin e shekullit XX. Ai tashmë nuk ishte djaloshi idealist që adhuronte xhonturqit, por ishte patrioti që luftoi me të gjitha fuqitë për atdheun e tij. Ai diti që me intuitën që e karakterizonte të shënojë emrin në atë plejadë njërëzish që vunë në dispozicion të vendit dhe popullit të gjitha resurset financiare, materiale dhe mendore në shërbim të çështjes kombëtare. Korrespondenca na shfaq elbasanasin që qëndroi krah burrave të shtetit që pa dyshim shkruajtën emrin në historinë e Shqipërisë në fillimin e shek. XIX.

Në kapitullin e tretë "Kongresi i Elbasanit dhe Dervish Biçaku", jemi fokusuar në veprimtarinë e tij kulturore (pa përjashtuar tërësisht atë politike). Në këtë këndvështrim, është evidentuar puna e palodhur dhe jo e lehtë e klubeve patriotike që u formuan në Elbasan në

bashkëpunim edhe me klubin e Selanikut, për organizimin pas një viti të Kongresit të Elbasanit. Synimi është të evidentohet roli e Dervish Biçakut dhe i klubit që ai drejtonte në organizimin dhe mbarëvajtjen e Kongresit të Elbasanit, si dhe të vlerësohet kontributi i tij në ditët e mbajtjes së Kongresit, duke qenë se, ai është jo vetëm një nga financuesit e tij, por edhe një nga mbështetësit kryesorë të zbatimit të vendimeve të tij. Faktet na kanë nxitur të ndalemi në evidentimin e rolit të tij “si kryemësonjës i komisionit të Normales”, i cili menaxhoi mirëfunksionimin e kësaj shkolle duke e kryer këtë detyrë plot pasion dhe devotshmëri. Në këtë kapitull, kemi analizuar gjithashtu edhe problematikat që u shfaqën gjatë Kongresit të Elbasanit dhe zbatimin e vendimeve të marra në të, ku pesha dhe përgjegjësia më e madhe do t’i takonte patriotëve elbasanas. Kemi evidentuar gjithashtu veprimtarinë e pandërprerë të Dervishit në kuadrin e Këshillit Mbikëqyrës për hapjen e Normales në Elbasan, nga shtatori deri në dhjetor të vitit 1909.

Po në këtë kapitull " Kongresi i Elbasanit dhe Dervish Biçaku ", kemi pasqyruar kongresin në këndvështrimi e studiuesve të huaj, të cilët me objektivitet kanë vlerësuar arritjet e kongresit, por edhe dobësitë e tij. Kështu kemi trajtuar qëndrimet që mban studiuesi Gabriel Louis Jaray, i cili në veprën e tij "Shqipëria e panjohur", duke qenë i pranishëm në kongres, na ka dhënë detaje të vyera të atmosferës dhe bisedimeve që janë zhvilluar gjatë ditëve të kongresit. Po ky autor na jep detaje, veçanërisht rreth figurës së Dervish Biçakut dhe vlerëson tek ai faktin që ishte një dëgjues i vëmendshëm dhe tregonte interes për gjithçka. Gjithashtu, kemi trajtuar edhe mendimet e autorëve të tjerë, tepër interesante, si Joseph Sëire, Edwin Jacques dhe Nathalie Clayre.

Në kapitullin e katërt, "Veprimtaria e Dervish Biçakut nga 1910 deri më 1940", jemi fokusuar tek veprimtaria e tij politike. Përkushtimi maksimal në çështjen e arsimit, puna e tij si për shkollën ashtu si dhe për sigurimin e bazës materiale, gjykojmë se janë arsytet e përndjekjes së tij dhe të të vëllait gjatë terrorit xhonturk, të vjeshtës së vitit 1910, terror që çoi në mbylljen e Normales. Po këtu jemi ndalur në veprimtarinë e tij dhe të atdhetarëve të tjerë që u detyruan të largohen jashtë vendit si rrjedhojë e persekutimit të Portës së Lartë. Kemi trajtuar përpjekjet që ai së bashku me patriotë të tjerë bënë për ta rihapur Normalen jashtë Shqipërisë, në vende të tjera me qëllimin e vetëm që puna e nisur të mos ndërpritej, sepse shkolla dhe librat ishin e vetmja zgjidhje për vendin. Dervishi dhe i vëllai Hasani janë iniciatorë dhe drejtues kryesorë të klubit të ri që do të krijohet si rrjedhojë e unifikimit të dy klubeve kryesore, klubet "Bashkimi" dhe "Vllaznia" të quajtura “Bashkimi i Ri”, i cili krijohet në mars 1910 dhe që si qëllim parësor kishte luftën kundër xhonturqve (këtë gjë e vërteton emblema e duarve ku dhe në vulë dallohen dy duar të bashkuara). Kështu kemi analizuar

kontributin e tij në Shpalljen e Pavarësisë në Peqin e në Vlorë; rolin i tij në “Pleqësinë e Vlorës” dhe ndihmesën në ditët e para për formimin e qeverisë së Vlorës. Vitet 1913 – 1914 janë vite që e vendosin Dervish beun herë në konflikt me Aqif Pashën, herë në kahun e mbështetësve të princ Vedit. Përmes burimeve arkivore, jemi përpjekur të evidentojmë arsyet se përse në maj të 1913-ës, Dervishi distancohet nga Ismail Qemali dhe sikurse një pjesë e patriotëve të njohur të asaj kohe, rreshtohet përkrah Esad pashë Toptanit. Për më tepër, në muajt e fundit të vitit 1913, marrëdhënia ndërmjet Dervishit dhe Aqif Pashës, prefektit të Elbasanit, arrin në një përballje të armatosur ndërmjet përkrahësve të Dervishit që synonin të përfshinin edhe Elbasanin në zonën e ndikimit të tyre. Ndërkaq, qëndrimin e Dervishit në vitet 1913-1914 ndaj princit që ishte caktuar për të ardhur në Shqipëri, e kemi trajtuar përmes shfrytëzimit të dokumentacionit arkivor. Kemi analizuar lëvizjen e Haxhi Qamilit në trevën e Elbasanit, vështirësitë që ai kalon gjatë lëvizjes së Haxhi Qamilit dhe persekutimin e vëllezërve të tij.

Në këtë kapitull gjithashtu kemi trajtuar përfshirjen e tij dhe të Biçakçinjve të tjerë në jetën politike të Shqipërisë nga viti 1920 deri më 1940-ën. Kemi trajtuar përfshirjen e tij në politikë si mbështetës i grupit politik të Pleqësorëve, të udhëhequr nga Shefqet Vërlaci, ku i vëllai Hasani, zgjidhet deputet në zgjedhjet e vitit 1923 e më pas respektivisht në vitet 1925, 1928. Gjithashtu kemi trajtuar qëndrimin që Dervishi ka mbajtur në Levizjen e Qershorit të Fan Nolit, ku i vëllai i Dervishit dënohet me burgim si mbështetës i Ahmet Zogut. Dervishi emërohet gjithashtu si nënprefekt i Elbasanit më 1925 dhe më pas evidentohet përfshirja e tij në politikë në vitet 1932, 1937 si deputet në parlament duke u rreshtuar në grupimin politik të Pleqësorëve. Si deputet në legjislacionet e këtyre viteve, spikat përpjekja e Dervish Biçakut së bashku me përfaqësuesit e tjerë, për të vendosur shtetin ligjor duke qenë pjesëmarrës në miratimin e një sërë reformash, të cilat ishin shumë përparimtare për kohën. Ato lidheshin me fushën arsimore, të drejtat e njeriut dhe turizimin. Gjithashtu, Dervishi evidentohet nga hulumtimet si anëtar i asamblesë së krijuar në Shqipëri gjatë pushtimit gjerman, por që përmes dokumentacionit përkatës, nuk dëshmohet që të ketë patur veprimtari shumë aktive. Në përfundim të këtij kapitulli, për të kuptuar më mirë dhe për të vlerësuar rolin jo vetëm të Dervishit, por edhe të Biçakçinjve në vitet e Luftës së Dytë Botërore, kemi hulumtuar edhe ndikimin apo tërheqjen që mendohet të ketë patur prej programit të Ballit Kombëtar.

Ky studim është mbështetur në kërkimin dhe hulumtimin pranë Arkivës së Shtetit të dokumenteve të papublikuara më parë. Gjithashtu është hulumtuar në shtypin e kohës brenda dhe jashtë vendit qoftë ai lokal, apo kombëtar; janë shqyrtuar artikuj të ndryshëm, dokumente burimore dhe punime shkencore doktorale. Për shkak të specifikës që ka figura e Dervish beut,

punimi është mbështetur edhe në botime të realizuara nga historianë e diplomatë të huaj, të cilët në të shumtën e rasteve kanë qenë vetë pjesëmarrës në ngjarje kyçe të historisë sonë kombëtare. Siç e përmendëm dhe më lart, kontaktet e Dervish Biçakut me personalitete të tjera të kohës së tij, kanë qenë të shumta, prandaj pjesë e hulumtimit tonë janë fondi arkivor i Luigj Gurakuqit, Jani Vruhos, Shtjefën Gjeçovit, Aleksandër Xhuvanit, fondin e Koleksionit të shoqërive dhe klubeve shqiptare etj. Punimi merr në konsideratë edhe dokumentacionin e kancelarisë austro-hungareze, një pjesë të botuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike. Në studimin e kësaj figure, padyshim kam shfrytëzuar edhe studimet e profesorëve të nderuar elbasanas si: Roland Gjini, Kujtim Bevapi, Liman Varoshi, të cilët kanë shkruar artikuj studimorë shumë të vyer mbi ngjarjet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në fillim të shek. XX. Gjithashtu kemi marrë në konsideratë në këtë punim dhe një fond librash që lidhen me Historinë e Shqipërisë së kësaj periudhe si "Dokumente historike 1912-1918" nga fondi Lef Nosi. Gjithashtu është shfrytëzuar informacioni nga përmbledhje artikujsh të shtypit (vëllimi I-II "Mendimi politik e shoqëror i rilindjes kombëtare shqiptare" në vitet 1879-1910). Kemi gjetur edhe dokumente të tjera po të kësaj periudhe nga vëllimi I-II i "Syrja dhe Eqerem bej Vlora" botuar nga "Akademia e Studimeve Albanologjike". Gjithashtu, informacione të vjera janë marrë nga Bernd J. Fisher në librin "Mbreti Zog dhe përpjekjet për stabilitet në Shqipëri". Në përpilimin e këtij punimi, jemi mbështetur edhe në botimet me vlerë të akademikut Beqir Meta, studiuesit Gabriel Louis Jaray, Edwin Jacques, Joseph Swire e Nathalie Clayre. Vlen të përmendet punimi me shumë vlerë i profesorit Hysni Myzyri, "Shkolla Normale e Elbasanit 1909-1910". Burime jo më pak të rëndësishme cilësohen dhe të dhënat që na vijnë nga dokumentet e botuara në "Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj" si dhe shtypi periodik kombëtar i kësaj periudhe. Kështu mund të përmendim "Tomori", Elbasan (1910), "Bashkimi i Kombit" (1909), "Liria" (1908-1910), "La nazione Albanese", Catanzaro (1909), etj. Këto burime mbështeten në raporte konfidenciale të diplomatëve të huaj të hulumtuara këto, në botimet "Shqipëria në dokumentat austro-hungarezë", vëllimet II-VII. Parabola biografike e Dervish bej Biçakut, që ndërtohet si rezultat i shqyrtimeve të materialeve burimore nga fondi arkivor personal i tij, na jep mundësinë të dëshmojmë, mbështetur në fakte të pamohueshme, për atdhetarizmin e tij si dhe mohimin e qëllimshëm që i është bërë kontributit të tij dhe familjes së tij në Lëvizjen tonë Kombëtare. Spikat lufta e pakompromis që ai bëri për librin shqip, për shkollën kombëtare, përpjekjet e tij për një kishë kombëtare në mënyrë që të godiste ndërhyrjen dashakeqe të sinodit grek dhe patriarkanës së Stambollit, përfshirjen në Shpalljen e Pavarësisë dhe të gjithë kontributin në qeverinë e Vlorës (një tjetër aspekt që bie në sy gjatë shqyrtimit të materialeve mbi të cilat kemi punuar).

Në momentin që Dervishit (2012), është vendosur t'i jepet titulli “Qytetar Nderi i Elbasanit”, ka pasur një reagim për t'u rishikuar e ridimensionuar kjo figurë nga ata që shkruan historinë në Shqipëri në vitet 1945-1990, me pretendimin se ka mbështetur Esat pashë Toptanin (historianë dhe akademikë kanë konfirmuar tashmë qëndresën heroike që Esati ka bërë në mbrojtje të Shkodrës, që duke mos pasur municione dhe njerëz u detyrua të nënshkruajë aktin e kapitullimit) i cili është cilësuar tradhëtar. Po sipas këtyre zërave, Dervish Biçaku nuk e meritonte titullin, sepse ka mbështetur Ahmet Zogun, duke harruar kështu që ky i fundit, me gjithë anët problematike të veprimtarisë së tij, për herë të parë, vendosi në mënyrë të padiskutueshme shtetin e konsoliduar ligjor, vendosi stabilitetin aq të dëshiruar politik duke formësuar kështu administratën shtetërore si dhe ushqeui frymën e krenarisë kombëtare në Shqipëri gjë të cilën e konfirmoi me frymën e lartë të patriotizmit, kur nuk pranoi t'ia dorëzojë pushtetin Italisë.

Dervish Biçaku në mënyrë të pamohueshme luajti me të gjithë veprimtarinë e tij një rol shumë të rëndësishëm në ngjarjet e Elbasanit, por dhe të historisë sonë kombëtare në fund të shekullit XIX dhe në fillimin e shekullit XX. Ai padyshim mund të ketë problematikat e tij në qëndrimet që ka mbajtur në çështje të ndryshme, por ajo që vlen dhe nuk mund të mohohet dhe mund ta themi pa asnjë mëdyshje është që ai e deshi shumë qytetin e tij, që ishte mbështetës i flaktë i kishës kombëtare, mbështetës me shpirt i gjuhës shqipe dhe shkollës kombëtare, sepse siç ai vetë shkruan, ajo “asht gjallesa e vet kombit”. Dervish Biçaku, në gjithë veprimtarinë e tij gjatë 1912-ës, e shënoi emrin e tij, por edhe të Biçakçinjve në atë plejadë personalitetesh për të cilin çdo elbasanas dhe shqiptar do të ndihej krenar.

Hyrje

Dervish Biçakçiu (Biçakçiu)¹ lindi në Elbasan, më 1874. Ardhja e tij në jetë përkon me një periudhë trazirash për Ballkanin. Konflikti ruso-turk duket se do të trazonte ujërat dhe në territoret shqiptare. Në këtë kontekst edhe Elbasani do të ishte në vorbullën e ndryshimeve të fuqishme që do të trondisnin Ballkanin. Nëse Dervishi do të kishte lindur 100 vite më parë, sigurisht ai do të kishte qenë thjesht një nga sundimtarët e Elbasanit, por kushtet historike që kalonte Shqipëria teksa ai formohej, do ta shtynin që në moshë të re të lidhte fatin e tij me atë të qytetit dhe atdheut. Është i njohur tashmë fakti se viti 1878 shënon një kumt jo të mirë për Shqipërinë. Më 3 mars nënshkruhet traktati i Shën Stefanit, i cili i shkëput 80% të territoreve Perandorisë Osmane në Ballkan. Shqipërisë me të padrejtë vendosen t'i aneksohen territoret nga vendet sllave, Serbia dhe Mali i Zi. Sigurisht shqiptarët nuk do ta pranojnë këtë vendim dhe do të reagojnë duke krijuar Lidhjen e Prizrenit. Elbasani nuk do të bëjë përjashtim nga ky mobilizim mbarëkombëtar, por do të bashkohet në luftë për mbrojtjen e territoreve. Ndër figurat elbasanase që do të dallohen në këto momente kyçe do të ishin: Ismail bej Verlaci, Shazivar bej Karaosmani dhe Jusuf bej Biçakçiu, ky i fundit, i ati i Dervish bej Biçakçiut. Biçakçinjtë ishin një nga familjet më të mëdha të Elbasanit, që e kanë dominuar atë nga shekulli XV deri në gjysmën e parë të shekullit XX.

Sipas dëshmisë së Hedije Biçakçiut, vajza e Qamil Biçakçiut, familja posedon pemën gjenealogjike të familjes së Biçakçinjve. Sipas dëshmisë së saj, pema është regjistruar nga një tjetër pinjoll i familjes, nga Ibrahim Biçakçiu. Familja e Biçakçinjve, është një familje e madhe që e ka prejardhjen e saj të dokumentuar që nga fillimi i shek. XV siç e përmendëm edhe më lart. Kanë qenë në vazhdimësi të angazhuar në jetën politike e ekonomike të vendit deri në gjysmën e parë të shek. XX. Kontributi i familjes së Biçakçinjve ka qenë i madh si në lidhje me Perandorinë Osmane, ashtu edhe më pas në qytetin e Elbasanit. Anëtarë të kësaj familjeje kanë pasur tituj, grada dhe ofiqe të larta, gjë që e ka bërë një familje me emër në strukturat e larta të asaj kohe.

I pari që njihet është *Sinan pashë Biçakçiu*² (1400 – 1470) me postin e gjeneralit të Sulltan Muratit II (1412 – 1421) dhe Sulltan Mehmetit II (1421 – 1480). Për arsye të kohës, jo të gjitha të dhënat janë të ruajtura; ka edhe mungesa. Më pas njihet *Sinan bej Biçakçiu* (1430) i njohur gjithashtu si ushtarak me emër, kryekomandant dhe gjeneral dhe i njohur për

¹Mbiemri që hasim më së shumti në dokumente është Biçakçiu, prandaj kemi vendosur ta shkruajmë të tillë.

²*Elbasani Enciklopedi*, Elbasan: Botimet Sejko 2002, f.58. Të dhënat mbi origjinën Biçakçinjve janë marrë këtu.

drejtimin e fushatës ushtarake në pushtimin e Selanikut e më pas të Janinës. Njihet edhe një tjetër *Sinan pashë Biçakçiu* (1453) si mësues privat i Sulltan Mehmetit II dhe më pas bëhet vezir dhe këshilltar i afërt i tij. Njihet për natyrën protestuese, pasi burgoset e lirohet në protestat e Ulemasë. Sulltan Bajaziti e sjell në Adrianopojë dhe dihet se vdes në Stamboll, por jo viti i saktë i vdekjes. Njohuritë dhe angazhimet ushtarake, kanë qenë në vazhdimësi si interesa të familjes dhe vazhdon kjo gjë si traditë edhe më pas te një tjetër pinjoll i njohur i familjes, *Ahmet aga Biçakçiu* (1486 – 1548) si komandant ushtrie që u angazhua kryesisht në luftërat për pushtimin e Egjiptit dhe Arabisë.

Sinan pashë Biçakçiu (1506 – 1696) përmes pozicioneve që ka patur (herë si oficer pallati e më pas guvernator apo komandant flote etj.) ka më tepër të dhëna rreth jetës së tij se sa parardhësit e tjerë. Pozicioni i tij më i lartë ka qenë kryevezir. Ka drejtuar ekspeditat në Hungari e Serbi dhe në moshën 90 vjeçare ndërron jetë e varroset në lagjen Sedefçiler, në Stamboll. Disi ndryshe në profesion vjen *Sedefqar Mehmet Biçakçiu* (1570 – 1622), si kryearkitekt i perandorisë për të vijuar me *Muhamet aga Biçakçiun* (1572 – 1629) edhe ai arkitekt që ndërtoi ujësjellës në Elbasan më 1610. U vra nga Sulltan Murati IV, në kryengritjen e jeniçerëve, në vitin 1629. Po ashtu në luftë vritet edhe *Ibrahim pashë Biçakçiu* (1587-1632) vezir i Brusës. Në vitin 1627 përmendet një trashëgimtar me emrin Mehmet aga Biçakçiu i cili pas rebelimit ushtarak ndaj sulltanit ky i fundit kërkon ekzekutimin e tij. Fermani është gjetur në fondin e familjes së Dervish Biçakçiut.³

³Bëhet fjalë për një Ferman të vitit 1627, i ruajtur në arkivin privat të familjes të Dervish bej Biçakçiut në Elbasan, publikuar në librin “Ndihmese për historinë e sundimit turk në Shqipëri” të Eqrem Bej Vlorës dhe Baronesses Marie Von Godin.

Sulltani kerkonte kokën e Mehmet Biçakçiut nga Elbasani, pas rebelimit ushruar kundër tij dhe dënimit të mbështetësve të tij. Ja teksti i Fermanit mbërritur në Elbasan drejtuar pushtetarëve vendorë të Elbasanit : “O ti më i larti i emirëve të mi të ndritur, më i zgjedhuri ndër të mëdhenjtë e perandorisë sime, mbartës i vetive më të pëlqyeshme për mua, mjeshtër i ligjëtimeve të shkëlqyeshme, Sanxhakbeu im i fuqishëm dhe besnik i Elbasanit Ali, që Allahu i plotëfuqishëm ta shtoftë lavdinë, t’i plotësoftë dëshirat, të ruajtë pushtetin, dhe ju, krerët më të shquar, ju, kadilerët e sanxhakut tim të Elbasanit, zoti ua ruajtë dijet dhe emrin, dhe ju, dijetarët e drejtësisë dhe të urtët, që zoti ua ruajtë virtytet, dhe ju, te nderuarit e popullit, ju agallaret dhe jeniçerët e mi besnikë, dhe ju kështjellarë dhe mbrojtës të kështjellave të mija, që Zoti ua shtoftë zellin dhe vëmendjen: kur kjo letër e shkruar me dorën time të lartë të arrijë tek ju, mësoni se me një ferman të mëparshëm perandorak, u kisha urdhëruar ta quanit si detyrën tuaj më të rëndësishme asgjësimin përfundimtar të të tradhëtarit të Zotit dhe perandorisë , Mehmet Biçakoglu, që shpirti i tij i qelbur të dëbohej sa më shpejt nga kjo jetë dhe trupi i tij të zhdukej nga kjo tokë. Por për ta sabotuar këtë urdhër tim të pakundërshtueshëm, përreth tradhëtarit u mbledhën dhe guxuan të thonë se fermani im i shenjtë nuk ishte i vërtetë, por i rremë. Këta gënjeshtarë dinakë dhe rebelë janë Sulejman Bejzade (bir i beut), Ahmet Shishko (trashalوقي), Ibrahim Solomonzade (i biri i Solomonit, hebre i kthyer),

Ushtarakë të lartë kanë qenë edhe *Halil pashë Biçakçiu* (1690 – 1775) i cili mori arsimin ushtarak. U dallua në disa detyra në Bagdad, ndërsa gjatë luftës me Austrinë u mor me ndërtimin e kalasë së Nishit. Për meritat e tij në fushën ushtarake, në vitin 1717 Sulltani e dekretoi atë kryeministër. Në këtë detyrë qendroi 13 muaj. Më vonë ai ka shërbyer si prefekt në Selanik. Sipas dëshmisë, Halili pashë Biçakçiu ka patur një vëlla të quajtur *Sinan agë Biçakçiu* (1692 – 1760). Një nga pinjollët e tjerë është *Mahmut bej I Biçakçiu* (1709 – 1744) i cili ka drejtuar betejën për pushtimin e Beogradit ku edhe ka humbur jetën në betejë.

Ibrahim Halil pashë Biçakçiu (1715 – 1770) ka qenë disa herë vezir i perandorisë, me kulturë të gjerë e njohës i disa gjuhëve të huaja e për t'u evidentuar është fakti që kohën më të madhe e kalonte me poetë, muzikantë e duke lexuar divane persisht.

Sulejman pashë I Biçakçiu (1720-1794) njihet si sundimtari Elbasanit i cili pati tre fëmijë, njëri prej të cilëve Ibrahim, u martua me motrën e Karamahmut pashë Bushatit. Ndryshe nga profili i të tjerëve parardhës, është *Sefedin bej Biçakçiu* (1793 – 1865) i cili ndërtoi dy kisha të krishtera në qytet dhe komandoi ushtrinë me Mustafa pashë Bushatin në luftën ruso-turke 1828-1829. Këtë periudhë kemi *Dervish bej I Biçakçiun* (1820 – 1885), sundimtar i Elbasanit, martuar me mbesën e Mustafa pashë Bushatit për të vijuar me *Mustafa pashë III Biçakçiu* (1860 – 1926) pushtetar në administratën turke. *Mahmut Biçakçiu* (1835-1898), atdhetar, kreu studimet e larta për mjekësi në Stamboll. Më 1873 u emërua kajmekan. Në këtë detyrë shërbeu në Mat, Kërçovë, Podgoricë dhe Elbasan. Ka bashkëpunuar gjatë vitit 1878 me Abdyl Frashërin. Ka dhënë ndihmesë në hapjen e shkollës së parë në gjuhën shqipe.

Hysen dhe Kurt imami dhe shokët e tyre. Për tu dhënë fund njëherë e mirë të gjitha sajimeve të këtyre tradhëtarëve dhe yshtësve, po ju dërgoj këtë letër të dytë dhe urdhëroj : pa humbur kohë duke u menduar gjatë dhe pa lejuar tu trembin me llafe të kota t'i kapni nxitësit e trazirave të kësaj lëvizje kriminale dhe t'i varni menjëherë si shembull tmerrues për të gjithë njerëzit e tjerë të pabindur. Ndërsa për të arrestuar tradhëtarin e gjithë këtyre trubullirave, Mehmet Biçakoglu dhe për ta sjellë atë në oborrin tim të ndritur, kam ngarkuar dhe derguar tek ju kapuxhibashin, (oficer i gardes se pallatit), Hysenin- i denjë për të gjitha nderet dhe për besimin tuajtë plotë , që zoti ia shpërbleftë mundimin,- dhe ai do të jetë zbatuesi i vullnetit tim të lartë. Sapo vullneti im i ndritur të bëhet i ditur, urdhëroj : t'i mëkëmbësi im, ju paria e vendit, ju dijetarë të ligjit, mbledhni ushtarët dhe popullin dhe kapni dhe varni ata që guxuan e thanë se Fermani im i parë ishte i rremë. Urdhëroj që me gjithë mjetet që keni ta kapni tradhëtarin Biçakoglu dhe t'ia dorëzoni kapuxhibashit tim.....Sepse dijeni : po vepruat ndryshe, u betohem mbi shpirtin e shejtë të të parëve të mi të ndritur se do tua pres kokat të gjithëve. Dhe mos kërkonti pastaj mëshirë. Asnjë pendim i mëvonshëm nuk do të pranohet. Ju të gjithë e keni për detyrë t'i kapni nxitësit e këtyre trazirave , tua dorëzoni shpatës së drejtësisë që ata të varen në sheshet e lagjeve tuaja. Ndërsa Biçakoglun duhet t'ia dorëzoni Portës time të Lartë, që të marrë vendimin e merituar. Ky është vullneti im i lartë që përmban ky ferman perandorak të cili duhet t'i jepni besim të plotë dhe të bëni ashtu siç thotë ai. i lëshuar në pallatin tim të lumturisë.

Ishte i ati i Aqif pashë Biçakçiut. Figura e Aqif pashës (1860 – 1926) është më e njohura në këtë familje, për gjithë kontributin që ai ka dhënë në lëvizjen para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë. Ai ka qenë kryetar i klubit “Bashkimi”. Ka marrë pjesë në Kongresin e Dibrës në korrik të vitit 1909 si dhe në Kongresin e Elbasanit në shtator 1909. Ka qenë një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Ismail Qemalit. Ngriti flamurin në Elbasan me 25 nëntor të 1912. Aqifi pashë Biçakçiu ka qenë ministër i brendshëm në qeverinë e V.Vidit. Më 1920 mori pjesë në Kongresin e Lushnjes në të cilin u zgjodh kryetar. Aqifi kishte këto fëmijë: Ibrahimin, Nigjarin dhe Sadetin. *Ibrahim Biçakçiu* (1905-1977) ishte shkolluar në Austri, më 1937 zgjidhet deputet i Elbasanit. Pas kapitullimit të Italisë, zgjidhet si kryetari i komitetit ekzekutiv të përkohshëm nga Gjermanët. Më 1943 në kushtet e luftës, ai zgjidhet deputet i Elbasanit në Kuvendin Kombëtar. Më 6 shtator 1944 pranon të bëhet kryeminister. *Jusuf bej Biçakçiu* (1854 – 1919) ishte i martuar me hallën e Ahmet Zogu I, Hedijen me të cilën pati 9 fëmijë: Ruhijen, Sejrijen, Hafifien, Nejrenë, Nadirenë, Dervishin, Hasanin dhe Qamilin. Nga gjithë ky brez njerëzit të përgatitur e me tituj të lartë vjen edhe *Dervish bej II Biçakçiu* (1874 – 1952), i biri i Jusufit dhe Hedijes, i cili ka patur 8 fëmijë. Ishte patriot dhe veprimtar i lëvizjes kombëtare⁴.

Elbasani i fundit të shekullit XIX, ashtu si pjesa tjetër e Shqipërisë, gjendet i përfshirë nga ajo që njihet si lëvizja më e madhe kombëtare, pra Rilindja, duke mbështetur me të gjitha mundësitë kërkesat dhe detyrat themelore të saj siç ishin:

1. sigurimi i autonomisë,
2. bashkimi i katër vilajeteve në një vilajet të vetëm,
3. sigurimi i gjuhës shqipe si dhe
4. përdorimi i një pjese të taksave për punime botore në Shqipëri.

Rilindasit, që në fillimet e lëvizjes e vunë theksin kryesor tek zhvillimi i gjuhës dhe shkollës shqipe, si mbartëse dhe forcuese të identitetit kombëtar, pa të cilin nuk mund të arrihej bashkimi kombëtar. Periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare përfaqëson një faqe të re të historisë sonë. Ajo ishte një lëvizje e fuqishme politike, shoqërore dhe kulturore mbarëkombëtare, e mbështetur në iluminizmin evropian dhe në përpjekjet vendore gjatë shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX për identitet kombëtar, mëvetësi e përparim. Elbasani u bë një vatër e nxehtë e luftës për emancipimin shoqëror, politik e kulturor. I përfshirë si i gjithë vendi në lëvizjen e madhe të Rilindjes, Elbasani dha një kontribut të vyer në procesin e formimit të vetëdijes kombëtare të diturisë, arsimit dhe të ideve kombëtare që ishin shkrirë

⁴*Elbasani Enciklopedi*, Elbasan: Botimet Sejko 2002, f.59.

tashmë në një lëvizje të fuqishme, e cila çoi më 1912 në shpalljen e pavarësisë së vendit. Ka qenë mjedisi intelektual i qytetit të Elbasanit, rrjedhojë e një akumulimi dhe kultivimi shumëvjeçar, që mbështeti fuqishëm lëvizjen arsimore-kulturore në qytetin tonë. Një dëshmi autentike që pasqyron dhe dëshmon për mjedisin psikosocial dhe intelektual të Elbasanit, janë shënimet e Edit Durhamit, ku mes të tjerash thekson: *“Në Elbasan prekesh nga përpjekjet që bëhen për dije e kulturë. Gjen njerëz që pa kurrfarë ndihme japin e marrin me gramatikën frënge e madje dhe gjermane. Ka një numër mjaft të madh njerëzish të shkolluar dhe të ditur... Në Elbasan s’ka vetëm fjalë... Elbasani ëndërron për një të ardhme të ndritur, dhe vetë pozita e tij në qendër të vendit do të ishte ideale përkryeqytet...”*⁵ Po kështu Elvia Çelebia, figurë e njohur e botës arabe e përcakton Elbasanin si *“djepi i shumë dijetarëve, poetëve dhe komponentëve”*⁶. Duke u nisur nga këto fakte, dalim në përfundimin se këta dijetarë janë shkolluar në një mjedis me traditë në arsim e kulturë, në qytetin e lindjes, Elbasanin.

Figurat e shquara të Elbasanit dhe pjesa intelektuale e klerit të qytetit, futën në shkolla mendimet dhe idetë progresiste që erdhën duke u shtuar në këtë qytet. Kështu në vitin 1738, u ngrit një shkollë greke e cila mori emrin dhe njihej si “Shkolla e Kalasë”. Në gjysmën e parë të shek. XVII Anonimi i Elbasanit, çeli serinë e alfabeve origjinale. Ai përmban disa fragmente ungjijsh dhe një predikim të lirë të ritit ortodoks, i cili shkruhet me një fjalor origjinal, më i vjetri i njohur për Shqipërinë⁷. Gjuha e tij e pasur dhe e punuar, dëshmon se ai nuk kishte punuar në një terren të palëvruar më parë. Alfabeti i Dhaskal Todrit që u përdor gjerësisht në Elbasan, Berat e Kavajë, përpjekjet e tij, për të ngritur një shtypshkronjë, përkthimet e letërsisë fetare po nga Anonimi e Todri në gjuhën shqipe, dëshmojnë për një traditë të arsimit. Një nga rilindësit e shquar, që jeta dhe vepra e të cilit hyri në gojëdhënë e popullit, ishte Kostandin Kristoforidhi Elbasanasi, i cili ishte jo vetëm gjuhëtari më me autoritet i shek. XIX, por edhe ai që ngriti lart dinjitetin e gjuhës shqipe. Ai ngriti “Shkollat shëtitëse” dhe me trastën e abetareve në krahë, shtegtoi në çdo skaj të vendit që t’u mësonte bashkatdhetarëve gjuhën shqipe⁸. Në fillim të shek. XIX, arsimi shqip publik ishte i ndaluar nga turqit. Duke propaganduar parimin se “fe e kombësi (din e iman) janë një”, ata lejonin për të krishterët të hapeshin shkolla greke (dhe vllahe në Shën Koll), kurse për myslimanët duhet të frekuentonin shkollat mejtepet turke.

⁵ Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*, Tiranë: 8 Nëntori, 1991, f. 81.

⁶ Rudolf Deliana, *Shkollat në Elbasan deri në 1012*, në *Gjuha dhe shkolla shqipe në vite*, Elbasan: 2002, Silver, f.79.

⁷ *Elbasani –Enciklopedi*,” Në Panteon drejt Panteonit 2000”, Elbasan: 2000, Sejko, f. 16.

⁸ Kujtim Bevapi, *Tradita kulturore dhe arsimore e Elbasanit deri në shpalljen e Pavarësisë në “Normalja në Traditë”*, Elbasan, 1995, f.13.

Në gjysmën e dytë të shek. XIX në Elbasan funksiononin këto lloj shkollash:

1- Shkollat turke (sipas të dhënave duket se janë hapur e kanë funksionuar vetëm në Elbasan). Këto ishin 2 lloje: shtetërore dhe private. Si të parat dhe të dytat kishin këtë renditje:

- Shkollat ibdajete, të barasvlerëshme me ciklin e ulët të sotëm të shkollës 8-vjeçare. Ato kishin një klasë përgatitore që formohej nga harriçet dhe tre kasa të tjera.
- Shkollat ruzhdije, që ishin shkolla qytetëse të përbëra nga tri klasa. Ato ndiqeshin nga nxënës që kishin mbaruar ibtidaitet dhe ishin të barasvlerëshme me ciklin e lartë të sotëm të shkollës 8-vjeçare. Kush përfundonte shkollën ruzhdije, mund të vazhdonte gjimnazin e Manastirit.
- Shkollat idadije që zëvendësuan shkollat ruzhdije, ishin një lloj gjimnazi i ulët me tri klasa.

2 - Shkollat greke e rumune.

Në lagjen “Kala” funksiononte një shkollë greke dhe në lagjen “Shën Koll” një shkollë rumune, ku jetonte një komunitet ortodoks.⁹

Si shkollat greke ashtu edhe ato turke në Elbasan shfrytëzoheshin prej patriotëve elbasanas, pa dallim feje, për të mësuar fshehtas gjuhën shqipe amtare, me gjithë përpjekjet që duhet të përballnin ato nga ana e autoriteteve turke, nga ana e Patriarkanës kishtare greke dhe agjentëve të tyre. Në disa prej këtyre shkollave fillore sikurse thamë, mësohej fshehtas gjuha shqipe; mbasi mbaronte mësimi i rregullt, aty jepnin mësim shqip Fejz Guranjaku me të vëllanë e tij Arif Guranjakun, Xhaferr Dedej e Ibrahim Guma, Hasan Dervishhasani, Hasan Mezja, Hasip Filipi, Hysen Ceka, Fetah Ceka etj.¹⁰

Çelja zyrtarisht e së parës shkollë shqipe, më 7 mars 1887, i dha hov të mëtejshëm zhvillimit të arsimit të shkollës shqipe. Rreth vitit 1890 Abdyl Abdulla Xhinsi që kishte mbaruar Normalen në Stamboll, hapi një shkollë fillore turke në qytet ku kryhej edhe mësimi në gjuhën shqipe¹¹. Po këtë vit patrioti elbasanas Llosh Papajani e kishte shndërruar depon e tij në një çerdhe, ku mësohej shkrim e këndim në gjuhën amtare. Dyqani i elbasanasit Osman Berberi, që populli e pagëzoi me emrin Muç Shqiptari, ishte kthyer në një librari ilegale të librave shqip. Sa herë që do të kthehej Muçi prej udhëtimit nga Manastiri e Selaniku, atdhetarët e Elbasanit e pritnin me gëzim të madh, sepse e dinin të gjithë që Muçi do të sillte

⁹ Këto të dhëna janë marrë nga Rudolf Deliana në *Shkolla dhe gjuha shqipe në vite*, Elbasan: Silver, 2002, f.80-84.

¹⁰ Arkivi i Muzeut të Elbasanit,(më tej A.M .E.),Shyqyri Demiri, *Gjendja politike-arsimore e zonës së Elbasanit gjatë shek. XVIII-1912*, F .3, D. 6.

¹¹ Kujtim Bevapi, *Hulumtime albanologjike*, Sejko, 2005, f. 49.

me vete libra e gazeta shqip, si dhe lajme të sakta mbi gjendjen e çështjes kombëtare¹². Meraku i madh që kishte Muçi për të përhapur mësimin e gjuhës amtare dhe guximi i tij në përkrahjen e çështjes kombëtare, u bënë shkak që populli i tij ta quante Muç Shqiptari.

Patrioti Tushi i Pinës (Dhimitër Pina), me të mbaruar mësimet në gjuhën greke, predikonte shumë për gjuhën shqipe dhe i mësonte fshehurazi abetaren nxënësve, te të cilët kishte besim¹³. Nuk ishte e rastësishme që në Elbasan përfaqësues të shtresave të ndryshme në hapësira kohore të ndryshme kontribuan për gjuhën shqipe.

Tabani kulturor u shtresëzua pak nga pak me:

- Mendjen e ndritur të Dhaskal Todrit i cili konsiderohet lëvrues i gjuhës shqipe, por edhe paraardhës i Rilindjes Kombëtare;
- Kostandin Kristoforidhin i cili duke hulumtuar gjuhën e folur të popullit e çmonte atë si nje thesar të gjuhës shqipe;
- Luftën dhe mbështetjen financiare të bejlerëve të Elbasanit: Dervish Biçakçiut, Shefqet Vërlacit, Qemal Karaosmanit, Aqif Pashë Biçakçiut;
- Dijen dhe kulturën e qindra elbasanasve dhe jo vetëm që me zërin e tyre vunë në shërbim të shkollës shqipe gjithçka kishin mundësi. Kjo përpjekje për zhvillimin e shkollës shqipe do të ishte shumë e vështirë, po të kemi parasysh qëndrimin negativ të Portës së Lartë si dhe shteteve fqinje. Mënyrat dhe rrugët për të siguruar mësimin e saj do të jenë të ndryshme. Shqiptarët do të përpiqen të shfrytëzojnë edhe hapësirat ligjore që lejonte Porta e Lartë për ta siguruar atë.

Vlen të përmendim se pjesë e lëvizjeve politike por jo vetëm, për kishën dhe shkollën shqipe në Shqipërinë e mesme në fund të shek XIX, ishte dhe Lëvizja Uniatiste. Që nga 1890-ta i ati i Dervishit, Jusufi, kishte ndihmuar dhe mbështetur këtë lëvizje. Lëvizja Uniatiste kishte përfshirë zonën e Shpatit dhe synonte që nëpërmjet kthimit nga ortodoksë në katolikë, banorët të siguronin më shumë të drejta. Lëvizja u bë e fuqishme sidomos në vitet 90 të shekullit XIX, ku siguron edhe mbështetjen e familjes Biçakçiu. Aq e fuqishme do të jetë lëvizja, sa do të shkaktojë përplasjen edhe të diplomacive të huaja greke, rusë, italiane, austriake dhe vetë Portës së Lartë. Kjo lëvizje do të trajtohet gjërësisht në kapitullin e parë.

¹² Mynever Zaimi, *Sagë strategësh*, Gervis, 2009, f.11.

¹³ Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Tiranë:1978, 8 Nëntori, f. 135.

Larg Shqipërisë ai ndjek studimet në kolegjin francez ¹⁴ në Gallatasaraj, ku pa dyshim, duke jetuar në zemrën e Perandorisë Osmane, Stambollin, kuptonte shtypjen që i bëhej atdheut të tij. Formimi intelektual i marrë këtu, formësoi një djalosh me ideale të përcaktuara qartë që kuptonte se vetëm librat¹⁵, mund ta çonin shoqërinë shqiptare përpara. Në vitet 1896-1897 ai ka lëvizur në një trekëndësh, midis Stambollit, Bukureshtit dhe Elbasanit, gjë që i ka dhënë mundësinë të jetë në kontakt me përfaqësuesit kryesorë të Rilindjes Kombëtare.

Në prill të 1896-ës Faik Konica shkruante: *“S’kam dyshim që me një atdhetarë të njehtë si ju, dhe me atdhetarë të tjerë, Elbasani ka për të loxur një lodër të madhe.”*¹⁶ Me sa duket Konica kishte nuhatur tek djaloshi Dervish, shpirtin e njeriut që i dhimbsej atdheu dhe vlerësonte se me mendje të tilla Elbasani pa dyshim do të ishte një nga epiqendrat e lëvizjes kombëtare ashtu si koha dëshmoi dhe Konica nuk gaboi aspak në parashikimin e tij. Sipas të dhënave burimore, Dervish Biçakçiu ka qenë një ndër ata që kanë dhënë kontributin më të madh në ngjarjet e viteve 1896-1912. Për këtë arsye, duke u ballafaquar në këtë punim me një figurë ende kontroverse, nuk mund të mos vëmë re se ndryshe nga sa është shkruar nga historia “zyrtare” për të, në shumë dokumente, botime, shkrime të ndryshme nga studiues të ndryshëm për Dervishin, është parë vetëm njëra anë e medaljes duke iu mohuar atij ashtu si në fakt do të ndodhte me shumë të tjerë, të gjitha përpjekjet që ai kishte bërë për të kundërshtuar administratën e Portës së Lartë në forma të ndryshme në të cilën ai do të përfshihet për kishën dhe gjuhën shqipe në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Dokumentet dhe dëshmitë na shpalosin personalitetin e tij e ndikimin që ka patur ai në lëvizjen kombëtare sidomos të ngjarjeve të mëdha të fillimit të shekullit XX. Ka mbështetur jo vetëm lëvizjet më përparimtare e të rëndësishme të kohës, por ka kontribuar financiarisht për zhvillimin e kulturës, gjuhës dhe shkollës shqipe. Konkretisht ai ka kontribuar në financimin e gazetës “Albania” të Faik Konicës, gazetës “Besa” të Mehmet H. Frashërit; ka një kontribut të gjithanshëm në klubin “Vllaznia”, është pjesëmarrës në ngjarje të rëndësishme të Historisë së Shqipërisë si: Kongresi i Dibrës. Ai ka organizuar dhe ka qënë një nga pjesëmarrësit kryesorë në Kongresin e Elbasanit, ka kontribuar në ngritjen dhe mbarëvajtjen e shkollës Normale; gjatë gjithë vitit 1909-1910, çdo “zëdhënje” e Këshillit Mbikqyrës të Normales dhe e pasqyruar në shtypin e kohës, mban firmën e Dervish Biçakçiu. Ai dhe familja është persekutuar gjatë terrorit turk të viteve 1910-1911, duke u

¹⁴ Kolegji në fjalë konsiderohej dritarja e Stambollit drejt perëndimit.

¹⁵ Në letërkëmbimet e Dervish Biçakçiu shprehimisht do gjejmë të përdorur fjalën vivllat.

¹⁶ AQSH. Fondi Dervish Biçakçiu nr. 69, D. 5, fl. 29-30.

detyruar të emigrojnë jashtë Shqipërisë dhe ku i vëllai i vogël Qamili, burgoset dhe internohet në Selanik.

Gjithashtu sarajet e tij i hapën dyert dhe u kthyen në vendqendrimi për patriotë të ndryshëm gjatë muajit Nëntor 1912. Ai ka kontribuar në organizimin e qeverisë së Vlorës dhe e mbështeti atë në muajt e parë të saj. Ka qënë një nga organizatorët e shpalljes së Pavarësisë në Peqin, qytet nga i cili mori dhe përfaqësimin në kuvendin e Vlorës.¹⁷

¹⁷ Mehmet Frasheri ishte më i vogli i vëllezërve Frashëri.

KAPITULLI . I

VEPRIMTARIA E BIÇAKÇINJVE NE KUADRIN E LËVIZJES KOMBËTARE

FUNDI SHEK.XIX - FILLIMI SHEK.XX

1.1 Jetëshkrim i shkurtër për Dervish Biçakun

Më 1874 në Elbasan, në familjen e Jusuf dhe Hedije Biçakçiut lindi fëmija i gjashtë i çiftit, djali me emrin Dervish. Jusufi ndoshta ka menduar ta pagëzonte të birin me këtë emër nga vlerat që përçon feja e tyre bektashiane, atë të dashurisë universale dhe të shërbimit ndaj njerëzve. Dervishi ishte djali i parë pas pesë motrave; Ruhije, Sejrije, Hafife, Najren dhe Nadiren dhe kuptohet vëmendja për të do të ishte maksimale. Ai kishte dhe dy vëllezër Hasanin dhe Qamilin. Dervishi, mësimet e para i mori në Elbasan në shkollën fillore turke. Dëshmohej se që i vogël fliste shumë mirë osmanishten. Nga dokumentet e shumta vërtetohet që Dervishi përdorte shumë mirë në të shkruar edhe gjuhën frënge, që evidentohet në korrespondencën që ai ka mbajtur me shumë atdhetarë shqiptarë, ku shquhen një numër i madh letrash që ai ka këmbyer veçanërisht edhe me Faik Konicën.

Të dhëna për jetën e Dervish bej Biçakçiut, jepen nga një trashëgimtare e tij, vajza e djalit të tij, Vasfiut¹⁸, Elona Biçakçiu Ziso. Sikurse dëshmon edhe mbesa e tij¹⁹, gjyshi i saj, Dervishi, kishte studiuar në Stamboll. Ai kishte patur në klasë djalin e mbretit të Sirisë. Nga një kërkim del që mund të jetë shkolluar konkretisht në Gallata Saraj, në kolegjin Perandorak Francez²⁰. Të njëjtin kolegji më vonë e ka vazhduar edhe Ahmet Zogu dhe Faik Konica.

Nëna e Dervishit siç e kemi shpjeguar ishte halla e Ahmet Zogollit²¹, (mbretit të ardhshëm të Shqiptarëve). Fisi i Zogollëve, ishte një nga më të njohurit në zonën e Matit, por nga ana tjetër vetë ato ishin lidhur në marrëdhënie krushqie me një tjetër derë të madhe në Shqipërinë e Mesme, me Toptanët. Nëna e Ahmet Zogut, ishte motra e feudalit më të

¹⁸Futbollistit i Kombëtares në fillim të viteve 50' të shekullit XX

¹⁹Gazeta Panorama, Tiranë më 19 Nëntor 2012.

²⁰Në këtë kolegji, periudha e arsimimit do të ishte pesë vjet. Gjuha dhe letërsia turke, frengjishtja, latinishtja, historia osmane, historia e përgjithshme, gjeografia osmane, gjeografia e përgjithshme, matematika, kozmografia, mekanika, fizika, kimia, njohuritë natyrore, drejtësia dhe kurse të tilla si kaligrafia dhe vizatimi, kontabiliteti, mbajtja e librave do të mësoheshin atje. Greqishtja dhe armenishtja nuk do të përfshiheshin në klasat e përgjithshme, por këto gjuhë do të mësoheshin nëse studentët dëshironin. Meqenëse çdo nxënës ishte i detyruar të përmbushte ritet dhe adhurimin e fesë dhe sektit të cilit ata i përkisnin, studentët myslimanë do të ndiqnin xhaminë e po kështu, studentët jomyslimanë do të dërgoheshin në tempujt që i përkisnin. 600 studentë, gjysma myslimanë dhe gjysma jomyslimanë, do të pranoheshin në shkollë çdo vit. Ky informacion është marrë nga eëbsite <https://islamansiklopedisi.org.tr/galatasaray-mekteb-i-sultanisi>

²¹Gazeta "Panorama", Tiranë, më 19 Nëntor 2012.

fuqishëm të Shqipërisë së Mesme Esat pashë Toptani. Origjina e saj ishte nga Burgajeti i Matit. Pikërisht gruaja e parë e Dervishit, do të vijë nga fejesa e shpallur me motrën e Murat Toptanit. Faktikisht, Dervishi ka patur më shumë se një grua, kjo jo si zgjedhje e tij, por i detyruar nga rrethanat e krijuara²². Fillimish, ndërsa fejesa e tij ishte bërë, xhaxhai i Dervishit ndërroi jetë papritur dhe sipas traditës së kohës, gruaja me fëmijët duhet t'i mbeteshin njërit prej djemve të shtëpisë, në këtë rast, Dervishit. Mendojmë se, këtu i ka fillimet edhe konflikti me familjen e Aqif Biçakçiut dhe më së shumti, kjo kishte ardhur për shkak të pasurisë që zotëronte gruaja e ve e xhaxhait të tij, pra ajo që do të bëhej gruaja e Dervishit.

Ndërkohë, kur ndodhi martesja e Dervishit me gruan e xhaxhait të tij, motra e Murat Toptanit pra e fejuara e Dervishit, Bejxheja, jetonte në Turqi. Ajo nuk e dinte që burri i saj i ardhshëm ishte martuar tashmë me një grua tjetër. Sipas asaj që rrëfen e mbesa e Dervishit, Bejxheja edhe pse ishte një grua e emancipuar për kohën, e shkolluar në një kolegji francez në Stamboll, i pranoi kushtet e jetës me Dervishin. Vetëm kur u kthye në Elbasan, mori vesh se Dervishi ishte martuar me gruan e xhaxhait të tij. Meqënëse ishte shpallur fejesa, respektoi vendimin e Dervishit dhe u bë gruaja e tij e dytë. Interesante sipas Ilona Biçakçiut është që, Bejxheja ditën e dasmës thirri njërën nga shoqërueset e saj dhe e ndërroi fustanin e bardhë dhe në vend të tij veshi një fustan të zi. Kur Dervishi e pyeti se pse ishte veshur ashtu, ajo i ishte përgjigjur se nuk kishte burrë, dhe se burri i saj kishte vdekur. Megjithatë, në martesën e tyre ata patën një djalë, i cili vdiq në moshën 10-vjeçare. Rreth 10 vite pas vdekjes të së birit, Dervishi u martua sërish. Nusja e fundit e tij quhej Naxhije dhe ishte vetëm 15 vjeçe, ndërsa ai kishte kaluar të dyzetat²³. Interesant është në fakt një shprehje e Dervishit përse i përket grave që ai kishte. Kjo shprehje na vjen përmes kujtimeve të një diplomati francez Justin Godart i cili citon Dervishin të jetë shprehur për tri gratë e tij: *“Gruaja e parë është një lule në kokë, gruaja e dytë është një halë në sy, ndërsa gruaja e tretë është dreqi vetë. Sapo mbaroi shpotinë Arkimandriti (Visarion Xhuvani) e pyeti: po gruaja e katërt? Dervish beu u kap në befasi, por e gjeti shpejt përgjigjen: Ajo bashkohet me të tre të tjerat për të mbajtur arkivolin e burrit”*²⁴.

Pavarësisht se kishte tri gra, sipas informacionit të mbesës së Dervishit, ai kishte një autoritet të madh në familje. Ai kishte krijuar një frymë të ekuilibruar familjare dhe kjo dukej në marrëdhëniet e mira që nusja e tij e tretë Naxhija kishte me Bejxhenë. Për më tepër, që Bejxheja ishte marrë vetë me shkollimin e Naxhijes, e cila ishte shumë e re kur erdhi si grua e

²²Gazeta” Panorama”, Tiranë, më 19 Nëntor 2012.

²³Justin Godart, *Shqipëria në vitin 1921*, Tiranë: Dituria 2008, f. 120.

²⁴Justin Godart, *Shqipëria në vitin 1921*, Tiranë: Dituria 2008, f. 120.

martuar në shtëpinë e Dervishit. Kur Bejxheja, si një zonjë e shkolluar dhe e emancipuar për kohën, kuptoi që ishte e tepërt në familje, (sidomos pas vdekjes së djalit të tyre të vetëm në moshën 10 vjeçare), i kërkoi Dervishit të largohej në Tiranë. Ai e mbështeti vendimin e saj duke treguar mirëkuptim.

Dervishi pati gjithsej 8 fëmijë. Ata ishin Naferiti, Sefedini, Dylfiqari, Vasifi, Sabahedini, Shyqyriu, Reshati dhe Hyseni. Sipas atyre që e kishin njohur Dervishin nga afër autoriteti i tij ndaj familjes së re që ai krijoi (gruas dhe fëmijëve) ishte i padiskutueshëm. Me një personalitet dhe temperament të jashtëzakonshëm, ai diti të ishte baba i përkushtuar, shembullor në familje, punëtori i palodhur që nuk e kishte për gjë edhe të merrej me punë të rendomta edhe më pas të vishte kostumin prej zotërie e të merrej me punë të rëndësishme që koha dhe momenti i kërkonte. Me një karakter të një njeriu plot fjalë por gjithmonë aty kur duhej, ai zotëronte dhe drejtonte derën e madhe të Biçakçinjve. Kështu interesant është fakti, që duke qënë një njeri fjala e të cilit nuk "binte poshtë", i pyetur nga Ahmet Zogu për nusen që ai duhet të zgjidhte (është fjala për Xheraldinën), ai i thotë: *"Po pse jo dhe emrin e paska të bukur Gjeraqine"*²⁵: Dëshmi mbi familjen jepen edhe nga diplomati francez Justin Gotard në vitin 1921. Në këtë kohë kur familja e Dervishit ishte shtuar me dy djem binjakë, Sabahedinin dhe Vasfiun, diplomati francez në ditarin e tij shkruan: *"Dervishi më solli të shoh dy djemtë e tij binjak dhe më kërkoi që të bëhem kumbari i njërit prej tyre, Sabahedit, të cilit i preva me madhështi një tufë të vogël flokësh."*²⁶

Familja e Biçakçinjve kishte në zotërim prona dhe pasuri të mëdha, një pjesë e të cilave ishte siguruar përmes blerjes së timareve në pronësi të pronarëve të tjerë. Kështu, në vitin 1884, rezulton se pasuria e Dervishit, zgjerohet jo vetëm përmes blerjes së timareve në trevën e Elbasanit por edhe në atë të Tiranës, ku përfshiheshin edhe disa pjesë mullinjsh²⁷. Më 1894 sipas dëshmive të dokumenteve osmane, është akuzuar për plagosje të një personi nga Manastiri i cili më pas ka ndërruar jetë, akuzë e cila mbeti e pavërtetuar²⁸. Më 1895 ai i pakënaqur ndaj masave të qeverisë kundërshtoi me armë në mes të njerëzve .

²⁵Gazeta Panorama, Tiranë më 19 Nëntor 2012.

²⁶Justin Gotard, *Mars 1921-Dhjetor 1951*, Tiranë: Ditura 2008, f.120.

²⁷Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, Aqif Pasha (1860-1926), Tiranë: Marin Barleti 2012, f. 46. Jusuf Beu i Sali Pashës, paresi e Elbasanit i shet disa pjesë mullinjsh e pronash të tjera ndër katunde të ndryshme të Elbasanit e të Tiranës që hyjnë në juridiksion timarësh, Dervish Beut, parisë së Elbasanit, myteselim e Serbevali. Zotëruese i timarevet ku janë këto katunde, Mehmedi vet i tëtëmëdheti timariot lëshon këtë akt me të cilin ai dhe shokët e tij njohin këtë shitblerje.

²⁸BEO (Fondi Kryeministrisë Osmane, Porta e Larte) 1493/111902, , përkthyer nga osmanologu Ermal Nurja. Deri tani jo vetëm që nuk është bërë e mundur arrestimi i Dervishit birit të Jusuf beut nga Elbasani, në moshë 20

Vitet 1896-1897 e gjejnë Dervishin në Bukuresht, ku gjendej një ndër qendrat më të rëndësishme të diasporës shqiptare, veprimtaria e së cilës ishte e përqëndruar në krijimin e shoqërive patriotike shqiptare. Kontributi i tyre evidentohet dukshëm në botimin e librave dhe literaturës në gjuhën shqipe, që më pas dërgoheshin dhe futeshin ilegalisht në Shqipëri. Në Bukuresht, Dervishi ra në kontakt me idetë e Rilindasve dhe u ndikua nga lëvizja patriotëve e shqiptarë atje, të cilët po përpiqeshin shumë për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Viti 1898 e gjeti djaloshin Dervish, në vendlindje, pra në Elbasan, të përfshirë në Lëvizjen Uniatiste, qëllimi i së cilës ishte krijimi i një kishe kombëtare dhe hapja e shkollave shqipe.

Disa vite më pas, në një dokument shit-blerje na shfaqet emri i Dervishit, përmes shitblerjes së pronave me Aqif Pashën²⁹. Sipas burimit në fjalë, personi me emrin Atlje, na rezulton gruaja e Dervish beut, e cila i shet Aqif beut, një pjesë të vijave të mullirit.

Më 1902 sipas dëshmive të dokumentave Osmane ishte në konflikt me Aqif Pashën për çështje trashigimie³⁰. Gjatë viteve 1901-1904, merr pjesë aktive në kryengritjet për të kundërshtuar pagesat e taksave ndaj Perandorisë Osmane.

Më 1909, bëhet themelues i klubit "Vllaznia". Po gjatë këtij viti, organizon dhe drejton punimet e kongresit të Elbasanit. Më 1 dhjetor të këtij viti, është një nga protagonistët e hapjes së shkollës Normale në Elbasan, shkollës së parë të mesme në Shqipëri.

Gjatë viteve 1910-1912, merr pjesë aktivisht në kryengritjet antiosmane për sigurimin e Pavarësisë të Shqipërisë. Nëntori i 1912-ës e gjen nënprefekt të prefekturës së Peqinit dhe më 26 nëntor 1912 ngre flamurin në Peqin. Më 30 nëntor të po këtij viti, Dervishi gjendet në Vlorë për të marrë pjesë në Kuvendin e Vlorës, të organizuar nga Ismail bej Qemali. Atje, zgjidhet anëtar i Pleqësisë si dhe i caktohet detyra për t'u marrë me organizimin e Ministrisë

vjecare, i dyshuar për plagosjen me pasojë vrasje të Keman Arifit nga Manastiri. Dervishi pas kësaj ngjarjeje është arratisur dhe nuk është identifikuar vendi ku strehohet, prandaj nga ana e kryesisë së gjykatës i jepet afat 10 ditë nga data e shpalljes së këtij akti që të paraqitet para gjykatës në respektim të ligjeve në fuqi, dhe nëse i akuzuari nuk do të paraqitet para gjykatës brenda këtij afati kohor, do të konsiderohet si person që nuk i bindet ligjeve, do të zhveshet nga të drejtat që i njeh e drejta civile dhe do të gjykohej në mungesë, gjatë së cilës do të shpallet vendimi i konfiskimit hipotetik në të gjithë pronat e tija të luajtshme dhe të paluajtshme, nuk do të ketë të drejtë që të aplikoj në gjyq si palë pretenduese, do të ngrihet detyra kundër tij dhe nëse njoftohemi saktësisht se ku strehohet do të arrestohet me forcë nga ana e policisë gjyqësore, sepse janë të detyruar që të zbatojnë këtë urdhër. Shpallet ky vendim që të vihet në dijeni me datë 25 mars 1894.

²⁹Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, *Aqif Pasha(1860-1926)*,Tiranë: Marin Barleti 2012 f. 46-47. E nderuemja Adlije Hamni e bija e Mehmet Beut dhe e shoqja e Dervish Beut, birit të të ndjerit Jusuf Beut, parësi e vendit, me banim në lagjen Silakshar, në sy të dëshmitarëve Ibrahim agës të birit të Sulejman Daklit, nga banorët e lagjes Kara-Veli dhe Sulejman Efendiut të birit të Mehmet Efendiut, nga Banorët e Lagjes Babuagllu, i shet nderëmadhut Aqif Beut të birit të të ndjerit Mahmut Pashës, një të katërtën pjesë të dy vijave të mullirit që zotëron në katundet Kullas e Haxhijas për grosh 5000, shumë të cilën e ka marrë prej Ali Beut.

³⁰ BEO Fondi i Kryeministrisë Osmane, Porta e Lartë 1994/149478. Perkthyer nga osmanologu Ermal Nurja.

së Financave. Me propozimin e tij, ftohet një tjetër Elbasanas Ahmet Dakli për të riorganizuar Ministrinë në fjalë.

Duke filluar nga maji i vitit 1913 e në vazhdim vërejmë një ndryshim në bindjet e tij politike, duke i dalë kundër Ismail Qemalit dhe duke zgjedhur të mbështesë Esat pashë Toptanin. Më 1914 mbështet ardhjen e princ Vidit në Shqipëri. Me fillimin e kryengritjes së Haxhi Qamilit, largohet nga Shqipëria, sepse ai dhe familja e tij bien pre e terrorit të kryengritësve.

Më 1924, renditet në rradhët e mbështetësve të Ahmet Zogut, pra kundër Fan Nolit. Për këtë arsye, vëllai i tij Hasani, dënohet me burg nga Gjykata Speciale e ngritur nga qeveria e Nolit. Më pas, në vitin 1925, e shohim në detyrën e prefektit të Elbasanit, të cilën nuk e mban gjatë, pasi jep dorëheqjen pas disa muajsh. Në vitet 1923-1932, është aktiv në politikën shqiptare si dhe i vëllai Hasani, i cili ka qenë deputet në tri legjislatura, në 1923, 1925 dhe 1928. Hasani gjithashtu zgjidhet edhe kryetari i bashkisë së Elbasanit në tetor të 1933, ku në fokus të veprimtarisë së tij janë mbarëvajtja e shkollave të qytetit. Ai interesohet edhe për pagat e arsimtarëve. Gjithashtu, interesi i bashkisë ishte kanalizimi i ujit të mirë, pra bëhet fjalë për ujin e pijshëm dhe hapja e rrugëve të reja. Në atë periudhë, sipas dokumentave të kohës, fillon edhe ndërtimi i rrugëve që do të lidhnin Elbasanin me Beratin dhe Lushnjën³¹.

Në vitin 1932 Dervishi zgjidhet deputet në Asamblenë Kushtetuese në grupin mbështetës të qeverisë së asaj kohe, pra në grupin e Pleqësorëve. Duhet thënë që si pjesë e parlamentit shqiptar në këtë periudhë, ai do të ishte pro miratimit të ligjeve që do të ndihmonin në ecjen përpara të shoqërisë shqiptare. Kështu në vitin 1933 miratohet një amandament kushtetues që: "*i dha shtetit të drejtën ekskluzive për arsimimin e qytetarëve të tij ,pra nacionalizimin e sistemit arsimor*"³². Masat e marra synonin gjithashtu edhe luftën kundër analfabetizmit të rritur si dhe organizimin e kurseve arsimore për gratë. Një arritje e rëndësishme në periudhën e mandatit të tij të deputetit, në vitin 1936, ishte edhe krijimi për herë të parë i *Entit Kombëtar të Turizmit*. Rëndësia e krijimit të këtij institucioni, qëndron në faktin që u lehtësuan shumë procedurat për marrjen e pashaportave, vizave, modernizimin e hoteleve dhe të transportit. Po kështu ai si deputet në parlament në vitin 1937 mbështeti ligjet që lidheshin me emancipimin e gruas, duke ndaluar poligaminë dhe mbajtjen e perçes tek gratë³³.

³¹ Rudina Mita (Todri), Roland Gjini, *Dokumenta historike 1925-1940*, Tiranë: Maluka 2015, f. 413.

³² Edwin Jacques, *Shqiptarët*, Tiranë: botues Kartë e Pendë 1995, f. 436.

³³ Po aty, 436.

Dervishi Biçaku, që qëndrimet e tij politike mbështeste Shefqet Vërlacin dhe ishte mbështetësi kryesor i Ahmet Zogut në Elbasan. Dervish beu merr pjesë në një fushatë të egër zgjedhore, ku vihen re kombinacione dhe grupime nga më të çuditshmet. Kështu, në vitin 1937, zgjidhet sërish deputet, gjë që tregon që ndikimi i tij në Elbasan ishte shumë i madh.

Dervish Biçakçiu, përveçse ishte një organizator i mirë, kishte dhe një natyrë tepër bujare³⁴. Nga dokumentet e kohës dëshmohet se *bënte edhe shumë bamirësi*, ku mund të përmendim ndihmat që ka dhënë për spitalin Ushtarak apo ndihma kundrejt të vobektëve në qytetet e Elbasanit dhe Tiranës. Ishte më se normale që individë më një pasuri të tillë si ajo e Dervishit të përfshiheshin në iniciativa të tilla bamirësie. Pasuritë e tij tashmë ishin të konsoliduara dhe vetëm ndjenja e shpirti të madh bënte që ai të ishte i kudo ndohur në aksione të tilla. Më 15 prill 1939 ai bën pjesë në grupin e delegatëve të Elbasanit në Asamblenë Kushtetuese të fashizmit. Por në këtë kohë, rezulton që ai nuk ka qenë aktiv në politikë, kjo ndoshta për shkak të moshës së thyer. Më 1942 ishte pjesë e anëtarësisë së Ballit Kombëtar, por përmes konsultimit me dokumentacionin përkatës nuk e shohim të ketë qenë aktiv. Në nëntor të vitit 1944, Dervishi largohet nga Shqipëria në drejtim të Sirisë ku dhe *ndërron jetë më 1952*. Nga dëshmitë familjare ka jetuar në Damask dhe meqënëse ishte në moshë të thyer tregohet se ka jetuar në një xhami pranë së cilës ndodhet edhe varri.

Më 25 shkurt të vitit 1952, “Blloku Kombëtar Independent” ndërpreu mbledhjen e tij të tretë të zhvilluar në Romë për të respektuar kujtimin e Dervish Biçakçiut. Për të vlerësuar figurën e tij, Ernest Koliqi mbajti një fjalim ku ndër të tjera tha edhe këto fjalë: *“Emni i Dervish beut lidhen ngushtësisht me atë lulëzim ndjenjash pranverore dhe me shpresat guximtare që zgjoi ndër të gjithë shqiptarët themelimi i Normales së Elbasanit... por jo vetëm si punëtor, ndër ma të parët e lirisë do të kujtojmë këtë fisnik të shquar, por edhe si prind të një dëshmori të lirisë. I biri i tij Sefedini ra në lamë të nderit duke shugurue me gjak vullnetin e popullit shqiptar, me u ndenj besnik traditive ma të shëndosha.”*³⁵

1.2 Përfshirja e Biçakçinjve në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

Në fund të shekullit XIX Elbasani numëronte një popullsi prej 10 000 banorësh. Bënte pjesë në vilajetin e Manastirit, me një pozitë gjeografike shumë të favorshme që shërbente si urë lidhëse midis lindjes e perëndimit dhe veriut e jugut. Në Elbasan, në këtë kohë për sa i përket zhvillimit të ekonomisë, kemi ndërthurje të marrëdhënieve të vjetra feudale me elemente të zhvillimit kapitalist.

³⁴Po aty, f.327.

³⁵Kastriot Dervishi, *Elbasani Enciklopedi*, Elbasan:Botimet Sejko 2003,f.63.

Kështu në Elbasan mbizotëronin esnafët ku më shumë merreshin me tregti. Në vitet '80 të shekullit XIX, Elbasani numëronte rreth 733 dyqane³⁶. Tregtarët ndihmoheshin shumë nga fakti që kishin edhe shumë prona tokësore, ullishta, që i ndihmonin për të tregtuar produktet e ndryshme³⁷. Pikërisht një nga familjet më të mëdha çifligare ishte ajo e Biçakçinjve. Pasuria e kësaj familje kishte ardhur duke u rritur që nga fillimi i shekullit XVIII. Në përgjithësi, bejlerët e mëdhenj në trevat shqiptare kishin arritur të zgjeronin pasuritë e tyre në formanga më të ndryshmet; në disa raste, duke konfiskuar pasuritë e feudalëve më të vegjël, në raste të tjera duke i dalë në mbrojtje fshatarëve për të mos paguar taksa dhe me kalimin e kohës i futnin nën zotërimin e tyre³⁸. Në ndonjë rast përmes përdorimit të forcës apo dhe falsifikimeve. Këto familje të quajtura oxhaqe u bënë mbështetja kryesore e Portës së Lartë. Si shpërblim ajo i jepte tituj dhe poste të larta. E tillë ishte pra edhe familja e Biçakçinjve apo e Vërlacëve etj, në trevën Elbasan.³⁹

Një nga ngjarjet që do të ndikojë fuqishëm në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve pa dyshim ishte nënshkrimi më 3 Mars 1878, i traktatit të Shën Stefanit midis Perandorisë Osmane dhe Perandorisë Ruse. Përmes zbatimit të këtij traktati Perandorisë Osmane i shkëputeshin rreth 80% të territoreve në hapësirën ballkanike⁴⁰. Për më tepër, zgjerim të madh pësonte Bullgaria autonome e parashikuar në Traktatin e Shën Stefanit, ku në lindje ajo përfshinte territoret shqiptare të Korçës, Pogradecit, Strugës etj. Serbia nga ana tjetër do të aneksonte viset veriore dhe verilindore të Kosovës deri në Mitrovicë; Mali i Zi aneksonte Ulqinin, Anamalin, Hotin, Grudën, Tuzin, Kelmendin, Plavën, Gucinë, Rugovën⁴¹. Krijimi i një Bullgarie të madhe dhe rritja e shteteve sllave, do të kundërshtohet nga Fuqitë e Mëdha si: Anglia, Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia, sepse kuptohet fare mirë, që rritja e ndikimit sllav do të thoshte automatikisht rritje e ndikimit Rus. Kështu, vendoset të rishikohen vendimet e Traktatit të Shën Stefanit. Për këtë arsye, brenda tri muajve nga Traktati i Shën Stefanit në 13 Qershor 1878 u vendos të mblidhet Kongresi i Berlinit. Vendimet e traktatit të Shën Stefanit, shërbyen si katalizator për organizimin e një rezistence të armatosur, për të mbrojtur me luftë trevat shqiptare që rrezikoheshin nga copëtimi. Kështu më 10 qershor të vitit 1878, u mbledh Kuvendi i Prizrenit, ku rolin kryesor e luante klubi i Stambollit me në krye Abdyl Frashërin. Dy traktate ju dërguan Kongresit të

³⁶Zh. Kadilli Daja., *Elbasani në vitet 1892-1908*, Tiranë: Morava 2014, f.24.

³⁷Po aty, f.26.

³⁸Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi I, Tiranë: Toena 2002, f.614.

³⁹Po aty, f.614.

⁴⁰Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f.146.

⁴¹Po aty, f.147.

Berlini dhe Portës së Lartë. Përmes tyre, shprehej gadishmëria e shqiptarëve për të luftuar deri tek njeriu i fundit, për të kundërshtuar çdo vendim që do të cënonte tërësinë territoriale të atdheut. Gjithashtu, kërkesa më kryesore me karakter politik, lidhej me krijimin e një Vilajeti të bashkuar me autonomi administrative⁴².

Lidhja e Prizrenit, shumë shpejt krijoi degët e saj në të gjithë Shqipërinë. Në gjirin e saj u krijuan tre rryma; rryma radikale, rryma e moderuar dhe rryma sulltaniste. Në rrymën e moderuar ose rryma e dytë me lëvizjen kombëtare, bënë pjesë personalitete si: Ali bej Guçia, Iliaz pashë Dibra, Mahmud pashë Biçakçiu, Omer pashë Vrioni. Ata kërkonin që lidhja të kishte karakter kombëtar dhe e pranonin në parim idenë e një vilajeti të bashkuar autonom. Ata shpresonin që me pëlqimin e Sulltanit mund të krijohej vilajeti Shqiptar⁴³.

Edhe në Elbasan, më 8 dhjetor 1878 u krijua dega e Komitetit të Lidhjes së Prizrenit me emrin “Komiteti i ndërlidhjes”. Funksioni i këtij komiteti, do të ishte kordinimi i veprimeve midis komiteteve përkatëse të trevave të veriut dhe atyre të jugut. Në Elbasan, komiteti njihej me emrin “Xhemijeti Hihadije” (Shoqëria e Besës). Dega e Elbasanit do të shërbente si urë lidhëse midis veriut dhe jugut të Shqipërisë. Këtë funksion mund ta luante edhe dega në Selanik, që shërbente si ndërmjetëse për lidhjet e komiteteve kombëtare⁴⁴. Ky komitet në Elbasan ka funksionuar për 2 vjet. Patriotët elbasanas bënë pjesë në rrymën e moderuar, ku bënë pjesë personalitete si: Ali bej Guçia, Iliaz pashë Dibra, Omer pashë Vrioni, Mahmud pashë Biçakçiu ky i fundit një nga drejtuesit kryesor që do ta ngrinte në një nivel më të lartë duke gjallëruar veprimtarinë e saj⁴⁵. Anëtarë të degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan ishin bejlerët më në zë të këtij qyteti, duke përfshirë edhe Biçakçijtë. Në Këshillin Drejtues bënë pjesë Ismail bej Verlaci, Isuf bej Biçakçiu, Shazivar bej Karaosmani dhe në cilësinë e kryetarit myftiu i Elbasanit, Hasan Tahsin efendi Alltoka⁴⁶. Sikurse konstatohet anëtar i degës së Lidhjes së Prizrenit në Elbasan ishte Isuf bej Biçakçiu, i ati i Dervishit, (që në atë kohë ishte në moshë të vogël). Ndërkaq, Mahmud pashë Biçakçiu konsiderohej si një ndër krerët mbështetës të Lidhjes së Prizrenit dhe komitetit të Elbasanit që mbante kontakte me Abdyl Frashërin. Ata pranonin në parim idenë e një vilajeti të bashkuar. Komiteti i Elbasanit edhe pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit më 1881, do të vazhdonte veprimet për të kundërshtuar politikën e osmanëve ndaj shqiptarëve.

⁴²Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f.156.

⁴³Po aty, f.150.

⁴⁴Po aty, f.167.

⁴⁵AME, kutia 2, Dos 6, fl. 3.

⁴⁶Majlinda Peza, Desertacion për mbrojtjen e grades Doktor i Shkencave, *Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*, mbrojtur në Fakultetin e Filologjikut Tiranë: 2014, f. 30.

Ndërkaq, në kushtet e reja që u krijuan në Shqipëri pas shtypjes së, programi i Rilindjes Kombëtare, u përqëndrua në kërkesa me karakter arsimor-kulturor. Patriotët shqiptarë u fokusuan në përhapjen e mësimi të gjuhës shqipe, që në atë kohë mësohej ilegalisht. Përmes shkollës dhe letërsisë në gjuhën shqipe rilindasit synonin forcimin e ndërgjegjes kombëtare tek shqiptarët⁴⁷. Gjithashtu, problem mbetej edhe gjetja e librave për mësimin e shqipes, që më së shumti botoheshin në kolonitë shqiptare në mërgim dhe futeshin ilegalisht në trevat shqiptare. Duke hulumtuar me kujdes në dokumentacionin e kohës, përfshirë këtu shumë letërkëmbime të patriotëve shqiptarë nga qytete të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë, rezulton se lëvizja kombëtare në trevën e Elbasanit ishte në ngritje e sipër. Nga letërkëmbimet në shtypin e kohës midis patriotëve shqiptarë, evidentohen lidhjet e Elbasanit me Korçën, Manastirin, Bukureshtin, Ohrin prej nga vinin abetare e libra në mënyrë ilegale.

Gjatë shek. XIX do të evidentohen përpjekjet e para për përdorimin e gjuhës shqipe, në përkthime të materialeve kishtarë, duke krijuar kështu një letërsi fetare në gjuhën shqipe.

Në fundin e shekullit XIX, Elbasani ishte përzier përse i përket besimeve fetare. Pjesën më të madhe të popullsisë e përbënin myslimanët dhe të krishterët që ndaheshin në katolikë dhe ortodoksë. Një rol tërëndësishëm kishte sekti i bektashinjve. Në përgjithësi bejlerët e kishin përkatësi fetare muslimane, disa të sektit bektashi, por kjo nuk i pengonte ata të mbanin marrëdhënie të mira me popullsinë e krishterë, çfarë në këtë rast vlerësohet si shkalla e lartë e mirëkuptimit dhe bashkëjetesës fetare në këtë trevë. Biçakçinjtë i përkisnin sektit bektashian, një sekt ky i njohur si opozitar i Portës së Lartë, që në parim të punës së tij kishte barazinë, vëllazërinë, mirëkuptimin dhe tolerancën. Ndërkohë që edhe vetë protagonist i këtij punimi, mbante emrin Dervish. Pa atdhe nuk ka fe, - ishte një nga parimet e sektit bektashian që u bë frymëzuese e Rilindjes Kombëtare. Ishte i njohur fakti që Teqet e bektashinjve, ishin kthyer në vatra ku mësohej gjuha shqipe. Edhe pse me gërma arabe, dervishët shpesh vepronin si transportues të librave që silleshin nga jashtë vendi⁴⁸. Në këtë kontekst përfshirja e Biçakçijve nuk ishte e rastësishme në Lëvizjen Kombëtare.

Gjithashtu, nëpërmjet propagandës së helenizimit, grekët kishin krijuar një organizatë që në vitin 1871, nën hijen e Patriarkanës me emrin “Vëllazëria Qëndrore Kulturele”. Veprimtari aktive zhvillonte në mënyrë të veçantë “Sillogu (klubi)

⁴⁷Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, *Historia e Shqipërisë vëllimi II(1882-1908)*, Tiranë: 1973, f. 17.

⁴⁸Stavro Skëndo., *"Zgjimi Kombëtar Shqiptar"*, Tiranë: Botimet Maluka 2000, f 137

kulturalo-epirot”, i themeluar po në këtë vit. Qëllimet dhe veprimtaria e “Sillogut” grek, nxiteshin nga rreziku që vinte si rezultat i ngritjes së lëvizjes kombëtare shqiptare në përgjithësi dhe e popullsisë së krishterë në veçanti.⁴⁹ Pikërisht, një ngritje e tillë ishte evidentuar edhe në viset malore të trevës së Elbasanit, sikurse ishte dhe krahina e Shpatit. Në këtë krahinë ishte i përhapur fenomeni i kriptokristianizmit ⁵⁰. Në këtë krahinë, kjo ngritje më së shumti u reflektua edhe në mësimin fshehurazi të gjuhës shqipe. Ndër familjet shpatarake që u shndërruan në nismëtarë të drejtpërdrejtë të mësimi të gjuhës shqipe përmenden Qosjat, Dedjet, Sharrët, Panxhët etj⁵¹. Në fund të vitit 1896, popullsia e krahinës së Shpatit përmes një peticioni kërkonte ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha, tek autoritete turke për t’u akorduar shqiptarëve të drejtën e arsimimit në gjuhën shqipe. Ndër të tjera në këtë peticion thuhej: “*Ne banorët e krahinës së Shpatit në Shqipëri Ju drejtohem Juve dhe nëpërmjet Jush, Fuqive të Mëdha, duke i lutur Ato nxehtësisht që të bëjnë përçapje pranë Portës së Lartë, me qëllim që ajo të na akordojë edhe neve lirinë për t’u arsimuar në gjuhën tonë kombëtare, si të gjithë kombet e tjera nënshtetase të Perandorisë. Duke qenë shqiptarë e në qendër të Shqipërisë, ne nuk kuptojmë as greqishten, as bullgarishten dhe asnjë gjuhë tjetër, dhe nuk mund të shkollohem veçse në gjuhën tonë shqipen*”.⁵² Në zonën e Shpatit, dëshmohen edhe elementet e para të fillimit të lëvizjes uniaste, e cila shfaqej në përpjekjet për bashkimin fetar me Romën⁵³.

Në këtë kuadër, evidentohet qëndrimi i Jusuf Biçakçiu në mbrojtje të Lëvizjes Uniatiste në zonën malore të Shpatit, duke kërkuar kthimin në fenë katolike në për të siguruar sa më shumë liri. Lëvizja Uniatiste, synonte ndër të tjera përdorimin e gjuhës shqipe në kishë dhe në shkollë. Kjo lëvizje e mbështetur nga Jusuf Biçakçiu i kishte rrënjët e thella në kriptokristianizmin, pra tek të krishterët e fshehtë, laramanët⁵⁴. Ky fenomen filloi të shfaqet gjithmonë e më shumë për shkak të reformave të ndërmarra nga Perandoria Osmane që në gjysmën e parë të shek. XIX, e cila abrogoi taksën për kokë (xhizen) për të krishterët dhe e

⁴⁹Sul Dedej e Xhemal Xhepa, *Buletini shkencor*, Shkodër: 1975, f. 89.

⁵⁰Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Tiranë: Dituria 2006, f. 121
Edith Durham: Malet e Shpatit në afërsitë Elbasanit banohen nga një popull malësor, që në shumë drejtime i ngjan malësorëve të Shqipërisë së Veriut dhe që është mbajtur si gjysmë i pavarur ... në rrethin që vizitova unë pashë asnjë kishë asnjë xhami. Dhe çdo njëri kishte dy emra. Në prani të një muhamedani ai e quante veten Sulejman dhe në prani të një krishteri e quante veten Kostandin.

⁵¹Majlinda Peza, Disertacioni për marrjen e gradës shkencore Doktor, me temë: *Lëvizja politiko – arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*, f. 45.

⁵²Mahir Domi, *Të dhëna mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Buletini shkencor, Shkodër: 1875, nr. 1, f. 175.

⁵³Si burim informacioni shërben letërkëmbimi midis kontit Ipen në Shkodër dhe baronit Cvidinek, 9 dhjetor 1898.

⁵⁴Nathaly Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit Shqiptar*, Tiranë: Marin Barleti 2013, f.87.

zëvendësoi me taksat për shërbimin ushtarak të njohura si bedel. Kjo lëvizje fillimisht, lidhej me interesat ekonomike për të mos paguar taksa. Kështu jo vetëm shpatarakët, në trevën e Elbasanit por edhe sulovarët, kërkonin njohjen zyrtare si të krishterë. Në këtë kontekst, në këto rajone malore ku administrata osmane e kishte të vështirë për të depërtuar, për shkak të relievit, ishte më të lehtë që lidhja me këtë popullsi të bëhej përmes bejlerëve vendas. Me këtë shpjegohet edhe ndikimi i madh i Jusuf Biçakçiu në zonën e Shpatit. Duhet thënë se bejlerët e Elbasanit dhe të Tiranës, morën pozicione të ndryshme kundrejt asaj që quhet shqiptarizëm, por të gjithë së bashku ishin në një mendje, që të ushtronin trysni ndaj portës së lartë për të hapur shkollat në gjuhën shqipe.

Kështu, në këtë iniciativë, ndikimi i Jusufit ishte i padiskutueshëm; ishte aq i madh sa që administrata osmane ia kishte lënë në dorë praktikisht kontrollin. Aq i madh ishte ndikimi sa pushteti i bejlerëve në rajone të tilla si: Malësi e Tiranës, Malësi e Çermenikës, Martaneshi, Malësi e Krujës, Shpati, Gramsh, mbante në këmbë rendin publik, ndalonte konfliktet, nuk lejonte rekrutime ushtarësh, as gjygje, as taksa⁵⁵. Ajo që është e evidente, është shkalla e lartë e padijes dhe mungesa e shkollave. Ato që ekzistonin në pjesën më të madhe, ishin shkollat në gjuhën turke. Vetëm në Tiranë, (më 1862 ekzistonte një shkollë ruzhdie, deri diku e mesme në gjuhën turke.⁵⁶ Përqindja më e lartë e arsimimit paraqitej në rradhët e të krishterëve. Ata ishin ndikimin e austro-hungarezëve, italianëve, grekëve dhe arumunëve⁵⁷. Në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shekullit XIX, pjesa më e shkolluar e popullsisë, vinte pikërisht nga rradhët e bejlerëve. Ata kishin mundësi financiare të shkollonin fëmijët si brenda ashtu dhe jashtë vendit (Dervishi ishte shkolluar në Stamboll dhe nga dëshmitë e familjarëve në një kolegji francez, për këtë arsye ai flet dhe shkuan shumë mirë atë)

1.3 Lëvizja Uniatiste dhe Dervish Biçaku

Në vitet '70 të shek. XIX në Perandorinë Osmane, kishte filluar lëvizja që në histori njihet me emrin "Lëvizja Xhonturke". Siç dihet veprimtaria e xhonturqeve, u fokusua në luftën kundër shthurjes së oborrit perandorak, despotizmit dhe arbitraritetit. Pikërisht, në një situatë të tillë më shumë se kurrë bëhej e domosdoshme që njerëzit e ditur të shfrytëzonin mundësitë që lejonte Porta e Lartë, për të siguruar krijimin e një kishe kombëtare, por mbi të gjitha arsimimin në gjuhën shqipe. Në qoftë se do të gjykojmë rastin e Dervishit, edhe pse

⁵⁵Po aty, f.88.

⁵⁶Po aty, f. 90

⁵⁷Po aty, f. 90.

rridhte nga një prej tre familjeve më të pasura të Elbasanit, i formuar intelektualisht, mendojmë se ai i kishte vënë vetes një misison të shenjtë, zgjimin kulturor të popullit të tij, detyrë që e bëri me shumë zell dhe devotshmëri.

Nga letërkëmbimi i zhvilluar në harkun kohor të viteve 1896-1897 ndërmjet Dervish Himës dhe Dr.Ibrahim Temos, Hamdi Ohrit, Dervish Biçakut, Dhimitër Pinës, evidentohet mjaft qartë fakti se, përhapja e librave në gjuhën shqipe në Elbasan përbënte një dukuri më se të zakonshme. Në këtë kontekst, Dervish Hima, më 4 korrik të vitit 1896 i shkruante Ibrahim Temos se *“Abetaret që na dërgove në rrugën e Vlorës, i morëm edhe pse me një mijë mundime, edhe Dervish Hiçit në Elbasan i mbërritën”*⁵⁸. Në korrespondencën ndërmjet tyre, në 22 gusht të vitit 1896 Dervish Biçakçiu (Elbasani) i shkruante Ibrahim Temos se, nuk i kishte marrë ende librat shqip, që ai i kishte çuar me rrugën e Durrësit dhe i lutej t’ia dërgonte drejtpërdrejt në Elbasan. Ndërkohë, ai i kërkonte t’i dërgonte edhe gazeta shqipe, për të cilat kishin shumë nevojë. Nëpërmjet letrave që Dervish Hima i dërgonte Ibrahim Temos evidentohet fakti se ai, si pjesëmarrës i lëvizjes së Turqve të Rinj në Elbasan dhe në qytete të tjera, kishte dhënë kontributin e tij në funksion të ngritjes së degëve të reja të kësaj lëvizjeje.

Në letrën e gushtit të vitit 1896, Dervish Hima shkruante se në Elbasan ishte ngritur Xhemijeti “Bashkimi Osman” dhe se, kishte futur në të të gjithë ata që dëshironin. Kurse në letrën e shtatorit të vitit 1896, bëhet fjalë për degë të xhemijetit “Bashkim e përparim” të krijuara në Elbasan, në Strugë etj. Këto degë mbanin lidhje me degën e komitetit “Bashkim e përparim” të Kostancës, me Ibrahim Temon, por dhe drejtpërdrejt me redaksinë e gazetës “Meshveret” të Parisit, së cilës i dërgonin materiale dhe i siguronin abonime në Shqipëri.

Ndërkaq, Lëvizja Uniatiste mbështej në atë që quhej “Programi i Kultit”, ose “Protokulti”, i nënshkruar që më 18 gusht 1855, midis Papatit dhe Austriakëve. Konkordati në fjalë shoqërohej me një kapitull, "Articulus Secretus", prej 10 nenesh dhe kontraktonte mbështetjen e një "Program veprimi" ose në gjermanisht "Ballhausplatz", i cili përmbante në mënyre indirekte të drejta të rëndësishme për shqiptarët katolikë ndërmjet të cilave:

1. hapjen e shkollave laike shqipe,
2. ndërtimin e vendeve të kultit,
3. ndërtimin e kolegjeve.

Ky konkordat ishte mbështetur në një marrëveshje të mëparshme të vitit 1837, i nënshkruar nga Imzot Benjanin Albertini në Vjenë dhe do të mbikqyrej nga Kongregata ose

⁵⁸Kristaq Prifti., *Dr. Ibrahim Temo*, Prishtinë: 1996, f. 86-87.

"Propaganda Fide" në Romë. Marrëdhëniet diplomatike me Romën do të zhvilloheshin nëpërmjet Nuncit Apostolik në Vjenë, ambasadorit austriak në Romë, konsullatës në Shkodër dhe Patriarkut të Armenëve në Kostandinopojë.⁵⁹ Pikërisht duke u nisur nga ky "Protokult", banorët e zonës së Shpatit, kërkonin të ktheheshin nga ortodoksë në katolikë. Pse kjo lëvizje shpërtheu në Shpat? Sepse këtu ishte më shumë i përhapur fenomeni i kriptokristianizimit, pra, të krishterët e fshehtë. Edhe pse mbanin emra myslimanë në ambiente publike, në shtëpi ata mbanin emrat ortodoksë dhe kremtonin festat e tyre të krishtera. Thelbi i kishës unite ishte *një kishë, një komb*. Në Elbasan, ishin pikërisht figura të tilla që edhe pse ishin të lidhur me myslimanizmin e mbështetën uniatizmin si: Dervish bej Biçakçiu, Aqif pasha dhe Shefqet Vërlaci. Kjo për arsye se, ata si përfaqësues të lëvizjes patriotike dhe nacionaliste në trevën e Elbasanit dhe influencës së madhe që kishin në popullsisë e kësaj treve, kërkonin të siguronin sa më shumë liri dhe të mund të arrinin të përdornin gjuhën amtare duke patur edhe mbështetjen e Papatit. Lëvizja Uniatiste në Elbasan, pati mbështetjen e monarkisë Austro-Hungareze. Kjo mbështetje, shikohej nga shqiptarët edhe si një goditje edhe ndaj ndërhyrjes së Patriarkanës greke, që kishte një ndikim të madh përmes shkollave greke dhe pengonte me çdo mënyrë përhapjen e gjuhës shqipe. Prandaj dhe patriotët shqiptarë shikonin tek Greqia dhe Patriku i Stambollit armiq po aq të rrezikshëm sa edhe turqit⁶⁰.

Ekziston mendimi, se rolin kryesor në Lëvizjen Uniatiste e luajti Dervish bej Biçakçiu⁶¹. Në dokumentat që gjenden në arkivat osmane të Stambollit, raportohet se në 30 maj 1895 situata ishte bërë shqetësuese nga sjelljet jo korrekte të nëpunësve të Portës së Lartë. Mytesarifin e Elbasanit i detyronte me pahir banorët e fshatrave Shpat i Sipërm dhe Shpat i poshtëm të ktheheshin në myslimanë⁶². Ky konflikt dëshmohej të ketë zgjatur deri në vitin 1897, kur Porta e Lartë për të qetësuar situatën shkarkoi nga detyra mytesarifin, Jonuz Efendiun⁶³. Kështu, siç e përmendëm i ka kundërshtuar veprimet e Portës së Lartë që më 1895⁶⁴.

⁵⁹<https://kishakatolikeshkodër.com/media/1248/janar-shkurt-2014>.

⁶⁰Akademi e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, *Historia e Shqipërisë, vëllimi II 1882-1908*, Tiranë: 1973, f. 15.

⁶¹Kujtim Bevapi, *Antropologjia e besimeve fetare në qytetin e Elbasanit dhe krahinat e tij*, Tiranë: Onufri 2020, f.84.

⁶²Ermal Nurja, *Elbasani në dokumentat osmane të arkivit të Stambollit*, Tiranë: Onufri 2019, f.231.

⁶³Po aty, f.231.

⁶⁴Eqerem bej Vlora, Baronesha Marie von Godin, *Ndihmesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri*, Tiranë, Botues "55" 2010, f.54 "…kur qeveria ndërmori veprime energjike, në mëngjes herët hidhet nga

Ndërkaq në këtë periudhë, burimet osmane të kohës osmane, dëshmojnë rreth faktit se Dervishi edhe pse në moshë të re, me veprimtarinë e tij në kuadër të lëvizjes kombëtare, po i sillte shqetësime administratës osmane dhe po trazonte ujërat e nacionalizmit shqiptar. Kështu, raportohej se më 9 tetor 1897, konsulli austro-hungarez i Shkodrës, ndodhej në Elbasan nën shoqërinë e Dervishit. Shfaqja e Dervishit përkrah konsullit austro-hungarez, kishte sjellë shqetësime përpushtetin osman, për faktin se ata e shikonin një marrëdhënie të tillë si një lëvizje kundër administratës osmane në favor të Lëvizjes Uniatiste. Përmes këtij raporti të administratës osmane, kërkohej marrja e masave, sepse sipas tyre ai synonte përhapjen e katolicizmit dhe jo siç pretendohet që lëvizte për qëllime tregëtie.⁶⁵ Mit'hat Frashëri gjithashtu deklaroi mbi përpjekjet e shqiptarëve të zonës së Shpatit për të kryer mesha në gjuhën shqipe dhe këtë arrijnë ta realizojnë në qendrën e Mitropolisë nga varej kjo zonë në Berat: *"Papa Dhimitri dhe Papa Jovani nga Elbasani, shkuan në Berat ...më 26 të vjeshtës së dytë 1897, d.m.th ditën e Shën Mitrit, u bë një meshë krejt shqip në kishë të mitropolisë së kalasë prej mitropolitit vetë dhe ndihmesës së dy priftërinjve të ardhur nga shpatarakët."*⁶⁶ Ky fakt tregon që shpatarakët jo në mënyrë rastësore ishin në pararojë të kësaj lëvizje.

Në kuadrin e përhapjes së lëvizjes kundër administratës osmane, flet edhe lidhja që ekzistonte midis përfaqësuesve të Shqipërisë së mesme, konkretisht Murat Toptanit dhe përfaqësuesve të lëvizjes patriotike në vilajetin e Kosovës⁶⁷. Qëllimi ishte krijimi i një Lidhje të re të shqiptarëve, që u quajt *Besëlidhja Shqiptare*, në krye të së cilës ishte Haxhi Zeka. Besëlidhja kishte si synim ruajtjen e territoreve shqiptare nga rreziku i jashtëm, por qëllimi kryesor ishte siguri i autonomisë⁶⁸. Veprimtaria e Besëlidhjes do të vihej në vështirësi nga masat shtypëse të Portës së Lartë. Në maj të 1897, Sulltani do të urdhëronte Valiun e Kosovës të shtypte çdo lëvizje antiosmane, duke kundërshtuar hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, ku thuhej se: *"Meqënëse gjuha e shtetit Osman është gjuha Osmane, nuk do të ishte aspak e lejueshme që të hapen shkolla në të cilat mësimi të zhvillohet në gjuhën shqipe"*⁶⁹. Në këtë kuadër do të shpërthejnë kryengritje në të gjithë Kosovën dhe në Shqipërinë e Mesme. Qëndresa kundërosmane që shpërtheu në Elbasan, Tiranë dhe Vlorë kishte si qëllim sigurimin

dritarja poshtë e kercet e ikën, ndërsa e motra e tij e re dhe e bukur e priste me kalë dhe armë diku udhës nga do të kalonte, duke e ndihmuar kështu që të arratiset.

⁶⁵Po aty, f.345.

⁶⁶Mid'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, Vëllimi II, Tiranë, Oufri 2018, f.469.

⁶⁷Skënder Blakaj, Ismail Ismaili, *Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë: Arbi 2014, f. 362.

⁶⁸Akademi e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 268.

⁶⁹Po aty, f. 270.

e autonomisë. Kështu konsulli austro-hungarez i Janinës njoftonte më 31 maj 1897 *"se çasti i një autonomie Shqiptare nuk është i largët"*.⁷⁰ Një nga drejtuesit kryesorë në Shqipërinë e Mesme ishte Murat Toptani, i cili si një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë, pati Dervish bej Biçakçiun. *"Qëllimi i tij dhe bashkëpunëtorëve ishte të krijonin një lidhje mbarë kombëtare, që të bashkonte të gjithë shqiptarët, gege e toskë, myslimanë dhe të krishterë"*⁷¹. Kuptohet që përpjekjet e shqiptarëve për bashkim, nuk do të mirëpriteshin aspak nga shtetet fqinjë, të cilët do të mbanin një qëndrim shumë armiqësor. Lëvizja që në fakt synonte ndërgjegjësimin e shqiptarëve mund të çonte drejt autonomisë gjë që do të prishte status-quonë në Ballkan.

Në vijim të veprimtarisë së tyre, në tetor 1897, Murat bej Toptani dhe Dervish bej Biçakçiun në Elbasan, u arrestuan për lidhjet me partinë Xhonturke dhe me komitetet shqiptare të Italisë dhe Rumanisë⁷². Në këtë kohë, me inisiativën e shoqërisë "Dituria" në Bukuresht në bashkëpunim me kolonitë organizua një takim madhështor dhe u aprovua një memorandum, që kishte karakter të theksuar autonomist. Përmes tij kërkohej njohja e popullsisë shqiptare, autonomi territoriale dhe administrative, duke bashkuar katër vilajetet në një të vetëm me kryeqendër Manastirin dhe njohjen e gjuhës shqipe në shkollat⁷³.

Ndërkaq, lëvizja Uniatiste dhe format e rebelimit në kuadrin e saj në trevën e Elbasanit, do të vijonin edhe përgjatë vitit 1898. Gjithmonë sipas dëshmive të Midhat Frashërit në Stamboll në këtë vit kishte mbërritur Rexhep Qosja, shpatar sipas tij *"ishte nationalist, anëtar i gjuhës shqipe dhe i mësimit shqip, mbase dhe i një kishe thjesht shqiptare."*⁷⁴ Ai i ishte drejtuar ambasadorit Rus në Stamboll Zinovievit nëpërmjet një memorandumi në frëngjisht ku i kërkonte të mbronte kombësinë shqiptare.⁷⁵ Ndërkohë që ky shqiptar patriot bënte përpjekje për të mbrojtur kombësinë shqiptare një tjetër shqiptar i njohur Syrja bej Vlora i dërgonte sulltanit më 31 korrik 1898 një memorandum që, kundër çështjes shqiptare, sipas tij dëshmohet qartë që, Dervish beu dhe Murat beu, vazhdonin mbështetjen për apostazinë e popullsisë së krahinës së Shpatit në Elbasan. Sipas Syrja beut,

⁷⁰Beqir Meta, Hasan Bello, *Syrja dhe Eqerem bej Vlora*, Vëllimi I, Tiranë: Onufri 2017, f. 66. Në këtë njoftim të konsullit të Janinës shprehet ideja që në Shqipëri duhet të ndërhyjë një fuqi Europiane dhe të mos ndodhë një copëtim i ri që do të zhbënte kombësinë e Shqipërisë së jugut. Një princ i huaj është i pranueshëm.

⁷¹Akademi e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 271

⁷²Po aty, f. 272.

⁷³Akademi e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, *Historia e Shqipërisë, vëllimi II 1882-1908*, Tiranë: 1973, f. 60-61.

⁷⁴Mid'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, Vëllimi II, Tiranë: Onufri 2018, f. 470.

⁷⁵Po aty, f. 470. "S'di ç'u bë më pastaj Rexhepi i gjorë, se përnjehere u zhduk nga Stambolli dhe ahëre besuam se turqit e bënë gjëkundit syrgjyn."

që të dy ata ishin: “*agjentë ngatarresash, të cilët morën rrugën e rebelizmit*”⁷⁶. Në mbështetje të popullsisë së Shpatit kishin ardhur edhe priftërinj katolikë, të cilët mbështeteshin nga konsullata e Austrisë në Shkodër. Ndërkaq, referuar burimeve të shfytëzuara mendojmë se popullsia në zonat malore të trevës së Elbasani, kishte mbështetjen e plotë bejlerëve të Elbasanit, që duhet thënë në jo pak raste, kishin një dëshirë për t’i shërbyer ambicieve të veçanta të tyre.

Rivalitetet ndërmjet Fuqive të huaja të interesuar për çështjen shqiptare dhe veprimtaria e tyre, ishin prezente në trevat shqiptare përmes konsujve të tyre. Kundrejt politikës së diplomacisë Vjeneze që shfaqej përmes mbështetjes së lëvizjes Uniatiste, rusët do të dërgonin në Elbasan konsullin e Manastirit. Ndërkaq, edhe italianët nuk kishin mbetur më pas, por kishin marrë masa për t’i tërhequr shqiptarët nga ana e tyre. Ata kishin organizuar në Napoli e në Kalabri njerëzit e tyre të emigruar prej kohësh, për të botuar gazeta në gjuhën shqipe. Këto propaganda u bënë më pas shkak i rebelimeve në Korçë, Elbasan dhe Shkodër. Për këtë problem Syrja Vlora shprehej: “*E gjithë kjo situatë i ka hapur shtegun edhe Dervish bej Elbasanit që të dalë nga ndigjesa publikisht qeverisë dhe të shëtisë në terrenin e rebelizmit*”⁷⁷. Përsëri po sipas tij, me shfaqjen e divergjencave fetare dhe manifestimeve tradhëtare, Austria i ngriti në një rang më të lartë Konsullatat e Durrësit dhe të Vlorës⁷⁸. Një qëndrim për problemin e mësipërm në Elbasan ka mbajtur edhe konsulli austro-hungarez, Teodor Ippen, person ky shumë i lidhur me çështjen shqiptare⁷⁹. Ai ka qëndruar në Shqipëri në kohë të ndryshme por për herë të parë erdhi në Shqipëri më 1884 dhe punoi në Konsullatën në Shkodër. Kështu në tetor të 1897, Ippeni ndërmori një udhëtim në Tiranë dhe Elbasan. Në këto takime ai mësoi mbi krijimin e një partie nacionaliste shqiptare, e cila synonte zhvillimin kulturor mbi baza kombëtare, që kishte si qëllim garantimin e gjuhës amtare dhe hapjen e shkollave shqipe⁸⁰.

Konsujt e Austrisë i dolën në mbrojtje Murat bej Toptanit për ikjen e tij nga Tripoli dhe mbështetjen për të, Ippeni e konsideronte shumë të rëndësishme: “*Për sa kohë qeveria austriake do të mbante një qëndrim jo miqësor kundrejt Murat beut, ne do të humbim një herë e përgjithmonë simpatinë e shqiptarëve.*”⁸¹ Ippen e kuptonte fare mirë që të bënte për vete

⁷⁶ Beqir Meta, Hasan Bello, Syrja dhe Eqerem bej Vlora, Vëllimi I, Tiranë, Onufri 2017, f.78

⁷⁷ Akademi e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f.74

⁷⁸ Po aty, f.73.

⁷⁹ Stavro Skëndo, “*Zgjimi Kombëtar Shqiptar*”, Tiranë: Botimet Maluka 2000, f. 272.

⁸⁰ Wernicke A, “*Teodor Ippen dhe Shqipëria në fokusin e Perandorisë Austrohungareze*”, Tiranë: Plejad 2012, f. 43.

⁸¹ Skënder Blakaj, Ismail Ismaili, *Lëterkëmbime të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, Arbi 2014, f.64.

popullsinë shqiptare duhej në rradhë të parë të fitonte përkrahjen e çifligarëve të mëdhenj sidomos në Shqipëri dhe Mesme, ndikimi i të cilëve ishte i padiskutueshëm. Austro-hungarezët duhej medoemos të fitonin mbështetjen e familjeve të mëdha sikurse ishin Toptanët, Biçakçinjtë, Verlacet në zonën e Shqipërisë së Mesme. Vetëm kështu ata mund të siguronin kthimin e popullsisë në fenë katolike. Ja si shprehej ai: *“Unë e konsideroj jashtëzakonisht të nevojshme shtrirjen e rrënjëve të ndikimit tonë në mbarë popullsinë, përndryshe do të ndeshemi me situata befasisëse, ku dhe ai ndikim i menduar prej nesh, që s’është në lartësinë e kërkesave që shtohen do të refuzohet”*.⁸² Kështu, shihej si shumë e rëndësishme për fuqizimin e interesave të tyre në territoret shqiptare mbështetja që duhej ti jepte konkretisht Vjena problematikave që shqetësonin marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe Portës së Lartë. Ndërkaq, shikohej si shumë e rëndësishme mbështetja për ata që ishin vënë në krye të lëvizjes antiosmane.

Mbërritjen në Durrës të Murat Toptanit me një anije me flamur malazez, Syrja bej Vlora ia faturonte austriakëve. Të tilla anije të vogla i kanë shpëtuar kontrollit të Portës së Lartë dhe këto anije kanë furnizuar me pushkë vende të ndryshme të Shqipërisë ku janë shitur 100 grosh copa. Numri i pushkëve llogaritej në disa mijëra. Syrjaji i sugjeronte Sulltanit të gjendeshin mënyra për të ndaluar kontaktin e të huajve me popullin. Kështu sipas tij në Itali (Xhenova) dhe në Rumani botoheshin revista të shkruara në gjuhën shqipe *“me një stil heretik e bektashian”*.⁸³ Ai i sugjeronte Sulltanit që të merreshin masa edhe kundër dhëndrit të Murat bej Toptanit, Dervish bej Elbasnit dhe tradhëtarëve të tjerë, sepse ishte shumë i rëndësishëm neutralizimi i tyre në mënyrë që të mos rritej rebelimi popullor. Aq larg shkonte ai, sa që kërkonte të merreshin masa jo vetëm kundër Dervishit, por edhe kundrejt farefisit të tij. Ky memorandum i një shqiptari të devotshëm ndaj Portës së Lartë, tregon qartë që ai ishte bërë shqetësim i madh për qetësinë në sanxhakun e Elbasanit dhe mund të ndikonte në rebelime të tjera në rajone të tjera të territoreve Shqiptare.⁸⁴

Murat bej Toptani (1868-1917), skulptor, poet veprimtar i Rilindjes. I ati i tij, Seit Toptani u arsimua në Paris. Madje aty mori pjesë në Revolucionin e vitit 1848. Ishte kryetar i degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Tiranën. Për shkak të pikëpamjeve të tij përparimtare e patriotike, qeveria osmane për njëzet vjet e internoi në viset e Kaukazit. I biri, Murat Toptani, veprimtarinë e zhvilloi edhe në mërgim, në Stamboll, Napoli, Brindizi, Bukuresht, etj. Mbajti lidhje intensive me familjen Frashëri (ishte dhëndër i tyre) dhe me veprimtarë të tjerë të Rilindjes Shqiptare. Murat Toptani, si delegat i Tiranës, nënshkroi Aktin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë, më 28 nëntor 1912.

⁸²Skënder Blakaj, Ismail Ismaili, *Lëterkëmbime të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë: Arbi 2014, f. 64.

⁸³Beqir Meta, Hasan Bello, Syrja dhe Eqerem bej Vlora, Vëllimi I, Tiranë, Onufri 2017f.75.

⁸⁴Sigurisht që Dervishi kurrë nuk ka qenë në dijeni të një memorandumit kundër tij nga ana e Syrja Vlorës në vitin 1900. Vite më vonë nga dokumentet vërtetohet që Dervishi do të jete prezent madje mik në shtëpinë e tij teksa diskutohej mbi të ardhmen e qeverisë së Vlorës.

Në analizën që Syrja bej Vlora i bënte popullsisë së Shpatit, megjithëse pranonte se ata dëshironin të ktheheshin në katolikë, theksohej se ata akoma praktikonin disa dispozita islame ndër të cilat përmendte; poligaminë, prohibicionet e ndryshme, emrat myslimanë etj. Sipas tij e vetmja arsye e apostezisë së shpatarakëve ishte se ata ishin mashtruar vetëm me propagandën për të refuzuar shërbimin ushtarak. Në këtë kontekst, krahina e Shpatit dhe zonat malore rreth e rrotull kishin mbetur në injorancë dhe në gjendje primitive dhe për këtë arsye Porta e Lartë, duhet të dërgonte misione nga Ulemaja⁸⁵ që t'i predikonin dhe këshillonin të mos largoheshin nga feja islame. Gjithahstu, ai shtonte se, pavarësisht nëse situata në dukje mund të ishte qetë, në fakt frynte një aromë turbullirash. Kështu Porta e Lartë duke parë një situatë aspak në favorin e saj, nisi një fushatë shtypëse ndaj lëvizjes së shqiptarëve. Duhet theksuar se Sulltani nuk qe në gjendje të shtypte dhe ti ç'armatoste shqiptarët. Kjo për faktin se atij nuk i interesonte të hidhte forca të shumta në Shqipëri, për faktin se mund ti jepte shkas shteteve fqinje të ndërhyjnë në Turqinë Europiane⁸⁶. Sulltani e kuptonte fare mirë sa jetike ishin territoret shqiptare për të ardhmen e Perandorisë në Ballkan.

Referuar dëshmive të vetë Murat Toptanit në një letër që ai i shkruante Visar Dodanit në 19 shtator 1898 nga Napoli, informohemi se Komiteti i krijuar atje, po punonte me shumë dëshirë për bashkimin e gjithë shqiptarëve. Ai shpjegonte gjithashtu se, po bënë një program në krye të të cilit kishin shkruar "Shqipëria vetëm për kombin shqiptar."⁸⁷ Ai kërkonte që i gjithë komuniteti shqiptar të kishte një qëllim; lirinë e gjuhës shqiptare në Shqipëri dhe bashkimin e katër vilajeteve. Ajo çfarë ai i sugjeronte mikut të tij, kishte të bënte me unifikimin e kërkesave të shqiptarëve të Rumanisë dhe të Egjiptit. Në këtë letër ai i rrëfente gjithashtu edhe për një skulpturë të Skënderbeut që ai e kishte bërë vetë⁸⁸. Kjo skulpturë sipas tij do të shërbente si simbol i bashkimit të gjithë shoqërive. Një ndër objektivat e rilindasve shqiptarë në funksion të forcimit të identitetit kombëtar, kishte të bënte edhe me evokimin e historisë së popullit shqiptar në të kaluarën historike, e sidomos periudhën e lavdishme të Skënderbeut.

Ndërkohë nga ana tjetër në maj 1900, Patriarkana greke për të neutralizuar situatën, arriti deri aty sa të kërkonte zëvendësimin e mitropolitit ortodoks të Elbasanit dhe drejtuesit e

⁸⁵ Beqir Meta, Hasan Bello, Syrja dhe Egerem bej Vlora, Vëllimi I, Tiranë, Onufri 2017, f.78.

⁸⁶ Akademi e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 275.

⁸⁷ Skënder Blakaj, Ismail Ismaili, *Lëterkëmbime të Rilindjes Kombëtare*, Prishrinë: Arbi 2014, f. 376.

⁸⁸ Po aty, f. 376. "Kam ba buston e Scanderbegut të math sa ish pothuaj. Ketu ma pëlqenë, po ti qisim formë do tju dërgoj një juve, dhe një në komitet që të jetë suvenir i bashkimit të gjithë shoqërive. Këtë bust e kam ba pas një tabloje të Marquer Aulettes e të D'ora d'Istria e Konfortit. Tabloja ish po thua si plaj, e unë e bëra më të ri e mvesha me hekra sikur shekon me sy armikne me sy të egërsuara."

tjerë kyç⁸⁹. Kështu nga Patriarkana ishte kërkuar që të lehtësoheshin procedurat e ministrisë përkatëse që të transferohej në Stamboll at Germanoi, me qëllim neutralizimin e veprimtarinë e tij në mbështetje të katolikëve. Ky i fundit, dukej se ishte konvertuar nga ortodoks në katolik dhe administrata osmane i sqaronte Kryeministrit se, nuk mund ta detyronin atë për tu nisur për në Stamboll. Patriarkana vazhdonte të insistonte përmes fjalëve se: *"Shkruhet se një grup priftërinjsh katolikë po kryejnë ndërmarrje me qëllime turbulluese atyre anëve duke ftuar në katolicizëm komunitetin ortodoks të Elbasanit, prandaj luten që të ndalohej kjo veprimtari"*⁹⁰.

Ndërkohë Patrikana e Komunitetit Ortodoks në Stamboll, në një letër drejtuar Ministrit së Drejtësisë dhe Feve bënte me dije se: *"është njoftuar nga metropoliti vendor se një grup priftërinjsh katolikë, kanë shkuar atyre anëve që gjenden nën administrimin fetar të Patrikanës në Elbasan duke ftuar popullsinë ortodokse që gjendet aty të kthehen në katolikë dhe më një më dy janë kthyer në mjete të propagandës me qëllime turbulluese"*⁹¹. Jepeshin këshilla që në rast se këto ndërmarrje do të rezultojnë të suksesshme, jo vetëm që do të cenohej e drejta e Patrikanës në atë hapësirë, por në fund fare do të dëmtoheshin rëndë edhe interesat e shtetit osman. Prandaj nga ana e pushtetit duhej të merreshin masa në funksion të vendosjes se rendit dhe qetësisë si dhe kërkohej që të pengoheshin ndërmarrjet e tilla dhe që popullsia e atij vendi të lihej në gjendjen e saj⁹². Sipas dokumentit në fjalë shkruhej se: *"Njoftohemi nga metropoliti vendor se një grup priftërinjsh katolikë, kanë shkuar atyre anëve që gjenden nën administrimin fetar të Patrikanës në Elbasan duke ftuar popullsinë ortodokse që gjendet aty të kthehen në katolikë dhe më një më dy janë kthyer në mjete të propagandës me qëllime turbulluese. Në rast se këto ndërmarrje do të rezultojnë të suksesshme, jo vetëm që do të cënohet e drejta e Patrikanës në atë hapësirë por në fund fare do të dëmtohen rëndë edhe interesat e shtetit osman, prandaj ia parashtrojmë vështimin tuaj largpamës që falë pushtetit tuaj që dëshiron vetëm rendin dhe qetësinë të pengohen ndërmarrjet e tilla që popullsia e atij vendi të lihet në gjendjen e saj, pasi që urdhri dhe fermani i takojnë pushtetit që ka përgjegjësinë e çështjes data 5 maj 1900"*⁹³.

Porta e Lartë e konsideronte shumë të rrezikshme prekjen e interesave të Patrikanës, më të cilën mbante gjithmonë marrëdhënie të mira, por mbi të gjitha i trembej se kjo lëvizje

⁸⁹Skënder Blakaj, Ismail Ismaili, *Lëterkëmbime të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë: Arbi 2014, f.234.

⁹⁰BEO-Fondi i Kryeministrit Osmane, Porta e Lartë 1493-111902 . Përkthyer nga osmanologu Ermal Nurja.

⁹¹Po aty, 1493-111902 .

⁹²Po aty, 1493-111902. Përkthyer nga osmanologu Ermal Nurja. Patriarkana e Komunitetit Ortodoks Stamboll, numër dokumenti 180 Drejtuar Ministrit së Drejtësisë dhe Feve Parashtresë e kërkuar.

⁹³Po aty, 1493-111902.

cënonte rëndë interesat e Shtetit Osman. Kuptohet se nëpërmjet këtij dokumenti duket fare qartë që mitropoliti vendor e shikonte me shqetësim faktin që, pikërisht nga rradhët e priftërinjve shqiptar ata me të vërtetë e kuptonin se, situata duhej të ndryshonte në mënyrë që shqiptarët të fitonin më shumë të drejta lidhur me shkollën shqipe. Propoganda sipas tyre ishte kthyer në një mjet turbullues. Vërtet që shqiptarët e fillimit të shekullit XX-të e kuptonin fare mirë që vetëm duke kërkuar më shumë të drejta mund ti fitonin ato. Lidhur me këtë çështje nga administrata osmane njoftohej se, peshkopi i Durrësit kishte blerë 3 shtëpi pranë kishës ortodokse dhe dyshohej se, kishte synim të ndërtonte aty më vonë një kishë katolike.

Me mbështetjen e drejtpërdrejtë të Dervish Biçakçiut, në vitin 1900 At Gjermanoi dhe Dom Nikoll Kaçorri, (ky i fundit meshari i Dioqezës së krishterë katolike të Durrësit), u nisën për në Romë. Dervishi kishte vënë në dispozicion jo vetëm njerëzit që i shoqëronin, por edhe financat për realizimin e këtij udhëtimi. Rëndësia qëndron në faktin që nëpërmjet shkëputjes nga kisha ortodokse dhe mbështetjes së Papatit, do të mund të sigurohej ngritja e shkollës shqipe. Kjo lëvizje ishte shumë e rrezikshme për Dervishin duke pasur parasysh reagimin e Portës së Lartë e cila kërkoi ta shpallte të jashtëligjshme Kishën Unite të Shqipërisë së mesme⁹⁴. Kisha greke gjithashtu bëri lëvizjen e rradhës, duke dërguar në Durrës inspektorin e konsullatave të Epirit. Po kështu në korrik të 1901 njoftohej që: *“I është ndaluar atë Germanoit të vijë këtyre anëve pasi është bërë ndërmjetës që komuniteti ortodoks në Elbasan të anojë nga katolicizmi.”*⁹⁵

Mendojmë se ndalimi i atë Gjermanoit, lidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë me qëllimin për t’i dhënë njëgoditje lëvizjes Uniatiste dhe për të penguar përhapjen e saj në pjesën tjetër të Shqipërisë. Në harkun kohor 1900-1904, rreth 50 familje të krishtera ortodokse u kthyen në kishën unite. Konvertimi i këtyre familjeve shqetësoi shumë sinodin grek. Si gjithmonë në mbështetje të kishës ortodokse Greke ishte diplomacia Ruse Gjatë një vizite që konsulli i Manastirt Rostovski bëri në Elbasan në datë 5 Maj 1900, ai do të takohej me përfaqësues të familjeve ortodokse në qytet. Kështu, ai takohet me Beniamin Delianën dhe doktor Delianën:”...Këto familje ishin me influencë në komunitetin ortodoks, qëllimi i vizitës në fakt ishte ti bënte presion at Gjermanoit të braktiste Uniatizmin ose në rast të kundërt do ta arrestonte dhe burgoste⁹⁶. Konsulli Rostovski i ofroi 3000 lira turke Gjermanoit dhe një rrogë

⁹⁴Kujtim Bevapi., *"Antropologjia e besimeve fetare në qytetin e Elbasanit dhe krahinat e tij"*, Tiranë: Onufri 2020, f.85.

⁹⁵Ermal Nurja., *"Elbasani në dokumentat osmane të Arkivit të Stambollit"*, Tiranë: Onufri 2019, f.236.

⁹⁶Hyqmet Kotherja, Pavarësia e Elbasanit 1912, Tiranë: Dy lindje Dy përdim, 2012 f. 71.

vjetore prej 3000 lirash me garanci bankare ”⁹⁷. Gjithashtu aq larg shkuan propozimet sa që i premtuan një bursë studimi në Kiev dhe kthimin në Elbasan jo më si prift por si metropolit. Atë Gjermanoi nuk pranoi dhe kjo rriti besimin e ndjekësve tek ai. Konsulli Ippen për këtë çështje nuk e pranonte mendimin e Imzot Primo Bianchi se, shqiptarët u kthyen në katolikë nga dashuria për kishën katolike. Shkaku i vërtetë ishte neveria që kishin shqiptarët për helenizimin e Patriakanës Ekumenike.

Në këtë lëvizje, sigurisht, Atë Gjermanoi do të mbështetej edhe nga idhtari dhe mbrojtësi i flaktë i gjuhës shqipe, Dervish Biçakçiu në Elbasan dhe Refik, Avdi e Mehmet Frashëri në Tiranë, qëllimi i të cilëve ishte ndërtimi i një kishe mbi baza kombëtare ⁹⁸. Ndërkaq, Sinodi i shenjtë i kërkoi At Gjermanoit të shkonte në Stamboll. Synimi ishte që të neutralizonin lëvizjen uniatiste dhe të godisnin mbështetjen austro-hungareze dhe italiane që mbanin përgjegjësinë për dekompozimin e “fesë së drejtë”. Gjithashtu, Sinodi grek kërkonte ti jepte një goditje lidhjeve të At Gjermanoit unit dhe Dervish beut dhe Aqif beut, si bartës të idesë për një kishë të përbashkët shqiptare⁹⁹. Ajo që është e rëndësishme në të gjithë këtë lëvizje, është rritja e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve dhe të popullsisë së trevës së Elbasanit dhe fakti që ata po luftonin fort për të ruajtur identitetin e tyre kombëtar. Sigurisht në dështimin e kësaj lëvizjeje, kanë ndikuar faktorë të ndryshëm, ku si më të rëndësishëm mendojmë se janë:

- Indiferenca e austro-hungarezëve për të siguruar një leje për të ndërtuar një kishë Unite ne Sanxhakun e Elbasanit
- Qëndrimi negativ që mbante Porta e Lartë.
- Politika përçarëse që ndiqte sinodi Grek dhe diplomacia Ruse.
- Fakti që ajo mbeti në kuadrin e një lëvizje lokale jo me përhapje të gjërë.

Edhe pse patriotët shqiptarë me gjithë përpjekjet e tyre luftuan për të siguruar më shumë të drejta, theksojmë se nuk ja arritën qëllimit dhe vetë Lëvizja Uniatiste, pothuajse u shua aty nga viti 1908. Kjo lëvizje do të rinisë sërisht me kryengritjet e 1910 ku zona e Shpatit, do të jetë njëra rajonet kryesore në kryengritjet e armatosura anti-osmane. Ndër figurat kryesore do të jetë Lef Nosi një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Dervish Bej Biçakçikut në klubin Vllaznia që do të krijohet më vonë. Shpatarakët i mbështetën fort shkollat shqipe edhe pas 1908.

⁹⁷Po aty, f.85.

⁹⁸Roland Gjini, Malësia Nr.7, "Lëvizja Unite(Uniatizmi) në trevën e Elbasanit", Potgoricë, IVPE 2012, f. 373.

⁹⁹Po aty, f. 5.

Kështu konsulli Posfai raportonte për Vjenën se: "*Mbajtja e shkollave është krejt në duart e klubit të Elbasanit.*" Në Shpat ishin caktuar tre mësues shëtitës, Omer Dervishi, një kaçak i zonës kishte marrë në mbikëqyrje këtë lokalitet duke i dhënë besën klubit të Shpatit se, nuk do të lejonin hapjen e shkollës Greke¹⁰⁰. Fakti që Dervishi mbështeti Lëvizjen edhe pse ishte në një moshë mjaft të re, vetëm 26 vjeç, tregon që nga familja, ai ishte ushqyer me dashurinë për gjuhën dhe kulturën shqipe. Duket fare qartë që tek patrioti i ri ndjenja e atdhetarizmit është mbizotëruese. Boll që ajo të vihej në funksion të shqiptarizmit, të botimit të librave shqip dhe të zhvillimit të kulturës kombëtare. Popullsia e Shpatit kishte kërkuar amnisti, por "elementët sherraxhinj", kështu etiketoheshin nga qeveria lokale, në qoftë se e siguronin atë mund të rimblidheshin sërish duke përdorur armë kundër kompanisë. Dokumentacioni vërteton që në mbështetje të tyre kishin dalë përfaqësues të parisë si Shehysyvar Karaosmani, Aqif pasha, Dervish beu dhe Shefqet Vërlaci. Duke qenë se të katërt nuk e kishin pranuar mbështetjen për popullsinë e Shpatit, por e gjykonin të drejtë dhe me asnjë qëllim të dëmshëm përpjekjet e popullit për të kërkuar amnisti. Në këtë dokument përmendet kryetari i grupit protestues të Shpatit, Jusuf Qose. Kërkesa e tij ishte disi e çuditshme po të kemi parasysh ndikimin e madh që kishin në këto zona bejlerët e Elbasanit. "*Mbi këtë situatë së fundmi Jusuf Qose nga Shpati dhe një tjetër person ng Sulova, që janë kryetarët e grupit të mbledhur kanë ardhur para meje dhe janë shprehur në mënyrë konfidenciale në emër të personave të grumbulluar në tubim se megjithëse kërkohet liri i të dënuarve, nuk duhen emëruar në këtë pozicion bejlerët e përmendur*"¹⁰¹. Kjo sigurisht ka qënë arsyeja që kur shpatarakët do të kërkonin ndihmë për mësues të shqipes më 1908. Përgjigja e Aqif Pashës do të ishte negative, për faktin se edhe ata pak mësues ishin shpërndarë për të dhënë mësim në trevën e Elbasanit. Edhe pse përfundoi aty nga 1908, në këtë fazë Lëvizja Uniatiste tregoi që shqiptarët në të gjitha format luftuan për gjuhën dhe Kishën kombëtare. Mund të pohojmë se kontributi i Dervish Biçakçiut në lëvizjen Uniatiste në qytetin e Elbasanit, por jo vetëm, shënoi një hap të rëndësishëm në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Ajo shënoi një hap të rëndësishëm në përpjekjet e shqiptarëve për kishën kombëtare:

Së pari, kjo konfirmon edhe një herë që Elbasani jo rastësisht ishte një nga qendrat më të rëndësishme të lëvizjes tonë kombëtare. Kjo lëvizje tregoi që Dervish Biçakçiu, në të gjithë

¹⁰⁰Alfabeti i gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit, Tiranë: Mihal Duri 1976, f. 364.

¹⁰¹BEO-Fondi i Kryeministrisë Osmane, Porta e Lartë1994/149478. Dokumenti është përkthyer nga osmanologu Ermal Nurja.

veprimtarinë e tij gjatë kësaj periudhe u bë mbështetësi kryesor dhe ithtari më i flaktë për shkollën shqipe dhe kishën kombëtare. Pavarësisht se ai duke qënë përfaqësues i shtresës çifligare mund ta ketë mbështetur këtë lëvizje edhe për arsye ekonomike ajo që dominon është përpjekja për shkollën shqipe.

Së dyti, lëvizja Uniatiste do të shërbente si bazë për luftën e mëvonshme që do të bënin shqiptarët për të krijuar kishën kombëtare. Për të formuar identitetin e tyre etnik, shqiptarët do të përballeshin me intrigat e sinodit grek, patriarkanës së Stambollit e qëndrimeve negative të Rusisë, por nuk hoqën dorë nga ideja e krijimi të institucioneve shoqërore dhe shpirtërore të pavarura. Edhe pse mysliman i sektit bektashian, Dervishi do të jetë një mbështetës dhe financues i krijimit të kishës kombëtare. Nuk është rastësi fakti që bektashianët ishin në krye të Lëvizjes kombëtare për shkollën shqipe po të kemi parasysh sa liberal ishte ky sekt.

Në fillim të shekullit XX-të bektashinjtë do të rezultonin mbështetësit kryesor të ngjarjes së madhe të pavarësisë.

Së treti, lëvizja Uniatiste do të dështonte edhe për shkak të qëndrimit jo këmbëngulës të austro –hungarezëve, që u treguan të lëkundur në mbështetje të katolikëve duke i lënë hapësira ndikimit të rivalëve të tyre italianëve. Kundrejt tyre ajo dukej gjithmonë e më e dobët. Në këtë kuadër veprimtaria e Dervish beut në funksion të kësaj lëvizje, ishte një kontribut me vlera në funksion të zhvillimit të shkollës shqipe, veprimtari e cila do të vazhdojë të vazhdonte, duke arritur kulmin me Kongresin e Elbasanit dhe hapjen e shkollës Normale.

1.4 Fillesat e konfliktit me Aqif Pashë Biçakun.

Jusuf Biçakçiu kishte dy vëllezër Ismailin dhe Mahmutin. Sikurse edhe e kemi përmendur familja e Biçakçinjve zotëronte prona të shumta në të gjithë sanxhakun e Elbasanit. Kështu më 1723, Mahmut bej Biçakçiu [i ati i Aqif Pashës] arriti të fusë në zotërim një çiflig në Çengelaj dhe disa çifligje të tjera. Pasuritë e kësaj familjeje u shtuan shumë sidomos në kohë të Sulejman pashë Biçakçiu (1765-1773), i cili arriti të mbajë titullin e Vezirit duke futur në zotërim fshatra në Librazhd, Mirakë, Pishkash, Çermenikë, Skoskë¹⁰². Në fund të shekullit XIX, familja e Biçakçinjve luante një rol të rëndësishëm në jetën politike të Elbasanit. Është e kuptueshme që ato kishin ndikim të madh në një territor që përfshinte

¹⁰²Shyqyri Demiri, *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Tiranë: Shtypshkronja Sh.B. Medaur 2006, f.67.

pjesën më të madhe të Sanxhakut të Elbasanit. Ashtu si Jusufi edhe Mahmuti ishte i angazhuar jo vetëm në lëvizjet kombëtare, por edhe administrimin e pronave të shumta. Familja llogariste pasuri në prona tokësore mbi 2100 ha. Në burimet osmane të kohës thuhej se ata [Biçakçinjtë] gjithashtu ishin në rradhët e para të administratës osmane në qytetet dhe për shërbime të devotshme ndaj portës së lartë edhe janë dekoruar. I tillë është urdhëri i dekorimit të: "*Aqif beu i biri i Mahmut Pashës nga paria e Elbasanit dekorohet me dekoratë të shkallëse së dytë*"¹⁰³.

Duke respektuar traditën, vdekja e parakohshme e Ismailit, bëri që familja të vihej në lëvizje për një bashkëshort të ri për të venë e tij. Rregulli ishte që bashkëshorti i ri duhej të ishte brenda familjes. Në këtë rast, kandidatë ishin Dervishi dhe Aqifi. Sikurse dëshmohet, bashkëshorti i ri të vesë së xhaxhait të tyre rezultoi të jetë bërë Dervishi, i cili natyrisht do të gëzonte edhe pasurinë e familjes, gjë që, mendojmë se i turbulloi marrëdhëniet ndërmjet dy kushërinjve¹⁰⁴. Por, duhet thënë se, konflikti ndërmjet Aqif pashës dhe Dervish beut ka qenë edhe më i hershëm. Një dokument i inspektorit të drejtësisë për Vilajetin e Manastirit dhe Kosovës, na njeh me disa detaje të këtij konflikti. Letra me të cilën ai njoftonte Kryeministrinë mban datën 9 prill 1903¹⁰⁵. Sipas këtij informacioni, marrëdhëniet e ftohta dhe konfliktuale ndërmjet dy kushërinjve, buronin për çështje trashëgimie. Pas kësaj martese të Dervishit, situata ndërmjet tyre ishte përkeqësuar edhe më shumë. Inspektori i drejtësisë, shprehej se sado që nëpunësit e lartë të administratës. Përpiqeshin të unifikonin qëndrimin e tyre, duke i respektuar e mbajtur me fjalë të mira, ata shpërfillnin ligjin dhe njerëzit që i mbështesnin dhe shpesh, nuk hezitnin të përdornin armët duke mos respektuar kështu ligjin. Kështu, sipas mytesarif Reshit Pasha, ky i fundit ishte përpjekur të vendoste pajtimin midis tyre. Ndërkaq, për të qetësuar situatën ishte emëruar një mytesarif i ri me emrin Nexhip beu, i cili duke mos njohur situatat specifike të sanxhakut, kishte mbajtur një qëndrim të hapur në mbrojtje të Dervish beut. Kjo duket se ka shkaktuar zemërimin e Aqif pashës, i cili ka nxitur përdorimin e armëve duke shkaktuar një konflikt të hapur midis Mytesarifit të Elbasanit dhe Aqifit. Pas kësaj ngjarjeje, sipas dëshmisë së inspektorit, kishte mbërritur një urdhër perandorak për zgjidhjen e konfliktit. Qeveria vendore kishte kërkuar shtimin e forcave ushtarake, sepse xhandarmëria nuk arrinte të vendoste rendin dhe qetësinë e dëshiruar. Sipas

¹⁰³ DH.KMT (Fondi i Kryeministrisë Osmane, Porta e Lartë), 1447 /31, 15 shtator 1887. (Dokumenti është përkthyer nga osmanologu Ermal Nurja).

¹⁰⁴ BEO (Fondi i Kryeministrisë Osmane, Porta e Lartë), 1994/149478, 7 shkurt 1903. (Dokumenti është përkthyer nga osmanologu Ermal Nurja).

¹⁰⁵ BEO (Fondi i Kryeministrisë Osmane, Porta e Lartë), 1994/149478.

inspektorit, populli ishte i ndarë sipas personave që kishin famë dhe pasuri. Mbështetja ishte aq e madhe dhe kishte shkuar aq larg, sa që disa prej mbështetësve kishin kryer edhe vepra penale të rënda¹⁰⁶.

Gjithashtu, një tjetër problem që evidentohet në raportimin e inspektorit të drejtësisë, lidhet me faktin se, nga ana e administratës shtetërore, u ishin dërguar të dy kushërinjë shkresa, ku kërkohet që të identifikoheshin personat që gjendeshin në listat e atyre që ishin kërkim, në mënyrë që t'i dorëzonin pranë qeverisë lokale. Interesante ishte përgjigjja e Aqif pashës i cili shprehet se: *“Nuk kam asnjë lloj lidhje me asnjë person që shkel ligjin”*¹⁰⁷. Në përgjigjen e letrës, inspektori i drejtësisë kishte bërë edhe një përshkrim të xhandarmërisë vendase, Mytesarifit të Elbasanit dhe Dervish beut. Duket qartë se letra ishte e mbushur me konotacion kundër Dervishit, gjë që kishte acaruar edhe më shumë marrëdhëniet e ftohta midis tyre¹⁰⁸. Nga përshkrimi që inspektori bënte, dukej që numri i personave të përfshirë në konflikt ishte shumë i lartë, madje edhe nëse do të dërgohej një forcë ushtarake, ajo nuk do të kapte më shumë se një të tretën e tyre. Inspektori jepte detaje të rëndësishme duke thënë se Mytesarifi ishte njeri i drejtë me qëllime të shëndosha, i cili mbante anën e Dervishit. Ai nga ana tjetër e vlerësonte figurën e Aqifit, si njeri të devotshëm ndaj detyrave shtetërore duke u shprehur: *“Prandaj kur vendi ka nevojë për të mirën e tyre materiale dhe financiare nuk duhet të lejohet fara e smirës për qëllime personale”*¹⁰⁹. Në fakt duket që edhe pse inspektori i lartë jepte këshilla të vryera në funksion të ruajtjes së rendit dhe të qetësisë, *“pajtimi në dukje”*, ishte shumë i largët dhe asnjëherë nuk do të vendosej midis Aqifit dhe Dervish beut.

1.5 Veprimtaria patriotike e Dervishit Biçakut në vitet 1900 - 1908

Që në vitin 1889, Xhonturqit kishin krijuar në Stamboll komitetin e fshehtë "Bashkim e Përparim" ('Ittihad ve Terakki'). Ky komitet u shpërnda nga Sulltani. Pavarësisht kësaj, veprimtaria e këtij komiteti vazhdoi jashtë kryeqytetit të pernadorisë, duke krijuar shumë nëndegë, një prej të cilave arriti të ngrihej edhe në Elbasan. Përmes letërkëmbimit ndërmjet Dervish Himë dhe Ibrahim Temos evidentohet fakti se ai, si pjesëmarrës i lëvizjes së Turqve

¹⁰⁶ BEO 1994/149478 , (Fondi i Kryeministrit Osmane, Porta e Lartë, 7 shkurt 1903, përkthyer nga osmanologu Ermal Nurja

¹⁰⁷ Po aty

¹⁰⁸ BEO 1994/149478 , (Fondi i Kryeministrit Osmane, Porta e Lartë, 7 shkurt 1903, përkthyer nga osmanologu Ermal Nurja

¹⁰⁹ Po aty.

të Rinj në Elbasan dhe në qytete të tjera, kishte dhënë kontributin e tij në funksion të ngritjes së degëve të reja të kësaj lëvizjeje. Në letrën e gushtit të vitit 1896, Dervish Hima shkruante se në Elbasan ishte ngritur Xhemijeti “Bashkimi Osman” dhe se kishte futur në të, të gjithë ata që dëshironin. Kurse në letrën e shtatorit të vitit 1896 bëhet fjalë për degë të Xhemijetit “Bashkim e Përparim” të krijuara në Elbasan, në Strugë, etj. Këto degë mbanin lidhje me degën e komitetit “Bashkim e Përparim” të Kostancës, me Ibrahim Temon, por dhe drejtpërdrejt me redaksinë e gazetës “Meshveret” të Parisit, së cilës i dërgonin materiale dhe i siguronin abonime në Shqipëri¹¹⁰.

Në janar 1898, shoqëritë patriotike në mërgim botuan një memorandum nën titullin: “*Në emër të popullit shqiptar*”, që i drejtohej Sulltanit dhe Fuqive të Mëdha. Në memorandum dënoheshin intrigat e shteteve fqinje në Shqipëri dhe politika armiqësore e Portës së Lartë, që mbështeste hapjen e shkollave dhe kishave greke, serbe dhe bullgare dhe duke mos lejuar ato shqiptare. Memorandumi drejtohej edhe kundër politikës së ndërhyrjes së Fuqive të Mëdha. Kërkesa më kryesore ishte ajo për autonomi administrative¹¹¹. Faktikisht periudha e rënies së lëvizjes shqiptare nuk vazhdoi gjatë. Konjunkturat rajonale ishin acaruar me rishfaqjen e “çështjes maqedone”, në fillim të vitit 1899, duke krijuar një situatë të nderë politike në Ballkan dhe në trevat shqiptare. Fuqitë e Mëdha, bënë përpjekje kolektive për të detyruar Portën e Lartëtë zbatonte reformat në Maqedoni dhe për të ndaluar vrullin kryengritës. Në këto rrethana, do të evidentohet një lëvizje shqiptare për krijimin e një lidhje të re, nën shembullin e Lidhjes së Prizrenit. Lidhja e re do të krijohet në Pejë në 23-29 janar 1899. Kjo lidhje njihet me emrin Lidhja e Pejës ose Besa - Besë. Në një nga vendimet e marra në Lidhjen e Pejës, kërkohej të formoheshin besëlidhje në të gjitha vilajetet shqiptare. Kështu, shumë shpejt u krijuan degë të Lidhjes së Pejës në sanxhakun e Dibrës, Ohër, Starovë dhe në Elbasan¹¹². Komiteti i Dibrës në mbështetje të Lidhjes së Pejës, u bënte thirrje shqiptarëve për tu bashkuar nën drejtimin e Lidhjes së Pejës. Me qëllim që besa të përhapej edhe në qytetet e tjera të vendit, vendimet e Dibrës ju njoftuan krahinave më të afërta me Dibrën, ku një ndër të cilat ishte dhe Elbasani. Por, në fund të vitit 1899, për mobilizimit të ushtrisë osmane në Vilajetin e Kosovës Lidhja e Pejës u shtyp me forcë. Edhe në Dibër u dërguan forca të shumta përshtypjen e lëvizjes në mbështetje të Lidhjes së Pejës.

¹¹⁰Majlinda Peza, *Desertacion per mbrojtjen e grades Doktor i Shkencave, Zhvillimet politiko - arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*.

¹¹¹Akademi e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, *Historia e Shqipërisë, vëllimi II (1882-1908)*, Tiranë: 1973, f.70-71.

¹¹²*Po aty*, Tiranë: 1973, f.71.

Në këtë rrethana, duke filluar nga vera dhe vjeshta e viteve 1900-1901, vihet re një pakënaqësi e përgjithshme në rradhët e Shqiptarëve. Përmes burimeve arkivore osmane, në shtator 1901, raportohej se në Elbasan, popullsia e qytetit kishte mbyllur dyqanet, sepse kërkonte faljen e taksës të së dhjetës së tokës përreth qytetit të Elbasanit dhe ullishtave që gjendeshin në grykën e Zaranikës¹¹³. Raportohej gjithashtu, se në qytet kishte patur probleme lidhur me mungesën e rendit dhe qetësisë. Për këtë arsye më 8 shtator 1901, kërkohej që të silleshin në Elbasan dy kompani ushtarësh nga Dibra. E gjithë kjo situatë, revoltoi poullsinë e Elbasanit, e cila i vazhdoi revoltat deri në dhjetor 1901. Ndërkaq, si *nxitës kryesor i këtyre trazirave dhe revoltave të popullsisë së Elbasanit akuzohej Dervish beu*. Për këtë qëllim, nga Porta e Lartë, i kërkohej Riza beut, agait të taborrit të Manastirit që së bashku me 50 xhandarë në Elbasan, ta thërrisnin Dervish beun në qendër të Vilajetit¹¹⁴.

Gjithashtu, në tetor të vitit 1901, në krahinën e Tiranës, kërkohej ngritja e dy gazermave ushtarake dhe tri postave të xhandarmërisë. Bejlerët e Tiranës, por edhe ato të Elbasanit (Dervish beu), kërkonin që *në këmbim të mos t'i paguajnë taksa qeverisë*. Nga këto ngjarje duket që Dervishi ishte kthyer në një element shqetësues që po shqetëonte edhe vetë Portën e Lartë. Kërkesat që në dukje ishin me karakter ekonomik, adresonin problematika të një pakënaqësie të madhe ndaj Portës së Lartë dhe nuk do të ishte e largët dita kur këto kërkesa do të shndërroheshin në formë më ekstreme të mosbindjes ndaj saj. Ndërkohë theksojmë se, kërkesat për uljen apo mospagimin e taksave kishin qenë kërkesa të vazhdueshme të popullsisë shqiptare nën Perandorinë Osmane.

Gjendja vazhdonte të mbetej shumë kaotike edhe gjatë vitit 1902. Më 2 korrik të këtij viti, kryeministri Sait Pasha i shkruante Sulltanit: "*Shqipëria është duke dalë nga duart e shtetit Osman*", ndërsa lëvizjen shqiptare e quante si "*prelud të çështjes së ekzistencës ose të zhdukjes së sundimit osman në Ballkan*".¹¹⁵ Në këtë kontekst, pra në vazhden e përpjekjeve për të kundërshtuar politikën e Portës së Lartë, Dervish beu ka marrë pjesë në disa forma mosbindjeje në vitet 1902-1903 në Elbasan. Popullsia e Shpatit kishte kërkuar amnisti, por "*elementët sherraxhinj*", kështu etiketoheshin nga qeveria lokale, në qoftë se e siguronin atë, mund të rimblidheshin sërish duke përdorur armë kundër kompanisë. Dokumenti vërteton që në mbështetje të tyre, kishin dalë përfaqësues të parisë si: Shehysyvar Karaosmani, Aqif pasha, Dervish beu dhe Shefqet Vërlaci. Duket se të katërt nuk e kishin mbështetur

¹¹³Ernal Nurja, *Elbasani në dokumentat osmane të arkivit të Stambollit*, Tiranë: Onufri 2019, f. 346.

¹¹⁴Po aty, f.327.

¹¹⁵Po aty, f.306.

popullsinë e Shpatit, por e gjykonin të drejtë dhe me asnjë qëllim të dëmshëm përpjekjet e popullit për të kërkuar amnisti. Në këtë dokument, përmendej kryetari i grupit protestues të Shpatit, Jusuf Qose. Kërkesa e tij ishte disi e çuditshme po të kemi parasysh ndikimin e madh që kishin në këto zona bejlerët e Elbasanit, duke u shprehur se *“Mbi këtë situatë së fundmi Jusuf Qose nga Shpati dhe një tjetër person nga Sulova, që janë kryetarët e grupit të mbledhur kanë ardhur para meje dhe janë shprehur në mënyrë konfidenciale në emër të personave të grumbulluar në tubim se megjithëse kërkohet lirimi i të dënuarve, nuk duhen emëruar në këtë pozicion bejlerët e përmendur”*¹¹⁶.

Dervish Beu, ashtu si shumë shqiptarë, pati shpresuar në lëvizjen Xhonturke. Dihet që, shqiptarët patën luajtur një rol shumë të rëndësishëm në shpalljen e “Hyrrjetit” Kushtetutës Osmane të 23 korrikut 1908]. Siç dihet, më 20 Korrik 1908, kuvendi i mbledhur në Ferizaj, i dërgoi Sulltanit Abdyl Hamitit një telegram, ku kërkonin shpalljen e kushtetutës dhe gjithashtu mbledhjen e parlamentit. Më shumë se 30 000 shqiptarë, ishin gati të marshonin drejt Shkupit ¹¹⁷. Xhonturqit dolën në krah të lëvizjes së shqiptarëve. Në këto rrethana, Sulltani shpalli Kushtetutën më 23 Korrik 1908. Shpallja e saj u prit me gëzime edhe në Elbasan, qëndëshmohet edhe nga kujtimet e pjesëmarrësve në të: *“Në Elbasan dita e shpalljes së Hyrrjetit u prit me gëzim shumë të madh. U bë festë e madhe. Populli i vllazëruar pa dallim feje si edhe ushtarët ja shtruan me ahengje, me mish të pjekur, -shkruan në kujtimet e veta Jani Deliana, - me saze, me valle e këngë kombëtare. Burrat përqafoheshin njëri me tjetrin dhe thirrnin "Rroftë Hyrieti". Xhepi, tellalli më i vjetër i Elbasanit rrinte duke thirrur nëpër rrugët e pazarit: "U dha urdhër për me u këndue gjuha shqipe ashiqare". Ky lajm u përhap menjëherë dhe i gëzoi pa masë të gjithë patriotët që brohorisnin: "Rroftë gjuha shqipe! Rroftë Shqipëria!"*¹¹⁸.

¹¹⁶ BEO 1994/149478, Fondi i Kryeministrit Osmane, Porta e Lartë, 7 shkurt 1903, përkthyer nga osmanologu Eral Nurja.

¹¹⁷ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 377.

¹¹⁸ Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, *Aqif Pashë Elbasani (1860-1926)*, Tiranë 2012, f. 49

Ishte vera e vitit 1908. Simbas zakonit shkollat mbylleshin vitin mësimor dhe me atë rast organizoheshin ceremoni në të cilat këndoheshin këngë, jepeshin shfaqje, bëheshin recitime etj. Në festë merrnin pjesë prindërit e nxënësve, paria e qytetit, të cilës i rezervoheshin vendet e nderit. Në ceremoninë e atij viti ishin ftuar dhe kishin ardhur në ceremoninë e mbylljes së vitit shkollor, edhe Aqif Pasha, Shefqet Vërlaci, Dervish Biçaku, Qemal Karaosmani etj.

Gjatë zhvillimit të festës, papritur hyn brenda postieri i qytetit dhe i thotë: Aqif Pashës e të tjerëve se i kërkon të në telegraf Shemsi Pasha nga Manastiri. Ata u çuan menjëherë dhe shkuan në zyrën e telegrafës. Shemsi Pasha u tha se në Manastir ishte marrë vesh që këndej nga Elbasani disa oficera i kishin dalë kundra Dovletit (Perandorisë Osmane) dhe bënë propagandë kundër regjimit të Sulltan Abdyl Hamitit. Pasi tha këtë Shemsi Pasha urdhëroi që këta njerëz të dëmshëm duhej të gjendeshin dhe të kapeshin të gjallë ose të vriteshin.

Gjithashtu, në fondin e Dervish bej Biçakçiu, gjendet një kartolinë shumë interesante me nënshkrimin e Dervishit, ku shkruhet: “*Rroftë Atdheu, Rroftë Kombi, Rroft Ilirija, Rrofshin Osmallinjë, Rroftë Ustria*”.¹¹⁹ Sipas burimit në fjalë, kjo kartolinë ishte: “*Kujtim prej Shkodre*” dhe mban datën 11 korrik 1324, që sipas kalendarit hixhra përkon me 24 korrik 1908. Siç edhe dëshmohet në shumë qytete të Shqipërisë, ndërmjet të cilave edhe në Shkodër nga data 24-29 korrik 1908¹²⁰, janë mbajtur manifestime në mbështetje të Xhonturqve. Për këto festime dëshmon edhe autori Petër Bartl, në studimin e tij, i cili shkruan se, Komiteti Xhonturk mban festime për nder të shpalljes së Kushtetutës. Tema kryesore e oratorisë ishte Osmanizmi. Vlen të përmendet një fjalim i shkurtër i Dervish Himës në Shkodër ku ndër të tjera thotë: “*shqiptarët nuk do të jenë të kënaqur veçse kur të jenë të lirë në Shqipërinë e lirë, në mes të konfederatës së shteteve ballkanike nën sovranitetin e Sulltanit*”¹²¹. Shpallja e Kushtetës përvijoi idenë që për shqiptarët do të kishte më shumë liri dhe mundësi sidomos për të zhvilluar lëvizjen më qëllime kulturore në të gjithë vendin. Që të realizohej zhvillimi i diturisë, ishte shumë e rëndësishme që çdo shqiptar duhet të punojë për të lartësuar kombin: “*Që të bëjmë keto duhet, duhet vllazeri. Të lëmë mënjatë ligësitë dhe e armiqësitë që kemi në mes tonë, të harojmë gjakerat, të lëmë mënjatë hutat dhe fishekët, dhe të zemë pendët...dhe të mësojnë me dashuri*”¹²². Në fakt në rrjedhën e ngjarjeve që do të pasojnë vitet 1908-1912, patriotët shqiptarë do të zbulojnë esencën e Xhonturqve, sundimi i oligarkisë teokratike do të zëvendësohet me despotizëm kushtetons¹²³.

Aqif Pasha, Shefqet bej Vërlaci, Dervish bej Biçaku dhe Qemal Karaosmani, mbasi e biseduan çështjen ndërmjet tyre, iu përgjigjën Shemsi Pashës se ishte e rëndë të zinin ose të vrisnin oficerët e Sulltanit, prandaj i kërkuan t’u çonte një urdhër me shkrim. Shemsi Pasha pranoi dhe u premtoi se do t’ua çonte urdhërin me postën më të parë. Por disa orë më vonë vjen një telegram tjetër nga Manastiri në të cilin thuhej: Shemsi Pasha u vra sapo mbërriti në Manastir, më 7 korrik të vitit 1908.

¹¹⁹AQSH, Fondi. nr. 69, Dervish Biçakçiu, D. 5, fl. 49.

¹²⁰Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 377.

¹²¹Peter Bartl, *Myslimanët Shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare 1872-1912*, Tiranë: Dituria 2006, f.197.

¹²²Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f.377.

¹²³Arkivi i Ministrisë së jashtme Fanceze, korrespondencë politike, politika e jashtme, Shqipëria V-VII, Protestë e shqiptarëve te Egjiptit.

KAPITULLI . II

KORRESPONDENCA E DERVISH BIÇAKUT DHE VEPRIMTARIA E TIJ NË KUADRIN E KLUBEVE PATRIOTIKE

2.1 Letërkëmbimi me Faik Konicën

Në fund të shek. XIX veprimtaria e shqiptarëve jashtë Shqipërisë do të zgjerohej edhe më shumë, ku dallojnë për aktivitetin e tyre më të gjallë, shqiptarët në kolonitë e Rumanisë në Bukuresht. Atje atdhetarët shqiptarë gjetën kushte të favorshme ligjore për t'i vënë këto vatra në funksion të shqiptarizmit. Një nga shoqëritë më të rëndësishme ishte ajo me emrin “*Dituria*”. Ndërkaq, që në vitin 1899 në Bukuresht ishte ngritur “*Rrethi i studentëve shqiptarë*” me në krye Ibrahim Naxhiun, i njohur me emrin Dervish Hima. Qëllimi ishte të ndihmonte në përhapjen e kulturës midis shqiptarëve. Në këtë kontekst, Dervishi kishte arritur të hynte në kontakt edhe me patriotë që luftonin në të mirë të çështjes shqiptare si: Murat Toptani, Faik Konica, Nikolla Naço, Jani Vruho etj.

Sikurse pohon Konica në letrën dërguar Dervish beut, deri në 1896 duket që ai ka qëndruar në Stamboll. “*Më duket se qëndrimi i përhershëm në Turqi ju ka penguar për t’u vënë në dijeni të disa gjërave*”,¹²⁴ i shkruante Konica Dervishit. Kështu, në vitet 1897-1898, Dervishi ka lëvizur në drejtim të Bukureshtit dhe Elbasanit. Dihet fare mirë që Bukureshti ishte një vatër e rëndësishme e atdhetarizmit shqiptar. Kështu, një nga shoqëritë më të rëndësishme atje (siç e përmendëm më lart) ishte ajo e quajtur “*Dituria*”¹²⁵ ku një nga figurat kryesore ishte Pandeli Evangjeli, një tjetër atdhetar, i cili do të jepte kontributin e tij në politikën shqiptare përgjatë shekullit XX. Qëllimi kryesor i shoqërisë ishte të përhapte këndimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe. Në nëntor të 1897-ës, në Bukuresht mbahet një mbledhje e atdhetarëve shqiptarë, të cilin shtypi i kohës e cilëson si një kongres të shqiptarizmit,¹²⁶ ku një nga pjesëmarrësit ishte edhe Murat Toptani. Dervishi kishte lidhje krushqie me këtë të fundit pasi kishte marrë për grua motrën e tij. Murati shërbente si një urë lidhëse midis Dervishi Biçakçiu dhe kolonisë së Bukureshtit. Lidhjet ndërmjet tyre duken fare qartë edhe në mbështetjen që ata i kishin dhënë njëri-tjetrit në Lëvizjen Uniatise. Vihet re se në këtë kongres kanë marrë pjesë figura të tilla si: Faik Konica, Dervish Hima, Murat Toptani. Në këtë Kongres miratohet një memorandum sikurse shkruhej: “*Ndë emër të*

¹²⁴Faik Konica, Vepra IV, Tiranë: Duda 2001, f.6

¹²⁵Akademia e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 330.

¹²⁶Po aty, f. 330.

Llauzit (popullit) shqiptar", ku kërkohet njohja e popullsisë shqiptare dhe autonomia territoriale në një vilajet të vetëm¹²⁷.

Nga dokumentet e shumta vërtetohet që Dervish Biçakçiu përdorte shumë mirë në të shkruar edhe gjuhën frënge. Kjo dëshmohet në korespondencën që ai ka mbajtur me shumë atdhetarë, ku ndërmjet të tjerëve shquhen korespondenca që ai kishte me Faik Konicën. Interesante është përmbajtja e një letre që mbante datën 18 prill 1896, përmes së cilës evidentohet shqetësimi që ata ndanin në lidhje me *moskuptimin e thelbit* të një letre që kishin shkëmbyer me njëri tjetrin. Për këtë problem Konica shkruante: *"Ju nuk e keni kuptuar thelbin e mendimit tim: veçse gabimi nuk duhet kërkuar as tek ti as tek unë por tek gjuha jonë e gjorë, që është e varfër në terma të përgjithshme e filozofike, çka e bën të shprehësh me qartësinë e nevojshme për tema madhore"*¹³³.

Kjo letër tregon qartë që më shumë se kurrë shpirti i shqiptarizmit ishte rritur në lëvizjen tonë kombëtare. Të dy patriotët e shikojnë me shqetësim mungesën e një gjuhe të njesuar për shqiptarët. Në krye të letrës gjendet shënimi i Konicës, ku kërkesa kryesore e tij ndaj Dervishit dhe vetes, ishte tëshkruarit gjithmonë në shqip duke u shprehur se: *"Natyrish ky është një përjashtim dhe ju lutem të vazhdoni të më shkruani në gjuhën shqipe siç do të bëj dhe unë vetë"*¹³⁴. Mendojmë se një kërkesë e tij buronte nga fakti që të dy patriotët e shikonin më dhimbje mungesën e një shqipeje të shkruar e të konsoliduar, duke këmbëngulur që gjuha e komunikimit midis tyre dhe e të gjithë shqiptarëve të ishte ajo amtare.

Një letër tjetër e Konicës është ajo e datës 24 nëntor 1896, ku ai e vlerësonte Dervishin si një njeri *"me ment të lartë"*. Konica e vlerësonte Dervishin gjithashtu edhe për pjesëmarrjen në politikë, duke e konsideruar këtë pjesëmarrje thjesht si çështje nderi për të (Dervishin) dhe duke u shprehur se nuk niset *"për të holla"*. Edhe në këtë letër, ai ndan shqetësimin për zhvillimin e gjuhës shqipe. Ndërkaq, Konica i kërkonte sugjerime Dervishit edhe për një tjetër figurë tjetër të përfshirë në lëvizjen kombëtare që ndodhej në Bukuresht, Murat Bej Toptanin. Ai kërkonte të merrte garanci nga Dervishi, *"nëse ai mund të ndihmojë me diturinë e tij dhe nëse mund të ndihmojë në mënyrë tjetër"*.

Përmes kësaj korespondence, evidentohet qartë edhe një fakt tjetër që lidhe me personalitetin e Dervishit, i cili nuk është kursyer për të mbështetur financiarisht Konicën për botimin e revistës *"Albania"*. Kur bëjmë një pohim të tillë i referohemi, një letre që mban datën 7 maj 1897, ku Konica shkruante: *"Ndihmën që më dërgove për të përkohshmen e mora me gaz të madh"*¹³¹.

Në një tjetër letër të Konicës e vitit 1908 gjetur në dosjen personale të Dervishit, ai shkruante se: “*Shoh se klubi Bashkimi qenka themeluar dhe merr fortësi. S’kam dyshime se me atdhetar të njohur si ju, dhe më atdhetar të tjerë*”¹³².

Në këtë rast bëhet fjalë për klubin “Bashkimi” në Elbasan. Njoftimin për themelimin e tij Konica e kishte marrë nga korespondenca me Dervishin. Në fund të shek. XIX veprimtaria patriotike e shqiptarëve jashtë Shqipërisë në diasporë kishte ardhur duke u rritur. Një ndër qendrat më të rëndësishme që dallohej për një aktivitet të fuqishëm në funksion të mbështetjes sëlëvizjes kombëtare, ishte kolonia shqiptare e Bukureshtit në Rumani.

Në Rumani, atdhetarët shqiptarë gjetën kushte të favorshme ligjore për t’i vënë shndërruar këto qendra në vatra të rëndësishme në funksion të shqiptarizmit. Një nga shoqëritë më të rëndësishme të krijuar në Bukuresht nga patriotët shqiptarë ishte shoqëria që njihej me emrin “*Dituria*”.

Ndërkaq, në 1899 në Bukuresht ishte krijuar një shoqatë ku ishin anëtarësuar pjesa më e madhe e të rinjve shqiptarë, që njihej me emrin “*Rrethi i studentëve shqiptarë*”. Në krye kësaj shoqate shqiptare qëndronte patrioti Ibrahim Naxhiu, i njohur me emrin (pseudonimin) Dervish Hima. Qëllimi kryesor i kësaj shoqate ishte të ndihmonte në përhapjen e kulturës midis shqiptarëve. Në këtë kontekst, Dervish Hima kishte arritur të hynte në kontakt edhe me patriotë që luftonin në të mirë të çështjes shqiptare si: Murat Toptani, Faik Konica, Nikolla Naço, Jani Vruho etj.

¹³¹Faik Konica, vepra IV, Tiranë: Dudaj 2001, f. 6.

¹³²AQSH, Fondi nr. 69, Dervish Biçakçiu, Dos. 5, fl. 29.

¹³⁰ Faik Konica, Vepra IV, Tiranë: Dudaj 2001, f.

Në këtë letër, Konica i rrëfente Dervishit se kishte mbaruar së shkruari një Ese për Shqipërinë dhe shqiptarët (rreth 80 faqe) të titulluar “Ese mbi të ardhmen e Shqipërisë dhe përpjekjet e saj për pavarësi në shekullin XIX. Ali Pashë Tepelena, Revolucioni i 1831-shit, Kryengritja e vitit 1866, Abdyl beu dhe kryengritja e viteve 1879-80, roli i Bektashizmit në këtë kryengritje, Lëvizja bashkëkohore, Apostolol Margariti dhe ati Faveyrial. Naço dhe lëvizja anti-helenike”. Referuar burimit në fjalë, mendojmë se, kjo Ese më së shumti përbënte një traktat politik të Faik Konicës për çështjen shqiptare dhe të ardhmen politike të Shqipërisë. Interesant është fakti se, një ndër çështjet më të rëndësishme të parashtruar në ese, lidhej me pavarësinë e Shqipërisë, një mendim politik ky tepër i avancuar për atë kohë, po të kemi parasysh faktin që në kuadrin e platformës politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, predominonte platforma e autonomisë, një Shqipëri autonome nën Portën e Lartë. Këtë Ese 80-faqëshe të Konicës ku përfshiheshin edhe disa nga ngjarjet më kryesore të shek. XIX që kishin lidhje me Shqipërinë, Konica e kishte bërë gati për ta botuar në një nga organet e shtypit të kohës që dilnin në Bukuresht. Por, duke vijuar më tej, ai ndan me Dervishin edhe informacionin se, më pas ai e kishte djegur këtë material [Esene-në], duke i shkruar Dervishit, të cilin e konsideronte si një ndër miqtë e tij, se artikulli ishte dërguar në një revistë prestigjioze, por se drejtori i revistës nuk kishte pranuar ta botonte të plotë. Sipas Konicës, materiali që kishte dashur të botonte botuesi, ishte vetëm ai që kishte lidhje me bektashizmin duke u shprehur se: *"Unë parapëlqeva të hedh artikullin në zjarr sepse ai mund të rriste tirazhin e revistës, por nuk do t'u sillte kurrfarë dobie maleve tona të gjora"*.¹³⁵ Konica e shikonte situatën në Shqipëri shumë dëshpëruese dhe për të ekzistenca e Shqipërisë ishte e vështirë. Ai kërkonte zgjimin e shqiptarëve, pasi i shihte ata tepër moskokçarës. Konica ndante me Dervishin shqetësimin e madhe se në Shqipëri nuk kishte njerëz të arsimuar dhe se, nëse deri në atë kohë, me fatin e saj kishte luajtur sulltani, pas një çerek shekulli shqiptarët do të binin nën sundimin e sllavëve, grekëve dhe italianëve, duke u shprehur: *"si skllëvër të mjeruar që jemi"*. Për Konicën, ishte shumë e rëndësishme që shqiptarët të shihnin nga e ardhmja duke u shprehur përmes fjalëve: *"veçse mjere ata që vështrojnë vetëm të tashmen dhe nuk shqetësohen për të ardhmen"*.¹³⁶ Konica i sugjeronte mikut të tij Dervish, krijimin e një shoqërie sekrete (si karbonarizmi në Itali, Filiki-Eteria në Greqi para pavarësisë). Konica nuk sheh zgjidhje për t'u mbështetur tek ndonjë Fuqi e Madhe.

¹³³Faik Konica, vepra IV, Tiranë: Dudaj 2001, f. 5.

¹³⁴Po aty, f. 5

¹³⁵Po aty, f.

Aq i madh ishte dëshpërimi i tij në lidhje me intrigat e konspiracionet e fqinjëve, saqë si "zgjidhje" ai sugjeronte se shqiptarët duhet të vepronin si ata dhe t'i kundërpërgjigjeshin me të njëjtën monedhë fqinjë ballkanikë. Kjo ide e Konicës mund të ngrejë një sërë pyetjesh. A ishin shqiptarët e fundit të shekullit XIX të aftë për intriga?! A kishin mundësi financiare për të organizuar komplete? Po njerëzit e duhur? A kishin ndonjë fuqi të madhe që do t'i mbështeste? Pikërisht, zhvillimet historike do të jenë tregues të faktit se, kjo ide e tij lidhur me komplete nuk mund të realizohej. Ndërsa për sa i përket krijimit të shoqërive të fshehta në kuptimin e plotë të fjalës, që të luanin rol vendimtar në sigurimin e autonomisë në Shqipëri deri në vitin 1908 asnjëherë nuk dhanë rezultat. Shqiptarët ngritën shoqëri dhe klube të cilat shrytëzuan liritë e legjislacionit osman, që të mund të përhapnin kulturë dhe dije, por jo të realizonin komplete dhe intriga. Historia do të tregojë që vetëm falë mbështetjes që do të sigurohet nga fuqi si Italia dhe Austro-Hungaria të cilat kishin interesat e tyre gjeo-politike në Shqipëri dhe pas shumë humbjeve në ngjarjet e Luftërave Ballkanike 1912-1913, do mund të sigurohej njohja e Shqipërisë si shtet i pavarur. Konica kërkonte një zgjidhje shumë të thjeshtë duke dhënë një mesazh për të gjithë shqiptarët; një abetare dhe disa libra për të kthyer në jetë një popull që po vdes. Në këtë kontekst kuptohet që detyra e patriotëve është që duhet me patjetër të realizohet ngritja kulturore e shqiptarëve.

Sipas informacionit që marrim nga Konica, dëshmohet se deri në 1896 Dervishi kishte qëndruar gjatë në kryeqytetin e perandorisë në Stamboll. Kështu ai i drejtohej Dervishit përmes fjalëve: "*Më duket se qëndrimi i përhershëm në Turqi ju ka penguar për t'u vënë në dijeni të disa gjërave*"¹³⁷. Mendojmë se një shqetësim i tillë i Konicës, kishte lidhje me faktin se ai mendonte se tek njerëz të tillë, si ajo e Dervishit ai shikonte një ndër ata të rinj të cilët mund të kontribuonin fort për çështjen shqiptare.

¹³⁶Faik Konica, vepra IV, Tiranë: Dudaj 2001, f.5.

¹³⁷Po aty, f. 6.

Vitet 1896-1897 e gjejnë Dervishin në Bukuresht. Atje ra në kontakt me patriotë shqiptarë që punonin për Lëvizjen Kombëtare. Kështu, në vitet 1897-1898, Dervishi ka lëvizur në drejtim të Bukureshtit dhe Elbasanit. Dihet fare mirë që Bukureshti ishte një vatër e rëndësishme e atdhetarizmit shqiptar. Kështu, një nga shoqëritë më të rëndësishme atje (siç e përmendëm më lart) ishte ajo e quajtur “*Dituria*”¹³⁸. Një ndër figurat kryesore të diasporës shqiptare në Bukuresht dhe njëkohësisht drejtues i kësaj shoqërie ishte Pandeli Evangjeli, një tjetër atdhetar, i cili do të jepte kontributin e tij në politikën shqiptare të viteve '20 të shekullit XX. Qëllimi kryesor i shoqërisë “*Dituria*” ishte të përhapte këndimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe. Në kuadrin e veprimtarisë së kësaj shoqërie, në nëntor të 1898, në Bukuresht mbahet një mbledhje e atdhetarëve shqiptarë, të cilin shtypi i kohës e cilëson si një kongres të shqiptarizmit¹³⁹. Një nga pjesëmarrësit në këtë kongres ishte edhe Murat Toptani, një ndër miqtë dhe bashkëpunëtorët e Dervishit¹⁴⁰. Ai shërbente si një urë lidhëse ndërmjet Dervishit dhe kolonisë së Bukureshtit. Lidhjet ndërmjet tyre do të jenë evidente edhe në mbështetjen që ata i do t’i jepnin njëri-tjetrit në kuadrin e Lëvizjen Uniatise. Gjithashtu, në këtë kongres kanë marrë pjesë figura të tilla si: Faik Konica, Dervish Hima, Murat Toptani etj. Në këtë kongres miratohet një memorandum "nde emër te llauzit (popullit) shqiptar ku kërkohet njohja e kombësisë shqiptare dhe autonomia territoriale.”¹⁴¹

Një tjetër letër e Konicës ishte ajo e datës 24 nëntor 1896, ku kryesisht ai vlerësonte të riun Dervish Biçakçiu si një njeri “*me ment të lartë*”¹⁴². Ai vlerësonte Dervishin për pjesëmarrjen aktive të tij në politike, duke e konsideruar këtë veprim thjesht si çështje nderi për të (Dervishin) dhe që nuk motivohej nga përfitime të tjera sikurse shkruante ai: “*nuk niset për të holla*”. Edhe në këtë letër, ai ndan yë njëjtin shqetësimin për zhvillimin e gjuhës shqipe. Gjithashtu, përmes kësaj letre Konica i kërkonte Dervishit sugjerime edhe për një tjetër figurë të përfshirë në lëvizjen kombëtare dhe që ndodhej në Bukuresht, Murat Bej Toptanin. Ai kërkonte të dinte nga Dervishi: “*nëse ai mund të ndihmojë me diturinë e tij dhe nëse mund të ndihmojë në mënyrë tjetër*”. Duket qartë, që Dervishi nuk është kursyer për të mbështetur financiarisht Konicën për botimin e revistës “*Albania*”. Një fakt i tillë dëshmohet përmes falenderimit që Konica do t’i shprehë Dervishit në letrën e dt. 7 maj 1897 duke u shprehur: “*Ndihmën që më dërgove për të përkohshmen e mora me gaz të madh*”¹⁴³.

¹³⁸ Akademia e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 330.

¹³⁹ Po aty, f. 330.

¹⁴⁰ Dervish Biçakçiu ishte martuar me Motrën e Murat Toptanit.

¹⁴¹ Akademi e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë, Toena 2002, f. 272

¹⁴² Faik Konica, *Vepra IV*, Tiranë, Botimet Dudaj 2001, f. 12

¹⁴³ Po aty, f. 14

Burimet e kohës dëshmojnë në favor të faktit se, korespondenca ndërmjet Faik Konicës dhe Dervish Biçakçiu, ka vijuar edhe në fillim të shek.XX. Konica ishte në dijeni të zhvillimeve politiko-arsimore në trevën e Elbasanit dhe njëkohësisht edhe të veprimtarisë së Dervishit. Kur bëjmë një pohim të tillë, më së shumti i refrohemi një tjetër letre dërguar Dervishit në vitin 1908 gjetur në dosjen personale të Dervishit, ku ai shkruante se: *“Shoh se klubi Bashkimi qenka themeluar dhe merr fortësi. S’kam dyshime se me atdhetar të njohur si ju, dhe më atdhetar të tjerë, Elbasani ka për loxur një lodër te madhe e të xghuat¹⁴⁴të Shqipërisë”*.¹⁴⁵ Në këtë letër, Konica përmend edhe një atdhetar tjetër të shquar të Elbasanit që ishte Lef Nosi, duke shprehur gëzimin se për të Elbasani, duhet të bëhet *centri [qendra]* i gjithë Shqipërisë. Konica pa dyshim vlerësonte qytetin e lindjes së Dervishit, duke kuptuar rëndësinë e madhe që kishte pozicioni gjeografik i tij. Gjithashtu, Konica vlerësonte shumë edhe një figurë tjetër të njohur, Mehdi bej Frashërin¹⁴⁶ i cili sipas tij kishte ndikuar deri tek *lord Braitford* të “lëvdoj” me *"Times"* Mehdiun. *“Skam dyshim, thotë ai që kjo do të ndihmoj Mehdi Beut pranë guvernës së re e në disa muaj do të bëhet mytesoveif*.^{147”} Kjo letër e Konicës ishte tregues i faktit se bejlerët shqiptarë funksiononin mbi bazën e tarafeve, pavarësisht vendit që do tëzërë secili në këtë histori. Nga ana tjetër evidentohet qartë se sa peshë ka fjala e një anglezi për të bërë karrierë.

2.2 Letërkëmbime të Dervish Biçakut përgjatë viteve 1895-1914

Deri në vitin 1909, në qytetin e Elbasanit ishin krijuar dy klube patriotike. I pari ishte klubi “Bashkimi” i krijuar në vitin 1908 pas shpalljes së Hyrrietit, në krye të të cilit qëndronte Aqif Pasha dhe i dyti klubi “Vllaznija” me kryetar Dervish beun. Dy kushërinjtë Biçakçinj ishin në krye të dy klubeve të para patriotike që u krijuan fillimisht në qytetin e Elbasanit. Pas krijimit të klubeve "Vllaznia" e "Bashkimi", mosmarrëveshjet ndërmjet tyre shfaqeshin hera-herës. Këto mosmarrëveshje ishin jo vetëm verbale, gjë që dëshohet përmes fjalëve që shkruhen në letër: *“...sikurse me fjalë dje e shfaqëm...”*), por që konfliktet vijonin

¹⁴⁴zgjuar

¹⁴⁵AQSH, Fondi 69, Dervish Biçakçiu, D. 5, fl.30

¹⁴⁶B. Meta dhe H. Bello, *Syrja dhe Eqerem bej Vora*, Vëllimi II, Tiranë, Onufri 2020, f.64. Mehdi Frashëri kishte kryer studimet në Stamboll me rezultate të shkëlqyera, karakterizohet nga thjeshtësia, zotësia e tij personale, pa anësia do të bëj që të jetë një nga figurat kryesorë në politikën shqiptare në gjysmën e parë të shekullit XIX.

¹⁴⁷AQSH, F.69 Dervish Biçakçiu, Dos. 5, fl.29.

edhe përmes korespondencës e letërkëmbimit ndërmjet tyre. Një korespondencë e tillë është edhe ajo e datave 11 - 12 prill 1909 : një letër e kryetarit të klubit "Vllaznia", Dervish beut dhe tjetra si kundërpërgjigje nga kryetari i klubit "Bashkimi". Së pari ajo që të bie në sy, është pakënaqësia e shfaqur përmes fjalëve të përdorura më shpesh; "*idhnim*", "*sundim*" dhe "*padrejtësi*", ku kërkohej një e drejtë, që sipas Dervishit i ishte mohuar klubit të tij. Fjalët e përdorura janë shprehje e një ankese drejtuar klubit "Bashkimi" duke u shprehur se: "*Me idhnim shofim një të padrejtë bamun Klubit "Vllaznia" nga sundimi i Klubit Bashkimi*", mbi një letër, që është në adresë të klubit "Vllaznia" nga sundimtari nuk bëhet e qartë se cili mund të jetë emri i tij], por është marrë dhe është hapur nga anëtarë të klubit tjetër. Ndërkaq, përgjigjja e nënkryesonjësit të klubit "Bashkimi", Hysen Hastopalli, vjen me tone më të buta e pa "*qëllim të keq sikurse na duket, doni juve të besoni [...] prandaj do themi se do t'ishte shumë më mirë një për një mos nisim me protestime, po të mirreshim vesh një herë*" se "*shkaku i kësaj pune*" është "*nonji tjetër gjë e paudhë*"¹⁴⁸. Shpeshherë të dy klubet e gjenin veten në grindje nga ndërhyrje të tjera, siç aludohet edhe në letër¹⁴⁹.

Përmendim këtu edhe një tjetër figurë si Faik Konica, i cili thekson se "*Të mendojmë shpesh këto fjalë se janë të vërteta edhe s'i them as unë as tjetër kush; i thotë puna, i thonë shekujt, i thotë historia; kombet që s'dinë përveç grindje e zije, si kombi jonë, janë kombe të humbur*"¹⁵⁰.

Duke qenë kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të Normales, Dervishi ka pasur komunikim me shumë personalitete të kohës, një ndër to ishte edhe Jani Vruho. Ai ka qenë një publicist dhe figurë e nacionalizmit shqiptar. Lindi më 5 gusht 1863, në Poliçan. Kur ishte ende i ri, emigroi drejt Egjiptit, në qytetin El Fayum, ku kaloi pjesën më të madhe të jetës. U dallua për publikimet e artikujve në mbrojtje të çështjes kombëre, veçanërisht në gazetën "Rrufeja" që e publikoi vetë. Nga Elbasani ishin tre personalitete që ishin abonuar në gazetën e tij duke përmendur:

- 1.Monseur Shefqet Ismail Bej Vlasi (Vërlaci)
- 2.Monseur Dervish bej Biçakçiu
3. Aqif Pasha¹⁵¹

Nëpërmjet gazetës Rrufeja dhe shkrimeve që botonte në shtypin e kohës, ai gjithnjë pasqyrore kushtet në të cilat ndodhej Shqipëria, duke i bërë një analizë të thellë shkaqeve, ku

¹⁴⁸AQSH, F. nr. 102, Koleksioni i shoqërive dhe klubeve shqiptare, D. 12, f. 82.

¹⁴⁹Po aty, D. 12, f. 82.

¹⁵⁰AQSH, F. 592, Milto Sotir Gurra, D. 2, fl. 1-4.

¹⁵¹Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, Aqif Pasha (1860-1926), Tiranë, Marin Barleti 2012, f. 64.

padyschim me fatet e Shqipërisë luanin shtetet fqinjë por edhe Fuqitë e Mëdha. Ai e rendiste veten në një prej publicistëve më të mirë të kohës dhe që gjithë jetën e tij e vuri në shërbim të çështjes kombëtare. Në shkrimet e tij evidentohet politika pragmatiste e ndjekur nga Diplomacia europiane e cila kishte vetëm një merak sipastij: “Të përmbahej qetësia dhe paqja midis të fortëve të dheut”¹⁵². Në të gjithë shkrimet e tij ndjehet shpirti i atdhetarit të flaktë dhe mbi të gjitha mjeshtër i penës shqipe¹⁵³.

Në këtë kuadër, nuk mungon edhe korespondenca e tij me Dervishin. Në një letër që mban datën 18 vjeshtë e dytë 1909, Dervishi i drejtohej atij me fjalët: “*Zotni i shkronjave shqiptare*” duke i kërkuar me shumë mirësjellje jo vetëm të vazhdojë t’i dërgojë gazeta, por edhe letra. Ai ndan me të kënaqësinë e përpjekjeve për hapjen e shkollës Normale. Kështu në fund të tetorit 1909, ai lajmëron atë për projektet në Elbasan për hapjen e saj: “*Për punën e shkollës Normale u lajmërojmë se më 3 të të muajit që vjen (behët fjalë për datën 16 Nëntor 1909) do të çelë dyert me system European dhe me mësim të larteramjaft për të nxjerr mesonjës për shkollat shqipe dhe shpresojmë se me fuqinë e atdhetarëve do të mbahet mot me jete. Nuk dyshojmë as pak se shqiptarët e Misirit do të bajn detyrën e tyre si kurdoher kanë rrëfyer e ca më tepër si zotnia jote që me ndihmesën e vet po bën një punë kombëtare duke nxjerrun gazetën*”¹⁵⁴ Dervishi shprehej besimplotë se puna e nisur do të bënte që shqiptarët të dilnin nga prapambetja duke u shprehur përmes fjalëve: “*le të perpiqemi pra së bashku juve prej andej dhe neve prej këtij që ta nxjerrim nga errësira, t’a dritësojmë dhe t’a qytetërojmë kombin t’onë*”.¹⁵⁵

Një tjetër letër të datës 17 vjeshtë e dytë 1909, Dervishi i shpjegonte Jani Vruhos nevojën e madhe që kishte shkolla Normale për libra. Pikërisht për këtë qëllim ishte menduar të ngrihej një bibliotekë që për t’i ardhur në ndihmë mësuesvë. Ai i kishte idetë shumë të qarta lidhur me të ardhmen e pavarur të Shqipërisë kur shprehej: “*Kjo bibliotekë sot për sot do të mbushi nevojat e Shkollës, po pas kohe si të pasurohet mund të jetë basi i një Biblioteke Kombetare*”¹⁵⁶. Vizioni i tij për bibliotekën kombëtare është një ide që për kohën në të cilën kalonte Shqipëria, tregonte qartë që shpresa e tij ishte e madhe dhe që shumë shpejt kombi shiptar do të radhitej përkrah kombeve të qytetëruara dhe të civilizuar të Evropës. Dervishi e kuptonte fare mirë që investimi për një bibliotekë do të ishte një investim për të ardhmen e brezave që do të vinin dhe padyshim, do të ishte investim për të ardhmen e një Shqipërie ndryshe.

¹⁵²Arben Puto, *Pavarësia Shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: Toena 2012, f. 51.

¹⁵³Po aty, f. 52.

¹⁵⁴AQSH, F. Jani Vruho, Dos. 7, fl. 80-81.

¹⁵⁵Po aty, Dos. 7, fl. 80-81.

¹⁵⁶AQSH, F. 69, Dos. 7, fl. 3.

Në kërkesën e tij për libra, ai udhëzonte që librat të dërgoheshin në Durrës në adresë të Pietro Danisca¹⁵⁷. Gjithashtu nga komunikimi midis të dyve kuptohet qartë që ata mbanin lidhje me një tjetër patriot tjetër Elbasanas që ishte Aleksandër Xhuvani.

Në një tjetër letër të datës 3 prill 1910, Dervishi shprehte kënaqësinë e përputhshmërisë së mendimeve për çështjen shqiptare, që ushqenin të dy figurat e njohura, duke theksuar ndër të tjera se "*mendimet e zotënisë suajë nuk ndryshojnë asfare pothua prej mendimevet që ushqenj edhe unë sikurse dhe çdo shqiptar që ëndërron një përparim me themel për atdheun e dashur*"¹⁵⁸. Komunikimi i tyre ka vijuar për muaj, siç duket edhe në letër ku citohet data 20 mars si pjesë e komunikimit të mëparshëm për të njëjtat shqetësime, për vendimin e marrë për të ngritur më në fund ndërtesën e Normales dhe letra konsiston në kërkesën e Dervishit për ndihma nga ana e Vruhos dhe shqiptarëve të Misirit. Dervishi nuk nguron madje edhe të njoftojë J.Vruhon se do ta vizitojë në Egjipt për mbledhjen e ndihmave. Nga letra duket qartë që ekzistonte një lidhje edhe midis Jani Vruhos dhe mikut të ngushtë të Dervishit, Aleksandër Xhuvanit, gjë e cila vërtetohet nga letërkëmbimet e shumta të gjetura në fondin e Jani Vruhos. Aleksandër Xhuvani për ti shpëtuar terrorit turk kishte emigruar për disa kohë në Egjipt. Kështu në një nga letrat më interesante, Aleksandër Xhuvani i shkruante Jani Vruhos: "*Na dridhet zemra kur mendohemi se ajo Shqipëri, për të cilën na kishim shpresë të madhe t'a ngjallnim e t'a rimëkëmbnim, po copëtohet e po humbet. Jo, me gjithë këtë, kemi një shkëndijë shprese: të gjitha gazetatat e Evropës, edhe më fort, ato t'Italisë, t'Austrisë e t'Anglisë, shkuajnë se duhet bërë një Shqipëri më vehte*"¹⁵⁹. Aleksandër Xhuvani vlerësonte ndjenjat kombëtare "*për gazetën e vlyerë Rrufeen që nxirrnit për ndjenjat komptare*", në letrën dërguar Jani Vruhos më 25/8/1910. Ai i tregonte që ishte Elbasanas dhe kishte studiuar në Greqi për filologji 4 vjet në Athinë dhe që ishte larguar nga Greqia sepse kërkonin ta quanin Grek duke u shprehur: "*mbasi u xûna me Grekët, të cilët duan qi shqiptarët ti thonë vetes Grek*", i shpjegonte se kishte punuar në Elbasan si "*mësonjës*" në shkollën Normale "*e cila u hap me shpresë se do të përhapte dritën e mësimi komptar nëpër Shqipëri...në të cilën po gatuhesh bashkimi i Toskëve e i gegevët, po shkulesh fanatizmi e po rritësh idheja kombëtare*". Ai shkruante se terrori xhonturk nuk kurse, rrafi e burgosi burrat atdhetarë"*dhe se shume atdhetarë ikën nga Shqiperia... Aqif Pasha, Dervish Beu, Shefqet Beu shtyllat e atdhësiës t'Elbasanit iknë n'Italië*".¹⁶⁰ Ky vlerësim në gojën e një prej mendjeve më të ndritura që ka

¹⁵⁷AQSH, Fondi 57, Shefqet Vërlaci, Dos. 1, fl. 133 (Pietro Danisca duket që ka qëndruar shumë gjatë në Shqipëri dhe ndër të tjera ka qenë Sekretari i tretë i Legatës së L.M.R. të Italisë).

¹⁵⁸AQSH, F.Jani Vruho, Dos. 6, fl. 6.

¹⁵⁹AQSH, F. Jani Vruho, Dos. 6, fl.6.

¹⁶⁰Po aty, Dos. 6, fl.6.

nxjerrë qyteti i Elbasanit merr një dimension atdhetar duke evidentuar faktin që terrori osman po shtypte me egërsi çdo lloj përpjekje të Shqiptarëve për më shumë liri. Atdhetar i cili që në moshë të re kishte pasur mësues një nga figurat më të shquara të Rilindjes kombëtare Kostandin Kristoforidhin ishte i vetëdijshëm që vetëm dija mund të siguronte zgjimin kombëtar. Që më 1897 ai në gazetën Albania¹⁶¹ kishte shkruar mbi pastërtinë e gjuhës shqipe, mision të cilin ai do ta vazhdojë edhe në vitet në vazhdim. Aleksandër Xhuvani, në letrën dërguar Jani Vruhos vlerësonte edhe një herë punën e Dervishit në shkollën Normale duke e kuptuar fare mirë që mbrojtja e saj do të thoshte të mbroje gjuhën dhe të ardhmen e Shqipërisë.

Në kuadrin e komunikimit me patriotët në disporë, kemi një letër me patriotin Ibrahim Temo, i cili luante një rol primar në koloninë e shqiptarëve në Bukuresht. Ai lindi në Strugë më 1865. Në profesion ishte mjek i diplomuar në Stamboll më 1892. Më 1895 ai shkon në Rumani ku atje krijon nëndegë të komitetit "Bashkim e Përparim" ku marrin pjesë edhe Dervish Hima. Nëndegë të këtij komiteti krijohen edhe në Strugë e Elbasan. Më 1908 ai kandidon për deputet në Elbasan dhe kjo nuk ishte e rastësishme. Midis dy patriotëve ndahet shqetësimi për mosreagim të Portës së Lartë ndaj një memorandumit të dërguar kësaj të fundit nga shqiptarët. Siç dihet, meqenëse në këtë periudhë sulltani nuk ishte në gjendje të zgjidhte "çështjen maqedonase" dhe as të ndalonte trysninë e Fuqive të Mëdha, më 22 prill 1896 ai shpall dekretin mbi reformat në Vilajetin e Rumelisë, ku pretendonte të garantonte barazinë e të krishterëve me myslimanët. Këto reforma u zbatuan në mënyrë gjysmake dhe nuk arritën të parandalonin lëvizjet çlirimtare në Ballkan¹⁶². Reformat, në rastin e shqiptarëve, u pritën me shqetësim, sepse ata e kuptonin qartë që përfshirja e vilajetit të Manastirit dhe Kosovës do të thoshte shpërbërje e tyre dhe pranim si toka sllavo-maqedonase¹⁶³. Për këto arsye, Dervishi më datë 25 Maj 1896, në letrën që i dërgonte mikut të tij Ibrahim Temo, zgjidhjen për fatet e shqiptarëve ai e shikonte te mbështetja e Europës duke u shprehur: "*Lipemi t'i qahemi Evropës*"¹⁶⁴. Ai rrëfente se ata i kishin dërguar një memorandum myfetishatit të Rumelisë, duke i shkruar gjithashtu: "*Dashnia e mëmëdheut ashtë një mall i padurushëm*". Shqetësimi më i madh që ai ndante me Ibrahim Temon, ishte kërkesa për të patur libra shqip sikurse shprehet: "*Veçse jemi keq për ca vivlla shqip*". Nga letra gjithashtu kuptohet qartë që ai ishte

¹⁶¹Akademia e Shkencave, *Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë: Mihal Duri 1986, f.74.

¹⁶²Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 261.

¹⁶³Po aty, f. 262.

¹⁶⁴AQSH, Fondi nr.2, Dos. 32/3, fl. 4.

i përfshirë në çështjet e atdhetarizmit dhe ishte në kontakt me atdhetarë si: Nikolla Naço, Ibrahim Bumci etj.¹⁶⁵

Dervishi Biçakçiu e kuptonte fare mirë që pas hapjes së Normales, që kjo shkollë të funksiononte sa më mirë duhet të sigurohej mbështetjen e bashkëatdhetarëve të organizuar në shoqëri dhe klube patriotike. Një nga këto shoqëri, ishte dhe ajo e quajtur Besa-Besë e krijuar në ShBA që më 1908 duke luajtur një rol të rëndësishëm në përpjekjet për të zgjidhur çështjen shqiptare. Themeluesi i saj ishte Kristo Krika. Kjo shoqëri botoi gazetën *Dielli* një nga më të njohurat në botën jashtë Shqipërisë që luftoi për çështjen shqiptare. Kjo gazetë drejtohej nga Fan Noli dhe deviza e kësaj gazete ishte “ *Dielli është organ i shqiptarëve kombëtar, që kërkon vetëqeverimin e Shqipërisë*”¹⁶⁶. Në një komunikim me shoqërinë "Besa-Besë" në SHBA për hapjen e Normales, ai i shkruante më datë 12 shtator 1909 dhe i drejtohej Pleqësisë së Shoqërisë "Besa-Besë"¹⁶⁷ ku i bëheshin të ditura vendimet e kongresit të Elbasanit: "Kam nderin t'u bajmë sot të njoftun fare shkurtasi se Kongresi pas ditësh pune vendosi këto:

1. Për çeljen e shkollës Normale në Elbasan;
2. Klubet e shoqënitë të bashkohen;
3. Për formimin e shoqërisë "Përparimi" në Korçë.

Dervishi i siguronte se do të vijonte t'i mbante të informuar duke u shkruar: "...do të merren vesh plotësisht punët e Kongresit sapo të shtypen kanonizmat dhe vendimet"¹⁶⁸. Duke fare qartë që aktiviteti i tij në funksion të atdhetarizmit ka qenë i shprehur qartë duke kërkuar që të beheshin të ditura të gjitha vendimet historike të Kongresit të Elbasanit¹⁶⁹. Korespondenca e tij për të bërë të ditur veprimatrinë e Normales ka vazhduar pa ndërpreje. Kështu në një letër tjetër ai shkruante: "Janë ma tepër se shtatë muaj qi shkolla Normale ka hapun dyert e sajë për me i dhanë djalëries shqiptare dritën e dituniës që ka pas mangut." Këto janë fjalë që niste letrën Dervishi drejtuar gazetës "Bashkimi i Kombit"¹⁷⁰. Ai shprehte kënaqësinë që numri i nxënësve ishte rritur: "kanë ardhur nga qishdo kand i Shqypënisë janë tue marrë këtë dritë, - duke vijuar të tregonte se nxënësit po tregojnë një zell të madh për të mësuar në gjuhën shqipe dhe se numri i tyre i kish kaluar çdo parashikim. Në letër del në pah edhe njëherë shpirti i tij patriotik kur shprehet : "Per lavdi të kombit t'ënë e

¹⁶⁵ Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: albPaper 2004, f.393.

¹⁶⁶ Po aty, f. 393.

¹⁶⁷ Shoqëria Besa-Besë ishte krijuar në Boston Sh.B.A më 6 Janar 1907, kryetar i saj u zgjodh Fan Noli duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në lëvizjen patriotike atje. Ajo botoi gazetën "Dielli".

¹⁶⁸ Po aty, f. 393.

¹⁶⁹ Po aty, f. 354.

¹⁷⁰ Po aty, f. 393.

për gëzim të zemres s'eme nxënësit janë ma tepër se 140." Ai nënvizonte faktin se duke u shtuar nxënësit, shtoheshin nevojat e shkollës dhe se ajo që është kryesorja është nevoja për një ndërtesë të mirë e që në fakt duhet t'i përgjigjet dinjitetit të kombit tonë. Ai e justifikon me faktin e drejtë që shëndeti i nxënësve kërkon një ndërtesë të mirë e të gjërë, një ndërtesë që siç thotë ai: *"te bame për një shkollë Elbasani"*, i bindur kështu se qyteti që ngriti atë shkollë ishte qyteti i duhur për nga kultura, tradita, historia dhe figurat që mbarte. Përmes letrës, Dervishi theksonte jo vetëm rëndësinë e shkollës, por dhe kontributin monetar që të gjithë duhet të japin për të si një *"një shkollë shqipe qi t'i mbushi gjithë nevojat e një të këtillë mësonjëtoe"*¹⁷¹. Edhe në gazetën *"Tomorri"* flitej për *"nevojën e ngritjes së një ndërtese të re për Normalen"* dhe ndër të tjera përmendet: *"nevoja e një të tille ndërtese më të madhe, pasi pritet të jenë 200-300 nxënës dhe nuk ekziston, jo në Elbasan, por në tërë Shqipërinë një ndërtesë në ato përmasa, për aq nxënës"*.¹⁷² Këtu në këtë letër përmendet Dervishi, pasi është marrë vesh se *"Dervish be Elbasani, kryetari i parësiës"* së atjeshme *"qëllon për pak kohë të dalë nëpër Shqipëri dhe jasht Turqisë ku gjenden atdhetarë mjaft të pasun, me qëllim që të mbledhë të hollat e nevojshme për ndërtesën"* që kanë nevojë, siç e përmendëm më lart.

Nga kjo shihet se Dervish beu ka dhënë një kontribut të madh për një godinë të re të kësaj shkolle, ka qenë mbështetës i fuqishëm e me zë. Po ashtu edhe në një letër tjetër, evidentohet kontributi i palodhur i Dervish beut. Kështu Luigj Gurakuqi, e përmend në letrën dërguar Jani Vruhos e padaturar [mendohet të jetë e pranverës së vitit 1910] ku shpjegon se *"motin që vjen do të kemi më tepër s 500 çuna"* dhe kërkohen ndihma të shumta që duhet të vijnë jo vetëm nga vendi por edhe jashtë vendit për ta mbajtur shkollën Normale, si *"qëndri i arësimit t'onë"*. Aty theksohet puna e palodhur e Dervishit *"ndë punërat kombëtare"*, pasi po jepte ndihmë të madhe në lidhje me shkollën Normale. Shihet tepër vlerësues kontributi i vazhdueshëm i tij në ekzistencën e kësaj shkolle. Ky letërkëmbim kërkohet të vijojë me *"letra të gjata e të dendura"* gjë që tregon shqetësimin e madh të tre patriotëve për mbarëvajtjen e Normales¹⁷³.

Një ndër veprimtarët dhe patriotët shqiptarë në Egjipt e më pas në Rumani me të cilin Dervish beu mbante korespondencë ishte Nikolla Naço. Ai ishte mbështetës i flaktë i çështjes shqiptare e sidomos i shkollës shqipe. N. Naço ishte mbështetës i idesë që shqiptarët duhet të

¹⁷¹Po aty, f. 394.

¹⁷²Gazeta *"Tomorri"*, Nr. 6, 30 prill 1910.

¹⁷³AQSH, F. Jani Vruho, D. 7, fl. 193-194. N. Naço vdiq në Bukuresht në vitin 1913 ishte një nga atdhetarët kryesorë të kolonisë së Bukureshtit. Për veprimtarinë e tij Poradeci e cilësonte si *"shqiptar epopeik që nxjerr tym dhe zjarr nga mushkëritë e tij të çelnikta."*

ishin bashkëpunues me arumunët e Maqedonisë, Shqipërisë dhe rajonit të Pindusit¹⁷⁴. Kjo ide vinte prej shpresës për ndihmë politike dhe materiale rumune. Pasi ishte njohës i mirë i politikës rumune, ai mendonte se shqiptarët mund të gjenin përkrahje politike tek Rumania duke sfiduar përpjekjet shoviniste për copëtimin e Shqipërisë prej Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë. Lidhur me çështjen e alfabetit shqip, Nikolla Naço kundërshtoi alfabetin e Stambollit dhe mbështeti idenë e një alfabeti të vetëm latin, si më të rëndësishëm për bashkimin e shqiptarëve. Nikolla Naços i takon merita si themelues i një prej gazetave më të vjetra shqiptare në Rumani, "Shqiptari" (The Albanian 1888 - 1903). Një gazetë e përjavshme me karakter politiko - kulturor që botohej në disa gjuhë (frëngjisht, shqip dhe rumunisht) dhe që zgjati disa vjet¹⁷⁵. Ai ishte autor i disa memorandumeve dërguar Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha në mbrojtje të çështjes shqiptare.

Nikolla Naço kërkonte gjithashtu të kishte edhe mbështetjen e austro-hungarezëve dhe italianëve,¹⁷⁶ si dy Fuqi të Mëdha që kishin interesa në Ballkan. Në këtë pikë mendimet e tij konvergojnë me profilin e njohur tashmë nga ne të Dervish Biçakçiu. Të dy e shihnin mbështetjen e Austro-Hungarisë të rëndësishme për zhvillimin e kulturës dhe të shkollës shqipe. Më herët që me lëvizjen Uniatiste Dervish Bicakçiu kishte kërkuar mbështetjen e Austro-Hungarisë dhe Italisë në mbështetje të zhvillimit të gjuhës shqipe.

Në një letër drejtuar Dervishit, Nikolla Naço shpreh mbështetjen në thirrjen e Dervishit për organizimin e Kongresit të Elbasanit. Në këtë letër sqarohet se N. Naço mbështeste dhe i bashkohej klubit "Vllaznia" dhe protestës së tyre kundër mbylljes së klubeve nga Porta e Lartë, Stambolli. Ai theksonte ndër të tjera se "*së bashku me gjithë klubet e tjerë të japim protestonë që lypsetë*" duke theksuar rëndësinë e madhe të çështjes. Kësaj përfaqësie, do t'i shtohej mbështetja e klubit të Selanikut dhe ai garantonte pjesëmarrje dhe "emërat e të gjithë delegatëve vilajetit" të Selanikut. Nikolla Naço tregonte edhe një herë që të gjithë jetën e tij e kishte vënë në shërbim të vendit. Në këtë letër ai konfirmonte jo vetëm pjesëmarrjen në kongres por edhe mbështetjen për këtë ngjarje të shënuar të historisë sonë kombëtare. Në fund ai vlerësonte edhe miqësinë e vjetër me Dervish beun, si dhe i shprehte mirënjohje që s'e kishte harruar edhe pas gjithë këtyre viteve duke u shprehur se: "*Miq të mirë ndër kohë çlirimi njihen më bukur...*"¹⁷⁷ Naço gjatë gjithë jetës së tij punoi në të mirë të çështjes kombëtare.

¹⁷⁴Stavri Skëndo, "Zgjimi Kombëtar Shqiptar", Tiranë: Botimet Maluka, f. 148.

¹⁷⁵Po aty f. 149 – 151.

¹⁷⁶Po aty f. 149.

¹⁷⁷Stavro Skëndo, "Zgjimi Kombëtar Shqiptar", Tiranë: Botimet Maluka, f. 148.

Në një letër të datës 3 tetor 1909 të "Këshillit mbikëqyrës të shkollës Normale", ndryshe thënë "zëdhënje", Dervish beu i bën të njohur *"shqipëtarëvet dhe për më tepër prindërvet"* se me ndihmën e gjithë Shqipërisë, shkolla *Normale* do të hapë dyert më datë 24 të muajit tetor. Në fakt është një njoftim që bën Komisioni i Shkollës Normale, kryetar i së cilës është Dervishi, mbi hapjen e shkollës Normale. Në letër përcaktohen edhe paralelet e klasave që do të krijohen në shkollë si dhe paralelisht me lëndë të tjera në shkollën e mesme, do të mësohej edhe gjuha shqipe. Pasi bën një përmbledhje të organizimit të shkollës ai shkruan: *"Programi do të jetë i plotë, sipas shkollave të huaja të këtij drejtimi, kështu që nxënësit që do të mbarojnë këtë shkollë përveç që do të kenë një arësim të plotë, do të kenë edhe një diplomë mësorje për shkollat e para dhe të dyta"*¹⁷⁸. Ai njoftonte gjithashtu se nxënësit në shkollë do të mësonin gjuhë të huaja turqisht, frëngjisht me detyrim dhe me dëshirën e tyre mund të mësohej greqisht dhe anglisht. Në këtë letër, del në pah mbështetja financiare e nxënësve nga ky këshill edhe në *"rrojtjen e tyre me një pagesë 10 lira tyrke (të cilat do të paguheshin në dy kohra) ushqimin dhe të ndenjurit për një mot shkollar"*. Po në lidhje me kontributin e tij në Normale, është evident fakti se edhe i vëllai më i vogël, Hasan beu angazhohet në Këshillin Mbikëqyrës si kryetar komisioni si vendimarrës në mbarëvajtjen e shkollës¹⁷⁹. Jo vetëm Dervishi, por e tërë vëllazëria ishin aktivë dhe mbështetës të Normales. Me rastin e mbylljes së shkollës, jepeshin dhurata motivuese dhe kontributi i tyre është i dokumentuar si mbështetje.¹⁸⁰

Në një letër dërguar nga Fiume, Dervishi ndante shqetësimin për mbylljen e shkollës Normale nga terrori Xhonturk në vjeshtën e 1910. E shkruar nga Fiume e Italisë, por është e paqartë për personin të cilit i adresohet. Ndërkaq, përmendet përsëri signor Pietro Danisca¹⁸¹, përmes ndërmjetësisë të së cilit, dërgohet letra. Në këtë periudhë, Xhonturqit kanë mbyllur shkollën Normale dhe e kanë akuzuar atë (Dervishin) si përhapës të germave latine. Theksojmë këtu ndikimin e tij perëndimor prej formimit frankofon, shkollimit të tij por këtë ndikim e shohim edhe si rrjedhojë të bashkëpunimit me figura të njohura si: Naço, Konica etj., të cilët e shihnin të ardhmen e Shqipërisë me drejtim perëndimor dhe jo oriental. Shqetësimi që ndan në letër, është ai i sigurimit të ndihmave dhe sidomos sigurimit të librave për shkollën Normale. Në këtë mision, ai ka pranë patriotin dhe njëkohësisht drejtorin e Normales Luigj Gurakuqin. Misioni i tyre ishte të shkonin në koloninë e shqiptarëve në

¹⁷⁸Gazeta Lirija, nr. 60, 24 tetor 1909.

¹⁷⁹Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: albPaper 2004, f. 378.

¹⁸⁰Po aty, f. 408.

¹⁸¹Pietro Danisca kishte gjithashtu një shoqëri transporti në Durrës.

Bukuresht, ku shpresonin të siguronin ndihma. Vetëm prej kësaj mbështetjeje sakrifikuese të kësaj figure e të tjerëve pas tij, u ruajt dhe u vijua mësimi dhe vazhdimi i shkollës shqipe. Është këmbëngulja e tyre që arrinin të siguronin ekonomikisht të ardhura për të mbajtur gjallë lëvizjen arsime dashëse të patriotëve jashtë vendit. Ata bëheshin zëri i problemeve brenda vendit që kërkonin zgjidhje imediate, duke rrezikuar veten dhe familjen e tyre, pa kursyer as të ardhurat e veta. Vizioni i tyre për shkollën shqipe, lidhej me vetë ekzistencën ose mosekzistencën e kombit tonë. Edhe pse ajo u mundësua në fillim në Elbasan, tashmë e rëndësishme shihej vijimi i saj, mosdorëzimi para kushteve të reja të mbylljes së saj. Shkolla Normale mund të hapej kudo, edhe jashtë vendit (si një mundësi që theksohet nga letra), vetëm të ishte në funksion të çështjes kombëtare; pa këtë nuk mund të diturohej brezi i ri dhe të sigurohej shkëputja përfundimtare nga Porta e Lartë. Vetëm dija do të ishte liri për shqiptarët. Shqetësimi për të mbledhur ndihma, është kaq i madh sa që përpjekjet sipas tij duhet të jenë "*me gjithë shpirt e me gjithë fuqitë*". Ekzistenca e kësaj shkolle i kishte dhënë emër qytetit duke vlerësua kështu përpjekjet e intelektualëve dhe patriotëve për vazhdimësinë e saj këta njërin do të kontribuojnë gjithë secili në mënyra të ndryshme për një qëllim final atë të rihapjes së saj në mënyrë që të vihet në funksion të çështjes shqiptare. Në letër e tij ai tregon interes për Aleksandër Xhuvanin, i cili siç dihet kishte qënë një nga mësuesit e shkollës Normale dhe një nga njerëzit më të shkolluar që e kishte vendosur veten tashmë në krah të zhvillimit e përparimit të Shqipërisë.

Letër e Dervish beut dhe Lef Nosit dërguar Luigj Gurakuqit që i përket vitit 1913, më konkretisht datës 13 prill. Në letër tregohet qartë gjendja e tensionuar në gjirin e qeverisë së Vlorës. Siç edhe shpjegohet në letër, tashmë ishin krijuar dy kampe kundërshtarë, nga njëra anë ishte Ismail Qemali dhe mbështetësit e tij, e nga ana tjetër kampi që kryesohej nga Syrja Vlora. Duket qartë që Dervish beu deri në këto momente nuk ishte larguar ende nga Ismail Qemali. Siç shpjegohet në letër, ishte mbajtur një mbledhje ku kishin marrë pjesë: Dom Nikoll Kacorri, Murat bej Toptani, Fazlli Pasha, Syrja Vlora dhe sipas Dervishit, në këtë mbledhje, Fazlli Pasha ishte përpjekur të tregonte që qeveria nuk ishte "*e zonja me qeverisun*" dhe propozonte që Syrja beu të formonte një qeveri të re e të merrej me zgjedhjen e një princi. Sipas Lef Nosit, ata kishin dashur të bënin një shkresë për ta dërguar në Vjenë, por kishin hasur kundërshtinë e Dervish beut dhe po sipas tij Dom Nikoll Kaçorri, Murat bej Toptani, Fazlli pasha ishin nisur për në Vjenë për të realizuar qëllimin, dhe shprehin bindjen se kështu "*këtyre t'u prishet pëlhura e dhëllpëriveret intrigantëve të marrë*"¹⁸². Gjendja në

¹⁸² AQSH, F.32, Lef Nosi, Dos. 9, fl. 6.

Shqipëri në pranverën e 1913-ës ishte shumë e tensionuar. Fuqitë e Mëdha nuk e kishin njohur Pavarësinë e Shqipërisë dhe shtetet fqinjë po bënin përpjekje për pushtimin e territoreve. Nga ana tjetër, Fuqitë e Mëdha nuk po binin dakord lidhur me kufijtë e Shqipërisë. Politika shqiptare po trazohej edhe më shumë, nga ngjarjet që po ndodhnin në veri me Shkodrën ku Esat Pasha akuzohet për veprën e tradhëtisë, atë të dorëzimit të saj Malit të Zi. Qeveria e Vlorës e quajti *“atentat kundër pavarësisë së Shqipërisë”*.¹⁸³

Përgjatë shtatorit të 1914-ës, Dervish beu, tashmë në arrati drejt Italisë, për shkak të kryengritjes së Haxhi Qamilit, i shkruan Shefqet Vërlacit, disa letra radhazi, përkatësisht: Zvicër, Bari/Brindizi (Itali), Korfuz, Durrës/Vlorë. Nga Bari për në Zvicër e kërkon Shefqet Vërlacin, por nuk e takon dot dhe për këtë e mbështet duke i thënë: *“për ju do të përpiqem me gja e me trup”*. Në këtë letër kuptohet lidhja e konsoliduar që vijon të ketë me Esat Pashë Toptanin, për të cilin mendon të kthehet në vend jo vetëm për të ndihmuar Shefqet Vërlacin, por citoj *“tue u përpjekë për kthimin në atdhe dhe për ta gjet një mjet shpëtimi edhe për ata që janë me plot kuptimin e fjalës kundra.”* tij dhe thonë fjalë të kota kundra tij (Dervishit). Shqetësimet që përmbajnë letrat ishin mbi:

- largimin e Princ Vedit,
- kryengritjen e Haxhi Qamilit,
- fatet e atdheut,
- kthimi në Shqipëri nga arratia.

Një fakt interesant në letër është citimi i fjalëve të at Gjergj Fishtës nga Luigj Gurakuqi *“Babai i poetëve Patër Fishta ka thanë një gja: Deri sa të forcohet një qeveri mos me thanë asnjë të keqe.”*, pasi Dervishi ia faturon dështimin e qeverisë së Vedit pikërisht *“se deshi me kap menjëherë qiellin me dorë.”*. Qeveria e Vedit siç edhe faktet dëshmojnë u tregua e paaftë në mbrojtjen e çështjes shqiptare dhe mirëfunksionimin e shtetit ligjor.

Në letër citohet shqetësimi ndaj kryengritësit Qamil Haxhi Feza dhe Haxhi Qamili që *“kanë bame gjithë fare ligësish, kanë rreziku fatet e atdheut dhe e kanë kthye punen në anarchi. Bahet çdo lloj poshtërsie...”* duke përdorur aktet zyrtare të qeverisë shqiptare dhe *“kur shofin ndër to emnin e ndokujt që ka marr të holla nga qeveria e përmendun ose ka qenë me rrogë (nëpunës) e arrestojnë menjëherë dhe e torturojnë...”*.

Në situatën historike të këtyre viteve, të tërheq vëmendjen në letër shqetësimi mbi konfliktet e brendshme, kërcënimin me vdekje nga Ismail Qemali ku thotë në letër: *“Kur isha*

¹⁸³ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë: Toena 2002, f. 37.

*në Vlonë takova djemtë e Ismail beut dhe u thashë se, kurse ati juaj ka pas dhanë urdhën për kapjen time të gjallë ose të vdekun, unë nuk ju baj ndonji të keqe...” mosbesimin mbi argumentin e mësipërm nga Aqif pasha dhe dhimbjen për gjendjen në të cilën është atdheu, prej të rinjve në politikë pasi "nuk menduen për shpëtimin e Shqipërisë. Mjerisht! Mjerë kombi ynë fisnik mjerë atdheu t'onë i shenjtë! Të mira të këqija mjer përpjekjet t'ona. Tue më rrjedh lotë nga sytë, po e shkruaj këtë letër të gjatë. Nuk ditem me qeverisë, s'ka tjetër."*¹⁸⁴

2.3 Veprimtaria e Dervish Biçakut në kuadrin e klubeve patriotike në Elbasan

Në Elbasan, deri në prag të shpalljes së Hyrjetit (Kushtetutës turke më 23 korrik 1908) rezultonin tri shkolla fillore publike shtetërore (Ibtidaije): Hamidiye afër Xhamisë Sulejmanie, me kryemësues Ibrahim Gumën; shkolla tek ndërtesa e depos së kripës (afër Xhamisë Mbret) me mësues Mustafa Qafëmollën dhe Ali Krypën; Mejtebi i Adem Grykshit dhe Afëz Ukut, në fillim të rrugës së Xhamisë Mbret. Ndërkaq ekzistonin edhe katër shkolla private që ishin: Shkolla ku mësonte Fejz Guranjaku bashkë me të vëllanë, Arifin, afër Xhamisë së Agait, shkolla e Hafëz Karadakut, shkolla e Mullah Tahirit, afër lapidarit të Dyli e Haxhire Myzyrit dhe shkolla e Hidrajt në merkatë, me mësues Hafiz Gjelin dhe Imam Vrapin¹⁸⁵. Deri në vitin 1908, në disa prej këtyre shkollave mësohej fshehurazi edhe gjuha shqipe.

Pas fitores së Revolucionit Xhonturk, krijohen rrethana të reja që kushtëzuan një drejtim të ri të lëvizjes patriotike në trevat shqiptare dhe më gjerë. Shpallja e kushtetutës ngjalli shpresën e madhe për popullin shqiptar se nën regjimin e ri do të garantoheshin “liria, barazia, drejtësia”. Një situatë e tillë shfrytëzua më së miri nga patriotët shqiptarë për të krijuar klube dhe shoqëri me karakter kulturor, në funksion të përhapjes së dijes dhe arsimit në qytetet shqiptare. Në 31 korrik të vitit 1908, u themelua klubi “Bashkimi” i Manastirit, si një ndër klubet më të mëdha dhe më të rëndësishëm, që luajti një rol aktiv në formimin e klubeve të tjera dhe në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Me krijimin e tij, disa nga përfaqësuesit e tij, pa humbur kohë filluan veprimtarinë për krijimin e degëve të klubit të Manastirit në qytetet shqiptare. Në këto rrethanan, në bashkëpunim të ngushtë me patriotët e Manastirit në Elbasan krijohet dega e klubit të Manastirit, me të njëjtin emër, klubi “Bashkimi” i Elbasanit¹⁸⁶. Që me e krijimin e këtij klubi, një ndër kontribuesit e parë

¹⁸⁴AQSH, Fondi 69, Dos.6, fl.1-7.

¹⁸⁵Shyqyri Demiri, *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Elbasan: Egnatia 2006, f. 87.

¹⁸⁶AME (Arkivi i Muzeut Etnografik Elbasan), F. 2, Dos. 6, f. 5.

financiarë të këtij klubi ishte Lef Nosi, që në 8 shtator 1908 do të jepte një shumë prej 60 groshë¹⁸⁷.

Në kushtet e reja të krijuara, Lëvizja kombëtare në Elbasan u zhvillua me intemsitet; në përhapjen e mësimit shqip në forma individuale, në hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, në formimin e klubeve dhe shoqërive kombëtare me karakter patriotik¹⁸⁸. Patriotët Elbasanas nuk vonuan të hapin shkollën e parë shqipe në këtë qytet në 2 gusht të vitit 1908¹⁸⁹. Ndërkaq, po në të njëjtën datë u krijua në Elbasan edhe klubi i njohur me emrin “Bashkimi”, çka është tregues i faktit se në Elbasan kishte kohë që ilegalisht ishte krijuar një mjedis intelektual dhe kulturor, që u konkretizua sapo u shpallën liritë kushtetuese. Referuar studiuesit elbasanas Shyqyri Demiri, patriotët shqiptarë nuk nguruan ta cilësonin klubin “Bashkimi” të Elbasanit për një periudhë kohe si klubin qendror në Shqipëri, çka dëshmon faktin se ky klub përbënte në një ndër klubet më të rëndësishme në qendër të trevave shqiptare¹⁹⁰.

Në statutin e tij, programi i klubit “Bashkimi” të Elbasanit, shprehet karakteri kulturor që kishte klubi i Elbasanit. Kjo bëhej për shkak të njohjes së tij nga autoritetet xhonturke. Por ndërkaq, veprimtaria e këtij klubi përfshinte gjithashtu edhe fushën politike në favor të lëvizjes kombëtare. Sipas dokumentacionit zyrtar, në kryesinë e klubit “Bashkimi” të Elbasanit, kryetar rezultonte Refik efendi Myftiu, ndërsa nënkryetar: Dhimitër Buda, që më pas zëvendësohet nga Hysen Hostopalli. Sekretar ishte Simon Shuteriqi, nënsekretar: Ahmet Dakli, arkëtar: Nexhip Haxhiademi, ndërsa si anëtarë të fillimisht rezultonin: Qamil beu, Muç Shqiptari, Beqir Plangarica, Pavli Papadhopuli dhe Kamber efendiu¹⁹¹. Pas zgjedhjeve të reja që bëhen në tetor të vitit 1909 për kryesinë e Klubit “Bashkimi”, kryetar i tij zgjidhet Hysen Hastopalli që në vitin 1908 kishte zëvendësuar përkohësisht në cilësinë e nënkryetarit të klubit Dhimitër Budën¹⁹². Ky klub luajti një rol të rëndësishëm në hapjen e shkollave shqipe. Në një komunikim midis klubit të Elbasanit dhe klubit të Manastirit më 31 dhjetor të 1908, parashtrohej kërkesa që i drejtohej Portës së Lartë për njohjen zyrtare të kombit shqiptar.

Ndërkaq, theksojmë se në gjirin e klubeve shqiptare që u krijuan në vitin 1908, nuk mungonin divergjencat dhe kontradiktat ndërmejt anëtarëve të tyre. Mendojmë se një situatë e tillë ishte rezultat i rrymave që ishin krijuar në kuadrin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por që më së shumti kontradiktat ndërmjet tyre nxiteshin dhe gjeneroheshin nga vetë xhonturqit

¹⁸⁷AQSH, F. Lef Nosi nr. 32, Dos. 7, fl. 1.

¹⁸⁸Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: alb PAPER 2004, f. 162-163.

¹⁸⁹Po aty, f.164.

¹⁹⁰Shyqyri Demiri, *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Elbasan: Egnatia 2006, f. 94.

¹⁹¹AQSH, F. 32, Dos. 7, fl. 2-3.

¹⁹²Kujtim Bevapi, *Hulumtime Etnologjike*, Elbasan: Sejko 2007, f. 128.

të cilët ishin të frikësuar nga zhvillimet e shpejta të lëvizjes kombëtare. Ata do të përdornin të gjithë mjetet dhe format e mundshme për të penguar zhvillimin normal të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare sikurse shprehet Sejfi Vllamasi: “... me qëllim që nacionalizmin tonë ta mbytnin, para se të zhvillohej ndërgjegjja kombëtare”¹⁹³.

Kështu, në klubin e Manastirit, thellimi i kontradiktave të brendshme bëri që në këtë klub të shfaqen dy fraksione. Grupi i parë përfaqësohej nga elementët më të vendosur dhe patriotët e krahut radikal ku bënë pjesë 150 anëtarë dhe grupi i dytë ku bënë pjesë 400 anëtarë të krahut të moderuar. Sipas konsullit të Manastirit ndarja në dy grupe ishte rezultat dhe vepër e turqve të rinj të cilët ishin të shqetësuar për shkak të përhapjes së idesë së pavarësisë në klube ¹⁹⁴.

Gjithashtu, një dukuri e tillë u shfaq edhe në Elbasan që me formimin e klubit “Bashkimi”. Dokumentet arkivore na japin informacion rreth faktit se formimi i klubit “Bashkimi” në Elbasan nuk kaloi pa përplasje ndërmjet patriotëve të këtij qyteti. Sipas tyre raportohej se në qendër të këtij konflikti ishte pikërisht Dervish Biçakçiu duke u shprehur se: “Në Elbasan formimi i klubit “Bashkimi” u shoqërua me përleshje midis patriotëve shqiptarë dhe turqëve të rinj që u përkrahën nga aventurierë të tillë si Dervish bej Biçaku etj. që deshën të hynin me forcë në klub dhe ta shtinin në dorë atë” ¹⁹⁵. Të njëjtin informacion na jep edhe studiuesi K. Prifti në një botim të vitit 1972, ku pikërisht Dervishi në këtë rast konsiderohej si “aventurier” dhe përfaqësues i krahut xhonturk, që deshi të hyjë me forcë në klub dhe ta shtijë në dorë atë ¹⁹⁶. Një situatë e tillë natyrshëm të bën të mendosh se përse Dervishi, një ndër figurat e rëndësishme të asaj kohe, nuk rezulton anëtar i klubit “Bashkimi”, klubi i parë që krijohet në Elbasan. Për më tepër, referuar burimit të sipërcituar, mendojmë se ai jo vetëm që ka dashur të jetë pjesë e këtij klubi, por duke tentuar të përdorë edhe forcën, ka synuar edhe drejtimin e ardhshëm të tij. Ndërkaq, edhe kushëriri i Dervishit, Aqif Biçakçiu nuk na rezulton në dokumenta si anëtar i klubit “Bashkimi”. Pavarësisht kësaj, mendojmë se Aqif Pasha de fakto ishte drejtues i këshillit mbikëqyrës jo vetëm i këtij klubi, por edhe i klubeve dhe shoqërive kulturore që do të krijohen në vitet në vijim në Elbasan. Faktikisht burimet dokumentare për këtë konflikt të Dervishit në klubin “Bashkimi” janë të kufizuara. Një

¹⁹³Sefli Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: Neraida 2000, f. 50.

¹⁹⁴Informacion i konsullit francez në Manastir, 21 tetor 1908, marrë nga *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 1972, f. 59.

¹⁹⁵AQSH, Fondi Klubi “Bashkimi” i Manastirit, D. 6, f. 350; D. 7, f. 291; D. 9, f. 1.

¹⁹⁶Kristaq Prifti, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe kongresi i Manastirit*, Universiteti i Tiranës: Mihal Duri 1972, f.

vlerësim mjaft i vyer na vjen për të dy figurat sërisht nga një personalitet si Faik Konica”Më shkruajnë nga Elbasani, 5 Vjeshtë II, 1908: ”Në hapjen e shkollës ishte shkakëtar Dervish Beu, e në ngrefjet clubit Aqif Pasha”-Dervish beu edhe Aqif Pasha janë pas mëndimeve t’Europës.” Në vazhdim Konica vlerëson edhe njëherë Dervishin beun:”...është i njohur në të gjithë Shqipërië për patriotizmin e tij, të cilin e dëftoi në ditët më të zeza të Turqisë së Vjetër”.¹⁹⁷ Edhe njëherë ky vlerësim tregon fare qartë që Dervishi beu tashmë me veprimtarinë e tij ishte vënë plotësisht në shërbim të çështjes kombëtare. Gjithsesi, duke marrë në konsideratë marrëdhëniet ndërmjet dy kushërinjve, mendojmë se kjo situatë mund të ketë lidhje edhe me konfliktet e vjetra ndërmjet tyre, që shfaqeshin herë pas herë në forma të ndryshme. Konflikte që nuk do të mungonin edhe në vitet pasardhëse dhe do të kulmojnë në vitin 1913.

Ndërkaq, një ndër problemet më të rëndësishme që duhej të zgjidhte klubi "*Bashkimi*" kishte të bënte me mungesën e mësuesve që do të jepnin gjuhën shqipe në shkollat e hapura. Situata paraqitej shumë e vështirë sidomos në zonat rurale. Në zonën malore të Shpatit, kërkoheshin mësues të gjuhës shqipe, por siç dihet këta ishin të paktë në numër. Pikërisht në këtë kohë, në Elbasan, u vu re edhe fenomeni i mësuesve shëtitës dhe kjo u realizua nga patriotët elbasanas në emër të dashurisë për gjuhën dhe për të përhapur dijen. Mësues të tillë ishin Hasan Ceka dhe Simon Shuteriqi.¹⁹⁸ Për t’i ardhur në ndihmë zgjidhjes së këtij problemi, pranë klubit "*Bashkimi*" u ngrit edhe një kurs mujor për përgatitjen e mësuesve. Duke patur parasysh që kishte vështirësi shumë të mëdha për hapjen e shkollave shqipe në të gjithë vendin, klubet shqiptare të Elbasanit dhe të Janinës që nga tetori 1908, i kërkuan autoriteteve lokale që gjuha shqipe të futej si lëndë mësimi në shkollat shtetërore turke dhe greke. Në këtë kuadër, patriotët elbasanas ia dolën me për të futur në shkollën greke të qytetit si gjuhë mësimi gjuhën shqipe, ndërsa gjuhës greke iu la vëndi i dytë¹⁹⁹. Në shumë raste, mësimi i gjuhës shqipe bëhej në mënyrë vullnetare nga mësuesit patriotë shqiptarë. Po në tetor të 1908, pranë klubit "*Bashkimi*" u çel një "*shkollë nate ku mësonin mbrëmje për*

¹⁹⁷ Faik Konica, Shkrime nga "Albania" 2, Prishtinë, Faik Konica, 2013, f.204 Konica jep detaje për Dervishin beun dhe Aqif pashën: Është i marutar me të motrën e Murad b' Toptanit, dhe motra e vetë është e martuar me Mehdi be' Franshërin, për të cilin Z.Brailford shkruajti aq bukur në TIMES (shihni te FLETA E DREQTORIT). Aqif Pasha është i biri i Mahmuf Pashës, është martuar me një zonjë nga të Vrionëve, dhe është i lidhur me dyert e Toskërisë nga martesë e motrës së tij, Vehibe Hanëmit, me Hajdër be' Delvinën. Një tjetër motër e tij është Ballkësh Hanëmi, e shoqia e General Saadëddin Pashës.

¹⁹⁸ Shyqyri Demiri, *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, materiale depozituar në arkivin e muzeut etnografik Elbasan, f. 20.

¹⁹⁹ HHSTA PA A, informacion i konsullit austro-hungarez në Durrës, 7 nëntor 1908.

*mbrëmje 60-70 djem të rinj muslimanë e të krishterë*²⁰⁰. Gjithashtu, nën kryesinë e Aqif pashë Biçakçiut, zhvillohet një mbledhje që synonte vetëm të mësonte djemtë e vajzat në gjuhën e vet. Brenda dy ditësh u bë e mundur që të mblidheshin më tepër se 200 lira turke, me anën e të cilave do të paguheshin financiarisht mësuesit, pa pritur që ata të paguheshin nga organet shtetërore osmane. Gjithashtu, ishte vendosur të caktohej nga një mësues për mësimin e gjuhës shqipe në shkollat fillore turke dhe greke të qytetit²⁰¹.

Në kuadrin e problematikave që dilnin për zgjidhje para klubeve shqiptare, do të vinte edhe propozimi i klubit “Bashkimi” të Elbasanit drejtuar atij të Manastirit, për organizimin e një kongresi të gjuhës shqipe, duke dhënë edhe mendime që ky kongres të mbahej në një qytet në qendër të Shqipërisë duke parakuptuar qytetin e Elbasanit dhe që duhej të zgjidhte nevojën e ngutshme të njesimit të dialekteve në shkrimin e shqipes.

Dëshira që Kongresi të mbahej në Elbasan, komentohet edhe në një letër që patrioti Luigj Gurakuqi i dërgonte Feim Be Zavalanit. Ajo që vlen të theksohet në këtë letër, ishte edhe shqetësimi që Klubi i Manastirit nuk kishte ndërmend të ftonë drejtorin e gazetës “Albania” Faik be Konicën. Kështu, ndërmjet Luigj Gurakuqi dhe Feim Zavalanit ai informohej rreth pakënaqësisë që vinte nga Elbasani për mbajtjen e kongresit në Manastir duke i shkruar më konkretisht se: *“Nga Elbasani më shkruajnë se atyre nuk u pëlqen që Mbledhja e Abc-esë të bëhet në Manastir, nga ana tjera po marr vesh se edhe në Berat duan të bëjnë një mbledhje për të zgjidhur çështjen e alfabetit... Nga Elbasani më shkruajnë edhe se Ju kini qëllim që mos t’a ftoni në mbledhje Faik bej Konicën, drejtorin e Albanies së Londonit; unë nuk e zë besë këtë punë, ju si do që në qoftë, ju lutem dhe një herë që të thirrni të gjithë shkronjëtorët shqiptarë, e kryetarët e klubevet e të shoqëriravet kudo që ndodhen, kështu që Mbledhja e Manastirit të dalë një mbledhje Kombëtare, e përgjithshme e që t’i japë fund një herë e për gjithëmonë çështjes së alfabetit”*²⁰².

Gjithashtu, në një letër që Luigj Gurakuqi i dërgonte një mikut të tij në Elbasan midis të tjerave ai shprehej se: *“Edhe mue më dëshironte zembëra që kongresi për çështje t’alfabetit të mbahej në Elbasan, po, pasi që ata të Manastirit i kishin bamun gati të gjitha punët, tash nuk asht mirë të kundërshtohemi...Të lutem, pra, mundohu sa të kesh fuqi që të mos të dalin ngatrrime t’jera...Shkrova në Monastir që t’a thërrasin domosdo Faik Konicën në kongres ku*

²⁰⁰ Po aty, f20.

²⁰¹ “Lirija”, Selanik, nr. 8, vjeshtë e parë, 1908.

²⁰² Majlinda Peza, disertacioni me temë: “Lëvizja politilo-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914, f. 71.

kam shpresë se ke për të qenë edhe ti; na do të vijmë nj'a pesë a gjashtë vetë; tue u k-ëthye nga Monastiri kemi për t'ardhun n'Elbasan"²⁰³.

Për gjuhën që duhej përdorur duke sugjeruar si gjuhë të përbashkët të folurën e Elbasanit, klubi "Bashkimi" i Elbasanit i shkruante atij të Manastirit se: "*Mbas mendimit tonë lypset që mbledhja të marri masa që si gjuhë e përgjithshme në gjithë Shqipërinë, ligjëroja ma e bukur me të cilën asht bashkumun si me thanë toskënishtja me gegënishten asht ajo e Elbasanit, që mund të merret vesh e të flitet prej të gjithë shqiptarëve*".²⁰⁴

Ndërkaq, propozimi tjetër i klubit të Elbasanit kishte karakter politik. Ata "*kërkonin që të bëhej një përçarje e përbashkët e të gjithë klubeve për njohje zyrtare të kombësisë Shqiptare*"²⁰⁵. Ajo që bie në sy në përpjekjet e klubeve shqiptare në çështjen e Shqiptarizmit, është mungesa e një programi unik ku të renditen kërkesa të qarta ndaj Portës së Lartë. Një ndër problemet e rëndësishme arsimore që ishte njesimi i alfabetit të gjuhës shqipe, nuk ishte thjesht çështje kulture, por edhe një çështje politike e cila konsiderohej një nga detyrat më të ngutshme të lëvizjes kombëtare²⁰⁶. Përtej çështjes së një alfabeti, duhej dëshmuar ekzistenca e një dinamike të përbashkët në të mirë të Shqiptarizmit²⁰⁷. Kështu në vijim të përpjekjeve të shqiptarëve për të mbrojtur çështjen shqiptare në Elbasan sikurse njoftohet nga gazeta Albania ishte mbledhur parësia e qytetit për të lexuar një "tejtshkrim" që kishte mbërritur nga Stambolli nga ana e 51 shqiptarëve të cilët i kishin dorëzuar: "*nji letër Portës së Lartë ,edhe nji Ambasadorëve të Fuqivet të Mëdha ...në të cilën i përmëndët qi në qoftë se i epet sikurse edhe nji pëllamë tokë nga e Shqipënisë të huajve , jemi gati të vdesim të tanë Myslimanë e të Krishterë.*" Letra tregon edhe njëherë që Elbasani ishte jo rastësisht në qendër të organizimit të ngjarjeve të rëndësishme dhe se paria e saj kishte një pozitë kyçe në ngjarjet madhore të kësaj periudhe.²⁰⁸

Për të mos krijuar përçarje, Kongresi do të organizohet në Manastir nga 14 deri më 22 nëntor 1908. Në kongres morën pjesë 50 delegatë, ku nga këto të drejtë vote kishin 32 persona dhe me konsensus u zgjodhën dy për çdo klub që merrte pjesë²⁰⁹. Drejtues i këtij Kongresi ishte at Gjergj Fishta. Këshilla sundimtare e klubit të Elbasanit organizoi një mbledhje për të zgjedhur përfaqësuesit në kongresin e Manastirit që ishin: Taqi Anastasi

²⁰³AQSH. Fondi, Luigj Gurakuqi, Dos. 30, 17 tetor 1908, fl. 1.

²⁰⁴Po aty.

²⁰⁵Mahir Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: 8 nëntori, 1972, f.53.

²⁰⁶Po aty, f. 301.

²⁰⁷Nathaly Clayre, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë: 2012, f.557.

²⁰⁸Faik Konica, *Shkrime nga "Albania"* 2, Prishtinë, Faik Konica, 2013, f.193 Letra mban datën 15 Vjeshtë e dytë II 1908, ose 28 tetor 1908 me kalendarin e ri.

²⁰⁹Mahir Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: Mihal Duri 1972, f. 34.

(Taqi Buda), Simon Shuteriqi dhe Kamer Efendi Sejдини, Ysbash i Avxhi Taborrit (kapiten i batalionit gjuajtës). Përsa i përket këtij të fundit thuhet se: *“Ky zotni qi përmendëm në fundt, u nis sot për në Manastire, ene prandaj ju lutemi shumë të përpiqeni të merrni prej kumandantit këti lejen qi t’qëndrojë aty deri sa t’mbarohet puna e bashkimit të abecesë”*²¹⁰. Delegatët e Elbasanit në Kongresin e Manastirit që ishin Simon Shuteriqi dhe Dhimitraq Buda, i cili në këtë kongres u shpreh se: *“Qëllimi i Kongresit nuk është të merret me filozofi se këtë fuqi s’e kanë delegatët, por është më mirë të merremi vetëm me **a, b e ce-të**”*²¹¹. Në kongresin e Manastirit kanë marrë pjesë edhe Josif Haxhimina e Petër Dodbiba²¹². Ndërsa Lef Nosi ishte pa të drejtë vote.

Në Kongres u vunë re divergjenca të shumta midis patriotëve. Kështu u vendos që të pranohej alfabeti i Stambollit dhe alfabeti me gërma latine. Të dy alfabetet do të përdoreshin me detyrim në shkolla.²¹³ Po pse u vendos për dy alfabete? Një shpjegim të qartë na jep Gjergj Qiriazi: *“Telegramet e ardhura nga Gegëria na luteshin të merrnim alfabetin e Bashkimit dhe telegramet e ardhura nga Toskëria na luteshin të merrnin alfabetin e Stambollit, po të mos merrej parasysh njëri ose tjetri do të shkactohej pengesë e madhe në përparimin e kombit. Ne vendosëm me vota të plota të adaptojmë të dy alfabetet ”*²¹⁴. E rëndësishme është që alfabetet e Manastirit të dy ishin me gërma latine. Fakti që Kongresi vendosi për çështjen e alfabetit pavarësisht se u miratuan dy të tillë, dëshmon qartazi se Kongresi i Manastirit dha një ndihmesë të madhe në zhvillimin e gjuhës letrare Shqipe, sikurse edhe në zhvillimin e lëvizjes kombëtare. Gjatë ditëve të Kongresit patriotët diskutuan edhe çështje të rëndësishme që lidheshin me qëndrimin ndaj Xhonturqve, se cilat duhet të ishin lëvizjet e radhës se shqiptarëve dhe çfarë kërkesash i duheshin dërguar Portës së Lartë. Ishte më se e domosdoshme hartimi i një platforme mbarë kombëtare. Kështu në mbledhjet e fshehta të mbajtura gjatë Kongresit u hartua një program dhe ju kërkua Shahin Kolonjës që deputet në parlamentin Turk që t’i paraqiste në parlament²¹⁵. Kërkesat ishin; njohja zyrtare e gjuhës dhe kombësisë shqipe duke u shënuar kjo e fundit nëpër leternjoftime, shqiptarët të kishin më shumë kompetenca në organet lokale, kërkohej gjithashtu edhe zhvillimi i arsimit ku shkollat fillore turke të ktheheshin në shkolla shqipe. Kërkesat shkonin edhe më tej dhe patriotët e kishin të qartë që, të realizohej dituria e vëndit dhe ai të ecte përpara, duhej siguruar hapja e

²¹⁰AQSH. Fondi klubi shqiptar “Bashkimi” në Manastir, D. 5, f. 239.

²¹¹“Lirija” Selanik, vjeshtë e tretë 1908 (nëntor 1908).

²¹²Elbasani-Enciklopedi, Elbasan : Seiko 2003, f. 303.

²¹³Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave Shqipërisë, Vëllimi II, Tiranë:Toena 2002, f. 392.

²¹⁴Mahir Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: Mihal Duri 1972, f. 34, f. 34.

²¹⁵Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë, Toena 2002, f.46.

një Universiteti. Gjithashtu, kërkesat përmbanin edhe pika të tjera që lidheshin me zhvillimin e ekonomisë. Të gjitha këto kërkesa do të çonin drejt sigurimit të autonomisë. Por, megjithëse u parashtruan në Kongres, këto kërkesa mbetën vetëm në letër sepse deputeti shqiptar Shahin Kolonja nuk i paraqiti asnjëherë në parlament.

Lidhur me arritjet e Kongresit pati mendime të ndryshme. Sipas studiueses Nathalie Clayer, këto vendime dhe mosarritja e dakortësisë në çështjen e alfabetit mund të konsiderohen një gjysëm dështim i Kongresit. Një tjetër intelektual si Konica i pa me shumë ftohtësi vendimet Kongresit. Albanologu Holger Persen i konsideronte vendimet e Kongresit të Manastirit si shumë positive dhe sukses për popullin Shqiptar²¹⁶. Atë që Shqiptarët fituan nga ky Kongres shprehet qartë në gojën e një patrioti mëndje ndritur Mit'hat Frashëri: "...botës u tregoi qenien dhe rrojtën e një kombi shqiptar. Bota, që na pandehte se s'jemi të zotë për asnjë vepër qytetarie, ajo botë, ndër ta dhe armiq të tanë, kuptoi që shqiptarët s'qenkan ashtu si pandehnin, s'qenkan aq "të egër" sa thuhej"²¹⁷

Lëvizja arsimore në Elbasan në vitet 1908-1909 dhe veprimtaria e klubit "Bashkimi" po intensifikohej gjithnjë e më shumë. Kështu, klubi "Bashkimi" i Elbasanit mbante mësues që jepnin gjuhën shqipe në shkollat turke dhe greke të trevës së Elbasanit, sikurse shprehej konsulli austro – hungarez në Manastir: "Klubi mban mësues shqiptarë edhe në shumë shkolla turke dhe greke të sanxhakut. Në Shpat janë caktuar tre mësues shëtitës, kaçaku Omer Dervishi të cilit dikur ja kanë patur frikën, së bashku me të dy vëllezërit e tij, ata i kanë ndarë në lokalitete, kështu që secilit prej tyre i takojnë afërsisht dhjetë fshatra"²¹⁸. Në këtë kohënë qytetin e Elbasanit funksiononin katër shkolla fillore turke me afërsisht 270 nxënës dhe gjithashtu edhe një shkollë ruzhdiye. Duhet thënë se në këto shkolla gjuha shqipe mësohej si lëndë e detyrueshme, ndërsa gjuha e mësimi ishte turqishtja. Ndërkaq, edhe në të vetmen shkollë fillore të komitetit ortodoks mësohej gjuha shqipe. Në këtë shkollë që numëronte rreth 80 nxënës jepeshin edhe kurse të gjuhës shqipe që zhvilloheshin mbasdite ose natën ku ishin regjistruar rreth 60 të rinj. Ndërkaq, shkolla shqipe e qytetit të Elbasanit sipas raporteve të konsullit austro – hungarez të Durrësit në mars 1909, ishte përkohësisht vetëm një shkollë nate. Ajo ndiqej prej afërsisht 100 djemve dhe mbahej prej klubit shqiptar "Bashkimi"²¹⁹.

²¹⁶Domi M., *Alfabeti i gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirt*, Tiranë: Mihal Duri 1972, f. 39.

²¹⁷Frashëri M., *Vepra të zgjedhura*, Instituturi i Historisë Lumo Skëndo, Onufri 2017, f. 253.

²¹⁸Majlinda Peza, disertacioni me temë: "Lëvizja politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914", f. 77-78.

²¹⁹HHSTA, PA, nr. 27, raport i konsullit austro-hungarez në Durrës dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme Vjenë, më 12 mars 1909.

Kështu, klubi “Bashkimi” në Elbasan, si i vetmi klub në këtë qytet, përballej gjithnjë e më shumë me problematikat që lindnin çdo ditë për mbajtjen e shkollave, për mbështetjen financiare të mësuesve, për furnizimin me bazën materiale të shkollave etj.

Ndërkaq, situata politike në Stamboll në prill të vitit 1909 ishte tepër e trazuar. Në këtë kohë xhonturqit, në qendrën e Perandorisë Osmane përballen me një ngjarje të rëndë. Shpërthen kundërrevolucioni i drejtuar nga forcat konservatore të Perandorisë. Garnizoni i Stambollit përmbysi qeverinë xhonturke dhe detyroi Komitetin “Bashkim e Përparim” të largohej nga Stambolli duke rivendosur pushtetin e mbështetësve të sulltan Abdyl Hamiti II. Qëndrimi i mbajtur nga rrethet shqiptare brenda dhe jashtë vendit ndaj kësaj situatë të re të krijuar, nuk ishte në mbështetje këtij kundërrevolucioni, pavarësisht pakënaqësive që ata kishin ndaj keqqeverisjes së pushtetit xhonturk. Por ky kundërrevolucion nuk e pati jetën të gjatë dhe dështoi. Në informacionet që vinin nga Ismail Qemali deputet në Stamboll kërkohej që: “ *më të gjitha anët e Shqipnis të mos i bin prapa halldupvet se ata janë armiq tët të liris*”²²⁰. Si rezultat i kësaj situatë politike të krijuar në prill të vitit 1909, ekziston mendimi se klubi “Bashkimi” i Elbasanit që në fillim kishte shfaqur një qëndrim kundër xhonturqve, pas kësaj ngjarjeje ishte kthyer në krahun e komitetit xhonturk²²¹. Për më tepër ky klub i kishte dërguar klubit të Selanikut një shumë prej 20 lirash, me qëllim që t’i jepej fëmijëve që kishin mbetur jetimë nga ngjarjet e kundërrevolucionit në Stamboll²²².

Në këto rrethana, do të krijohet në Elbasan një klub tjetër. Patriotët elbasanas e konsideruan si domosdoshmëri themelimin e një klubi tjetër, që do të vijonte të përmbushte të njëjtat objektiva si të klubit “Bashkimi” duke i lehtësuar edhe ngarkesën e punëve klubit “Bashkimi”. Kështu, në 18 prill 1909 krijohet në Elbasan një klub i ri i njohur me emrin “Vllaznia”²²³, një emërtim tepër domethënës për kohën. Mbi bazën e statutit të këtij klubi që u miratua në mbledhjen e përgjithshme themeluese, u zgjodhën organet drejtuese të klubit “Vllaznia”; Këshilla sundimtare ose kryesia dhe Këshilla përmikëqyrëse ose komisioni i kontrollit. Në kryesi bënte pjesë kryetari që rezultonte Dervish Ibrahim [Dervish Bej Biçakçiu], ndërsa nënkryetar i klubit ishte patrioti Lef Nosi, arkëtar Hysen Ceka, shkronjëse ose sekretar Fot Papajani dhe pesë anëtarët: Demir be Sulçebeu, Tahsin Myftiu, Isuf Skilja, Simon Popa, Anton Beçja²²⁴. Ndërsa Këshilla Përmikëqyrëse përbëhej nga kryetari Myderiz

²²⁰Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: alb PAPER 2004, f. 180.

²²¹HHSTA, PA, Raport i nën/konsullit austro-hungarez në Durrës, nr. 42, dt. 12 maj 1909.

²²²“Lirija”, nr. 49, Selanik dt. 20 qershor 1909, fl. 2.

²²³Hysni Myzyri *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: alb PAPER 2004, f. 181.

²²⁴Majlinda Peza *Klubet, Shoqëritë dhe Arsimi në Elbasan në vitet 1909-1911*, artikull botuar në Buletinin shkencor të UE-së, nr. 32, viti botimit 2011/2, f. 116.

Haçi Aliu, këshillonjës Haxhi Shejh Riza dhe sekretar Mustafa Qafëmolla. Përveç tyre në përbërje të kësaj këshille të klubit “Vllaznia” ishin edhe 11 anëtarë si më poshtë:

1. Haxhi Shejh Rizai
2. Shejh Xhaferri
3. Z. Isuf be Taushani
4. Hafiz Qazim Bejtja
5. Isak Bishqemi
6. Imam Isuf efendi Hallva
7. Z. Ibrahim Bizhuta
8. Z. Ismail Daiu
9. Hysen Pajuni
10. Prifti Veniamin Deliana,
11. Mylazim Riza efendi²²⁵

Mendojmë se ideatori i krijimit të klubit “Vllaznia” ishte Dervish Biçakçiu, i cili edhe më parë kishte tentuar të bëhej pjesë dhe të drejtonte një klub në Elbasan. Ai pati rolin kryesor në organizimin, krijimin dhe funksionimin e këtij klubi të ri. Në komunikatën e hapjes së klubit “Vllaznia” jepej edhe qëllimi kryesor i këtij klubi që sikurse shkruhej ishte : *"për me përhapun gjuhën shqip në qytet si dhe nëpër fshatrat rreth tij"*²²⁶.

Në themel të funksionimit të këtij klubi, qëndronte filozofia e Dervishit, ku klubi duhej të ishte si një faltore ku të mbizotëronte thjeshtësia, respekti, urtësia dhe vllaznia ndërmjet shqiptarëve për një të mirë të përbashkët. Kështu, brenda dy ditëve nga krijimi i klubit Vllaznia u regjistruan rreth 300 anëtarë. Sikurse konstatohet nga përbërja e tij, klubi dhe organet drejtuese të tij, kishin një përbërje heterogjene si në aspektin social ashtu edhe në atë fetar, çka tregon për shkallën e lartë të tolerancës fetare, që për hir të së vërtetës duhet thënë kishte qenë karakteristikë për këtë qytet. Thuhej, se me krijimin e këtij klubi edhe hoxhallarët fanatikë të Elbasanit, kishin ndryshuar aq shumë sa që edhe në xhamia “këndohej” në gjuhën shqipe.

Në Arkivin Qëndror Shtetëror në Tiranë, gjenden dy dorëshkrime që përbëjnë dy fjalime të mbajtura në ditën e përzemërimit të klubit “Vllazniaja”, por që emri i personave që

²²⁵AQSH, Fondi. “Klubet dhe shoqëritë patriotike” nr.102, Dos. 45, fl. 7. Dokumenti është procesverbali i mbajtur në përzemërimit të klubit “Vllaznia” në 18 prill 1909.

²²⁶Gazeta "Dielli", Boston, nr .9,29 maj 1909, f. 2.

kanë mbajtur fjalimin nuk jepet. Pavarësisht këtij fakti, mesazhi që përcillet në këto dy fjalime është tepër domethënës. Aty flitet për misionin kombëtar të klubit “Vllaznia” për mbrojtjen e atdheut dhe të gjuhës amtare. Gjithashtu, rekomandohej edhe përdorimi i atyre alfabeteve që ishin miratuar në kongresin e Manastirit, edhe në ato vende që akoma nuk ishin “zgjumun” dhe nëpër katundet që gjendeshin në errësirë.

Klubi “Vllaznia” kishte marrë përsipër pagesën e mësuesve që jepnin mësim në shkollat ortodokse. Ky fakt tregon që në ditët e para të themelimit, klubi ka adresuar çështje të rëndësishme që lidhen me mbarëvajtjen e përhapjes së gjuhës shqipe. Në cilësinë e drejtuesit të klubit “Vllaznia”, Dervishi do të kishte edhe peshën dhe përgjegjësinë më të madhe në mbarëvajtjen e veprimtarisë së këtij klubi por dhe në marrëdhëniet që ky klub do të krijonte jo vetëm me klubin “Bashkimi” të Elbasanit, por edhe me klubet e tjera që ishin krijuar në trevat shqiptare.

Kështu, në kuadrin e marrëdhënieve me klubet e tjera, mendojmë se Dervish Biçakçiu mbante korespondencë me kryetarin e klubit të Selanikut Mid’hat bej Frashërin. Me krijimin e klubit “Vllaznia”, në korespondencën ndërmjet tyre, Mit’hat Frashëri nuk do të vononte t’i dërgonte Dervishit urimet e përzemërta për hapjen e këtij klubi. Interesant është fakti se, ndërmjet të tjerave ai kërkonte të dinte edhe për marrëdhëniet që Dervishi kishte me klubin “Bashkimi” të Elbasanit. Nuk jemi të sigurtë se çfarë informacioni kishte Mit’hat Frashëri në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet dy klubeve të Elbasanit, por nga përgjigja e Dervishit, kuptojmë se marrëdhëniet ndërmjet klubit “Bashkimi” dhe “Vllaznija” ishin dhe do të ishin të mira²²⁷. Ndërkaq, përmes letrës drejtuar Mit’hat Frashërit, mendojmë se Dervishi shprehte pasionin dhe vendosmërinë e tij për të punuar pa u lodhur në funksion të përmbushjes së qëllimit të këtij klubi, të përhapurit e gjuhës shqipe me shkronjat e pëlqyeme të Kongresit të Manastirit në qytet dhe në fshatra të Elbasanit, ku klubi “Bashkimi” nuk kishte patur mundësi të ndihmonte²²⁸.

Gjithashtu, krijimi i klubit “Vllaznija” kishte si qëllim edhe bashkimin rreth tij të përfaqësuesve të rrymave të ndryshme që ishin krijuar në kuadrin e lëvizjes kombëtare në trevën e Elbasanit në favor të ideve kombëtare por dhe në krijimin e komiteteve të fshehta anëtarë të të cilëve ishin edhe përfaqësuesit e klubit “Vllaznia”²²⁹. Kështu, gazeta Albania e

²²⁷AQSH, Fondi. “Klubet dhe shoqëritë patriotike” nr.102, Dos. 46. fl. 2.

²²⁸Po aty.

²²⁹HHSTA, PA, Raport i nënkonsullit austro-hungarez në Manastir, nr.24, 2 maj 1909.

Konicës shkruan “U-hap në Elbasan një klub i ri, i quajtur “Vllaznia”. Qëllimi i tij ishte me përhapun gjuhën shqipe, si dhe nëpër fshatrat për rreth .Hapj’ e tij zyrtarisht u –kremtua me gëzim të madh prej vendit “²³⁰

Në letërkëmbimin ndërmjet Klubit “Vllaznia” dhe Stavri Stavrit, shprehen falenderimet nga ky patriot për besimin që ky klub i jepte zgjedhjes së Dervish Himës si drejtues i fletores “Bashkimi i Kombit” që do të shtypej në Manastir. Në letrën e Stavro Stavrit shkruhej: “

*Vllaznija asht faltorja jonë Na e ruaj ti o perëndi
Elbasan u bafshin si ti. Gjith sa jan qytetet n’ Shqipni*²³¹.

Gjithashtu, prefekti i Elbasanit në gusht të vitit 1909, i kërkonte klubit “Vllaznia” që të caktonte dy anëtarë për të qenë pjesë e komisionit të arsimit të qytetit të Elbasanit. Marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet dy klubeve në Elbasan, evidentohen edhe në ftesat që klubi “Bashkimi” i Elbasanit i dërgonte kryetarit të klubit “Vllaznia” Dervish Biçakçiu, për të marrë pjesë në provimet e nxënësve të shkollës së djemve të Shën Kollit në qershor të vitit 1909 dhe të provimeve të nxënësve të shkollës shqipe të Shpatit në po të njëjtin muaj²³². Këto provime zhvilloheshin në godinën e klubit “Bashkimi”. Ndërkaq, zgjedhja e kryesisë së klubit realizohej nëpërmjet procesit të votimit. Në një letër dërguar klubit “Vllaznia” nga disa anëtarë të tij në tetor të vitit 1909, informohemi se në tetor të vitit 1909 si nën/kryetar i ri i klubit “Vllaznia” zgjidhet Hasan Bej Elbasani, i cili për efekt të detyrimeve të tjera i paraqet kryesisë së klubit dorëheqjen duke u shprehur “... Ju lutem me pranue dorëheqjen vëllazën”²³³. Mendojmë se dorëheqja e Hasan bej Elbasanit si nën/kryetar i zgjedhur i klubit “Vllaznia”, pavarësisht angazhimeve që ai kishte, lidhej edhe me faktin se ai ishte i vëllai i Dervish Biçakçiu kryetarit të klubit “Vllaznia”.

Kështu më 13 mars 1909-ës, klubi “Bashkimi” dhe “Vllaznia” u bashkuan dhe krijuan një shoqëri të përbashkët me emrin “Bashkimi i Ri” në kryesinë e të cilit ishte Hasan bej Biçakçiu vëllai i Dervishit, Emin Haxhiademi, Demir bej, Hysen Hastopalli etj. Nënkonsulli austro-hungarez në Durrës njoftonte që ky Bashkim erdhi si rrjedhojë e agjitacionit të

²³⁰ Faik Konica, Shkrime nga “Albania” 2, Efthim Dodona, Prishtinë, Faik Konica, 2013, f.208.

²³¹ AQSH. Fondi. “Klubet dhe shoqëritë patriotike” nr.102, Dos. 66, fl. 1.

²³² Demiri Sh., Material depozituar në arkivin e muzeut etnografik Elbasan, Dos. 1. fl. 1-5.

²³³ A.Q.SH, F. 102, Dos. 59, fl. 1-5. Kërkesë personash për dorëheqje nga kryesia e klubit “Vllaznia”.

Xhonturqve për të sulmuar alfabeti latin.²³⁴ Po në maj ai njofton për një letër të ardhur në adresë të klubit "*Vllaznia*" nga protestantët amerikanë të shoqërisë *Phienes B. Kenedi* ku i kërkon ngritjen e një shkolle të mesme për djem në Elbasan që të kishte një degë industriale dhe një degë bujqësore. Sipas shpjegimit, ajo do të ishte për të gjithë djemtë dhe paga do të ishte e ulët. Misionarët shpjegojnë ndër të tjera se kërkojnë një ndërtesë të shëndetshme dhe të bukur. Ata për këtë arsye kërkonin mbështetjen financiare të banorëve të Elbasanit.²³⁵ Ky fakt është për t'u vlerësuar në vazhden e përpjekjeve për zhvillimin e arsimit dhe ka shumë rëndësi se Elbasani edhe në opinionin e të huajve, është një qytet që ia vlente të hapej një shkollë e mesme.

²³⁴Po aty, f. 93.

²³⁵AQSH, Fondi. "Klubet dhe shoqëritë patriotike" nr.102, Dos. 50, f. 1.

KAPITULLI . III

KONGRESI I ELBASANIT DHE DERVISH BIÇAKÇIU

3.1 Përpyjekjet e Dervish Biçakut dhe patriotëve shqiptarë në organizimin e Kongresit të Elbasanit.

Kongresi i Elbasanit u thirr me nismën e klubit të Selanikut me në krye Mit'hat Frashërin. Ky klub njoftoi për këtë nismë që në muajin mars 1909. Ngjarjet që kishin ndodhur ndërkohë në 13 Prill 1909-ës, në Perandorinë Osmane, bënë që të shtyhej për më vonë mbledhja e Kongresit të Elbasanit. Është e ditur që klubi i Selanikut me në krye patriotin Mit'hat Frashëri, luajti rolin kryesor në organizimin e Kongresit të Elbasanit. Ai shpall në gazetën "Lirija" "...të bëhet një mbledhje (kongres) prej gjithë klubeve dhe shoqërive..."(Thirrje e klubit të Selanikut, drejtuar Klubeve dhe Shoqërive Shqiptare)²³⁶. Nga informacionet e diplomacisë austro-hungareze, kuptohet që Kongresi është shtyrë disa herë për arsye të ndryshme. Lidhur me organizmin e Kongresit në maj 1909, Luigj Gurakuqi është treguar skeptik ndaj *Klubit të Selanikut*, duke i kërkuar Mit'hat Frashërit të bëjë kujdes, sepse duhet të krijohen kushtet për një organizim të mirë të tij. Shqetësimi i Luigj Gurakuqit është që shkolla që do të çelet, të ketë taban kombëtar (ku të jepet një mësim që rrjedh nga zakonet tona e t'u përgjigjet nevojave të kombësisë sonë, si të lëndshmë, si të palëndshmë... "A janë të gatshëm shqiptarët të vënë në Kongres të Elbasanit e ta zgjedhin mirë e përgjithshme në problemin e shkollave...Luigj Gurakuqi mund të kenë qënë shtysa kryesore për klubin *Bashkimi dhe Vllaznia* që reagojnë pozitivisht duke marrë me seriozitet përgatitjet për të"²³⁷. Në 17 maj 1908 në një mbledhje të fshehtë të Komitetit të Klubit të Manastirit u vendos të dërgohet në Elbasan Kamber Sejdiu për të kontaktuar direkt shoqërinë "*Bashkimi*" dhe shoqërinë "*Vllaznia*". Kongresi që ishte planifikuar për në mars ishte shtyrë sërish. Sipas letrës dëshira ishte të bëhej më 1 qershor²³⁸. Në fakt mundësia më e madhe ishte që sërish të mos zhvillohej, sepse koha ishte e pamjaftueshme për organizim. Në vijim të raportimeve, konsulli Bilinski njofton më 25 korrik 1909 në një raport që e cilëson sekret, se Kongresi do të mbahet në fund të gushtit dhe ka renditur çështjet që do të diskutohen:

1. Krijimi i shkollave shqipe, caktimi i numrit dhe i vendeve.

²³⁶ Mit'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, Instituti i Studimeve Historike Lumo Skëndo, Onufri 2017, f.264.

²³⁷ Gazeta Lirija, nr 2, 15 Maj 1909.

²³⁸ Mahir Domi M, *Alfabeti i gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: Mihal Duri 1972, f. 374

2. Çelja e një shkolle pedagogjike për mësues të shkollave shqipe.
3. Mënyra e mbajtjes së shkollave. Sigurimi i mjeteve të tjera.
4. Buxheti shkollor dhe zgjedhja e arsimtarëve.
5. Zgjedhja e një arsimtari për të gjitha shkollat.
6. Krijimi i një insituti qendror për kontrollimin dhe administrimin e shkollave.
7. Pranimin e shkollave shqipe ne buxhetin e shtetit, kthimin e institucioneve arsimore greke që janë sot në Shqipëri, në shkolla shqipe.
8. Bashkimi i klubeve në një program politik të përbashkët.²³⁹

Ndërkohë në vijim të kontakteve, Klubi i Manastirit i ka kërkuar tashmë qeverisë turke të njohë gjuhën shqipe në shkolla idadije dhe ruzhdiye. Në këtë mënyrë patriotët shqiptarë shfrytëzojnë të gjitha hapësirat ligjore që i garanton konstitucioni i Xhonturqve për të çuar përpara Lëvizjen Kombëtare.

Propozohet që data e mbledhjes së Kongresit të ishte 13 qershori i 1909-ës. Qeveria e Stambollit që në thelb mbështetej në politikën e osmanizmit, panturqizmit dhe panislamizmit, duke parë që ky Kongres përveç çështjeve kulturore do të trajtonte dhe çështje me karakter politik, po i nxirrte pengesa. Xhonturqit përdorën të gjitha mjetet duke filluar nga ndalimi i

²³⁹Po aty, f.375 Thirrje klubit të Selanikut drejtuar klubeve dhe shoqërive shqiptare Duke marrë në vërejtje që për nevojat tona, tani që kemi lirinë, duhet të përpiqemi më shumë e më tepër forcë dhe punonjësi nga ç' kemi bërë gjer më sot dhe, duke ditur se më e fortë e nevojave tona është përparimi e të përhapurit e gjuhës, burimi i çdo diturie, marrim nderin t'ju lajmërojmë se: Për të përhapurit e gjuhës, domethënë, për themelimin e shkollave, është nevoja që shqipëtarët të përpiqen vetë dhe pa humbur fare kohë. Për të bërë gjë me rrënjë dhe me rregull, është nevoja që gjithë shqiptarët të bashkojnë fuqinë e tyre për këtë qëllim me anë të Klubeve. Duke shikuar këto nevojat, e pamë të udhës që të bëhet një mbledhje (kongres) prej gjithë klubeve dhe shoqërive. Çdo klub duhet të dërgojë një a më tepër delegatë, që të marrin pjesë në këtë kongres. U pa e udhës që të shënohet për këtë mbledhje qyteti i Elbasanit, më 1 të majit 1909. Delegatët duhet të jenë të dërguar në klubet, shoqëritë a nga qytetet dhe të jenë marrë vesh më parë me klubin, qytetin dhe shoqërinë që i dërgon, duke gjykuar gjer' e gjatë punët, që do të sillen përpara kongresit dhe që janë këto:

1. Themelimi i shkollave shqip: numri dhe vendi i tyre.
 2. Themelimi i një shkolle për mësonjëse (école normale).
 3. Si do të mbahen shkollat? Ku do të gjenden të hollat? Sa do të ndihin klubet? Qysh do të mblidhen të hollat prej klubeve.
 4. Programi i shkollave; ç' mësim do të mësohen dhe me sa rreshta do të jenë shkollat?
 5. Bydçe e shkollave dhe të zgjedhurit e mësonjëseve.
 6. Të zgjedhurit një këqyrtari për gjithë shkollat.
 7. Të bërët një qendre për të rregulluar dhe për të shikuar punët e shkollave.
 8. Ç' rrugë do të zihet për të bërë shkolla shqip nga ana e qeverisë dhe për të kthyer shkollat, që sot janë në greqisht.
 9. Lidhja e klubeve me njëri-tjetrin dhe zgjedhja e një programi të përgjithshëm.
- Pritni, ju lutemi, të falurat me nder.
Kryetari: Mid' hat

shkollave deri në ekspeditat ushtarake të udhëhequra. Nga burimet austro - hungareze mësohet se Kongresi nuk do të shqyrtonte vetëm çështje kulturore por ai do të merrej edhe me çështje të karakterit politik dhe kuptohet do të përpiquej të nxirrte pengesa, duke penguar kështu hapjen e shkollave por edhe duke përdorur ekspedita ndëshkuese siç ishte ajo e Xhavit pashës për të shtypur lëvizjen e shqiptarizmit.²⁴⁰ Po kështu nga raportimet e konsullit austro-hungarez në Manastir, Postla, mësohet se Xhonturqit e komitetit "*Bashkim e Përparim*" nuk e shikonin me sy të mirë mbajtjen e kongresit të Elbasanit. Prandaj, përdorën mënyra të ndryshme për ta penguar atë. Qeveria e Stambollit transferoi papritur nga Elbasani në Manastir komandatin e xhandarmërisë, majorin Haxhi.

Në raportin e saj, konsullata austro-hungareze e Janinës më 25 gusht 1909, duke folur për kongresin e ardhshëm të Elbasanit vë re: "*Ajo që bie në sy është fakt se inisjativa për këto përgatitje nuk ka dal prej klubit qëndror të Manastirit, por prej klubit të Selanikut, i cili si në shumë raste të tjera, ashtu edhe këtë herë shikon që të rrëmbejë për vete drejtimin qëndror, në kundërshtim me vendimin që kishte zgjedhur klubin e Manastirit për dy vjet.*"²⁴¹ Pra, bëhet fjalë për zgjedhjen e klubit të Manastirit si klub drejtues nga vendimet e kongresit të Manastirit. Me gjithë pengesat që u përpoq të nxirrte Porta e Lartë, ajo nuk ndali dot zhvillimin e tij.

Me përgatitjen direkte të kongresit, u morën klubi i "Bashkimit" dhe ai i "Vllaznisë" në Elbasan. Të dy këto klube u kujdesën për shpërndarjen e ftesave për klubet dhe shoqëritë brenda dhe jashtë vendit.²⁴² Për vetë rëndësinë e vendimeve që mori, kongresi ka hyrë në ngjarjet e mëdha të historisë sonë. Në punimet e tij, kongresi do të shqyrtonte në mënyrë të veçantë problemin e shkollës shqipe që ishte bërë objekt i sulmeve të Xhonturqve, përgatitjen e mësuesve, organizimin në shkallë kombëtare të rrjetit të shkollave shqipe, drejtimin e përqendruar të tyre nga një institucion kombëtar dhe sigurimin e mjeteve financiare për mbajtjen e tyre. Thirrja bëhej e domosdoshme edhe për shkak të rritjes së shkollave shqipe pas kongresit të Manastirit.

²⁴⁰Petraq Pepo, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe kongresi i Manastirit*, Tiranë: Mihal Duri 1972, f.102 Popullsia e Vlorës nuk dërgoi delegatë në kongresin e Elbasanit që u mbajt nga 22-26 gusht stil i vjetër ...mos marrja pjesë në aksionin më të ri të Elbasanit është një nga pasojat me nacionalistët e këtushëm me xhonturqit që ndodhi në këtë pranverë ...

²⁴¹Mahir Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe kongresi i Manastirit*, Tiranë: Mihal Duri, 1972, f.44.

²⁴²Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f.415.

Më 22 korrik 1909 thërritet kongresi i Dibrës me nismën e Komitetit Qëndror "*Bashkim e Përparim*".²⁴³ Kongresi u thirr pas një situatë shumë të vështirë që kishin kaluar territoret shqiptare me terrorin që kishin kryer trupat e Xhavit Pashës. Qëllimi ishte që në një farë mënyre të qetësohej situata nga lëvizjet e armatosura në Kosovë e veçanërisht në zonën e Lumës. Sipas projektit të xhonturqve, Kongresi do të mbledhej në datën 23 Korrik 1908 në përvjetorin e parë të Hyrietit. Kongresi kishte karakter osman. Qëllimi i kongresit ishte t'i detyronte shqiptarët të hiqnin dorë nga lufta për çlirim. Klubi i Manastirit dhe ai i Selanikut që po merrej me përgatitjet për thirrjen e Kongresit të Elbasanit, u përpoqën të dërgojnë përfaqësuesit e tyre duke zgjedhur elementë atdhetarë²⁴⁴. Në kongres kanë marrë pjesë përfaqësues nga 5 vilajete të tjera ku numri total i pjesëmarrësve shkonte në 315. Në Kongres morën pjesë atdhetarë laikë dhe klerikë të dërguar nga Klubet dhe shoqëritë e ndryshme si Vehbi Dibra, Dervish Hima, Abdyl Ypi, Sotir Peci, Fehmi Zavalina, Hafiz Ali Korça, Loni Logora, Aqif Pasha, Beniamin Nosi. Vlen të përmendet që përfaqësues nga Elbasani në Kongresin e Dibrës ishte dhe Dervish Biçakçiu. Në një letër drejtuar Lef Nosit më datë 26 Korrik 1909 shkruhet: "*Në Dibër këti ditë është bërë një mbledhje prej njerëzish të cmuar nga shumë qytete të Shqipërisë sikurse ene nga Elbasani qenë zotnitë Haxhi Ali, Aqif pasha, Dervish Bej, Veniamin Nosi.*"²⁴⁵

Kryetari i kongresit u zgjodh Vehbi Dibra. E rëndësishme ishte që atdhetarët vendosën që punimet e kongresit të mos vijonin në qoftë se nuk do të mbronin interesat e shqiptarëve. Konsulli Kral raportonte nga Shkodra se një rol të rëndësishëm luajti në kongres Dervish Hima: "qëndrimi i patrembur e i bazuar mbi bindjen burrërore meriton mirënjohje".²⁴⁶ Kongresi miratoi një program në thelb të të cilit ishin kërkesat për mbrojtjen e popullsisë

²⁴³Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, *Aqif Pashë Elbasani (1860-1926)*, Tiranë:2012.

Ftesat që janë dërguar për kongres nga Xhonturqit. Kartat të cilat u hartuan deri para një viti për copëtimin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë, u grisën dhe u bënë të pavlefshme. Providenca hyjnore nuk mund të duronte më gjatë turpin që pësoi nga qeveria e mëparshme dhe ai u duk nën dritën e bashkimit dhe të vëllazërimit, në sajë të këtij ndricimi hyjnor, u zhduk grindja e vjetër fetare dhe kombëtare, jo vetëm tek neve por edhe në të gjitha pjesët e perandorisë, për të treguar unanimitetin tonë, në emër të zotit ju dërgojmë ftesën që këtij nga Dibra, qendër e Shqipërisë, që populli të dërgojë këtu përfaqësorin të denjë muhamedanë, që të marrin pjesë në bisedime në datën 10 korrik për qëllimet e përmendura më lart, si dhe në festimet e 9 korrikut.

Dashuria ndaj atdheut të shenjtë do të lehtësojë edhe mundimet.

Patriotë! ne u presim juve patjetër!

Komiteti i partisë konstitucionale Otomano-Arnaute në Dibër".

²⁴⁴Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f. 412.

²⁴⁵ Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, *Aqif Pashë Elbasani (1860-1926)*, Tiranë 2012, f 59.

²⁴⁶ Marenglen Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze 1877-1918*, Tiranë, Klean 2014, f. 114-115-116. Gjatë punimeve të kongresit vdes papritur deputeti dibran Isamil Pasah që ishte zgjedhur Kryetar, kështu që ditën e dytë zgjidhet kryetar Vebi Dibra.

shqiptare. *"Kërkohej marrja e masave që kishin të bënin me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik e kulturor...të hapeshin shkolla fillore, të mesme dhe të larta për tregëti e mjeshtri, ku gjuha shqipe të mësohej lirshëm në kufijtë e dëshiruar."*²⁴⁷ Xhon turqit imponuan nënshkrimin e një rezolutë në formën e një peticioni në të cilën Shqiptarët të shprehnin besnikërinë e tyre ndaj Perandorisë Osmane. Duhet vlersuar që krahu nationalist në Kongres ku bënin pjesë edhe patriotët e Elbasanit nuk pranuan. Këta patriotë paraqiten kërkesa të tjera disa prej të cilave ishin:

- Ndërtimin e rrugëve;
- Bonifikimin e moçaleve;
- Hapjen e shkollave fillore dhe të mesme në gjuhën Shqipe;
- Përcaktimin e rregullave për shërbimin ushtarak.²⁴⁸

Xhonturqit kërkuan që çështja e alfabetit të lihej në dorë sipas krahinave gjë që shënonte kthim pas në arritjet e Rilindjes kombëtare po të kemi parasysh që kjo gjë ishte vendosur në Kongresin e Manastirit. Kuptohej fare mirë që qëllimi i Xhon Turqve ishte të përcante shqiptarët. Kështu diplomacia Austro-Hungareze ishte përpjekur që në periudhën kohore midis Kongresit të Manastirit dhe Kongresit të Elbasanit të sheshonte mosmarrëveshjet midis shqiptarëve: "Në mbështetje të shqiptarëve në këtë periudhë ishte dhe qëndrimi i diplomacisë së Vjenës që interesohej për nxitjen e kujdesshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, për zhvillimin e arsimit dhe kulturës kombëtare si dhe për të konsoliduar rradhët e lobit proaustriak ndër shqiptarët."²⁴⁹ Me gjithë se nuk shënoi arritje të dukshme, Kongresi i Dibrës ishte një tjetër përpjekje e shqiptarëve për të çuar përpara kërkesat e Lëvizjes Kombëtare. Pjesëmarrja e Dervishit në të tregon qartë që ai ishte i angazhuar në ngjarje të rëndësishme ku shqiptarët përpiqeshin të siguronin sa më shumë të drejta nga Porta e Lartë. Të qënurit përfaqësues i Elbasanit tregonte që ai tashmë edhe pse në moshë të re merrte pjesë në Kuvende ku shqyrtoheshin çështje për të ardhmen e Shqipërisë. Dervishi përfaqësoi Elbasanin krahu për krahu me patriotët të tjerë si Vehbi Dibra, Dervish Hima, Abdyl Ypi, Sotir Peci, Fehmi bej Zavalani, Aqif pasha, Beniamin Nosi etj, të cilët kishin kohë që ishin vënë në shërbim të çështjes Kombëtare dhe që po luftonin fort për të siguruar të drejta që do të mund ta çonin Shqipërinë drejt autonomisë. Pikërisht ishin këta figura që mbështesnin krahun nationalist dhe do të bëheshin pengesë për xhonturqit. Këta patriotë nuk pranuan programin

²⁴⁷ Po aty, f. 414.

²⁴⁸ Arben Puto, Shqipëria politike 1912-1939, Tiranë, Toena 2009, f. 13.

²⁴⁹ Maringlen Verli, Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze 1877-1918, Tirane, Klean 2014, f. 139.

xhonturk, duke shprehur dakortësinë për krijimin e një komisioni ku bënin pjesë 5 përfaqësues nga çdo vilajet për të përcaktuar një program të hollësishëm si shtojcë që u miratuan mes debatesh të mëdha.²⁵⁰

3.2 Kongresi i Elbasanit dhe roli i Dervish Biçakut në të.

Në këtë kohë Elbasani ishte shndërruar në një qendër të rëndësishme të ngjarjeve e veprimtarive për çështjen kombëtare dhe paraqiste një nivel të kënaqshëm të zhvillimit arsimor e kulturor në shkallë kombëtare.²⁵¹ Pesë klube dhe shoqëri patriotike ishin krijuar dhe zhvillonin aktivitetin e tyre në këtë qytet, në mbështetje të Lëvizjes Kombëtare. Mbërritja e tridhjetë e pesë delegatëve nga njëzet e tetë klube e shoqëri patriotike në Elbasanin e njohur për traditën e tij, arsimore e kulturore dhe me figura të shquara të Rilindjes Kombëtare, u prit me gëzim nga banorët e këtij qyteti. Nuk arritën të merrnin pjesë delegatët e Vlorës, Shkodrës dhe Kosovës.²⁵² Arsyeja e mospjesëmarrjes së tyre ka të bëjë me politikën përçarëse që ndiqnin xhonturqit. Kështu nga raportimet e diplomacisë austro-hungareze, nënvizohet mungesa e degatëve nga Shqipëria e Veriut, ku burimin e përçarjes e shikonin te propaganda turke. Ndërsa në rastin e Vlorës, ishte ushtruar dhunë ndaj parisë së atjeshme²⁵³.

Në këtë kongres, siç u përmend edhe më lart, morën pjesë delegatë të klubeve shqiptare dhe këto klube janë mburoja e nacionalizmit shqiptar.²⁵⁴ Ky kongres do të jetë një ngjarje e rëndësishme që do të shënojë jetën e tij dhe atë të historisë së qytetit që ai (Dervish beu) aq shumë e deshi. Dervishi me personalitetin e tij të padiskutueshëm diti të bëjë bashkë myslimanë dhe të krishterë, ortodoksë e katolikë gjatë ditëve të mbajtjes së tij. Mbajtja e kongresit në Elbasan, qe një ngjarje e shumëpritur për qytetin që kishte dhënë një kontribut deri tani të konfirmuar për gjuhën shqipe. Intelektualët e këtij qyteti mirëpritën delegatët nga e gjithë Shqipëria dhe trojet jashtë saj. Për rëndësinë e madhe të kongresit, është folur aq shumë, është shkruajtur aq shumë nga historianë vendas dhe të huaj, saqë tashmë ai

²⁵⁰Po aty, f.119.

²⁵¹Po aty, f.102.

²⁵² HHSTA PA A, raport i konsullit të austro-hungarisë në Vlorë, 18 shtator 1909. Në këtë raport thuhet: "...popullësia e Vlorës nuk dërgoi delegatë në kongresin e Elbasanit... mosmarrja pjesë në aksionin më të ri në Elbasan është një nga pasojat e shumta të këqija të përçarjes së hapur të nacionalistëve të këtushëm me Xhonturqit që ndodhi në këtë pranverë si dhe raprezeljeve që morën këta kundër këtyre."

²⁵³Maringle Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze 1887-1918*, Tiranë:Klean 2014, f. 142.

²⁵⁴Jaray G.L , " *Shqipëria e panjohur*",Tiranë:Dituria 2006, f.143.

konsiderohet si një Kongres Kombëtar i Elbasanit.²⁵⁵ Kongresi që përmbushja e aspiratave shumëvjeçare të shqiptarëve që më në fund të hapnin një shkollë të mesme për përgatitjen e mësuesve.

Pse Kongresi u vendos të thirrej në Elbasan? Vendimi, që në këtë qytet të mbahej Kongresi, nuk është i rastësishëm.

Së pari, ky qytet kishte dhënë deri në këtë kohë kontribut shumë të madh në fushën e arsimit; mjafton të përmendim këtu figura të tilla si: Kostandin Kristoforidhi, Theodor Haxhifilipi ose siç njihet ndryshe Dhaskal Todri, dhe përpjekjet që kishin bërë ata për hapjen e disa shkollave fillore jo vetëm në qytet, por edhe në zonat rurale.

Së dyti, Elbasani siç edhe e kemi përmendur, është një vatër e rëndësishme e Shqiptarizms dhe në këtë kontekst kishte mbi të gjitha, potencialin intelektual për t'i dhënë jetë atij.

Së treti, në Elbasan ishin krijuar tashmë shumë klube dhe shoqëri të cilat kishin krijuar djepin e domosdoshëm nga ku do merrte jetë Normalja.

Së katërti, vetë pozita gjeografike në mes të Shqipërisë e bënte më të lehtë organizmin, po të kemi parasysh terrorin e egër Xhonturk që kishte nisur që nga pranvera e 1909.²⁵⁶

Së pesti, që të mund të funksiononte normalisht, punimet Kongresi kishte nevojë për mbështetje financiare gjë të cilën bejlerët elbasanas nuk e kursyen jo vetëm gjatë ditëve të mbajtjes së tij, por edhe më vonë në mbështetjen financiare të Normales. Konkretisht kanë kontribuar Biçakçinjtë, Verlacët, Toptanasit etj, madje bejlerët e shkolluar pranuan të bëjnë edhe punën e mësuesit vetëm që të kontribuonin në arsimin e popullsisë.

Punimet u zhvilluan në një atmosferë shumë entuziaste, të ngrohtë dhe të gëzueshme. Përgjatë gjithë ditëve të zhvillimit të punimeve, nga data 2 deri më 8 shtator, të pranishmit diskutuan jo vetëm për probleme të arsimit, që ishte synimi kryesor i tij, por edhe për probleme politike dhe kombëtare. Delegatët e kongresit në rrugë demokratike, me vota të fshehta, zgjodhën forumin drejtues. Me 39 vota pro u zgjodh kryetar Dervish Biçakçiu, me 29 vota pro nënkryetar u zgjodh Mit'hat Frashëri, ndërsa shkronjës të kongresit u caktuan Simon

²⁵⁵Liman Varoshi, "Normalja në traditë", botuar nga gazeta "Reklama" 1995, f.36.

²⁵⁶Akademia e Shkencave, *Historia e popullit Shqiptar*, Vëllimi i II, Tiranë: Toena 2002, f.415.

Shuteriqi dhe Josif Haxhimima.²⁵⁷ Pjesëmarrës të tjerë në kongres ishin: Orhan Pojani, Gjergj Qiriazhi, Andrea Konomi, Thoma Papapano, Don Nikoll Kaçorri, Qemal bej Karaosmani, Refik Toptani, Hafëz Ibrahim, Mahmud aga Fortuzi, Hamdi Ohri, Idhomeni Kosturi, Mihal Gjurashtovici. Delegatët e dërguar nga ana e klubeve dhe shoqërive, që gjenden brenda dhe jashtë Shqipërisë, u mbledhën më 20 gjer më 27 të gushtit 1909 dhe morën vendime të rëndësishme.²⁵⁸

Entuziazmi ishte shumë i madh gjë që vërtetohet edhe nga francezi Yaray, por edhe nga një pjesëmarrës në Kongres i cili shkruante: *"Ne nuk mund të harrojmë shërbimet që kishim nga të gjithë anëtarët e klubeve dhe shoqëritë të Elbasanit. Ishte gaz i madh për neve të shohësh kryesonjësin e Kongresit, të çquarin Dervish bej, të të rrijë në këmbë duke nderuar dhe duke shërbyer miqtë...Aqif Pasha, Shefqet beu dhe Dervish beu benë dhe darkë në shtëpi për të gjithë delegatët".*²⁵⁹ Kështu në Kongres u zgjodhën tri komisione të cilat do të shqyrtonin tri probleme:

- a. për themelimin e shkollës normale që do të përgatiste mësues, përpunonte rregulloren dhe planet mësimore;
- b. për shoqërinë qendrore shkollore dhe do të hartonte një projekt rregullor të saj;
- c. për bashkërendimin më të mirë të klubeve kombëtare.

Siç bëhet e ditur punimet filluan në klubin "Bashkimi" dhe vazhduan më pas në ndërtesën e klubit Vllaznia.²⁶⁰ Sipas diskutimeve në kongres krijohet një komision i cili përbëhej nga 9 vetë i cili kishte si mision të shkonte në Korçë dhe së bashku me klubet atje do të zgjidhnin Pleqësinë e shoqërisë Përparimi. Në këtë komision bënë pjesë Dervish bej, Mit'hat Frashëri, Ahmet Dakli, Teki bej, Kristo Daka, Selman Blloshmi, Gjergji Qiriazhi, Irfan bej, Haxhi Bajrami. Këta anëtarë më pas do të merrnin pjesë në mbledhjen për krijimin e Pleqësisë së shoqërisë "Përparimi" në Korçë, mbledhje e cila u mbajt më 23 shtator ku kryetar u zgjodh

²⁵⁷Elbasani-Enciklopedi, Sejko: 2003, f.301-302.

²⁵⁸Po aty, f. 267, Delegatët e Kongresit të Elbasanit; Elbasan: (klubi "Vllaznia"): Dervish bej, Qamil Feza; Elbasan: (klubi "Bashkimi"): Emin Haçi Ademi, Taqi Buda; Elbasan: (Shoqëria "Afërdita"): Josif Haçi Mima, Simon Shuteriqi; Berat: Qemal bej Elbasani, Kahreman Vrioni; Filat: Mid'hat Frashëri; Selanik: Mid'hat Frashëri, Osman effendi; Shkup: Mid'hat Frashëri, Osman effendi; Strugë: Abdullah Ahmet Dakli; Kozan: Abdurrahim effendi; Ohër: Hamdi bej, Irfan bej; Përmet: Haçi Bajram bej, Gjeki bej; Leskovik: Haçi Bajram bej, Gjeki bej; Manastir: Gjeorgji Qiriazhi; Dibër: Gjeorgji Qiriazhi; Misioni Amerikan: Cilka, Dako, Zonja S. Qiriazhi; Skrapar: Abdullah bej; Janinë: Mid'hat Frashëri; Jeniçë: Mid'hat Frashëri; Karaferia: Mid'hat Frashëri, Osman effendi; Korçë: Orhan bej, Idhomene Kosturi; Gjirokastrë: Andre Ikonomi, Thoma Papapano; Starovë: Selman, Sylejman efendi; Tiranë: Refik bej, Hafëz effendi; Peqin: Sabri efendi; Frashër: Mid'hat Frashëri; Gramsh: Tahla bej; Durrës: D.Kaçori, Jahja efendi, Mihal K. Sava; Qypri: Dervish bej Elbasani.

²⁵⁹H. Myzyri., *Shkolla Normale e Elbasanit* (1909-1912), Tiranë: albPaper 2004, f.193.

²⁶⁰Po aty, f.192.

Orhan Pojani. Edhe këtu kontributi i Dervishit është për t'u vlerësuar për vetë rolin që do të luante shoqëria "Përparimi" e cila kishte disa detyra të rëndësishme:

- a. Çelja e shkollave shqipe;
- b. Botimi i librave shqip;
- c. Emërimi i inspektorëve për të kontrolluar gjendjen e nevojave të shkollave e klubeve;
- d. Forcimi i bashkëpunimit midis shoqërive brenda dhe jashtë vendit;
- e. Sigurimi i fondeve dhe ndihmave financiare për shkollën.

Sipas të dhënave në ditën e katërt krijohet një komision i përbërë nga Dervish bej Biçakçiu Qemal Beu, Teki Rusi, Refik Toptani, Orhan Pojani, Irfan Beu, "*i cili mori përsipër të bajë një listë të gjithë atdhetarëve të pasun qi ndodhën ndë të katërt anët e Shqipërisë e gjetkë, e t'u rrafi telegrafe, duke u lutun me emrin e kongresit qi t'i ndihin me sa të mundet me të holla për përmbajtjen e mësonjëtores e të mësonjëseve.*"²⁶¹ Sqarohet që klubi qëndror do të ishte ai i Manastirit, aty u vendos së në rast se klubi qëndror nuk kryente detyrën siç duhej, klubet e tjera kishin të drejtë t'i hiqnin funksionet dhe të zgjidhnin një klub qëndror.²⁶² Kongresi zgjodhi gjithashtu, më datë 7 shtator 1909, Pleqësinë kujdestare për shkollën e mësojvet. Kryetar i Pleqësisë edhe këtu ishte Dervish bej Biçakçiu, anëtarë ishin Hysen Ceka, Lef Nosi, Emin Haxhiademi, Dhimitër Buda, etj. Ndërkohë që mbahej Kongresi i Elbasanit, nën trysinë e kërkesave të shqiptarëve, Xhonturqit kishin arritur që më 3 shtator të pranonin që në shkollat qytetëse (ruzhdie) dhe gjimnazet (idadie) të mësohej gjuha shqipe dhe që mësuesit e kësaj gjuhe të paguheshin nga buxheti i shtetit. Në këto kushte ishte më e lehtë mbajtja e punimeve të kongresit të Elbasanit. Sipas vendimeve, shkolla Normale duhej të hapej më 14 shtator 1909, por kjo gjë ishte e pamundur për arsye subjektive, sepse nuk mundej që për një kohë të shkurtër të bëheshin të gjitha përgatitjet e nevojshme. Shkolla Normale do të kishte 6 klasa të ndara në dy etapa, 3 klasa të para në të cilat nxënësit do të pajiseshin me kulturë të përgjithshme dhe 3 klasa të larta në të cilat nxënësit do të studionin metodat e të mësuarit.²⁶³ Për mbarëvajtjen e shkollës Normale u krijua edhe një këshill që përbëhej nga 8 persona. Ky këshill do të zgjidhej një herë në vit. Ai do të bashkërendonte punën me drejtorin e shkollës, do të merrej me punën edukative e do të jepte ndihmë për forcimin e bazës materiale. Ky këshill kishte në dispozicion, çdo vit, 100 lira për t'i ardhur në

²⁶¹Po aty, f.109.

²⁶²M. Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: Mihal Duri 1972, f. 105. Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir derguar Mibnistrisë së punëve të jashtme në Vjenë.

²⁶³Po aty, f.107.

ndihmë nxënësve të vobektë. Delegatët e Kongresit vendosën që klubet dhe shoqëritë shqiptare të kishin lidhje midis tyre. Klubi “Bashkimi i Manastirit” u zgjodh klub qëndror. Duhet thënë që në kongres pati debate për këtë zgjedhje ku sipas konsullit austro-hungarez, Postl, thuhet: *“Mit’hati nk e mbajti dot zemërimin, prandaj lëshoi nga goja shprehje fyysi si “hëngshi njëri-tjetrin” gjë që shkaktoi indinjatë të përgjithshme...ai humbi shumë nga simpatia, nderimi dhe influenza që kishte ndër shqiptarë.”*²⁶⁴ Duket që Mit’hat Frashëri kishte pretenduar që si një nga organizatorët e Kongresit të Elbasanit, klubi i tij i Selanikut duhej të luante rolin e një klubi qëndror. Madje kaq i madh ka qënë zëmërimi sa në momentin që ka firmosur ka shkruar se nuk e pranonte Klubin e Manastirt si klub qëndror. Pretendohej nga ana e Mit’hat Frashërit që në Elbasan ishte bërë një pritje e ftohtë, kjo ndoshta nga fakti që ndër patriotët ishte i njohur fakti që ai merrte 15 lira turke çdo muaj nga Stambolli. Kjo e bëri që në ditën e fundit të thërrasë në mbledhje *“Poshtë Austria!”*²⁶⁵ Duhet thënë që Kongresi vendosi t’i dërgojë një telegram Vezirit të madh për persekutimin e patriotëve shqiptarë në Vlorë. Shoqëria “Përparimi” njofton më 3 dhjetor 1909: *“Të dashur atdhetarë! Mësënjëtorja për mësënjëtorë në Elbasan u çel; mësënjëtore kudo po hapen, ndihma kërkojnë nga të gjitha anëtë. Kemi të madhe shpresë se me të marrë këtë letër do të vraponi të na nderoni me ndihmën’ e zotëris’ suaj.”*²⁶⁶ Punimet e Kongresit u organizuan në dy mënyra, përveç mbledhjeve të hapura dhe vendimeve të publikuara, u mbajtën edhe mbledhje të mbyllura, në të cilat u diskutuan probleme të rëndësishme politike siç ishin:

- a. Atakimi i politikës së ndjekur nga Xhonturqit;
- b. Shtrimi i nevojës së domosdoshme për një organizim e lidhje më te mirë të komiteteve të fshehta
- c. U shpreh mendimi se mjeti më i mirë për të siguruar të drejtat kombëtare ishte lufta me armë²⁶⁷

Në një raport të diplomacisë austro-hungareze, dëshmohej se në kongres, ishin trajtuar edhe “çështje politike” për të cilat nuk kishte të shënuar gjë në protokoll. Sipas këtyrë raporteve, ishin diskutuar çështje të tilla :

- a. Për krijimin e një kishe kombëtare shqiptare;
- b. Propozime gjithashtu nga delegatët e Korçës që në shkollën që do krijohej të mos mësohej feja (por nuk kishte gjetur mbështetje);

²⁶⁴ *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Nr. 72, 20 shtator 1909, f. 365. Raporti i Konsulli Postfai.

²⁶⁵ M. Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: Mihal Duri 1972, f. 363.

²⁶⁶ *Gazeta Korça*, 3 dhjetor 1909, f.4.

²⁶⁷ Liman Varoshi, *"Normalja në traditë"*, Tiranë, botuar nga gazeta "Reklama" 1995, f.39.

Vlen të përmendet qëndrimi armiqësor që mbanin pjesa me e madhe e delegatëve ndaj xhonturqëve dhe politikës së tyre përçarëse. Diplomacia austro-hungareze nuk ka arritur rastësisht në këtë përfundim, sic dëshmohet, Komiteti Qendror i xhonturqëve nuk linte rast pa nxitur komitetet lokale të tyre në qytete të ndryshme për të penguar mbajtjen e kongresit.

Fryma që përshkoi gjithë Kongresin, me disa përjashtime, ishte një frymë atdhetare dhe e besimit se kjo ngjarje (kongresi) do të ndikonte dukshëm në të ardhmen e vendit. Shqiptarët nuk do të pranonin më kundërshtitë e qeverisë xhonturke për përparimin dhe autonominë e vendit. Kështu vlen të përmendet qënë paragrafin e fundit të raportit, konsulli Pasfai shkruante se: *“Bejlerët e Elbasanit, e para së gjithash Dervish Biçakçiu pothuajse hapur, janë shprehur, se kombi shqiptar, në qoftë se qeveria e sotme nuk njeh aspiratat e tijtë drejta për ruajtjen e pavarësisë (në kuptimin për të siguruar autonominë) dhe përpiqet të shtypë, do të gjejë rrugëdalje në dhunën e hapur, do të ishte i detyruar të rrëmbente armët”*.²⁶⁸ Ky qëndrim i Dervish Biçakçiut tregon qartë që ai nuk ishte rastësisht në këtë ngjarje madhore të Historisë sonë Kombëtare. Mendimet e shprehura tregojnë tashmë për një patriot të formësuar tashmë dhe që nuk kishte ndërmend ashtu siç historia do të tregojë, të bënte kompromis me regjimin xhonturk, përkundrazi do të jetë një nga njerëzit që për shkak të këtyre bindjeve do të bëhet pengesa kryesore dhe do të vuajë përgjatë terrorit të tyre. Njëkohësisht qëndrimi i tij tregon qartë frymën antiosmane që mbizotëronte në radhët e shqiptarëve. Qëndrimi i tij shpreh në mënyrë të përsëritur atë që ky personalitet por dhe qyteti që përfaqësonte, ishin një faktor shumë i rëndësishëm në lëvizjen tonë Kombëtare. Elbasani në mënyrë të padiskutueshme do jetë një nga promotorët kryesorë të zhvillimit të arsimit në vitet e mëvonshme dhe do të luajë rol kyç në Shpalljen e Pavarësisë.

Në Kongres ashtu siç edhe dëshmon diplomati austro-hungarez i Manastirit, u vunë re prirje antixhonturke, të cilët e shikonin me zemërim politikën e tyre: *“Kjo armiqësi nuk u shfaq haptazi në Kongres, për arsye se delegatët më të matur përmbajtën më të rrëmbyerit. Shumë prej tyre shprehën bindjen se Komiteti Qendror i Xhonturqve për sy e për faqe është në favor të shqiptarëve, ai i detyron komitetet lokale, të pengojnë aspiratat e shqiptarëve sa herë shfaqet rasti”*²⁶⁹. Duhet theksuar se vetë Kongresi dhe vendimet e tij do të shiheshin me skepticizëm nga Konsulli austro-hungarez në Manastir, Postfai, i cili shkruante: *“Në përgjithësi mund të themi se Kongresi nuk do t'i plotësoj aspak shpresat që kanë tek ai...për arsye se zbatimi i vendimeve të Kongresit dhe sidomos hapja e një shkolle Normale qysh në*

²⁶⁸Maringle Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze 1877-1918*, Tiranë, Klean 2014, f. 150.

²⁶⁹Petra Pepo, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: Mihal Duri 1972, f.105.

- Kongresi i mbajtur në Elbasan në zemër të Shqipërisë pohoi me ngulm deshirën e madhe të shqiptarëve për të njohur kombësinë e tyre.
- Në gazetën “La nazione Albanese”, Kongresi cilësohej si “...*Pohimi më i lartë i intelektit shqiptar, shprehja më e lartë në praktikë e tij.*”²⁷¹
- Kongresi mund të konsiderohet një xhevahir në kurorën e madhe të përpjekjeve të rilindasve për shkollën dhe gjuhën shqipe.
- Vendimet që ai mori qenë një goditje për Portën e Lartë e cila nuk kishte lejuar për 500 vjet shkollat dhe gjuhën shqipe.
- Në arritjet e Kongresit pa dyshim një pjesë e meritës i takon Dervishi bej Biçakçiut, i cili bëri një punë të palodhur në emër të shqiptarizms dhe gjuhës shqipe. Që nga ky moment e më pas ajo do të haste kundërshtimin e Portës së Lartë.²⁷²
- Kongresi Institucionalizoi idetë mbi të ardhmen e arsimit shqiptar.²⁷³

Kristo Dako konfirmonte se puna e Pleqësisë në muajt deri në hapjen e Normales ishte pareshtur, një nga problemet që kërkonte zgjidhje ishte sigurimi i trupës pedagogjike. Ishte shumë e vështirë të vendosje një figurë të ekuilibruar drejtor të shkollës. Ndërmjet shumë figurave të përzgjedhura dukej që ajo do të përmbushte kërkesat e Shqiptarëve dhe patriotëve do të ishte ajo e Luigj Gurakuqit, i cili ishte katolik dhe gëzonte edhe mbështetjen e një fuqie të madhe për kohën, atë të Austro-Hungarisë.

Në një raport të konsullit A.H të Shkodrës, i klasifikuar si tepër sekret, njoftohet mbi një telegram të Dervish beut që njoftonte Luigj Gurakuqin mbi vendimin për hapjen e një shkolle normale në Elbasan. Shpjegohej se duhet të gjendëshin mësues të përshtatshëm, paga e të cilëve do të ishte 100 lira në muaj. Për drejtorin do të ishte 150 lira në muaj. Në raport duket se informacionet e konsullit janë të sakta, sepse ai konfirmon faktin që Luigji kishte pranuar dhe ky ishte një lajm pozitiv duke u shprehur: “*Pranë bujarëve elbasanas të zihen vendet në Normalen shqip me elementë që na duan të mirën tonë.*”²⁷⁴

Dukej që në këtë sipërmarrje ai kishte bindur edhe elbasanasin tjetër, Aleksandër Xhuvanin, i cili në këtë kohë ishte mësues në Kalabri. Në një letër që Luigj Gurakuqi i dërgonte nga Napoli Lef Nosit më datë 24 Tetor 1909 shkruante: “*Sot 10 ditë do të jemi në Elbasan, jam shumë i kënaqun që Aleksandri m'i ndëgjoi arsyet e mia e qi do jetë aty një nga*

²⁷¹La nazione Albanese, Cantanzaro, 1909, 15 tetor nr. 15.

²⁷²Po aty

²⁷³Tomor Plangarica, *Normalja në Traditë*, Elbasan:Reklama,1995,f29

²⁷⁴H. Myzyri, *Shkolla Normale*, Tiranë, albPaper 2004, f.355.

punëtorët e shkollës Normale."²⁷⁵

Në tetor 1909, Shoqëria i kërkonte klubit "Bashkimi" dhe "Vllaznia" të dhëna mbi të gjitha rregullat që kishin dalë nga Kongresi i Elbasanit si dhe i bënte të qartë që të gjitha shpenzimet duke përfshirë edhe pagat e mësuesve do të paguheshin nga shoqëria "Përparimi".

Ky këshill bëri gjithashtu një punë të palodhur për gjetjen e godinës dhe të orendisë së shkollës. Këshilli Mbikëqyrës për të cilën punoi me shumë zell Dervishi, arriti që më 21 Tetor 1909 t'u bënte të ditur atdhetarëve dhe prindërve se më 6 Nëntor do të fillonin regjistrimet. *"Programi i cili do të botohet pas pak kohe, do të jetë i plotë, sipas shkollave të huaja të këtij qëllimi, kështu që nxënësit që do të mbarojnë këtë shkollë, përveç që do kenë një arsim të plotë, do të kenë dhe një diplomë të huaj mësonjesi për shkollat e para dhe të dyta.*"²⁷⁶

Këshilli kishte detyrë të rëndësishme gjetjen e një godine për Normalen si dhe një godinë për konviktin. Si godinë e parë u mor me qera shtëpia e Hysen Zylfit. Problem paraqiste edhe sigurimi i konviktit me qenë se pritej të regjistroheshin nxënës nga shumë vise të Shqipërisë.²⁷⁷ Ky konvikt sipas sqarimeve të Keshillit do të ishte pa pagesë. Përpjekjet e Dervishit vërtetohen nga shtypi i kohës, letrat me patriotët e kohës, udhëtimet e shumta jashtë Shqipërisë, kontaktet me diplomacinë e huaj me qëllimin e vetëm për të siguruar hapjen e shkollave shqipe dhe botimet e librave në gjuhën shqipe.

Kështu në një atmosferë patriotike, dita e shumëpritur, 1 dhjetori i 1909-ës kishte mbërritur, e Normalja më në fund u hap. Luigj Gurakuqi, drejtori i shkollës, mbajti një fjalim që ka hyrë në histori: *"Elbasani, sikundër asht mezi i Shqypnies landore, ashtu do të jetë edhe mesi i Shqypnies mendore.*

Në gazetën Tomorri të datës 24.03.1910 jepen të dhëna mbi nurin e nxënësve të shkollës Normale. Në të shkruhej: 'Nxënësit e shkollës Normale sipas qyteteve që kanë ardhur dahan kështu:

²⁷⁵AQSH,F.Lef Nosi,D55/1, fl. 100.

²⁷⁶Mendimi Politik i Shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Vëllimi II, Tiranë: 8 Nëntori 1976, f. 347.

²⁷⁷Po aty, f. 217.

NR	VENDI	NXENES	NR	VENDI	NXENES
1	Elbasan	50	13	Picaar	1
2	Tiranë	4	14	Përmet	3
3	Berat	1	15	Libohovë	3
4	Peqin	1	16	Strugë	1
5	Cpat	6	17	Dibër	7
6	Gjirokastrë	2	18	Starovë	2
7	Peje	1	19	Shkodër	2
8	Jakove	3	20	Krujë	1
9	Mitrovicë	3	21	Kavajë	1
10	Prizren	2	22	Gjilan	5
11	Ysqyp	4	23	Vucitër	5
12	Delvinë	1	24	Pecovë	2

3.3 Kongresi Elbasanit në fokusin e studiuesve të huaj

Për shkak të rëndësisë së madhe që patën vendimet e marra në këtë Kongres në lidhje me ardhmërinë kombëtare, ai ka qënë temë e studimit të shumë autorëve shqiptarë, por edhe të huaj. Një nga autorët që na jep detaje mbi Kongresin e Elbasanit është Gabriel Louis Jaray. Ai ka qënë i pranishëm në ditët e para të punimeve. Ai na përshkruan një panoramë të qartë të ditës së Kongresit në librin “Shqipëria e panjohur”. Në mbretërinë e re të shqiptarve.” Konsiderohet si një nga studiuesit më të mirë të historisë së Europës Qëndrore, Italisë e Ballkanit. Autori jep një përshkrim edhe të portretit fizik të Dervishit duke u shprehur: “*Është një burrë rreth të dyzetave, i veshur me sqimë në mënyrë europiane me një xhakatë nën të cilën vërehet një jelek i bardhë dhe me një palë pantallona me ngjyrë të çelët. Në kokë një feste të kuqe, e cila është diçka kalimtare midis fesit turk dhe qeleshes shqiptare. Dervish beu është shtatëlart, zeshkan, me mustaqe të shkurtra. Ai ka një fytyrë të çuditshme, të cilët e gjallërojnë dy sy të ndritshëm, të përhimtë, gjithnjë në lëvizje.*”²⁷⁸ Autori bën një përshkrim deri në detaje të karakterit të tij nga ku kuptohet që Dervishi ishte një njeri që i pëlqente biseda dhe gjatë gjithë kohës bisedat i shoqëronte me gjeste të shumta. Banesa, sipas autorit, përbëhej nga dy ndërtesa. Ndërtesat ndaheshin nga një oborr i madh, tipik për shtëpitë karakteristike të Elbasanit të quajtura ‘hajate’. Ndërtesa në të majtë quhej ‘Haremlleku’, e

²⁷⁸ Gabriel Louis Jaray, *Shqipëria e panjohur*, Tiranë: Dituria 2006, f. 140.

zbukuruar me shumë gusto ose sqimë. Këtu banonin gratë dhe fëmijët. Pjesa tjetër quhej ‘Selamllëku’ ku mund të hynin vetëm burrat. Në shtëpinë e Dervishit kishte të paktën 10 shërbyes në moshë relativisht të re. Gabriel Yaray vlerëson “bejlerin” Dervish si përtëritës i madh i energjive të popullit të tij. Gjykimi merr vlerë në gojën e një të huaji që është larg ndikimit të pseudoautorëve që me të padrejtë e kanë konsideruar Dervishin konservator apo se ishte në anën e gabuar të historisë pas 1912. Po nga Yaray na shfaqet një tjetër pamje e karkterit të tij, ajo e mikëpritjes, po të kemi parasysh që gjatë gjithë ditëve të kongresit ajo që mbështetja kryesore e tij. Dervishi nuk kurseu as burimet financiare, as ato materiale dhe as ato njerëzore në funksion të mbarëvajtjes së kongresit dhe më pas të Normales.

Sipas tij Kongresi ishte një ngjarje e rëndësishme në Rilindjen e shqiptarëve. Ai ishte Kongresi i parë që “...u mbajt me nismën e shqiptarëve të cilët kërkonin të pohonin me ngulm kombësinë e tyre mu në zemër të Shqipërisë.”²⁷⁹ Kongresi “u mor zyrtarisht vetëm me klubet dhe shkollat shqiptare.” Zgjodhi tre komisione: “një për studimin e buxhetit, një për organizimin e klubeve dhe një të tretë për ngritjen e shkollave shqipe.”²⁸⁰ Ndërkaq ai shprehej se Kongresi trajtoi edhe çështje të veçanta, çështje të tjera si çështja e besimeve fetare, dhe marrëdhëniet me qeverinë turke.²⁸¹ Përveç mendimeve të shprehura në lidhje me vendimet e kongresit, Jaray ndalet gjerësisht edhe mbi pjesëmarrësit e tij, ku spikasin figurat e Dervish bej Biçakçiut, përfaqësues i klubit “Vllaznia”, Mit’hat bej Frashëri që përfaqësonte klubin e Stambollit dhe atë të Selanikut, Refik bej Toptani përfaqësues i klubit të Tiranës, Gjergj Qiriazi delegat i Manastirit. Sipas tij ishin bejlerët ata që morën drejtimin e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të vetë kongresit. Siç edhe dihet çifligarët e rinj ishin të pakënaqur nga politika dhe nga paaftësia e Perandorisë Osmane për të mbrojtur tërësinë territoriale të vendit nga rreziku i copëtimit dhe i zhdukjes së shqiptarëve si komb. Grupe të veçanta të kësaj force shoqërore u përfshinë në programin kombëtar shqiptar dhe luajtën një rol të dukshëm në lëvizjen nacionale në epokën e Rilindjes, kurse mjaft intelektualë, të dalë nga gjiri i kësaj shtrese çifligarësh, përqafuan idetë e reja, u bënë pionierë e ideologë të Rilindjes.²⁸²

Duke u shprehur për kongresin Jaray do të vlerësonte faktin se në diskutimet e shumta u kërkua një mënyrë që të sigurohej një buxhet i rregullt. Për këtë u vendos që klubet e çdo qyteti do të paguanin një shumë të caktuar për mbajtjen e shkollave dhe zhvillimin e

²⁷⁹ Gabriel Louis Yaray, “L’albanie inconnue”, Dituria: 2006, f.142.

²⁸⁰ Po aty, f.143

²⁸¹ Gabriel Louis Yaray, “L’albanie inconnue”, Dituria: 2006, f.144.

²⁸² Po aty, f.144

propagandës kombëtare. Duket fare qartë që çështja e gjuhës tek shqiptarët del në plan të parë, prandaj edhe vendimet më të rëndësishme u morën për shkollat. *“Asnjë vend i Evropës nuk është lënë aq në padije, asnjë popull nuk ka mbetur aq i mënjanuar nga arsimit, madje dhe nga ai më fillestari, siç ka mbetur populli shqiptar.”*²⁸³ Kjo nuk është gjë tjetër veçse politika e ndjekur nga Stambolli. Duke zbatuar këtë politikë Stambolli mendonte se mund të siguronte më me lehtësi besnikërinë e shqiptarëve ndaj Padishahut. Prandaj shkollat shqipe shihen me dyshim, gazetatat shqiptare ndalohen dhe shkrimi në gjuhën shqipe nuk lejohej fare.²⁸⁴ Prandaj u vendos që në Elbasan të ngrihej një shkollë pedagogjike që do të përgatiste mësuesit e ardhshëm. Sipas vendimeve të Kongresit gjuha turke do të mësohej si gjuhë e dytë së bashku me dy gjuhë te huaja. Interesant është fakti i zgjedhjes së gjuhëve të huaja, Jaray mendonte që do të zgjidhej italishtja dhe gjermanishtja, në fakt u zgjodh anglishtja dhe frëngjishtja. Dervish beu përfundoi duke i shpjeguar: *“është e qartë pse zgjodhëm frëngjishten duke e lidhur ndikimin e gjuhëve latine me shqipen, ndërsa për anglishten, ngurruam disi, por na u duk e arsyeshme që për marrëdhëniet tregtare duhet të parapëlqenim këtë gjuhë.”*²⁸⁵ Në fakt duket që aksioma e Dervishit për gjuhën Angleze në fushën tregëtare është edhe sot në fuqi. Kjo tregon qartë vizionin e tij prej njeriu jo vetëm me intelekt, por edhe nuhatës shumë të mirë të konjunkturave politike të kohës.

Padyshim qëndrimi gjatë nën perandorinë Osmane bënte që shumë intelektualë të kërkonin zgjidhjen e problemeve, por pa u shkëputur nga Turqia. Ndoshta kjo është arsyeja pse Jaray në librin e tij do të shprehej: *“Një pjesë mendonte që pavarësia do të ishte e dëmshme për Shqipërinë, madje arrihej deri në mendimin ekstrem që pavarësia mund të sillte vdekjen e Shqipërisë”*.²⁸⁶ Qëndrime të tilla janë të pranueshme, nëse mbajmë parasysh kontekstik historik dhe social në të cilin prej pesëqind vjetësh ndodhej Shqipëria. Si rrjedhojë e pushtimit dhe sundimit të gjatë Osman shqiptarët hynë të ndarë në historinë moderne, të ndarë në tre besime të ndryshme fetare. Politika teokratike e Perandorisë Osmane, që vinte shenjën e barazimit midis fesë e kombësisë mund të sillte pasoja të rrezikshme siç edhe u vërtetua nga historia në vitin 1913-të. Porta e Lartë, ndarjen e shqiptarëve në tre besime fetare e shfrytëzoi për t'i përçarë shqiptarët në tre kombësi të ndryshme. Në fakt ndërgjegjia fetare nuk e errësoi dhe nuk e mbuloi asnjëherë ndërgjegjien e kombësisë shqiptare. Ky fakt

²⁸³ Po aty, f. 144

²⁸⁴ Gabriel Louis Jaray, *"L'albanie inconnue"*, Dituria: 2006, f.142.

²⁸⁵ Po aty, f.145.

²⁸⁶ Po aty, f.147.

evidentohet edhe nga Jaray²⁸⁷ në kujtimet e tij për Kongresin. Ai do të shprehet: *“Edhe pse bejlerët po mundohen ta bëjnë fenë myslimane një lloj feje shtetërore, ata duan të sigurojnë një liri të plotë dhe të vërtetë për shqiptarët ortodoksë e katolikë. ... Njëri nga bejlerët më tha me një zhargon gjysmë frëngjisht dhe gjysmë turqisht: “Ai katolik, ai otodoks, unë mysliman, por të gjithë shqiptarë.”* Yaray mendon: *“...bejlerët shqiptarë përpiqen të bashkërendojnë përgjërimit të tyre për fenë myslimane me një tolerancë të sinqertë ndaj besimit katolik dhe atij ortodoks.”*²⁸⁸ Sipas tij bejlerët shqiptarë donin ta bënin fenë myslimane fe shtetërore, por nga ana tjetër dëshironin t’i garantonin liri të plotë për shqiptarët katolikë dhe ortodoksë.²⁸⁹ Yaray në fakt evidenton një vlerë të veçantë të shqiptarëve, atë të mirëkuptimit fetar aq shumë i dëshiruar sidomos në këto momente të vështira që kalonte kombi shqiptar. Për momentin diviza e shqiptarëve duhet të ishte atdheu po të kemi parasysh edhe qëndrimin negativ që mbanin shtetet fqinje si Greqia dhe Serbia, por edhe indiferenca e Fuqive të Mëdha të kohës si Italia dhe Austro-Hungaria. Ky qëndrim i tyre tregon fare qartë që çështja që, i shqetësonte më së shumti këta bejlerë të lexuar ishte ajo e shqiptarizmit. Dhe më shumë se kurrë atdheu dhe gjuha shqipe dilnin në plan të parë. Sipas Jaray një nga çështjet që është diskutuar ishte ajo e gazetave shqip. Sipas tij dihej fare qartë që deri në viti 1908 gazetat botoheshin jashtë vendit dhe nuk lejoheshin të futeshin në Shqipëri. Klubet shqiptare kishin kërkuar që të nxirrnin në Manastir një gazetë të madhe me emrin “Bashkimi i Kombit”, por sipas autorit kjo gjë nuk u realizua nga fillimi i Luftërave Ballkanike.

Po sipas Jaray, në kongres ka patur diskutime të karakterit politik. Sipas tij momenti në të cilin kalonte Shqipëria nuk e lejonte rrahjen e tyre botërisht. Dihet që debate të shumta ngjallte ideja toskë apo gegë, myslimanë apo ortodoksë, se cilët duhet të ishin ata që duhet të udhëhiqnin shqiptarët. Është diskutuar mbi figurën e njohur të kohës Ismail Qemalin, i cili është vlerësuar si një burrë me talent dhe me ndikim, por ky ndikim i tij ishte më i madh tek toskët dhe tek myslimanët. Për disa nga delegatët ky njeri shihej me skepticizëm, sepse ishte përpjekur të nxiste fanatizmin fetar.²⁹⁰ Sipas tij, shqiptarët e arsimuar e kuptonin prapambetjen e popullit të tyre dhe për këtë arsye kërkonin ringjalljen, përtëritjen ekonomike dhe intelektuale të popullit. Ai bënte një analizë të mendimeve, sidomos të bejlerëve me ndikim pro turk të cilët i rendisin shumë arsye përse nuk duhej që shqiptarët të shkëputeshin nga Turqia. *“Autonomi do të thotë vertet liri, por ajo do të thotë që ne do të bëjmë çdo gjë vetë.*

²⁸⁷Gabriel Louis Yaray, *"L'albanie inconnue"*, Tiranë: Dituria 2006, fq.142,143,144

²⁸⁸Po aty, f.149.

²⁸⁹Po aty, f.149.

²⁹⁰ Gabriel Louis Yaray, *"L'albanie inconnue"*, Tiranë: Dituria 2006, f.147.

*Mirëpo nuk kemi fonde monetare, nuk kemi organizim...ne jemi të varfër në çdo gjë, ne nuk kemi asnjë rrugë, asnjë kilometër linjash telefonike, asnjë shkollë tonën shqipe, asnjë port. Nuk kemi asgjë, hiç !*²⁹¹. Është e qartë pas 500 vjet nën sundimin e Portës së lartë pjesa më e madhe e shqipatrëvë e shikonin me skepticizëm shpëputjen nga ajo. Në logjikën e tij mungesa totale e infrastrukturës dhe varfëria në të cilën ndodhej Shqipëria dhe shto kësaj edhe mungesë e institucioneve të dijes, që mund ta çonin shoqërinë përpara bënte që ai të mos shikonte zgjidhje pohimi të ishte “hiç”.

Për një tjetër studiues Joseph Swire: “Kongresi i Elbasanit ishte thjesht shqiptar, qëllimi ishte të përpunohej një sistem arsimor i përcaktuar.”²⁹² Sipas tij një prej rrjedhimeve të menjëhershme të kongresit të Elbasanit ishte hapja në këtë qytet e shkollës Normale, për te plotësuar kërkesat për mësues shqiptarë të përgatitur. Sipas tij të gjitha klubet nacionaliste shqiptare, duke përfshirë edhe ato në Karaferia, Katerini dhe Drama, dërguan përfaqësuesit në Kongres. Dihet fare mirë që klubet u bënë zëdhënës në mbrojtje të çështjes kombëtare. Në pak muaj shqiptarët arritën të shmangnin legjislacionin e miratuar nga qeveria turke, në gusht 1909, që ishte kundër formimit të klubeve mbi baza racore apo politike, duke shpallur që klubet ishin shoqërore dhe jo politike.

Sipas J. Swire, turqit u përpoqën të zëvendësonin gërmat latine me gërmat arabe në gjuhën shqipe. Justifikimi ishte që të mos lejohej devijimi i myslimanëve të mirë nga besimi i tyre, sepse shkronjat arabe ishin të shenjta. Por, për Rilindasit dhe patriotët shqiptarë “Feja e Shqiptarit është Shqiptaria”. Ky ishte boshti ideologjik që përshkonte një literaturë të tërë politike e artistike të periudhës së Rilindjes, ishte pa dyshim afetar, por jo antifetare, një parim politik që synonte bashkimin e shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare. Ky koncept i shqiptarisë se “Feja e Shqiptarit është Shqiptaria” pushtoi gjatë epokës së Rilindjes mendjet dhe zemrat e shqiptarëve, duke u bërë një forcë ideore, që bashkoi shpirtërisht e mendërisht shqiptarët në luftën për çlirimin kombëtar. Mbi të tilla baza shqiptarizmi justifikohet edhe zgjedhja e Luigj Gurakuqit si drejtor i Normales, “*Edhe pse ai është katolik dhe pjesa tjetër e personelit ishin pa dyshim myslimanë.*”²⁹³ Në këtë mënyrë të gjitha zhvillimet e Kongresit të Elbasanit ishin një shuplakë e fuqishme për propagandën turke sipas së cilës “*Edhe shtypja e fjalëve Shqipëri dhe shqiptarë ishte e ndaluar. Nuk kishte më*

²⁹¹ Po aty, f.147.

²⁹² Joseph Swire, *The rise of a Kingdom*, Tiranë: Dituria2005, f.93-94

²⁹³ Joseph Swire, *The rise of a Kingdom*, Tiranë: Dituria 2005, f. 93-94

shqiptarë!"²⁹⁴. Myslimanë e të krishterë të të gjitha klasave u bashkuan në organizimin e mitingjeve të protestës, në Elbasan shtatë mijë shqiptarë u mbledhën dhe deklaruan gadishmërinë për të mbrojtur me jetën e vet, gjuhën e tyre.²⁹⁵ Po në këtë frymë të patriotizmit tridhjetë e tetë nxënës të shkollës së mesme shtetërore të qytetit lanë shkollën turke dhe ndoqën atë të ngritur nga klubi shqiptar. E gjithë puna dhe përpjekjet e bëra nga lëvizja e Rilindjes Kombëtare bënë të mundur që më në fund udhëheqësit shqiptarë të ishin të ndërgjegjshëm që nëse vendi i tyre nuk do të arrinte menjëherë autonominë dhe lirinë për të vazhduar arsimin kombëtar ai nuk do të ishte kurrë në gjendje të përgatitej për pavarësinë. Zbatimi i vendimeve të Kongresit do të haste vështirësi, sepse xhonturqit do të hiqnin dorë nga "dorashka e kadifenjtë" në marrëdhëniet me nacionalizmin shqiptar. Sipas Swire shqiptarët ishin të ndërgjegjshëm që nëse vendi nuk do të siguronte menjëherë autonominë dhe lirinë për zhvillimin e arsimit, vështirë se do të siguronte pavarësinë. Swire e shikonte evident faktin që Shqipëria të copëtohej mes vendeve fqinje.²⁹⁶

Francezi Edwin Jacques e konsideronte sfidë arsimore nevojën për përgatitjen e mësuesve, sepse rinia shqiptare deri më atëherë kishte qenë objekt i propagandës së huaj në shkollat e hapura nga qeveria turke ose kisha ortodokse greke, që të dyja këto fanatike ndaj gjuhës shqipe dhe të çdo ndjenjeje patriotike. Ajo që vlen të theksohet është që vlerson faktin që gjatë punës për krijimin e sistemit të tyre arsimor patriotët shqiptarë u ndeshën me tri probleme të mëdha:²⁹⁷

1. Pengesat nga autoritet greke dhe turke,
2. Mungesën e parave,
3. Mungesën e mësuesve të kualifikuar.

Sipas tij në kongres morën pjesë njëzet e tetë shoqëri e klube shqiptare. Autori nënvizon se ishte klubi i Selanikut ai që kishte kërkuar mbajtjen e Kongresit. Autori²⁹⁸ liston vendimet që siç dihet lidhen me hapjen dhe mirëfunksionimin e një Shkolle Normale. Për këtë klubit të Manastirit iu caktua si detyrë të jetë qendra për inkurajimin e një Federate të Klubeve Shqiptare në Shqipëri e gjetkë. Synimi i krijimit të federatës do të ishte zhvillimi i arsimit dhe

²⁹⁴Po aty f. 94

²⁹⁵Joseph Swire, *The rise of a Kingdom*, Tiranë: Dituria 2005, f.93-94

²⁹⁶Po aty f. 94

²⁹⁷Edwin Jaques, *"The Albanians: An ethnic history from pre-historic times to present"*, Tiranë: Kartë e Pendë 1996, f.350

²⁹⁸Po aty f. 350

mospërzierja e saj me politikën. Sipas tij, klubi “Përparimi” u caktua si qendra financiare që do të administronte ndihmat dhe do të mbikqyrte shtimin e shkollave të ditës dhe të natës. Thirrja e drejtuesve të “Përparimit” ishte: “...*për mbajtjen e shkollës Normale duhen: para, para e më shumë para.*” Hapja e shkollës padyshim shkaktoi një gëzim të paparë në rradhët e popullsisë së thjeshtë, por jo vetëm, ajo preku thellë nacionalistët shqiptarë. Lef Nosi shkruante për sakrificat e profesorëve që hoqën dorë nga “*Çlodhja e pushimi i ditës dhe nga qetësia e gjumit të natës.*”²⁹⁹ Me apo pa mjetet e përshtatshme shkolla Normale e Elbasanit vazhdoi të përgatisë pionierët e arsimit për Shqipërinë që po rilindte.

Autorja tjetër është Nathalie Clayre. Sipas saj, kongresi i Elbasanit është një kongres i veprimtarëve të shqiptarizmit. Kongresi është mbajtur në kushtet e kundër revolucionit turk. Mbledhja është organizuar nga klubi i Selanikut. Mobilizimi për organizimin e tij ishte sipas saj larg të qenit po aq i rëndësishëm sa kongresi i Manastirit. Kongresi mbledhi vetëm delegatë të rajoneve jugore dhe të Shqipërisë së mesme. Nuk mori pjesë asnjë delegat nga Shkodra, nga vilajeti i Kosovës dhe nga Vlora. Një të tretën e delegatëve në Asamble e përbënin delegatët e krishterë midis të cilëve tre misionarë protestantë që sipas konsullit italian të Manastirit, luajtën një rol të madh në mbështetje të Austro-Hungarisë. Vendimi për krijimin e shkollës Normale të Elbasanit krijoi një pol kombëtar. Sipas Nathalie, mbledhja e Elbasanit pati dhe anën e saj të fshehtë. Meqenëse duke ndjekur kulturën e klandestinitetit, shumë në modë në atë kohë, u vendos të ngriheshin komitete të fshehta dhe të bëhej kordinimi mes tyre.³⁰⁰

²⁹⁹Edwin Jaques, *"The Albanians: An ethnic history from pre-historic times to present"*, Tiranë: Kartë e Pendë 1996, f.350

³⁰⁰Clayer N., *"Në fillimet e nacionalizmit shqiptar"*, Tiranë, Marin Barleti 2012, f.559

KAPITULLI . IV

VEPRIMTARIA E DERVISH BIÇAKUT NË VITET 1910 – 1940

4.1 Veprimtaria patriotike e Dervish Biçakut 1910-1911

Dervishi në vitet 1910-1911 do të ishte pjesëmarrës direkt dhe indirekt në kryengritjet antiosmane. Që në shkurt të 1910 situata ishte rënduar në Elbasan. Turqit gjithmonë e më shumë kërkonin përdorimin e gërmave arabe në alfabetin shqip. Më 4 shkurt populli i Elbasanit organizoi një miting i cili u mbajt sheshin e Namazgjasë. *“Të paktën prej 7000 njerëzish, parësi, ylema, e qytetarë sikundër ene prej gjithë katundarevet rreth e qark qytetit.”* Në këtë miting fryma që mbizoteri ishte ajo e dhënies së besa-besës dhe se elbasanasit nuk do të *“kursehen asfare për për mbrojtjen e shkronjave shqipe dhe gjuhës.”*³⁰¹

Përpjekjet e shqiptarëve dhe arritjet gjatë vitit 1910 nuk u mirëpritën nga xhonturqit. Në gusht të vitit 1910, gjeneralit Shefqet Turgut pasha iu ngarkua detyra të shtypse kryengritjet që kishin filluar në Kosovë, Shqipërinë veriore dhe të mesme. Haki pasha, kryeministri i Turqisë shprehej për shqiptarët se: *“Ata kanë nisë të venë themelet e kombësisë me anë të shkrimit e këndimit shqip dhe një ditë mund të shtijnë në dorë gjithë Turqinë; kanë një gjuhë të lehtë e të plotë që shpejt mund t'i përparojë; historia e tyre, po doli në shesh, është prishja e Turqisë.”* Më pas ai shtonte: *‘Me të shpallurit e lirisë’*³⁰²; shqiptarët deshën mësim, hapën shkollat, të medha e të vogla; çelën klube; hapën shtypshkronja; mbajtën kongrese e bënë aq punë të mëdha që s'na i priste mendja, prandaj ky hov u duhet prerë, duhet t'i ndajmë e t'i përçajmë, t'i shtypim sa të mos kenë fuqi'.³⁰³ Në shtator 1910, me justifikimin se aktiviteti i shkollës Normale ishte i rrezikshëm për fenë dhe kushtetutën, xhonturqit e mbyllin atë.³⁰⁴ Kështu edhe Elbasani, do të përfshihej nga ekspedita e Turgut Pashës. Xhonturqit do të ishin të pamëshirshëm për të shtypur lëvizjen e armatosur të shqiptarve. Terrorri i tyre përfshiu qytete si Shkodra, Tirana dhe Elbasani. Në këto treva u arrestuan e u burgosën qindra atdhetarë. Shumë prej tyre u arratisën jashtë Shqipërisë³⁰⁵. Për t'i shpëtuar përndjekjeve, jo vetëm Dervishi, por edhe Luigj Gurakuqi dhe Aqif Pasha, u larguan në drejtim të Italisë, duke u vendosur në Romë. Gjatë qëndrimit të tyre në Romë,

³⁰¹ *Mendimi Politik e Shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: 1976, Vëllimi II , f.380.

³⁰² Bëhet fjalë për shpalljen e Kushtetutës më 23 korrik 1908.

³⁰³ Tako P, *Luigj Gurakuqi, Jeta dhe Vepra*, Tiranë, "8 nëntori"1980, f.137.

³⁰⁴ Akademia e Shkencave , *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II , Tiranë: Toena 2002, f.435.

³⁰⁵ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2002, f.435.

patriotët shqiptarë gjatë gjithë kohës nuk i ndërprejnë përpjekjet për të rihapur Normalen, qoftë edhe jashtë vendit, pasi ajo u mbyll prej qeverisë turke, më shtator 1910.

Në një raport të ambasadës austro-hungareze në Romë, që mban datën 4 tetor 1910, ndër emrat e përmendurrezultojnë Dervish beu dhe Luigj Gurakuqi. Përmes këtij dokumenti, përmendej çështja e shkollës Normale duke u shprehur se: “*ky institut, hapja e të cilit i detyrohesh Dervish beut dhe sakrificave të shqiptarëve brënda dhe jashtë Shqipërisë, ishte krenaria e tyre*”³⁰⁶. Përmes këtij dokumenti, evidentohet roli dhe kontributi i padiskutueshëm i Dervishit në hapjen e Normales, që vlerësohet edhe nga diplomatët austro – hungarezë. Mbyllja e Normales, sipas raportit të diplomatit austro-hungarez, konsiderohet një goditje e madhe për çështjen kombëtare shqiptare. Normalja konsiderohet, si një inspirim për rininë shqiptare, duke u përpjekur që nëpërmjet saj, t’i jepej brezit të ri një “*edukatë unike, kombëtare, që ishte destinuar për një mision të madh*.”³⁰⁷ Mundësia ishte të rihapej në Bosnjë ose në Egjipt. Për më tepër sikurse citohet në letër, për mbulimin e shpenzimeve të kësaj shkolle do të kontribuonin të gjithë shqiptarët brenda dhe jashtë vendit.

Përsa i përket hapjes së Normales jashtë vendit, Dervish Biçakçiu shprehte mendimin duke shfaqur madje siguri të plotë, se për shkak të pengesave që mund të hasnin në qytete të tjera, shkolla mund të hapej vetëm në Egjipt. Pikërisht për këtë arsye, ata kërkonin mbështetjen e Austro-Hungarisë sepse e kuptonin që, vështirësitë qoftë edhe burokratike do të ishin të shumta. Propozimi i Dervishit për të ngritur shkollën në Egjipt, mendojmë se buronte tek besimi që ai kishte në komunitetin e fuqishëm të shqiptarëve të Misirit. Për më tepër, edhe konsulli austro - hungarez, ishte besimplotë në mendimin e Dervishit. Ai (konsulli) i vlerësonte Dervishin dhe Luigj Gurakuqin si dy figura të pakompromentuar, që e kishin marrë me pasion hapjen e Normales dhe nuk shihte asnjë përfitim personal për të dy (Dervishin bashkë me Luigjin) në këtë angazhim, duke u shprehur se: “*...përkundrazi janë momentet reale politike bashkë me një optimizëm të madh që i udhëheqin në ndjekjen e planeve të tyre [...] duke marrë parasysh personalitetin e Dervish beut dhe shoqëruesit të tij, të cilët të dy sigurisht kanë bërë shumë për çëshjen shqiptare dhe gjithmonë kanë qenë partizanë të sinqertë të monarkisë*”³⁰⁸. Sipas raportit të diplomatit austro - hungarez, Luigj Gurakuqi kishte hartuar për të gjitha këto kërkesa një memorandum, për të cilin priste përgjigje nga Porta e Lartë. Duke ju referuar fjalëve të Dervishit ai shprehet se: “*Dervish beu,*

³⁰⁶ H. Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë, albPaper 2004, f. 413

³⁰⁷ Po aty, f. 413

³⁰⁸ H. Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë: AlbPaper 2004, f. 414.

*thotë se përgjigjen do ta presë këtu në Romë*³⁰⁹. Nga aty sa kuptohet nga memorandum i drejtuar Portës së Lartë, nga patriotët shqiptarë kërkohet edhe mbështetja e Austro-Hungarisë, për të siguruar rihapjen e normales në një vend tjetër, në rast se Porta e Lartë do të refuzonte hapjen e saj. Patriotët shqiptarë shikonin jetike rihapjen e saj dhe e kuptonin fare mirë, që kjo mund të realizohej vetëm me mbështetjen dhe ndërhyrjen e një Fuqie të Madhe. Në këtë veprimtari të tyre në Romë, ishin bërë bashkë dy shqiptarë me përkatësi fetare të ndryshme Luigji katolik dhe Dervishi muhamedan, që nuk për kohën mund të dukej e çuditshme, por për patriotët shqiptarë tashmë, konsiderohej si një bashkëmarrëdhënie e natyrshme. Duket se terrori i xhonturqve kishte bërë bashkë shqiptarët pa dallim feje dhe se kishte rritur në një shkallë të lartë ndërgjegjen kombëtare. Ajo që dilte në plan të parë ishte Çështja kombëtare.

Ndërkaq, në 10 tetor 1910 Komiteti i Studentëve Shqiptarë shpalli një letër të hapur, ku protestohej pranë botës së qytetëruar për dhunën e ushtruar nga ana e Xhonturqve: "*që po asgjësonin të gjitha tentativat e hapura të ringjalljes kulturore të popullit shqiptar*"³¹⁰. Studentët shqiptarë, akuzonin xhonturqit se ata po silleshin në mënyrë tiranike. Përmes këtij apeli, ata kërkonin t'i demaskonin ata në sytë e botës së civilizuar, duke treguar se xhonturqit nuk ishin element i rregullit dhe i civilizimit. Komiteti i studentëve, demaskonte kështu politikën e tyre të terrorit ndaj patriotëve gazetarë shqiptarë, ku përmendeshin Feim bej Zavalani drejtor i gazetës "Bashkimi i kombit", dënuar me 6 muaj burg, Mihal Grameno drejtor i gazetës "Lidhja Ortodokse", dënuar disa herë rrjesht me burg, Lef Nosi drejtor i revistës "Tommorri" dënuar me internim sepse kishte botuar një artikull në gazetën angleze "Times" mbi çështjen shqiptare. Gjithashtu në këtë, apel ata ishin prononcuar për dënimin nga gjykata ushtarake të dy vëllezërve të Dervis Beut; Hasan bej Biçakçiut dhe Qamil bej Biçakçiut. Hasani beu ishte kryetari i komitetit administrativ të shkollës Normale, ndërsa, Qamil beu u dënua me 10 vjet internim *me arsyen e vetme se ishte vëllai i vogël i Dervish Bej Biçakçiut*³¹¹. Në fund të këtij apeli, studentët kishin përmendur edhe dënimin e Hoxha Hafëz Ibrahimit me 10 vjet internim jashtë vendit, me arsyen se kishte qenë profesor në shkollën Normale. Në letër shprehej qartë që xhonturqit kishin harruar premtimet e bëra duke terrorizuar popullatën. Letra ishte një demaskim i hapur për tiraninë e regjimit xhonturk. Kjo tregon edhe njëherë që Dervishi dhe e gjithë familja e tij, ishte vënë në funksion të lëvizjes kombëtare dhe të shkollës shqipe duke u përballur edhe me pasojat e internimet. Ata nuk kishin ndërmend të bënin asnjë kompromis deri në sigurimin e lirive dhe të drejtave për

³⁰⁹ Po aty .f.414.

³¹⁰ Skënder Blakaj, Ismail Ismaili, *Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare shqiptare*, Prishtinë: Arbi 2014, f. 611.

³¹¹ Po aty, f. 611.

popullin e tyre. Ata refuzuan që në shkollën shqiptare të përdoreshin gërmat arabe. Duhet theksuar se studentët ishin të vendosur të mos lejonin mbylljen e gazetave, mbylljen e shtypshkronjave, mbylljen e shkollave fillore dhe të Normales që mbaheshin në këmbë nga financimet e vetë shqiptarëve, ishin kundër heqjes së gjuhës shqipe nga shkollat qeveritare mbi të gjitha ishin kundër dhunës dhe kundër mbylljes së klubeve kulturore të themeluara legalisht³¹².

Qëndrimi i Dervishit në Itali ishte disa mujor, kjo e detyruar edhe nga gjendja jo e mirë shëndetësore e Luigj Gurakuqit Kështu në fondin personal të Dervishit, ³¹³ndodhet një letër që mban datën 15.01.1911, ku ai shpjegonte që ishte duke u nisur për në veri, duke ndjerë një shqetësim të thellë për situatën. Ndërkaq, në një letër që Gurakuqi i drejtonte Asdrenit qënë fund të dhjetorit të vitit 1910, ai shprehej se për momentin nuk mendonte të kthehej në Shqipëri, pasi shkollën Normale, të cilës ai i kishte falur të gjitha fuqitë, e kishin mbyllur. Duke vijuar më tej ai shkruante se: *“Po përpqemi të hapim jashtë.Në këtë kohë, shkolla Normale ka ma nevojë se kurrë për ndihma...pse hapja e saj asht jeta e gjallesa e kombit t’ënë”*³¹⁴. Faktin që Dervishi dhe Luigji ishin nisur drejt Bukureshtit e konfirmon jo vetëm letra e Dervishit, por edhe ajo e Gurakuqit drejtuar Asdrenit. *“Unë nuk kam pasur qejfin të nisesha këto ditë, sepse u sëmura keq e tani më duhet të rrijë domosdo dhe nja dy javë që të shërohem mirë”*³¹⁵. Pas disa ditësh ata mbërrijnë në Bukuresht ku dhe *“shqiptarët e Bukureshtit i bënë një pritje të mirë.”*³¹⁶ Luigj Gurakuqi e vlerësonte shumë figurën dhe përpjekjet e Dervishit edhe në një letër që ai i dërgonte patriotit Jani Vruho ku shkruante se: *“Dervish Beu i cili po deftohet i palodhur ndër punërat kombëtare, po na jep ndihmë të madhe.”* Nga udhëtimi që bënë në Bukuresht, të dy ata morën mbështetje nga patriotët shqiptarë atje, të cilët premtuan t’i përkrahnin moralisht dhe materialisht për kryengritjen që pritej të shpërthente. Nga këtu, udhëtimi i Dervishit dhe Gurakuqit vazhdoi drejt Stambollit. Në Stamboll ata u takuan me Ismail Qemalin ku raportuan mbi rezultatet e vizitës në Bukuresht. Në Stamboll qëndrimi ka qënë rreth dy muaj ku ata bënë përpjekje maksimale për të bindur autoritetet qëndrore për të lejuar hapjen e shkollës Normale.³¹⁷

³¹²Po aty,f. 613

³¹³Po aty, fl. 1.

³¹⁴Po aty, fl. 1 .

³¹⁵Piro Tako, "Luigj Gurakuqi.Jeta dhe Vepra", Tiranë: "8 nëntori" 1980, f.141

³¹⁶Po aty, f.141. Një sqarim i dhënë nga një tjetër patriot, Jani Vruho, i cili u takua me Luigjin e Dervishin në Bukuresht.

³¹⁷Piro Tako, "Luigj Gurakuqi.Jeta dhe Vepra", Tiranë: "8 nëntori" 1980, f.142.

Pas shtypjes së lëvizjes së armatosur të vitit 1910, veprimtaria e patriotëve shqiptarë në kushtet e terrorit që mbizotëronte në territoret shqiptare, ishte zhvendosur në jug të Italisë në Napoli e Bari. Në Itali në 17 janar të vitit 1911 ishte krijuar një komitet i quajtur "Pro Albania". Ky komitet synonte mbledhjen e ndihmave për shpërthimin e një kryengritje të re në trevat shqiptare. Ky komitet ishte krijuar në Romë me nismën e patriotit Nikolla Ivanai dhe mbante lidhje të ngushta me shqiptarët e Barit dhe të Korfuzit. Po kështu në ndihmë të shqiptarëve ishte e dhe delegacioni i Federatës Kombëtare "Pro Italia Irridenta" e cila siç komunikon Gjenerali Ricotti Garibaldi, kishte marrë përsipër për të organizuar lëvizjen e shqiptarëve të Italisë. Synimi i tyre ishte të formonin një Këshill Shqiptar të Romës. Në këtë komitet si anëtar përmendeshin Domeniko Damis, Gjovani Kastriot Skëndërbeu, Guliemo Toci etj. Në mbledhje e organizuar nga ky komitet, ka marrë pjesë edhe Anselmo Lorekio në cilësinë e drejtorit të "Nacione Albanese". Vendimet që u morën ishin: 1. Krijimin e "Këshillin e Shqiptarëve të Italisë" me program politik i cili quhej "Shqipëria e shqiptarëve" 2. Kjo shoqatë do të luante rolin e organizatës që do të krijonte harmoni midis gjithë shoqatave dhe të krijoheshin lidhje me shqiptarët e "Mëmës atdhe"³¹⁸.

Në një raport tepër sekret të Legatës Mbretërore Bullgare në Romë, njoftohej gjithashtu për raprezaljet e bëra në Shqipëri, përmes fjalëve: "*Këtij terrori të pashembullt nuk i ka shpëtuar edhe shkolla Normale, e cila ishte e vetmja fidanishte për të nxjerrë mësues të shkollës Fillore*"³¹⁹. Ky informacion i është dhënë legatës bullgare nga një patriot i kësaj periudhe Nikoll Ivanaj, i cili ishte këshilluar që të largohej menjëherë nga territoret shqiptare, sepse do ta ndiqte fati i bejlerëve; Aqif Pasha, Dervish Biçakçiu, Refik bej Toptani si dhe Ismail Qemali të cilët ishin vendosur dhe kishin disa kohë që qëndronin në Napoli. Gjithashtu dëshmohet që në Napoli në këtë kohë ndodhej edhe Luigj Gurakuqi. Raporti po ashtu bën një përshkrim edhe të burgosjes së patriotit Lef Nosi.

Interesant është fakti se këta patriotë shqiptarë të mbledhur në Napoli, ndërmjet të cilëve një rol tepër të rëndësishëm kishte Dervish beu, po parashikonin mbajtjen e një Kongresi. Mendimi ishte që ky Kongres mund të mbahej edhe në Venecia. Ndërkohë që ishin përcaktuar edhe objektivat më kryesore që synonin të realizonin patriotët atje, përmes organizimit të tij sikurse ishin: Të hiqej dorë nga çdo pajtim me turqit, organizimi i kryengritjes së armatosur, kryengritja të jetë e pamëshirshme ndaj armikut, të rihapej

³¹⁸Piro Tako, "Luigj Gurakuqi. Jeta dhe Vepra", Tiranë: "8 nëntori" 1980, f. 616.

³¹⁹Po aty, f 415-416.

Normalja³²⁰.

Parë në këtë këndvështrim, nuk është e rastësishme që patriotët Elbasanas do të marrin pjesë dhe do të jenë faktor i rëndësishëm në kryengritjet e viteve 1911-1912. Në vitin 1911 në Elbasan ushtronin aktivitetin e tyre disa çeta të armatosura, kryesisht në zonat malore të trevës së Elbasanit, ku dallohej çeta e Gani Bungës. Sipas të dhënave në zonën e Shpatit ishin krijuar disa çeta të cilat në përbërje kishin dhjetra luftëtarë. Dalloheshin kështu figura të tilla si Jonuz Topuzi, Asllan Dervishin etj. Në zonën e Shpatit, ishte krijuar gjithashtu çetë e udhëhequr nga Ymer Dervishi: "Ajo ishte gati të merrte pjesë në çdo lëvizje kombëtare dhe luftoi me trimëri kundër turqve, sidomos në kryengritjen e vitit 1911"³²¹. Një çetë tjetër vepronte edhe në zonën e Martaneshit, që udhëhiqej nga patrioti Hysen Sulova³²². Në këtë periudhë në kushtet e terrorit Xhonturk u krijua një komitet i fshehtë në Shtërmen³²³ që u quajt "Komiteti fshehtë". Vlen të përmendet se në këtë komitet kanë kontribuar Simon Shuteriqi, Hysen Ceka, Irfan Ohri.

Ndërkaq, një rol të rëndësishëm në organizimin e kryengritjeve në të gjithë sanxhakun e Elbasanit do luante klubi "Bashkimi i ri", pjesë e të cilit ishte edhe Dervish Biçakçiu, ky klub mori përsipër shpërndarjen e armëve. Qëllimi i këtij komiteti ishte gjithashtu të organizonte dhe bashkërendonte veprimtarinë me komitetet e tjera sidomos ato të Vilajetit të Manastirit. Lidhje më kryesore ishin sidomos me komitetet e krijuara në zonën e Dibrës ku thuhej se: "*Klubi shqiptar i Elbasanit shpërndau armë në këtë krahinë*"³²⁴.

Ndërkohë pakënaqësia ndaj ekspeditës ndëshkuese të Turgut Pashës, u shpreh përmes lëvizjeve të armatosura në Dibër, ku në janar 1911 në vendin e quajtur Gryka e Vogël banorët e 13 fshatrave shqiptarë dëbuan nënpunësit turq të cilët kërkonin vjeljen e taksave³²⁵.

Në mars të 1911, Edit Durham shprehej se kishte filluar kryengritja në Malësinë e Madhe, që sipas saj ishte parakohshme dhe për këtë fakt edhe në këtë etapë të luftës ajo dështoi duke u shprehur: "*Të gjitha këto i mësova prej letrave që më prisnin në Stamboll. Atëherë takova Ismail Qemalin dhe Dervish beun e Elbasanit*".³²⁶ Që të dy kishin shumë shpresa vijonte ajo, se kryengritja, do të bënte që Shqipëria të trajtohej më mirë. Kështu, më

³²⁰Po aty, f. 416.

³²¹Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, *Aqif Pasha (1860-1926)*, Tiranë, Marin Barleti: 2012, f. 69.

³²²Majlinda Peza, *Desertacion për mbrojtjen e grades Doktor i Shkencave*, "Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914", fq. 138.

³²³Elbasani, *Enciklopedi*, Elbasan: Sejko 2002, f. 101.

³²⁴Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë: Marin Barleti, 2012, f.

³²⁵Peter Bartl, *Myslimanët Shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare 1872-1912*, Dituria: 2006, f. 213.
Edhit Durham, *Lufta për Shkodrën*, Tiranë, Argeta LMG, f. 28.

24 mars 1911 fillon kryengritja nga Podgorica, duke sulmuar postat kufitare në Rapsh dhe Trabonjë. Valiu i Shkodrës për t'iu kundërpërgjigjur bëri për vete myslimanët fanatikë, me qënë se kryengritësit në më të shumtën ishin katolikë, duke ndjekur kështu politikën e përçarjes.³²⁷ Për t'i ardhur në ndihmë valiut të Shkodrës, 8000 trupa erdhën nën udhëheqjen e Turgut Pashës. Në mbrojtje të kryengritësve doli mbreti Nikolla i Malit të Zi. Ndërkohë, kundër doli Rusia që ishte hapur kundër një konflikti midis Malit të Zi dhe Portës së Lartë. Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës, do të gjente përkrahjen e shqiptarëve në Mat, Dibër, Mirditë, etj. Në Mirditë, malësorët kishin shpallur pavarësinë e Shqipërisë dhe kishin krijuar një qeveri provizore me në krye Terenc Toçin.³²⁸ Megjithëse kjo qeveri jetoi vetëm disa ditë, i tregoi Portës së Lartë, por edhe shteteve fqinjë, që shqiptarët ishin një faktor shumë i rëndësishëm në Perandorinë Osmane dhe se çështja kombëtare ishte një fakt që duhej të merrej parasysh në axhendat e Fuqive të Mëdha. Por konsulli Britanik, mendonte që kjo situatë vetëm sa solli konfuzion tek shqiptarët³²⁹.

Në maj 1911 në Mal të Zi nga Italia kishte mbërritur Ismail Qemali dhe Luigi Gurakuqi. Një raport nga Trieste njoftonte se “Shqiptarët kanë lidhur besën “ja liri, ja vdekje” dhe po marrin ndihmën nga Italia. Interesant është fakti që diplomacia angleze njofton gjithashtu se 20.000 armë ishin mbledhur nga klubi ballkanik anglez³³⁰. Kjo gjë vërtetohet nga përfaqësuesi gjerman i cili konfirmonte se armët kishin kalur nëpërmjet Hamburgut dhe se ishin financuar nga shqiptarët e Londrës. Për të ndryshuar qëndrim mbi çështjen shqiptare tek Porta e Lartë ka ndikuar edhe qëndrimi kategorik i Austro-Hungarisë: “politika e dhunshme turke ishte në rrugën e duhur për ti bërë shqiptarët miq me armiqtë e tyre shekullor, sllavët”³³¹

Ndërkohë, më 23 qershor me pjesëmarrjen e Ismail Qemalit, Luigi Gurakuqit, të cilët ndodheshin në Malin e Zi hartohet memorandum i Greçës, që përmbante 13 pika i njohur me emrin Libri i Kuq. Thelbi i tij ishte njohja e kombësise shqiptare, riorganizimi administrativ i vilajeteve, përdorimin e gjuhës shqipe, etj. Vendimet e memorandumit u morën pas viziës së Sulltan Mehmet Reshatit të V në Kosovë, vizitë kjo që ishte organizuar nga komiteti “Bashkim e Përparim”. Këto të dhëna, jepen nga konsulli austro-hungarez në Manastir, i cili

³²⁷ Peter Bartl, *Mytlimanët Shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare 1872-1912*, Dituria 2006, f. 214.

³²⁸ Po aty, f. 214. Terenc Toçi kishte lindur më 1880 në San Cosmo Albanese, avokat dhe publicist i njohur në Itali, përfaqësues i Rilindjes Kombëtare.

³²⁹ Frashër Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja shqiptare (1875-1913)*, Prishtinë, CIP, 2017, f. 244.

³³⁰ Ismije Beshiri, *Diplomacia shqiptare për çështjen shqiptare*, Tiranë: Duda 2020, f. 107.

³³¹ Po aty, f. 107.

raportonte për vizitën e Sulltanit në këtë qytet, ku ai u takua me personalitete shqiptare ndërmjet të cilëve edhe Aqif Pasha, Dervish Biçakçiu, Xhemal Toptani. Në këtë takim kërkesa kryesore drejtuar Sulltanit lidhej me nevojat e bashkombasve të tyre që “*edhe ata të lejohen të hapin shkolla shqipe*”. Sipas burimeve angleze, Sulltan Reshati i V gjatë vizitës që bëri në Prishtinë dhuroi rreth 30,000 sterlina për ndaljen e hakmarrjes në Kosovë, kurse në 16 qershor, ai shpalli dekretin e faljes për pjesëmarrësit e kryengritjes së vitit 1910³³².

Në një situatë të tillë, Sulltani u përpoq të qetësonte kryengritësit duke zëvendësuar Shefqet Turgut Pashën me Esat Pashë Toptanin. Perandoria Osmane deklaroi një amnisti të plotë për uljen e taksave, për shërbimin ushtarak që të kryhej në vilajetin e Shkodrës dhe të hynte në bisedime me Malin e Zi. Kryengritësit, në situatën e krijuar pranuan kushtet. Ndërkohë, kryengritja vazhdonte në Jug të Shqipërisë, si Vlorë, Janinë, Gjirokastrë.

Në Elbasan u krijua një organizatë e fshehtë me emrin “Besa-Besë”³³³ që planifikonte që në fillim të korrikut të niste një kryengritje në të gjithë Shqipërinë Qëndrore. Kështu shqiptarët patriotë si Ismail Qemali dhe Themistokli Gërmenji krijuan në Korfuz një degë të komitetit shqiptar për të zgjeruar kështu kryengritjet edhe në Jug. Themistokli Gërmenji do ta zhvillojë veprimtarinë e tij në Korçë, ku do të jetë evident bashkëpunimi me komitetin e fshehtë të Elbasanit. Kështu, ekziston një lidhje midis tij dhe patriotit nga Shpati, Kodhel Dedja. Parrulla e njohur midis dy komiteteve, ku si ndërlidhës shërbente Kodhel Dedja, ishte “vije spango në gishtia dhe ata do të njohin”.³³⁴ Komiteti i Elbasanit ka bashkëpunuar ngushtë edhe me komitetin e Manastirit. Një veprimtari i tillë, vërtetohet me aksionet e përbashkëta, ku një ndër to është në zonën Polis-Shpat, ku përmendet patrioti Sadik Zharri. Aksioni u drejtua ndaj postës që do të nisej nga Manastiri. Në histori ky aksion njihet me emrin “Aksioni i Gurave të Zeza”. Ky patriot deklaronte që aksioni është kryer për qëllime kombëtare, arsimore dhe kulturore. Këto aksione dëshmojnë që Elbasani ishte një qendër e rëndësishme e Lëvizjes Patriotike Në vazhdën e përpjekjeve për të rihapur Normalen patriotët Elbasanas ku shquhen papa Beniamin Deliana, Alush Saraçi, Emin Haxhiademi i drejtojnë Abdyl Ypit një letër ku i kërkonin të përpiqej për rihapjen e Normales duke u shprehur: “...e të shohim të rendin në të me gëzim djemtë nga të katër anët e Shqipënisë”³³⁵

Më 17 qershor Shefqet Turgut Pasha në vazhdën e asaj që kishte deklaruar sulltani shpalli amnisti. Nuk flitej për asnjë të drejtë për kombësisht shqiptare. Për të hyrë në

³³²Ismije Beshiri, *Diplomacia shqiptare për çështjen shqiptare*, Tiranë: Dudaj 2020, f. 248.

³³³Po aty, f. 218.

³³⁴Shyqyri Demiri, *Elbasani qëndër... , vepër e cituar*, f. 15.

³³⁵Gazeta “Drita”, Nr. 20, 11 korrik 1912.

bisedime me katolikët në veri Porta e Lartë, kërkonte mbështetjen e protektorese së kultit të Austro-Hungarisë dhe Arkipeshkvi i Shkodrës, Jak Serreqi. Propozimet e Portës së Lartë ishin larg programit që synonin të realizonin kryengritësit prandaj propozimet nuk u pranuan dhe kjo lëvizje e saj dështoi³³⁶. Kryengritjet shqiptare të vitit 1910-1911 edhe pse dështuan, kishin rëndësi. Ato e çuan në një fazë më të lartë luftën për krijimin e shtetit kombëtar. Këto kryengritje tërhoqën vëmendjen e diplomacisë së huaj austro-hungareze, italiane, ruse, franceze dhe angleze. Kryengritja dështoi sepse ajo nuk kishte një qendër të vetme politike dhe shqiptarët nuk u treguan të aftë të parashtronin kauzën e tyre pranë fuqive të mëdha në mënyrë bindëse. Kryengritja kryesisht u zhvillua në Shqipërinë e Veriut. Shumë nga Fuqitë e Mëdha, qëndruan indiferente ndaj çështjes shqiptare. Perandoria Osmane diti të pengojë një zgjerim të saj me politikën e përçarjes. Gjithsesi, kryengritja e 1911 shërbeu si taban i ngjarjeve që do të vinin në vitin 1912. Pajtimi me Xhonturqit shërbente për të fituar kohë për një organizim më të mirë drejt arritjes së qëllimit final, atë të shkëputjes nga Porta e Lartë.

4.2 Roli i Dervish Biçakut në kryengritja e vitit 1912 në trevën e Elbasanit

Viti 1912 shënon një ngjarje të rëndësishme për historinë tonë kombëtare që lidhet me shkëputjen nga Porta e Lartë. Në shtator 1911 Perandoria Osmane hyn në luftë me Italinë. Kështu një numër i konsiderueshëm forcash osmane do të ishin të angazhuar në luftë dhe kjo ngjarje në gjykimin e patritëve Shqiptarë, konsiderohet një rast i volitshëm për fillimin e një kryengritje të përgjithshme. Opozita turke, në nëntor të 1911 kishte krijuar një parti të re (“Hurriyet ve itilaf” (Liri dhe Bashkim), duke vënë në vështirësi regjimin xhonturk. Për të shpëtuar pushtetin, në dhjetor të 1911, qeveria shpërndu parlamentin dhe shpalli zgjedhje të reja. Qëllimi i këtyre zgjedhjeve ishte eliminimi i opozitës. Në mënyrë që të kishin sa më shumë përkrahës në parlament, ata u përpoqën të bëjnë për vete edhe shqiptarët. Ata bënë lëshime në çështjen e shkollave shqipe, por kërkonin përdorimin e gërmave arabe, duke shkaktuar sërish pakënaqësi. Në zonën e Kosovës dhe të Shkodrës të cilat kishin qenë qendra të kryengritjes së 1911, u shty afati i pagesës së taksave. Në janar 1912 patrioti Hasan Prishtina u përpoq të bindte ministrin e jashtëm të Perandorisë Osmane që qeveria duhet të deklaronte zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë³³⁷, duke mbajtur edhe një fjalim të guximshëm në parlamentin Turk duke evidentuar:

³³⁶ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Tiranë: Toena 2002, f. 450.

³³⁷ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Tiranë: Toena 2002, f. 461.

- Njohjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve
- Shkeljen e të drejtave të kushtetuese nga xhonturqit
- Terrorin e pashembullt të ushtruar ndaj popullsisë Shqiptare

Kështu një grup patriotësh ku spikasin Hasan Prishtina, Esat Toptani, Ismail Qemali, Syrja Vlora, Myfit Libohova etj, vendosën të mbajnë një mbledhje në Stamboll ku u diskutua mbi fillimin e një kryengritje të armatosur. Hasan Prishtina do të organizonte forcat në verilindje, Esat Pashë Toptani premtoi të merrej me organizimin e një kryengritje të armatosur në Shqipërinë e mesme e në Mirditë dhe Eqerem Vlora në Shqipërinë e Jugut. Suksesi i kryengritjes do të varej mbi të gjitha edhe nga krijimi i një qendre të vetme unike të udhëheqjes së saj.

Organizimi i kryengritjes së armatosur përkoi me periudhën e fushatës së re zgjedhore parlamentare në Perandorinë Osmane. Në Stamboll, ishte krijuar një Komision për të vizituar Shqipërinë, që kryesohej nga ministri i brendshëm osman Haxhi Adil Beu, dhe njihej me emrin “Komisioni i reformave”. Vizitën e tij Komisioni e filloi nga Prishtina. Duke parë situatën e tensionuar në këto zona njoftohej Portë e Lartë përmes fjalëve: *“Për të fituar simpatinë dhe për të ringjallur një kënaqësi të përgjithshme ndër shqiptarët e këtushëm unë e quaj të nevojshme t’u jepen 700 lira turke për ndryshimin e xhamive”*³³⁸. Ky komision në përbërjen e të cilit ishin edhe dy europianë; anglezi Graves dhe francezi Foulon, shpallte si detyrë të njihje nevojat e popullsisë në të katër vilajetet, zgjidhja e të cilave ishte destinuar të zbatohej vetëm në të ardhmen e largët³³⁹. Ndërkohë po sipas këtij raporti Esat Pash Toptani po bënte një propagandë të fortë kryengritëse dhe ata shpresonin tek mbështetja e bashkëatdhetarëve të tyre në Itali, me gjithëse kjo e fundit ishte e zënë në luftë.

Ky komision, sipas të dhënave ka vizituar të gjithë qytetet kryesore të Shqipërisë, ndërmjet të cilëve edhe Elbasanin. Në Elbasan, ai është takuar edhe me patriotin Dervish Hima, që vinte pas një ndalese në sarajet e Dervish Biçakçiut në Çermë. Sipas dëshmimeve pritja që ishte bërë Adil beut në Elbasan, ishte e ftohtë nga ana e popullsisë. Me gjithë se dëshmohej që Esati do të organizonte lëvizjen në Shqipërinë e mesme, rrugës për në Elbasan Haxhi Adil beu ishte shoqëruar nga forcat e Esat Pashë Toptanit. Ai bëri një vizitë edhe në shkollën fillore të qytetit me 160 nxënës ku sipas dëshmimeve të Dervish Himës nuk ngjante “veç se me një stallë” dhe më pas realizon njëvizitë në shkollën Normale, për të cilën nuk premtoi asnjë

³³⁸Muhamet Shatri, Ramiz Abdyl, *Dokumenta Ruse Për lëvizjen Kombëtare shqiptare më 1912*, Pristinë, KGT 2006, f 67.

³³⁹Po aty, f 69.

investim pasi sipas ministrit vendimi do të merrej nga Stambolli. Normalja ishte hapur në 19 mars 1912 drejtor i së cilës ishte Fazlî Frashëri. Faktikisht, qëllimi më kryesor i Komisionit të Reformave, ishte ndërhyrja në fushatën zgjedhore që pozhvillohej, duke favorizuar kandidatët për deputetë të krahut xhonturk. Është me interes të evidentojmë faktin se manipulime dhe presione të shumta u bënë gjatë kësaj fushate zgjedhore. Edhe në Elbasan, dëshmohet presioni që kryetari i Komisionit të reformave Adil Beu drejtuar Shefqet Bej Verlaci, për të tërhequr kandidaturën e tij në zgjedhjet parlamentare.

Në Elbasan, kandidatët për deputetë ishin të shumtë por binin në sy figura nga paria feudale dhe patriotike e Elbasanit sikurse ishin Dervish Biçakçiu, Shefqet Verlaci. Ndërkaq një kandidat i rëndësishëm ishte gjithashtu dhe patroti nga Struga Dervish Hima. Sipas të dhënave ata sigurisht që bënë pjesë në krahun e opozitës kundër xhonturke³⁴⁰. Sikurse dëshmohet, në këto zgjedhje Shefqet Verlaci arrin pas shumë përpjekjesh të zgjidhet deputet, kjo falë mbështetjes së parisë së Elbasanit por edhe intuitës dhe personalitetit të tij individualist, duke patur edhe përkrahjen e një prej figurave më të njohura Esat Pashë Toptanit. Faktikisht, Shefqet bej Verlaci ishte kandidat i partisë nacionale shqiptare dhe emri i tij, gjendej në listën e re të rekomanduar nga Dervish Hima. Sipas konstatimeve, Shefqet beu nuk kishte hequr dorë nga kandidatura për deputet, pavarësisht presionit të bërë nga Ministri i Brendshëm Haxhi Ali Beu. Por, qëndrimin kundërshtues të tij përballë një ministri të Perandorisë Osmane, nën/konsulli austriak më së shumti ia atribuonte karakterit oportunist të Shefqet Verlaci duke u shprehur se: *“Ai [Shefqet Beu] ndoshta do të bëhet një opozitar që do të lundrojë në ujërat e Esad Pashës”*³⁴¹. Ndërkaq, fillimisht si kandidat për deputet në parlamentin osman gjatë fushatës zgjedhore na del në Elbasan edhe emri i Dervish Beut, ndërsa si fitues në përfundim të zgjedhjeve na rezulton Shefqet Bej Verlaci. Referuar burimeve të kosultuara për këtë problem, theksojmë se, për të shmangur përçarjen dhe për të sigurur sa më shumë vota, u ra dakord që përfundimisht në zgjedhjet parlamentare e vitit 1912 Elbasani të përfaqësohej vetëm me një kandidat, që do të garonte përkrah Opozitës së krijuar kundër kandidatëve xhonturq. Mendojmë se, në këtë rast Dervish Beu, është tërhequr duke lënë mënjanë ambicien e tij personale dhe duke favorizuar Shefqet Verlacin, një veprim ky, që bëhej për hir të një interesi të përbashkët kombëtar. Ndërkaq, Xhonturqit arritën të

³⁴⁰ Muhamet Shatri, *Dokumente Franceze për Shqipërinë dhe Shqiptarët më 1912*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2012, f.50.

³⁴¹ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze 1912*, Vëllimi II, përgatitur nga Ferid Duka, Dritan Egro, Sokol Gjermani, Tiranë: Botimet Toena, 2012, f. 130. Raport i konsullit austro - hungarez Halla në Durrës.

pengojnë rizgjedhjen si deputetë për në parlament të dy prej figurave më të rëndësishme politike shqiptare të asaj kohe, Ismail Qemalit dhe Hasan Prishtinës.

Në kuadrin e kryengritjes së përgjithshme në Elbasan ishin krijuar një sërë çetash. Referuar burimeve bullgare, Mersim Dema në krye të një çete të përbërë nga 25 luftëtarë, që në mars të vitit 1912 kishte kaluar në trevën e Elbasanit, duke përshkuar gati të gjithë fshatrat e kazasë së Elbasanit. Si rezultat i veprimtarisë së tij, në fshatrat e Elbasanit ishin krijuar dy çeta, njëra e përbërë nga 30 anëtarë dhe tjetra nga 35 anëtarë³⁴². Sipas të dhënave të konsullit bullgar, thuhej se: *“Krijimi i këtyre dy çetave, më së shumti kishte për qëllim që të bindeshin krerët e grupeve ordinere të Elbasanit që të mbështetnin kauzën e Lëvizjes Kombëtare. Në këtë mënyrë ai [Mersim Dema] vuri themelin e një organizimi atdhetar edhe në kazanë e Elbasanit”*³⁴³. Referuar burimit në fjalë, theksohej fakti se veprimtaria e tij, pati sukses jo vetëm në fshatrat e kësaj treve por edhe në vetë qytetin e Elbasanit. Në krye të kësaj lëvizje në Elbasan përmenden emrat e Dervish Beut, [bëhet fjalë për Dervish bej Biçakun] dhe Papa Ligorit [Papa Jorgji Theohari], një i krishterë ortodoks të cilin e kemi përmendur më lart, sikurse shprehej konsulli bullgar: *“ ..., por 7-8 vite më parë ishte konvertuar në katolik dhe konsiderohej njeri i Austro – Hungarisë”*³⁴⁴. Përmes këtyre të dhënave dëshmohej fakti se, që në mars të vitit 1912, në krye të lëvizjes së armatosur në trevën e Elbasanit qëndronte Dervish Biçaku. Ndërkaq, të bën përshtypje fakti se në mbledhjen e organizuar disa muaj më pas në shtëpinë e Ali Agjahut, ku do të merrej vendimi për shpërthimin kryengritjes në Elbasan, Dervish Biçaku nuk rezultonte më ndër krerët drejtues të saj. Për më tepër, emri i tij nuk përmendet më pas si pjesëmarrës në të, krahas pjesëmarrësve të tjerë si: Lef Nosi, Ahmet Dakli, Hysen Sulova, Ali Çelimara, Ali Çausi, Ahmet Isai, Irfan Ohri etj³⁴⁵.

Ndërkaq, interesant prapaqitet roli i Dervish Biçakut, i cili nëse deri në mars të vitit 1912, përmendet ndër të parët drejtues të lëvizjes së armatosur në Elbasan, pas krijimit të Komitetit Organizator Revolucionar, emri i Dervish Biçakut nuk figuron më në dokumentacionin e konsultuar, përmes të cilit do të pasqyrojmë ngjarjet në vazhdim në

³⁴² Muhamet Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme shqiptare antiosmane e vitit 1912*, Libri Shkollor, Prishtinë: 2016, f. 227. Raport i konsullit bullgar në Manastir, dërguar MPJ në Sofje, 3/16 mars 1912, nr. 181.

³⁴³ Muhamet Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme shqiptare antiosmane e vitit 1912*, Libri Shkollor, Prishtinë: 2016, f. 227-228. Raport i konsullit bullgar në Manastir, dërguar MPJ në Sofje, 3/16 mars 1912, nr. 181.

³⁴⁴ Muhamet Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme..., vepër e cituar*, f. 228. Raport i konsullit bullgar në Manastir, dërguar MPJ në Sofje, 3/16 mars 1912, nr. 181.

³⁴⁵ Liman Varoshi, *Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 dhe veçoritë e zhvillimit të saj në trevën e Elbasanit*, botuar në *“Normalja në Traditë”*, vepër e cituar, f. 19.

kuadrin e lëvizjes kryengritëse në trevën e Elbasanit. Nuk jemi të sigurtë, nëse mospërfshirja e tij në zhvillimet e mëvonshme revolucionare në Elbasan, ka qenë një vendimarrje e kushtëzuar, duke u ndjerë i spostuar nga krerët drejtues të Elbasanit, në këtë rast, nga kushëriri i tij Aqif Pashë Biçakçiu. Kur bëjmë një pohim të tillë, më së shumti i referohemi marrëdhënieve konfliktuale të vjetra ndërmjet tyre, që do të vijojnë edhe në muajt pasardhës dhe kulmin e acarimit do ta arrijnë pas shpalljes së pavarësisë³⁴⁶.

Në qershor të 1912 në trevën e Elbasanit përmendet çeta e Byshekut, ku rolin kryesor e luante Irfan Ohri, nipi i Aqif Pashës. Shpërthimi i kryengritjes edhe në Elbasan ishte shumë pozitive për faktin se, e detyronte Portën e Lartë që një pjesë të trupave të saj që do t'i dërgonte në Kosovë, t'i angazhonte në Elbasan. Kështu, në qershor 1912 raportohej që kryengritësit e Dibrës kishin pasur kontakte me ato të Elbasanit³⁴⁷. Me iniciativën e Aqif Pashës, në qershor të 1912 mbahet një mbledhje ku vendoset për shpërthimin e kryengritjes edhe në Elbasan. Në krye të Komitetit Organizator Revolucionar zgjidhet Irfan Ohri ³⁴⁸. Kështu, Lef Nosi do të merrej me organizimin e kryengritjes në zonën e Shpatit, ndërsa Ahmet Dakli në zonën e Martaneshit. Në kryengritjen e vitit 1912 edhe Gramshi ishte angazhuar me 2 çeta³⁴⁹. Ajo që po i jepte goditje reparteve osmane, ishte dezertimi në masë i ushtarëve shqiptarë që evidentoheshin përmes informacionit: "*Në Elbasan dezertoi majori Qemal beu (Biçakçiu), një oficer, një ushtar dhe 8 nëpunës të qeverisë* ³⁵⁰." Në 22 korrik 1912, të arratisur nga qyteti i Elbasanit si rrjedhojë e dhunës së Portës së Lartë, përmenden Irfan beu dhe Hasan bej Biçakçiu, Ahmet Dakli, Lef Nosi etj³⁵¹.

Sikurse e kemi përmendur, sikurse edhe në ngjarjet e tjera familja e Dervish Biçakçiut ishte e angazhuar në kryengritjen e 1912. Sipas dokumenteve të kohës dëshmohet se Irfan Ohri, Hasan Biçakçiu dhe Sheh Hyseni do të udhëtonin në drejtim të Prishtinës në mbështetje dhe në përkrahje të një memorandumit që do të shpallej në Kosovë³⁵². Në 6 gusht 1912, në kuvendin e organizuar në Ferizaj nga Hasan Prishtina u hartua një program që njihet në histori me emrin "14 pikat e Hasan Prishtinës".

³⁴⁶Është koha kur përplasjet ndërmjet tyre marrin përmasat e një përballje të hapur e të armatosur. Dervish Biçaku do të shndërrohet në kundërshtarin më të ashpër të prefektit të Elbasanit Aqif Pashës në muajt qershor-dhjetor 1913, duke dalë hapur në përkrahje të Esad Pashë Toptanit.

³⁴⁷*Shqipëria në dokumentat Austro -Hungareze*1912, vepër e cituar, f.150

³⁴⁸Ndër pjesëmarrësit kryesorë në zgjedhje shquhen figurat e Lef Nosit dhe Ahmet Daklit.

³⁴⁹Majlinda Peza, "Desertacion për mbrojtjen e grades Doktor i Shkencave," *Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*, f.148.

³⁵⁰*Shqipëria në dokumentat Austro -Hungareze*1912, vëllimi III, Tiranë, Toena 2012, f.340.

³⁵¹Po aty, vëllimi 4, f.94

³⁵²Po aty, f.223

Në kuadrin e veprimeve të armatosura në Elbasan zhvillohen edhe 2 tubime, në Kryezjarrth dhe në Byshek. Sipas udhëzimeve të marra nga Hasan Prishtina, kryengritësit pritnin me gatishmëri urdhrin për t'u futur në qytet. Bisedimet ndërmjet komisionit qeveritar turk dhe Hasan Prishtinës përfunduan më pranimin e 12 pikave. Irfan Ohri lajmëronte me telegram Elbasanin se "*Vendimet do të përfshinin gjithë Shqipërinë*"³⁵³.

Të dhëna për përfshirjen në kryengritjen dhe luftime për Elbasanin datohen në prill 1912 ku jepen detaje mbi : "*Arnautët e Krujës dhe Elbasanit posedojnë pushkë , "gras" "Mauzer" "Maliher" të marra pjesërisht prej shtetit.*"³⁵⁴ Siaps të dhënave pushkët Gras transportoheshin nga Greqia kurse pushkët Maliher transportoheshin nga Lezha. Siç na njoftojnë dokumentat austro-hungareze, më datë 22 Korrik 1912, konsulli Leyhanec raportonte ministrin e jashtëm në Vjenë se një kontigjent i konsiderueshëm i kryengritësve me rreth 700 burra, duken se ndodhen në fshatrat e Lushnjës, 52 km në veri-lindje të Vlorës.³⁵⁵ Këto përbëhen nga njërëz të rajonit të Elbasanit dhe udhëhiqen nga Hasan bej Elbasani, vëllai i Dervish beut. Në komunikim, kuptohet qartë se kryengritësit kishin ndërmend të hynin në qytet që t'i paraqisnin qeverisë së Beratit, një memorandum. Memorandumi, do t'i paraqitej edhe përfaqësuesve të fuqive të huaja. Kërkesat do të ishin me karakter kombëtar. Konsulli shpjegon se, në rast se në ditët në vijim nuk do të kishte një sqarim të situatës, do të shpërthente një anarki e përgjithshme në të gjithë vendin.³⁵⁶ Në vijim të situatës së krijuar, konti Halla nga Manastiri lajmëronte ministrin e jashtëm në Vienë se Irfan beu dhe 13 të tjerë nga qeveria e Elbasanit, i ishin bashkuar kryengritësve. Kështushqiptarët kishin adresuar kërkesa të drejta dhe që kishin kohë që i kishin formuluar. Kërkesat kryesore ishin :

- Shpërndarja e parlamentit
- Zgjedhje të reja të pandikuara
- Amnisti të përgjithshme
- Rrëzimin e kabinetit të sotëm.

Konti publikon listën e plotë të shqiptarëve të arratisur dhe që i ishin bashkuar kryengritjes:

Shtojce e raportit, Manastir, më 22 Korrik 1912.

Listë e parisë së shqiptarëve të arratisur prej Elbasanit.

1.Irfan Beu	2.Beqir Plangarica
2.Hasan Beu	9.Lef Nosi

³⁵³ Majlinda Peza, Desertacion per mbrojtjen e gradës Doktor i Shkencave, " Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914 "

³⁵⁴ Dokumenta austro-hungareze (1912), Vëllimi II, Tiranë:Kristalina KH 2012 , f 71.

³⁵⁵ Dokumenta austro-hungareze (1912), Vëllimi IV, Tiranë:Kristalina KH 2012, f.90

³⁵⁶ Po aty,91.

3.Abdulla Beu	10.Nexhip Tendari
4.Gani BEU	11.Naxhi Adem Shijaku
5.Baba sheh Hyseni	12.Kasem Haxhi Hyseni
6.Ismail Hakiu	13.Tohsun Lutfi Zade
7.Ahmet Dakli	14. Ali Aga ³⁵⁷

Po të vërejmë me kujdes emrat e të arratisurve, kuptohet fare mirë që shtresat shoqërore të përfshira në kryengitje ishin të ndryshme me një objektiv të vetëm atë të luftës kundër Ports së Lartë dhe të sigurimit të të drejtave të popullsisë Shqiptare. Shumë nga atdhetarët bënë thirrje që vetëm nëpërmjet luftës mund të siguroheshin ato që shqiptarët i kërkonin që nga fillimet e Rilindjes kombëtare. Kështu në gusht të 1912 Mit'hat Frashëri nga Stambolli i bënte thirrje shqiptarëve duje u shprehur përmes fjalëve: "Të mos themi që çdo njeri ka një udhë të ndryshme për të arritur qëllimin e përbashkët, unë them që udha dhe qëllimi është një shpëtimi prej vetes sonë"³⁵⁸

4.3 Dervish Biçaku dhe Shpallja e Pavarësisë Kombëtare

Kryengritja antiosmane e vitit 1912 përfundoi me nëshkrimin e marrëveshjes ku Porta e Lartë zotohej se do të realizonte kërkesat e shqiptarëve të njohur si 14 pikat e Hasan Prishtinës. Pavarësisht premtimeve, nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të ndikonte në qetësimin e situatës në trevat shqiptare gjithashtu edhe në rajonin e Ballkanit. Shtetet e pavarura ballkanike që ishin kundër autonomisë së Shqipërisë, po po i bënë presion dhe po kërcënonin hapur Portën e Lartë. Në 7 tetor 1912 nëpërmjet një note proteste austro-ruse i bëhej e qartë Portës së Lartë të ruante paqen dhe mbi të gjitha të respektonte status quo-në. Ndërkaq më 12 Tetor Mali i Zi në aleancë me Serbinë, Bullgarinë dhe Greqinë i shpallën luftë Portës së Lartë, duke sulmuar garnizonet turke nga të gjitha anët. Shumë shpejt ushtritë e shteteve ballkanike avancuan në territoret që ishin pjesë e Perandorisë Osmane duke kërkuar ndarjen e tyre. Kështu Serbia kërkonte të realizonte ëndrrën e vjetër të Stara Serbia, duke kërkuar territoret në Shqipërinë e veriut dhe mbi të gjitha të siguronte dalje në detin Adriatik. Ajo pretendonte të ndante territoret shqiptare sipas një marrëveshjeje me Greqinë dhe Malin e Zi, më 13 mars 1912 të parashikuar në shtojcën sekrete të Traktatit Serbo-Bullgar³⁵⁹.

Ndërkohë në parim, fqinji jugor Greqia ishte për një Shqipëri autonome në kufij

³⁵⁷Po aty, fq 94.

³⁵⁸Mit'hat Frashëri, Vepra të zgjedhura, vëllimi I, Tiranë: Onufi 2017, f. 288.

³⁵⁹Akademia e Studimeve Albanologjike, *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Tiranë: Kriatalina KH 2017, f. 110

shumë të ngushtë në sanxhakun e Elbasanit dhe Beratit. Mirëpo ngjarjet rrodhën krejt ndryshe dhe grekët do të ndryshojnë strategji. Duke mbrojtur interesat e tyre do të sakrifikojnë idenë e shtetit autonom shqiptar duke bashkëpunuar me Serbinë dhe duke krijuar kështu një situatë të pafavorshme për shqiptarët. Heqja dorë nga ideja për një shtet autonom shqiptar rridhte dhe nga fakti se kështu ata i prisnin rrugën ndërhyrjes austro-hungareze në Shqipëri. Kështu Serbët pushtuan krejt Kosovën, Mali i zi sulmoi Malësinë e Madhe duke synuar Shkodrën, ndërsa Greqia pushtoi Prevezën, Igumenicen dhe më pas Sarandën³⁶⁰. Shqiptarët ishin të pafuqishëm kundrejt këtij koalicioni ballkanik, mbi të gjitha në këtë situatë shqiptarët ende nuk kishin një qëndër të vetëm politike dhe organizative. Në fillim të nëntorit 1912 trupat serbe filluan sulmin në zonën e Lumës, Muditës dhe Matit. Ndërkohë patriotët shqiptarë u mbledhën në 5 nëntor 1912 në Bukuresht ku përcaktuan në vija të përgjithshme aksionin për Lëvizjen kombëtare shqiptare ku: *”shqiptarët të përmbledhin fuqitë dhe të krijojnë një komitet drejtues i cili të marrë në dorë qeverisjen e vëndit dhe të përpiqen që kombi shqiptar të mos dalë i mundur...për të mbrojtur në faqe të botës së qytetëuar e të Fuqive të Mëdha të drejtat Kombëtare e vendorë të popullit shqiptar”*³⁶¹. Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm do të luajë figura e Ismail Qemalit i cili, pas kontakteve diplomatike në Vjenë arriti të siguronte mbështetjen e kësaj të fundit për pavarësinë e Shqipërisë. Kështu ai i telegrafonte parisë së Vlorës: *”Arrij me anijen e parë. E ardhmja e shqipërisë është e sigurtuar”*³⁶²

Në vijim të rrugëtimit të tij Ismail Qemali nga Vjena niset për në Trieste me destinacion Durrësin së bashku me një grup patriotësh shqiptarë. Kështu më 21 nëntor ai mbërrin në Durrës dhe më 22 nëntor telegrafon patriotët nën Elbasan konkretisht Aqif Pashës, Shefqet Verlacin ku i shpjegon për një mbledhje: *”ku do merrej një vendim i premë.”*³⁶³

Në Elbasan ndërkohë po ndjehej frika e pushtimit nga forcat Serbe. Në emër të bejlerëve të Elbasanit, prifti Germanos i kishte kërkuar nënkonsullit austro-hungarez në rast të një okupimi serb të qytetit, Sinodi të vihej nën mbrojtjen e konsullatës austro-hungareze³⁶⁴. Kjo situatë shpjegohej me faktin që forcat serbe ishin futur thellë në territoret shqiptare, ku më 17 nëntor 1912 kishin pushtuar Lezhën duke u drejtuar drej Shqipërisë së Mesme për të pushtuar Durrësin.

Referuar versionit të historiografisë zyrtare para viteve '90, thuhet që Elbasani ishte

³⁶⁰Po aty, f. 111

³⁶¹Arben Puto, *Pavarësia e Shqipërisë dhe Diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914*, Tiranë: Toena, 2021 f. 83.

³⁶²Lef Nosi, *Dokumenta Historike 1912-1918*, Dituria, f.103.

³⁶²Po aty, f.103.

³⁶³Lef Nosi, *Dokumente historike*, D8, fl. 1..

³⁶⁴*Dokumenta austro-hungareze (1912)*, Vëllimi IV, Tiranë: Kristalina KH 2012, f. 320.

qyteti i parë që shpalli pavarësinë. Faktikisht, Elbasani ishte një nga qytetet që kishte luajtur rolin kryesor në ngjarjet e rëndësishme kulturore dhe politike të viteve të fundit të shekullit të XIX dhe fillimit të shekullit XX. Ai kishte në gjirin e tij intelektualë dhe patriotë që kishin dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në kryengritjet e viteve 1911-1912. Ndërkaq ekziston mendimi që, pavarësia dhe flamuri në Elbasan janë të lidhur me një datë tjetër e më konkretisht me 28 nëntorin e vitit 1912. Ndërsa në 25 nëntor 1912 paria e Elbasanit në mbledhjen e organizuar në shtëpinë e Aqif Pashës, në telegramin dërguar Vlorës deklaroi se populli i Elbasanit myslimanë e të krishterë me një zë e pranonin pavarësinë³⁶⁵. Siç dihet, Dervishi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në ngjarjet e pavarësisë në Peqin, Elbasan dhe në Vlorë gjatë nëntorit të vitit 1912. Kështu, pas mbërritjes së Ismail Qemalit në Durrës, së bashku me delegacionin e tij ku bënin pjesë Luigj Gurakuqi, Pandeli Cale, Dhimitër Berati, Spiridon Ilo ata do të niseshin për në Vlorë.

Dëshmohet që në mbashtetjen e 22 nëntorit 1912 në Peqin kishte qenë Pandeli Cale, i cili kishte kërkuar ndihmë patriotëve të Peqinit për të siguruar kalimin e Ismail Qemalit për në Vlorë. Në Peqin, ai kishte takuar me Mahmut Efendi Kaziun, Adem Gjinishin, Dervish Biçakçiun etj. Më 23 nëntor në mëngjes komisioni kishte caktuar një grup patriotësh, për të mbrojtur Ismail Qemalin. Ky grup kishte në përbërje 100 njerëz që udhëhiqeshin nga Adem Gjinishi. Ndërkohë grupit të Ismail Qemalit i ishin bashkuar dhe patriotët Dom Nikoll Kaçorri, Abdi dhe Murat Toptani që ishin njëkohësisht dhe bashkëpunëtorë të vjetër të Dervish Biçakçiu. Rrugëtimi i Ismail Qemalit nuk ishte i lehtë për në Vlorë. Porta e lartë u përpoq të pengonte udhëtimin në Lushnjë. Karvani nën sigurinë e forcave të Peqinit kaloi me vështirësi Shkumbinin dhe mbërriti në sarajet e Dervish Biçakçiu ka jmekanit të Peqinit, në vendin që quhej me emrin Çermë Pasha³⁶⁶. Po sipas dëshmive në mëngjesin e 24 nëntorit Ismail Qemali ka lënë Sarajet në Çermë dhe ishte nisur drejt Divjakës dhe Libofshes. Vlen të theksohet se sipas kujtimeve gojore Mahmud Efendi Kaziu dhe Dervish Bej Biçakçiun kishin shoqëruar Ismail Qemalin madje thuhet se udhërrëfyesit ishin njerëz të Dervish Bej Biçakçiu. Forcat e Peqinit i sigurojnë mbështetje për kalimin e Ismail Qemalit në Vlorë.

Sarajet e Dervish Beut në Çermë të Lushnjës u kthyen në një vendqëndrim të rëndësishëm për të gjithë patriotët shqiptarë që kalonin nga veriu në drejtim të jugut të Shqipërisë. Kështu më 22 nëntor 1912 Komisioni organizator i Vlorës njofton me telegram

³⁶⁵Desertacion për mbrojtjen e gradës Doktor i Shkencave, “ *Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*”, f.170.

³⁶⁶ Genc Gripshi, *Historia e Peqinit*, Tiranë: Reklama 2014, f. 144.

parinë e Peqinit se kuvendi do mblidhej në Vlorë: "Lutemi për shpëtim të atdheut që përfaqësuesit në fjalë duke e bërë natën ditë qetë gjenden në mbledhjen e përgjithshme kombëtare që do të bëhet në Vlorë". Paria e qytetit të Peqinit do të mblidhej duke krijuar Komisionin e parisë së qytetit dhe duke zgjedhur fillimisht si përfaqësues për në kuvendin e Vlorës dy patriotët peqinas Mahmut Efendi Kaziu dhe Adem Efendi Gjinishi. Ndërkaq, Dervish Bej Biçakçiu ishte propozuar si përfaqësues i Peqinit për në Kuvendin e Vlorës nga Kadri bej Bonati. Ndërkaq, paria e Elbasanit lajmëronte Dervish beun në 25 nëntor 1912 i cili në këtë kohë mbante postin e nënprefektit në Peqin se :*"Elbasani emnoi përfaqësues Mit'hat bej Frashërin, Shefqet Daiun e Lef Nosin dhe pardje u nisën në Vlorë. Pasi zotnia juaj jeni zgjedhë përfaqësues nga Peqini, natyrisht, jo Elbasanin por edhe të gjithë prefekturën e përfaqësoni"*³⁶⁷. Përmes këtij burimi, evidentohet vlerësimi që i bëhej Dervish Beut edhe si përfaqësues i Elbasanit në Kuvend, por nga ana tjetër dëshmohet edhe influenca që kishte ai si pjesë e rëndësishme e elitës së Elbasanit. Ashtu si pjesa më e madhe e qyteteve, Peqini e ngre flamurin më 27 Nëntor 1912, *"Ju bëjmë më dije se me dëshirën e gjithë popullit, mbrëmë, ora 6, nënprefektura e Peqinit e shpalli pavarësinë."*³⁶⁸ Ai ndihmoi Ismaili Qemalin në udhëtimin e tij nga Durrësi në Vlorë. Kështu Sejfi Vllamasi shkruan: *"Atëherë Ismail Qemali me ndihmën e Hamit Toptanit dhe Dervish Bej Biçakçiut nisët për në Çermë, në çifligun e këtij të fundit dhe të nesërmen duke ndryshuar rrugë ,nga ana e Kara Toprakut, shkon në Fier te Ymer pashë Vrioni dhe prej andej mbërrin në Vlorë"*³⁶⁹.

Shpallja e Pavarësisë shënon një ngjarje të rëndësishme për të cilën ishin investuar me shpirt dhe me zemër shqiptarët ku një meritë e veçantë pa dyshim i takonte edhe patriotëve Elbasanas që mbështeten pa u kursyer këtë ngjarje të madhe për të ardhmen e shtetit Shqiptar. Akti i shpalljes së pavarësisë ishte një ngjarje madhore pikërisht edhe për faktin që patriotët shqiptarë, ishin përfshirë në të jo vetëm me armë por edhe duke kontribuar me dijen e tyre duke e renditur Elbasanin në elitën e qyteteve që ndihmuan në shpalljen e pavarësisë.

Dervish Biçakçiu qëndron në Çermë i detyruar të presë atdhetarët e tjerë ndërmjet të cilëve edhe Mehmet Dërrallën. Mahmut Kaziu nga Peqini. Kështu Dervish Biçakçiu për shkak të vonesës në nisje dhe mbërritjes vonë në Vlorë, nuk rezulton nënshkruar i aktit të pavarësisë. Në datën 27 nëntor 1912 ai bashkë me Sami bej Vrionin ishin takuar me Isa

³⁶⁷Po aty ,f.103.

³⁶⁸Lef Nosi, *Dokumenta Historike 1912-1918*, Dituria, f.101,

³⁶⁹Sejfi Vllamasi. *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë, Botime Vllamasi ,f.66.

Buletinin³⁷⁰. Gjithashtu në listën e plotë që dërgonin përfaqësuesit e austro-hungarisë për pjesëmarrësit në hapjen e kuvendit përbri emrit të Dervishit ishte vënë shënimi "*jo i pranishëm*"³⁷¹. Në deklaratën e pavarësisë kanë nënshkruar të gjithë përfaqësuesit e tjerë të Elbasanit:

- 1.Lef Nosi
- 2.Shefqet Daiu (Shefqet Daji)
- 3.Qemal Karaosmani(Qemal bej Elbasani)
- 4.Mithat Frashëri edhe pse u zgjodh delegat nga Elbasani figuron në krahë të delegatëve të Përmetit dhe Kosovës.

Në një variant tjetër të treguar nga Adem Ballhysa³⁷² rezulton se ai, Dervishi ka qënë i pranishëm ditën e hapjes "*Peqinasi Jahaj Ballhysa që kishte qënë delegat i Durrësit në Vlorë me të drejtë vote së bashku me dy delegatët e Peqinit dhe Mahmut efendi Kaziun dhe Dervish Biçakçiun sapo ka lexuar rezolutën e themelimit të shtetit nga ana e Luigj Gurakuqi kanë dalë jashtë për të pirë kafe*". Sipas dokumentave të Lef Nosit, ai (Dervishi) i telegrafonte nga Fieri më datë 28 nëntor 1912 Ismail Qemalit: "*Lutemi n'emen të gjithëve, me na banë me ditë sa më shpejti ushpallë independenca e Shqypniës, Kabinete vet t' Europës apo jo*". Në fakt telegrami nuk mban orë dhe kjo mund të jetë një provë që ai mund ta ketë arritur orën kur u shpall pavarësia. Dihet që proklamata e shpalljes së pavarësisë është bërë pas orës 14.1 të datës 28.12.1912. Kështu edhe dy përfaqësues të tjerë që kanë qënë në momentin e hapjes nuk e kanë nënshkruar aktin e shpalljes së pavarësisë. Në fakt nuk dimë më saktësi se çfarë ka ndodhur por dëshmohet gjithashtu se edhe 2 patriotë të tjerë të cilët kanë qënë të mandatuar për në Kuvendin e Vlorës dhe kanë qënë të pranishëm, nuk e kanë firmosur aktin e shpalljes së Pavarësisë. Dhe këta patriot ishin Azis Gjirokastra dhe Ibrahim Efendiu (Ali Shahini)³⁷³.

Ndërkaq, dokumentacioni i kohës dëshmon faktin se Dervish Beu ishte pjesëmarrës në mbledhjen e dytë të Kuvendit kombëtar të Vlorës mbajtur në 30 nëntor 1912³⁷⁴. Në proces-verbalin e mbledhjes ndër të tjera shkruhej: "*Si delegatë të rinjë erdhën...Dervish*

³⁷⁰Majlinda Peza, Desertacion per mbrojtjen e grades Doktor i Shkencave, "*Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*". fq 173.

³⁷¹*Dokumenta austro-hungareze (1912)*, Vëllimi IV, Tiranë:Kristalina KH 2012,f. 379.

³⁷²Genc Gripshi,*Historia e Peqinit*,Tiranë: Reklama 2014,f. 144.

³⁷³*Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Tiranë: Kristalina KH, 2017,f. 173.

³⁷⁴Po aty, f. 45.

beu nga Elbasani e Mahmut efendi Kaziu nga Peqini”³⁷⁵. Një informacion i tillë hedh dritë rreth faktit se, Dervishi konsiderohej si delegat i ri në këtë mbledhje (i ardhur rishtazi), çka zbardh më shumë faktin se Dervishi nuk ka qenë prezent në hapjen e kongresit të Vlorës më 28 nëntor 1912. Në po të njëjtin burim, pasqyrohet edhe biseda ndërmjet tij dhe Ismail Qemalit, ku Dervish Biçakçiu kërkonte të dinte rreth kompozimit të qeverisë që do të krijohet përmes pyetjes se: “Sa do të jetë numri i ministrave të qeverisë? Në përgjigjen e Ismail Qemalit u tha se mund të emroheshin vetëm: “...ministri i punëve të jashtme, ministri i punëve të mrendshme, ministri i ushtëriës e i siguriës së përbotshme, ministri i kursimit, ministri i drejtësiës dhe ministri i mësimet e i punëve të përbotshme”³⁷⁶. Detyra imediate e qeverisë siç ishte të formonte kabinetin qeveritar me Ministra të zotë që duhet ti përgjigjeshin sfidave të kohës. Situata ishte shumë e vështirë po të kemi parasysh që territori jo i pushtuar ishte në trekëndëshin Fier-Lushnjë -Vlorë.

Nga Vlora më 1 dhjetor 1912 Dervishi i shkruante bashkisë së Elbasanit dhe Peqinit: “Ju përgëzoj se qeveria e Austrisë dhe Italisë e njoftën independencën e Shqipërisë.” Po kështu ai i drejtohet nënprefekturës së Peqinit: “Tyke u lidhun me Elbasanin të shikoni detyrën mirë dhe në qoftë se vjen aty ushtria serbe ju porosisim që t’i prisni si mik dhe të njoftoni herë pas herë si do rrjedhin punët. Sepse të drejtat tona do të rregullohen prej Qeveries tyre e Qeveries tonë.”³⁷⁷

Në mbledhjen e katërt të Kuvendit kombëtar të Vlorës, pjesëmarrësit zgjodhën këshillonjësit, të cilët do të përbënin atë që quhej “Organi i Pleqësisë”. Ky organ nuk ishte as parlament, as senat me kompetenca urdhëruese ndaj qeverisë. Pleqësia, ashtu siç shkruhej në proces-verbalin e mbledhjes së katërt, kishte funksione këshillimore. Në mbledhjen e pestë të Kuvendit të Vlorës u votua për të formuar Pleqësisë. Ndër emrat që fituan si anëtarë të Pleqësisë ishin edhe dy delegatët e Elbasanit; Shefqet Daiu me 30 zëra [vota] dhe Dervish Bej Biçaku me 29 zëra [vota]³⁷⁸. Gjithashtu, emri i Shefqet Daiut, figuron edhe në proces-verbalin e mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Vlorës më 7 dhjetor 1912. Emri i tij është renditur krahas emrave të Luigj Gurakuqit dhe Dom Kaçorrit, duke diskutuar rreth kompetencave që do të kishte Pleqësia, çka do të thotë se ai përfaqësonte një figurë të

³⁷⁵Po aty, f.45.

³⁷⁶Lef Nosi, *Dokumenta Historike 1912-1918*, Dituria 2007, f.179-180.

³⁷⁷Po aty, f.131

³⁷⁸Teki Selenica, *Shqipëria në 1927*, Tiranë: 1928, f. 21.

rëndësishme dhe me peshë në kuadrin e përfaqësuesve të tjerë në Kuvendin e Vlorës ³⁷⁹.

Dervishi ka dhënë kontribut edhe në krijimin e Ministrisë së Financave. Atij ju kërkua nga Ismail Qemali të merrej me organizmin e saj. Më 1 dhjetor 1912, Dervish beu i drejtohet nga Vlora Ahmet Daklit: *"Pasi për organizimin e financave të qeverisë së përkohshme shifet nevoja e një njeriu të zotin dhe zotënia juaj në atë zonë është i ditun, u pa e pëlqyeshme të merrni ju përsipër e po sot sa të merrni telegramin të niseni për këtu"*³⁸⁰. Meqenëse Dervish beut iu ngarkua të merrej me ministrinë e financave, konkludojmë që Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi kishin besim në zgjedhjet që ai do të bënte, bazuar kjo edhe tek formimi i tij intelektual dhe personaliteti. Ahmet Dakli ishte një tjetër personalitet që me veprimtarinë e tij ka shkruar emrin në atë rreth njerëzish patriot që kishin kontribuar në pavarësinë e Shqipërisë duke qenë pjesëmarrës aktiv në kryengritjet antiosmane në trevën e Elbasanit. Kuptohet që ai do t'i përgjigjej pozitivisht ftesës së Dervish Bej Biçakçiu për të shkuar si anëtar i qeverisë së Vlorës. Si anëtar i qeverisë së Vlorës ai shërbeu deri në 12 dhjetor të vitit 1913.

Ndërkohë që ishte krijuar qeveria e Vlorës gjendja paraqitej shumë e vështirë, ku në jug të Shqipërisë grekët po tentonin të pushtoni Janinën e cila mbrohej nga pashai Esat Pashë Janina. Situata ishte shumë e vështirë si rrjedhojë e shumë faktorëve, ndërprerjes së rrugave të ushtarëve nga Porta e Lartë, dezertimi masiv i shqiptarëve dhe dimrit të ashpër. Gjithashtu në një analizë të Eqerem bej Vlorës, dezertimi pas shpalljes së pavarësisë kishte krijuar idenë e gabuar të një pjesë e madhe e Shqiptarëve se asnjëherë e Shqipërisë do ti siguronte asaj miqësinë e fqinjëve propagandë e cila do të dëmtonte shumë qeverinë e Vlorës³⁸¹. Pikërisht në një situatë të tillë disa nga patriotët shqiptarë e konsideronin shumë të rëndësishëm organizimin e mbrojtjes së Janinës. Ismail Qemali i drejtohej me një qarkore të gjitha krahinave të Shqipërisë: "Pa humbur kohë, gjithë patriotët shqiptarë të rrokin armë dhe të shkojnë në ndihmë Janinës"³⁸².

Pas datës 14 dhjetor në dokumentat austro-hungareze dëshmohet se ishte përcaktuar qartë fati i territoreve të ardhshme të Shqipërisë. Berchtold ministri i jashtëm i Vjenës i përgjigjej Ministrit të Jashtëm Rus Sazanov: *"ndarja e territoreve duhet të mos çënojë interesat tona ekonomike dhe populli shqiptar të mëvetësohet"* si dhe konsulli Ipen i

³⁷⁹ Ahmet Dakli ka dhënë dorëheqjen në nëntor të vitit 1913.

³⁸⁰ Po aty, f.131.

³⁸¹ *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Tiranë, Kriatalina KH 2017, f. 150.

³⁸² Po aty, f.151

theksonte Raportit më 14-16 dhjetor 1912 duke i komentuar i komentuar ato se “Delvina, Gjirokastra dhe Korça nuk duhet të mbeten jashtë”.³⁸³

4.4 Raporti i Dervish Biçakut me Qeverinë e Vlorës 1913 - 1914

Ndërkohë që prapaskenat me fatet e Shqipërisë vazhdonin në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, patriotët shqiptarë kërkonin në mënyra të ndryshme që të mbrohej Janina. Kështu një grup patriotësh me në krye Azis Pashë Vrionit, i shkruanin Ismail Qemalit se rënia e Janinës do të rrezikonte pavarësinë e Shqipërisë; për këtë arsye kërkohej ndihma për ushtrinë Osmane me ushqime, sepse mosdhënia e saj do të çonte në zhdukjen e Shqipërisë së Jugut. Kështu i kërkohej Ismail Qemalit që: "ti jepej urdhër Bektash Cakranit, Musa Hamit Agait, Bektash Aga Corrushit, Veli bej Këlcyrës, Dervish Bej Biçakut dhe Qamil Beut" të organizonin forcat në ndihmë të Janinës. Pikërisht në ato ditë të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, i vëllai i Dervishit, Qamil beu, më 4 janar 1913 ndodhej në Kolonjë bashkë me patriotë të tjerë për t'i dhënë zemër popullsisë së Kolonjës që ishte larguar nga frika e terrorit grek në Përmet³⁸⁴.

Në 3 Prill të 1913 Dervish Biçakçiu dhe Lef Nosi i dërgonin një letër Luigj Gurakuqit dhe Ismaili Qemalit duke i shkruar se: "*Ana kundërshtare punon pa pushumen që të rrënoj qeverinë e parë dhe të hyji ndë kryesi Syrja Beun Vlorën*"³⁸⁵. Në letër kuptohet qartë, që akoma deri në këtë periudhë Dervishi mbështeste Ismail Qemalin, duke e informuar atë, që ishte krijuar një krah politik që kërkonte të merrte drejtimin e qeverisë së Vlorës. Në këtë grupim politik, bënin pjesë personalitete si: Eqrem bej Vlora, Fazlli Pasha, Avdi bej Toptani e Murat Toptani. Sipas Lef Nosit, Dervish bej Elbasani kishte marrë pjesë në një mbledhje në shtëpinë e Eqrem Vlorës, ku thelbi i diskutimit kishte qenë se “qeveria e sotme nuk asht e zonja me qeverisun”. Sipas Lef Nosit, vetëm këmbëngulja e Dervishit nuk i kishte lënë që të nënshkruanin një shkresë, të cilën kishin vendosur ta dërgonin pranë diplomacisë vieneze. Në letër sqarohej se ata e akuzonin Ismail Qemalin për shpenzimin disa mijëra napolonash³⁸⁶.

Në këtë kuadër Syrja bej Vlora vazhdonte komunikimet me Ministrinë e Jashtme austro-hungareze, ku i kërkonte atyre hartimin e një kushtetute moderne europiane për Shqipërinë, organizimin e xhandarmërisë, mbrojtjen e të drejtave dhe pasurisë së ish-

³⁸³ *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Tiranë: Kriatalina KH 2017, f. 242-243.

³⁸⁴ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë: Toena 2007, f. 271-272.

³⁸⁵ Eqrembej Vlora, ndihmesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri, Vëllimi i II Tiranë, Botime "55", f. 125.

³⁸⁶ Po aty, f. 125.

zyrtarëve shqiptarë, si dhe të drejtën e pronës në Shqipëri³⁸⁷. Në korrespondencën ndërmjet tij dhe austro-hungarezëve, shfaqet qëndrimi i Dervish Beut ndaj dy figurave të politikës shqiptare të asaj kohe. Faktikisht, që në këtë kohë, ai kishte filluar të shfaqej mosbesues Ismail Qemalit, ndërsa për sa i përket Esat Pashës, ai shprehte mendimin se Esati nuk ndiqte plane që shkonin më lart. Për më tepër, duke i dhënë përparësi interesave kombëtare, Dervishi ishte për një marrëveshje me Esat Pashën, në mënyrë që *"të mos i krijohen vëndit vështirësi prej tij"*. Ai i kërkonte konsullit të përgjithshëm austro - hungarez, që të zgjidhej sa më shpejt situata në të cilën gjendej Shqipëria, sepse në të kundërt, gjithmonë e më shumë do të bëhej e pamundur marrja vesh midis Qeverisë së Vlorës dhe Ismail Qemalit dhe Esat Pashës, Xhelal Pashës dhe Preng Bibë Doda³⁸⁸. Theksojmë se, mendimet e Dervishit do të rezultojnë të vërteta për atë kohë, për vetë faktin se situata politike do të precipitonte shumë shpejt dhe marrëdhëniet ndërmjet Ismail Qemalit dhe Esat Pashës do të merrnin karakter të dukshëm konfliktual. Gjithashtu, përmes kësaj letre, shikojmë të shfaqen edhe fillesat e para të një qëndrimi të lëkundur të Dervishit ndaj Ismail Qemalit, qëndrim ky që shumë shpejt do të shfaqet në mbështetje të Esat Pashës.

Ndërkaq, situata në Elbasan shfaqej e tillë, ku në maj 1913 ushtria serbe ishte larguar nga qyteti dhe trevat përreth. Në një letër që Ahmet Dakli i dërgonte në 13 maj 1913 Qeverisë së Vlorës, shpjegonte se Esat Pashë Toptani kishte filluar përpjekjet për të organizuar një Kongres në Krujë. Me pjesëmarrës nga Shqipëria e Mesme, ku evidentonte faktin që ai kërkonte që në këtë kongres të merrte pjesë dhe Elbasani. Sipas tij Aqifi e kishte konsideruar këtë mbledhje si shkatërrim të Shqipërisë. Ahmet Dakli e siguronte Qeverinë e Vlorës se në këtë ngjarje nuk ka punë Austria dhe se Esati nuk gëzon mbështetjen e katolikëve. Ahmet Dakli e akuzonte Esat Pashën për sllavofil duke u shprehur se: *"Përpjekja në Shkodër e ka bërë atë ta shohë veten në pasqyrën e divit"*³⁸⁹. Ai shfaqte bindjen se Esat Pasha nuk do mund t'i nxirrte vështirësi qeverisë së Vlorës.

Më 25 maj, prefekti i Durrësit Hamid Toptani njoftonte prefektin e Elbasanit Aqif Pashën mbi vendimet ³⁹⁰që u morën në mbledhjen e Krujës. Kërkesa kryesore ishte krijimi i një qeverie të re me në krye Esat Pashë Toptanin. Sipas asaj që njihet tashmë, Kongresi

³⁸⁷ Beqer Meta, Hasan Bello, Syrja dhe Eqerem bej Vlora (1890-1913), Vëllimi i parë, Tiranë: Onufri, 2020, f. 395.

³⁸⁸ Po aty, f. 400.

³⁸⁹ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë: 8 Nentori, 1962, f. 135.

³⁹⁰ Po aty, f. 142 a) Të zgjidhet nga mbretëritë një princ që të njoh gjëndjen tonë të përgjithshme. b) Kruja meqë ka rëndësi historike dhe meqë ndodhet në mes të Shqipërisë të caktotet si kryeqytet c) Për të siguruar qetësinë dhe rregullin në Gegëri, deri sa të vijë princi, Esat Pasha të caktotet kryetar i qeverisë.

parashtroi tri kërkesa kryesore:

- ✓ Së pari, Fuqitë e Mëdha të zgjidhnin një princ të huaj,
- ✓ Së dyti, Kruja të caktohej kryeqytet dhe
- ✓ Ajo që ishte më e rëndësishmja dhe për të cilin mendojmë se u mbledh ishte të zgjidhej Esad Pasha kyetar i qeverisë³⁹¹.

Kongresi i Krujës, dështoi për shkak të mosmarrëveshjeve midis tij dhe myftiut të Tiranës Musa Qazimit, i cili kërkonte nga Fuqitë e Mëdha një princ mysliman në krye të shtetit Shqiptar. Ishte e qartë që deri në këtë kohë ashtu siç edhe faktet janë të njohura, Esati ishte nën ndikim austriak. Ndërkohë dihet që Fuqitë e Mëdha kërkuan tërheqjen e forcave osmane nga territori shqiptar, gjë që u krye në mesin e qershorit 1913. Në verilindje të Shqipërisë ishin larguar edhe forcat Serbe. Me gjithë këtë, situata nuk ishte shumë e favorshme për qeverinë e Vlorës e cila nuk po siguronte mbështetjen e Fuqive të Mëdha. Esat Pasha pas dorëzimit të Shkodrës, vazhdonte aktivitetin në Shqipërinë e mesme dhe kishte rritur ndikimin në Durrës dhe Elbasan. Ismail Qemali kishte të qartë fuqinë që ai posedonte dhe që të thyente intrigat e tij, e ftoi për postin e Ministrit të Brendshëm të cilin Esati e pranon. Duket që situata që ai gjeti në Vlorë nuk e bindi që duhet të qëndronte në kabinetin e Ismail Qemalit. Fillimisht largohet në drejtim të Romës në shoqërinë e Syrja dhe Egerem Vlorës, që të dy dukshëm me ndikim proaustriak.³⁹² Po kështu një tjetër mbështetës i Esatit ishte Ahmet bej Mati (Zogolli) i cili në fillimin e qershorit 1913, kërkoi të organizojë një kongres në Tiranë, sikurse thuhej qëllimi ishte të bashkonte toskët dhe gegët³⁹³. Pakënaqësia ndaj Qeverisë së Vlorës në muajt në vijim sa vinte dhe rritej. Kështu përfaqësues të parisë së saj në Durrës, kishin kryer veprime arbitrare prandaj nga ana e Hasan Selahudinit i kërkohet që në administratën e prefekturave dhe nënprefekturave të emërohen njerëz të zotët dhe me ndërgjegje patriotike. Dukej që pozitat e Qeverisë së Vlorës gjithmonë e më shumë po pësonin goditje. Në periudhën kohore maj 1913 deri në janar 1914, dëshmohen dhjetra telegrame midis Ismail Qemalit dhe Aqif pashës prefektit të Elbasnait, të cilat vërtetojnë që Dervish beu tashmë shfaqej si mbështetës i Esat Pashës dhe që sipas tyre punonte kundër Qeverisë së Vlorës³⁹⁴.

Më 11 qershor 1913 në një letër që Dervish Biçakçiu i dërgon princit Salaudin një nga kandidatët për të zënë fronin e monarkisë në Shqipëri, jepen shpjegime mbi situatën në

³⁹¹ Akademia e Studimeve Albanologjike, *Historia e Shqiptarëve*, Tiranë: Botime Albanologjike: 2020, f. 269.

³⁹² Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë : Toena 2007, f. 47.

³⁹³ Po aty ,f. 149.

³⁹⁴ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë : Toena 2007, f.180.

zonën përreth Elbasanit ku kishin filluar propagandë antiqeveritare edhe për shkak të pakënaqësisë së madhe nga pagesa e taksave. Ai i bënte thirrje popullit të mos paguante taksa dhe të mos dorëzonin armët³⁹⁵. Tashmë mendojmë se Dervishi po fillonte të shfaqte hapur qëndrimin e tij, së pari në lidhje me princin që pritej të vinte në Shqipëri dhe së dyti në lidhje me qëndrimin ndaj qeverisë ekzistues të Vlorës.

Në 12 korrik të 1913-ës, Aqif Pasha i dërgonte një letër Ismail Qemalit, ku nga ajo çfarë shkruhet, kuptojmë që Dervishi ndodhej në Tiranë dhe i jepte vetes sipas tij "cilësinë e një kryetari", por nuk jep shpjegime konkrete se çfarë ai drejton. Duket qartazi që letra është mbushur me mllef kur ai shkruan për Dervishin se: *"me ato fjalët e tij të zakonshme që nuk lidhen me njëra tjetrën, po gabon dhe po intrigon naivët në Tiranë"*³⁹⁶. Megjithatë, duket që sipas Aqif Pashës, Dervishi vepronte në fshehtësi, gjë që e kuptojmë përmes fjalëve: *"Ky njeri në një anë shpërndan letra dhe lajme verbale nëpër fshatra kundra qeverisë së sotme dhe përpiqet të gabojë e të intrigojë njerëzit injorantë, në anën tjetër shtyhet sikur është në favor të qeverisë"*³⁹⁷. Aqif Pasha vazhdon me akuza të rënda ku sipas tij Dervishi, bashkëpunonte me *"intrigantë, kriminelë, hajdutë"*. Duke e mbyllur letrën, ai kërkonte të merreshin masa të menjëhershme për t'i dhënë fund kësaj situatë. Letra në fund mbyllet me fjalët: *"Urdhër"*³⁹⁸. Faktikisht, nuk jemi të sigurtë se cilat ishin rrethanat që e shtynë Dervishin, në këtë kohë në ndryshimin e qëndrimit të tij politik, kundër Qeverisë së Vlorës. Nuk përjashtojmë faktin se, qëndrimi i Dervishit mund të jetë edhe ai i një njeriu pragmatist, duke marrë shkas dhe për të përfituar nga konjunkturat politike të kohës. Për më tepër mendojmë se Dervishi mund të ketë shpresuar më shumë nga Kuvendi i Vlorës dhe Qeveria e dalë prej tij. Nga ana tjetër, duhet të theksojmë faktin se kushëriri dhe rivali i tij i vjetër Aqif Pasha, kishte mbështetjen e plotë të Ismail Qemalit, gjë që mund ta ketë çënuar apo lënduar Dervishin.

Ndërkaq, situata për Aqif Pashën nuk ishte aspak e sigurtë po të kemi parasysh që Ismail Qemali në këtë periudhë nuk ndodhej në Shqipëri. Ai gjithmonë e më shumë po përpiqej të siguronte njohje ndërkombëtare nga Fuqitë e Mëdha. Në fakt nga ana e Vjenës dhe Romës iu dha një farë shpresë e cila asnjëherë nuk u finalizua me njohje zyrtare, sepse

³⁹⁵ Akademia e Studimeve Albanologjike, *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Tiranë: Kristalina KH 2017, f. 270.

³⁹⁶ Po aty, f. 156.

³⁹⁷ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë : Toena 2007, f.156.

³⁹⁸ Po aty, f .156.

këto nuk mund të merrnin vendime që binin në kundërshtim me interesat e Fuqive të tjera të Mëdha³⁹⁹.

Më 15 korrik 1913 Ministri i Brendshëm Mufid Libohova, i kërkonte prefektit Aqif Pasha lirimin nga detyra të Kadri bej Peqinit, një pinjoll i familjes së famshme të Bonatëve në Peqin dhe njëkohësisht edhe mbështetës i Esat Pashës. Sipas tij, ai e kishte marrë detyrën e nënprefektit të Peqinit me të padrejtë si dhe ishte duke kryer akte të paligjshme dhe duke dëbuar nënprefektin e caktuar nga Qeveria e Vlorës. Ai i kërkonte Aqif Pashës në cilësinë e prefektit të Elbasanit, nëse ishte nevojshme që të shkonte vetë në Peqin për të mënjanuar çdo vështirësi. Aqifi do ta kishte shumë të vështirë të shkonte vetë në Peqin: "*Po të shihet nevoja urdhëroni vetë personalisht deri në Peqin*", gjë kjo e pamundur po të kemi parasysh që i ati i Kadriut ishte njeri me shumë fuqi jo vetëm në Peqin, por edhe në Shqipërinë e Mesme⁴⁰⁰. Nga ana tjetër nuk duhet harruar edhe një fakt që në Peqin, praktikisht kishte ndikim të madh Dervish Biçakçiu.

Me vendimin e 29 korrikut të 1913-ës, Fuqitë e Mëdha vendosën ta njohin: "*Shqipërinë principatë autonome, sovranë nën garancinë e Gjashtë Fuqive. Princi do të caktohej nga të Gjashtë Fuqitë*"⁴⁰¹. Po të kihet parasysh situata ndërkombëtare, mund të shpjegojmë edhe ndryshimin e qëndrimit të tij ndaj Qeverisë së Vlorës. Fakt është që gazeta zyrtare e Qeverisë së Vlorës, i mirëpriti vendimet e Fuqive të Mëdha duke i bërë jehonë: "*Këto lajme gazmore, duhet ti shohim si një pikë gëzimi në mes hidhërimit që ndjen zemra e çdo shqiptari për Kosovën, Dibërën dhe Çamërin*"⁴⁰². Njohja e Pavarësisë së Shqipërisë nga ana e Fuqive të Mëdha ishte një ngjarje e rëndësishme, po të kemi parasysh që ende trupat e shteteve fqinjë ndodheshin në territorin shqiptar. Por në vendimet që u morën ata nuk e njohën Qeverinë e Vlorës, si të vetmen qeveri shqiptare, fakt ky që i forconte pozitat e Esat Pashës i cili tashmë kishte dalë hapur kundër saj dhe kishte siguruar edhe mbështetjen e shumë figurave në Shqipërinë e Mesme ndërmjet të cilëve edhe Dervish Biçakçiu. Esati e kuptonte fare mirë që të godiste përfundimisht ndikimin e Qeverisë së Vlorës në Shqipërinë e Mesme duhet të ushtronte trysni mbi Aqif Pashën, i cili e mbështeste fort atë nga Elbasani. Faktet tregojnë që në mbështetje të Esatit do të jetë Dervishi dhe vëllëzërit e tij. Duke përkrahur Esatin, ai mendonte të realizonte ndoshta ëndrrën e vjetër të shkatërrimit të rivalit

³⁹⁹ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë; Toena 2007, f. 28.

⁴⁰⁰ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë :8 Nentori, 1962, f. 159.

⁴⁰¹ Po aty, f 60.

⁴⁰² Po aty, f 63.

të vjetër të tij, Aqif Pashës.

Esad Pasha, pasi kthehet nga Vjena, më 1 gusht të 1913-ës, shkon vetëm 2 ditë në Vlorë ku i parashtron qeverisë një program reformash administrative, të cilat ishin hartuar nga një grup me në krye Faik Konicën⁴⁰³. Ky program nuk u pranua nga Ismail Qemali. Në fakt Esati do të ketë mbështetjen e shumë prej figurave me peshë midis shqiptarëve dhe në listën e gjatë të personaliteteve që do jenë kundër Ismail Qemalit do rreshtoheshin: Faik Konica, Syrja dhe Eqerem Vlora, Dervish Hima, Dervish Biçakçiu të gjithë rrethin e madh të Toptanëve: "të gjithë bejlerët toptanas, të cilët i kundërviheshin kushëririt të tyre si një kandidaturë për fronin e Shqipërisë, ishin bashkuar plotësisht me të, pasi qënë të pakënaqur me Qeverinë e Vlorës"⁴⁰⁴. Ndërkohë më 9 gusht të 1913-ës, qeveria Angleze njoftonte Ismail Qemalin nëpërmjet H. Carlh Vud, se ata nuk mund ta pranojnë atë si përfaqësues të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër me justifikimin se: "*Në mungesën e një administrate të krijuar rregullisht në Shqipëri, çështja e një përfaqësonjësi të Shqipërisë në Londër duket e parakohshme.*"⁴⁰⁵ Kjo ishte një tjetër goditje për pozitën e Qeverisë së Vlorës, ndërkohë që Esati as nuk po e ushtronte pozitën e tij si Ministër i Brendshëm. Kështu ai dhe mbështetësit e tij dukej që nuk ia falnin Ismail Qemalit faktin që ai nuk po zbatonte programin ku sipas të cilit, duhet t'i pajiste ato me tapi për tokat që kishin.⁴⁰⁶

Më 18 gusht të 1913-ës në vazhden e situatës tepër të acaruar midis Qeverisë së Vlorës dhe Esat Pashë Toptanit, kemi sërish një raportim të Aqif Pashës për të ku ai ndjehet i kërcënuar pikërisht nga forca e Esatit. Sipas tij Esati e kishte kërcënuar për shkarkim nga detyra: "*Esat pasha me qëllim që të hakmerret kundër meje, në mënyrë dhelparake paska pasur mend të provokojë marrjen e një vendimi për ndërrimin e nënpunësve, bile kishte thënë nëse Kadri Beu hiqet nga Peqini edhe Aqif Pasha duhet të hiqet nga Elbasani.*" Ai aludon se në rast se ndodh kjo: "*populli do të shkoj pas atij prefekti që do të vijë këtu, i cili, natyrisht do të jetë partizan i Esat Pashës*"⁴⁰⁷. Aqif Pasha duke njohur mirë nga afër si Esatin, por edhe rivalin e tij Dervishin, shpreh ngurrim për situatën e krijuar ndaj ai i kërkonte hapur Ismail Qemalit largimin nga detyra e prefektit. Shqetësimi kryesor i tij me sa kuptohet edhe nga mesazhet e shumta midis njëri-tjetrit, ishte veprimtaria e Dervish

⁴⁰³ ASA, *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Tiranë, Kristalina KH 2017, f. 271.

⁴⁰⁴ Po aty, f. 71.

⁴⁰⁵ Po aty, f. 62.

⁴⁰⁶ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë, Toena 2007, f. 47.

⁴⁰⁷ Po aty, f.164.

Biçakçiut që sa vinte e rritej në zonën Elbasan-Peqin –Durrës.

Nga të dhënat e siguruara, dëshmohej se Ismail Qemali nuk ka qëndruar indiferent ndaj kërkesave të Aqif Pashës, jo vetëm për të qenë në krah të tij por edhe për të luftuar kundërshtarët e tij politik. Kështu, ai merr disa vendime për të rikompozuar Qeverinë e Vlorës, të cilat nuk bënë gjë tjetër veçse acaruan situatën midis tij dhe kundërshtarëve të tij dhe do përshpejtojnë dorëheqjen e tij. Ai urdhëroi zëvendësimin e ministrit të Bujqësisë Abdi bej Toptani me Hasan Prishtinën, zëvendësimin e mytesarifit të Beratit dhe largimin e kajmekanit të Peqinit. Kështu dihet shumë mirë që kajmekani i Peqinit ishte një nga njerëzit më besnikë Dervish bej Biçakçiut. Këto veprime të Ismail Qemalit do të iniciojnë një reagim të fortë të Dervish Biçakçiut ndaj qeverisë. Këto ngjarje të shtatorit 1913 dhe shumë akuza të tjera ndaj qeverisë së Vlorës e kanë vënë atë plotësisht në rradhë të kundërshtarëve më të mëdhenj të saj .

Cilat ishin disa nga akuzat që artikulohehin ndaj Qeverisë së Vlorës:

- ✓ Shpenzimet e tepërta të qeverisë për administratën dhe pagat,
- ✓ Emërimet e nënpunësve në vende të panevojshme,
- ✓ Për shitjen e parregullt të të dhjetave,
- ✓ Për dhënien e koncensionëve të huajve,
- ✓ Për mos përdorimin e gjuhës shqipe në administratën shtetërore,
- ✓ Idea për ngritjen e një sistemi kantonal në Shqipëri,
- ✓ Nepotizmin e egzagjeruar në administratë .⁴⁰⁸

Më shtator 1913 prefekti i Elbasanit i drejtohet qeverisë së Vlorës ku e vë në dijeni për veprimtarinë e Dervish Biçakçiut: *"Në mitingjet që u mbajtën në Kavajë dhe në Peqin është ndodhur Dervish Beu nga Elbasani dhe mitingjet i ka organizuar ai vetë. Ky njeri po i shtyn e i mashtron fanatikët që ndodhen në ato vende"*⁴⁰⁹. Thelbi i këtyre protestave siç dihet, ishte të krijohet një qeveri e re në Durrës ku të bënin pjesë edhe Esat Pasha edhe Ismail Qemali gjë e cila kuptohej që do të refuzohet nga Qeveria e Vlorës.⁴¹⁰ Kundërpërgjigja e Esatit dhe mbështetësve të tij do të ishte thirrja e një kuvendi në Durrës. Njëkohësisht kundërshtarët e Aqifit nuk do të qëndrojnë duarkryq, por do të veprojnë në mënyrë që të shpëpusin plotësisht kontaktet midis tij dhe Qeverisë së Vlorës. Më 12 shtator 1913, Aqifi

⁴⁰⁸ ASA, *Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Tiranë, Kristalina KH 2017, f271.

⁴⁰⁹ Po aty ,f.177.

⁴¹⁰ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë ,Toena 2007,f49.

raportonte sërish Qeverinë e Vlorës se: *"jemi lajmëruar me telegram nga nënprefekti Kadri i Peqinit për shkëputjen nga Elbasani dhe u lidh me Durrsin, gjithashtu ai njofton për bllokimin e rrugës Elbasan-Peqin, në një distancë tre orë nga Elbasan, nga vëllezërit Dervish bej, Hasan bej dhe Qamil bej. Kjo do të thoshte që udha Elbasan-Durrës ishte e mbyllur, dhe sipas gjasave punët do të shkonin edhe më keq.*⁴¹¹ Po në 12 shtator 1913 ish-inspektori i policisë, Teofik Rugo, njoftonte se *"Dervish beu dhe Hasan beu kishin shkuar në një mbledhje në Tiranë, ku kishin marrë pjesë 100 krerë nga malësi të ndryshme".*⁴¹² Siç dihet gjatë muajit shtator Esat Pashë Toptani po bënte të gjitha përpjekjet për të formësuar qeverinë e re paralele me atë të Ismail Qemalit në Shqipërinë e Mesme ndoshta për t'i treguar këtij të fundit që ai ende ishte "gjenerali" si dhe për t'i bërë të qartë atij që nuk kishte kompromis.

Në kundërpërgjigje të kësaj letre si dhe për të treguar forcën e qeverisë më 13 shtator 1913, Ismail Qemali i drejtonte një letër prefekturës së Elbasanit, ku kërkonte mendime për masat që duheshin marrë kundër njerëzve që kishin bllokuar komunikimin në rrugën Elbasan-Durrës, si dhe shkruante se: *"T'i tregohet vendi Kadri beut që guxon dhe kërkon të veprojë në emër të qeverisë me gjithë Hasan beun e Qamil beun."*⁴¹³ Po të gjykojmë nisur nga fjalët e Ismail Qemalit të krijohet përshtypja sikur situata ishte nën kontrollin qeveritar, por faktet tregojnë që nga java në javë dhe madje nga dita në ditë qeveria e tij po humbte kontrollin dhe ishte e paaftë të siguronte rendin dhe qetësinë madje dhe besimin aq shumë të dëshiruar në radhët e popullsisë.

Një letër që mban datën 14 shtator 1914 e kryetarit të Bashkisë së Tiranës Zyber Haki, të lë të kuptosh disa arsye se përse Qeveria e Vlorës nuk mund ta vazhdonte veprimtarinë e saj. Sipas tij duhej: *"të mbledhej Kuvendi i Përgjithshëm Kombëtar, të merreshin masat për të shëruar plagët që ishin hapur në atdhen fati, të ftohej një mbret që të shkulte nga rrënjët grindjet e ambicjet, dhe të kerkohej votëbesimi nga Kuvendi i Përgjithshëm"*⁴¹⁴. Në letër ai aukozonte Ismail Qemalin se e i vetmi qëllim ishte të forconte lirinë e vet brenda qeverisë. Kështu fakti që qeveria ishte ende në Vlorë kishte shkaktuar një paqëndrueshmëri të influencës së saj. Si zgjidhje për qendrën e qeverisë propozohej Durrësi në mënyrë për të lehtësuar kështu nevojat e malësive. Dyshohej gjithashtu se ishin dhënë koncensione të

⁴¹¹ Po aty, f.178.

⁴¹² Po aty, f.179.

⁴¹³ Po aty, f.181.

⁴¹⁴ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë :8 Nentori, 1962, f. 184.

dyshimta nga ana e qeverisë që duheshin patjetër të hetoheshin.⁴¹⁵

Më 15 shtator 1913, Ismail Qemali kërkonte hollësira për fuqinë që duhej të përgatitej që të mundeshin të marshonin në dy drejtime kundër Esatit, njëri drejtim nga Peqini dhe tjetri nga Tirana.⁴¹⁶ Siç edhe mund të kuptohet Ismail Qemali kurrë nuk e nënvlerësoi karakterin, aftësinë dhe dinakërinë e gjeneralit. Ajo që mund t'i siguronte atij qetësi ishte eliminimi me çdo kusht qoftë edhe me sakrifica të mëdha për të mposhtur ndikimin e tij në Shqipërinë e Mesme. Më 16 shtator 1913 Ismail Qemali kërkonte marrjen e masave kundër Esatit ku i kërkohet posaçërisht përgatitja e një batalioni i cili të kishte rreth 400-500 vetë. I kërkohet të përgatiten njerëz me armë dhe për këtë kërkohet: *"mbi këtë pikë jeni të autorizuar të bëni çdo lloj sakrifice dhe çdo shpenzim... Esat Pasha nuk i është treguar asgjë mbi çkemi koresponduar në mes tonë..."*⁴¹⁷ Gjithsesi Ismail Qemali e kishte të qartë se deri ku shkonte fuqia dhe ambicia e Esatit për të realizuar qëllimet e tij. Këshilla ishte të mos besonin asnjë fjalë të Esat Pashës, pasi ai "i trembej" ndoshta reagimit të tij.

Në shtator 1913-ës, Esati i shkruante kushëririt të tij Aqif Pashës se: "qëllimi i vetëm i tij është ti shërbej atdheut".⁴¹⁸ Sërish ai akuzonte Ismail Qemalin se qëllimi i tij ishte përfitimi personal dhe se ai për këtë, i kishte bërë koncensione të huajve duke vijuar: *"... ai ju gabon duke ju premtuar se Elbasani do të bëhet kryeqytet dhe se këtë nuk e kishte në dorë asnjëri dhe se kryeqytetin e përcakton Europa."* Esati i kujton Aqifit se duke i shërbyer Ismail Qemalit i thyen zemrën dhe shprehet me një gjuhë tepër të zgjedhur: *"më thyeni zemrën dhe më plagosni shpirtin."*⁴¹⁹ Shprehja e përdorur nga Esat Pasha ishte një tërheqje vëmendje për Aqif Pashën, i cili ishte ndër personalitet që duke qenë në krye të prefekturës së Elbasanit, krijonte idenë që Qeveria e Vlorës kishte pushtet edhe në Shqipërinë e Mesme. Në 18 shtator të 1913-ës, Aqif Pasha njoftonte Ismailin për vështirësitë që po hasin në gjetjen e njerëzve nën armë dhe për më shumë kërkonte ndihmë për oficerë⁴²⁰.

Gazeta "Përlindja e Shqipëniës" edhe njëherë përmes fjalëve të Rauf Ficos, vë në dukje qëllimet e Esat Pashës i cili kërkonte:

1. Të organizohej një mbledhje kombëtare;

⁴¹⁵ Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Tiranë :8 Nentori, 1962, f. 184.

⁴¹⁶ Po aty, f. 185.

⁴¹⁷ Po aty, f. 187

⁴¹⁸ Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 197.

⁴¹⁹ Po aty, f. 198.

⁴²⁰ Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 189.

2. Esati dhe Ismail Qemali të zgjedhin një kabinet të ri;
3. Ministrat të shkojnë në Durrës.⁴²¹

Më 1 tetor të 1913-ës Ismail Qemali informonte se, forcat antiqeveritare më në krye të njohurin Dervish beu dhe Bektash Agai nga Cakrani, një person ky me shumë influencë në zonën e Fierit, janë vendosur në krah të Shkumbinit, për të pushtuar Peqinin. Ai shprehte bindjen: *“se nuk duhet të ketë mundësi për këtë guxim të çmendur dhe kriminal”*.⁴²² Por, ndërkohë Qeverisë së Vlorës i kishin dalë kundër edhe vëllezërit Toptani, të cilët mbështesnin Esat Pashën, duke organizuar grupe të armatosura në Shëngjergj për t'i dërguar kundër Elbasanit. Për këtë problem Aqif Pasha shkruante: *“në fjalët e mia do ta ketë kuptuar Abdi beu se unë s'jam i gënjem e s'ka as një njeri këtu që të gënjehet sikur të vijnë të gjithë Toptanët, veç shtëpisë se Dervish beut.”* Kuptohej që Aqif Pasha do t'i mbetej besnik Qeverisë së Vlorës, por nga ana tjetër duket qartë që mbështetësit e Dervish Biçakçiut kishin fituar terren në nënprefekturën e Peqinit, duke arritur ta shkëpusnin nga administrata e Elbasanit. Kështu që nga data 12 shtator 1913, nën administrimin e Durrësit ishte përfshirë edhe Peqini. Format e mosbindjes ndaj prefekturës së Elbasanit dukeshin qartë në problemet që do të shkaktoheshin si pasojë e bllokimit të rrugës nga Elbasani në Durrës dhe anasjelltas. Udhëtarët mund të kalonin rrugën vetëm me një leje të posaçme të vëllezërve të Dervish bej Biçakçiut, Hasan beut dhe Qamil beut⁴²³. Në këtë kuadër theksojmë se tashmë vëllezërit Biçakçinj, po ushtronin një veprimtari të hapur për të shkëputur sa më shumë zona të prefekturës së Elbasanit dhe më gjerë nga ndikimi i Qeverisë së Vlorës.

Më 4 tetor të 1913-ës Esat Pasha i drejtonte një telegram prefekturës së Elbasanit, ku e njoftonte për sigurinë e marrë nga konsujt e Austro-Hungarisë dhe Italisë, që trupat serbe nuk do ta kalonin kufirin shqiptar duke i kërkuar që: *“të njoftonte aty ku duhet”*⁴²⁴. Në përgjigje të këtij telegrami, Ismail Qemali kërkonte që t'i dërgohej një telegram komadantit serb, të shprehur me gjuhë miqësore, por dhe të prerë se: *“Qeveria jonë marrëdhëniet e mëparshme me Serbinë nuk i ka ndryshuar dhe se prandaj as Serbia nuk ka arsye që të prishë këto marrëdhënie”*. Në situatën në të cilën ndodhej Qeveria e Vlorës, ku nuk kishte asnjë autoritet në territoret verilindore të Shqipërisë, një konflikt i ri i hapur me Serbinë nuk do të bënte gjë tjetër vetëm se do të përshpejtonte rënien e qeverisë.

⁴²¹ Po aty, f. 193.

⁴²² Po aty, f. 213.

⁴²³ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 178.

⁴²⁴ Po aty, f. 220.

Në situatën e krijuar faktet tregojnë qartë lidhjet që ekzistonin midis Dervishit dhe Esat Pashës. Më 6 tetor 1913 Dervish Biçakçiu njoftonte Esatin për forca të shumta që kishte grumbulluar dhe që i kalonin të 1000 vetat. Në telegram ai e quan Ismail Qemalin njeri të "molepsur" që sipas tij ka mbështetjen e prefekturës së Elbasanit e cila i shërben "qëllimit të tij djallëzor". Në fakt ndjehet shqetësimi në shkresën e tij kur ai shkruan, se kemi forca të pakta dhe për këtë arsye mund edhe të "na zhdukë të gjithëve". Ndërkaq, në fund të telegramit ai shprehej se nuk kishte frikë por kërkonte të ruante *dinjitetin e një komandanti të lartë siç është shkëlqësia juaj*. Në 6 tetor Aqif Pasha njoftonte Qeverinë e Vlorës se vëllezërit Dervish Beu, Hasan dhe Qamili kishin krijuar çeta të vogla prej 7-8 veta dhe kishin shkaktuar ndërprerjen e qarkullimit në rrugën Elbasan-Durrës me qëllim për të prishur qetësinë. Në telegram bëhej fjalë edhe për plaçkitje dhe vrasje. Gjithashtu akuzohej Qamil beu se në Sulovë kishte prerë vijën telegrafike Vlorë-Elbasan. Faktikisht, Aqifi e përshkruante situatën shumë të acaruar aq sa Hasani kish marrë familjen dhe e kish dërguar në Peqin. Ndërsa një ditë më parë në 5 tetor ata kishin bastisur edhe çifligun e Aqif Pashës në Cërrik dhe sipas tij i kishin vjedhur bagëtisë.⁴²⁵ Në situatën kaotike në të cilën po kalonte vendi veprime të tilla ishin më së normale. Këto akuza të Aqif Pashës për vjedhje asnjëherë nuk u pranuan nga ana Dervish Biçakçiu.

Dervish Biçakçiu, në letrën dërguar në 7 tetor 1913 Esatit, theksonte influencën në rritje të njerëzve të Ismail Qemalit të cilët duket se kërcënojnë forcat e tyre. "Duket që situata është shumë kaotike" shkruante ai, "dhe se qyteti duket që është ndarë midis mbështetësve të dy palëve". Ai vijonte duke akuzuar Aqifin për organizim protestash të popullit kundër tyre, gjithashtu duke sqaruar se i vëllai kishte përgatitur forca në Sulovë që prisnin vetëm urdhrin e tij⁴²⁶. Në një telegram po të kësaj date, Esati i konfirmonte Aqifit edhe njëherë detyrën për mbrojtjen e atdheut dhe se mbrojtja në rast se sulmohemi nga serbët do të kryhet me sakrifica të mëdha.⁴²⁷ Nga ana tjetër, në një letër të Lef Nosit drejtuar Qeverisë së Vlorës, shpjegohej se Dervish beu kishte qënë duke shkruar në Durrës për një mbledhje me Esat Pashën, ku mendohet që do të krijojë një qeveri të re në Tiranë dhe në të do të merrnin pjesë ato që do ai. Kjo letër që i kishte rënë në dorë kajmekanit të Durrësit e shkruar në greqisht i dërgohej nga dhespoti i Durrësit, dhespotit të Beratit. Kjo letër tregon qartë që politika greke që menaxhonte kishat ortodokse ishte shumë e vëmendëshme ndaj ngjarjeve që po ndodhnin në

⁴²⁵ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f.311.

⁴²⁶ Po aty, f. 222.

⁴²⁷ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 225.

Shqipëri.⁴²⁸Kuptohet që Esati duke forcuar shumë shpejt pozitat e tij në Shqipërinë e Mesme, mendonte si prioritet të godiste përfundimisht autoritetin e Ismail Qemalit. Në 8 tetor 1913 në Elbasan organizohet një miting i madh i popullit të Elbasanit i cili proteston kundër vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër që copëtojnë territorin shqiptar duke i marrë padrejtësisht krahinën e Çamërisë që ishte thjesht shqiptare, prandaj kërkohet të rishikohen këto vendime.⁴²⁹ Në këtë situatë, kur koha ishte kundër Ismail Qemalit, Esat Pasha bëhet iniciuesi i vërtetë i mbajtjes së asaj që në histori quhet “Pleqësia e Shqipërisë së Mesme. Më 12 Tetor 1913 ai merr atributet e kryetarit të qeverisë me funksione administrative deri në mbërritjen e princit. Kuptohet që ai dëshironte të legjitimonte pushtetin e tij. Sipas një programi të hartuar nga Faik Konica, qeveria do të kishte prioritet, kontaktet me Fuqitë e Mëdha për zgjedhjen e princit, administronte me kujdes, fondet publike, nuk do të lejonte asnjë koncesion⁴³⁰. Qëllimi i Esat Pashës ishte largimi i Ismail Qemalit, prandaj ai ishte shtytësi kryesor i organizimit të ngritjes së "oazeve"⁴³¹ kundër Qeverisë së Vlorës si në Fier të kryesuar nga Enver Pashë Vrioni dhe në zonën e Mallakastrës të kryesuar nga Bektash Cakrani etj.

Në datën 17 tetor, evidentohen përsëri divergjencat midis Ismail Qemalit dhe Esat Pashës për çështjen e përfaqësuesit shqiptar pranë Komisionit të Kontrollit të Fuqive të Mëdha duke shfaqur dyshime ndaj personit të Mufid Beut. Ky raportim bëhet nga konsulli Laihanec i Austro-Hungarisë.⁴³² Dukej fare qartë që situata politike për Ismail Qemalin nuk ishte aspak e favorshme; madje situata do të ishte shumë kaotike në Elbasan. Duke qenë nën ndikimin e kundërshtarëve të Aqif Pashës, një pjesë e mirë e popullsisë po e shikonte me skepticizëm Qeverinë e Vlorës madje ishte rritur shumë mosbesimi. Kuptohet që duke qenë në mesin e kësaj situate, Aqifi duke pasur edhe kontakt me njerëz që ishin afër edhe me palën tjetër kerkon të qetësoje "gjakrat" dhe të bindë Ismail Qemalin të ulet në bisedime me Esat Pashën.

Më 14 nëntor 1913, Aqif Pasha i dërgonte një letër Ismail Qemalit ku i bën një përshkrim të situatës në të cilën ndodhej qyteti dhe ku njerëzit ishin të ndarë midis tij dhe Esatit. Nga shkak i rivalitetit, një pjesë e personave të shquar kishin marrë anën kundërshtare disa haptas dhe disa shpirtërisht.

⁴²⁸Po aty, f. 227.

⁴²⁹Po aty, f. 226.

⁴³⁰*Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Tiranë: Kriatalina KH 2017, f. 273.

⁴³¹ Po aty, f. 273.

⁴³²*Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 230.

Aqif Pasha i kërkonte, që në mënyrë që të mos acarohet më tej situata dhe që të mos bëheshin objekt turpi, të pranojnë ndërmjetësimin nga një person i paanshëm. Ai propozonte transferimin e Qeverisë brenda 10 ditëve në Elbasan, ku Ismaili të mbante sërish postin e kryetarit të qeverisë dhe ku Esatit ti jepej posti i Ministrit të luftës. Ai e sqaronte Ismail Qemalin për faktin se në rast të kundërt Aqif Pasha ishte i detyruar të jepte dorëheqjen.⁴³³Duket që të gjitha lëvizjet që kishte realizuar Esati si dhe bllokimi që ai i kishte bërë Elbasanit nëpërmjet mbështetësve të tij, e kishin bërë që të reflektonte Aqif Pashën i cili tashmë e ndjente jo të largët ditën kur ai dhe Ismail Qemali duhet të largoheshin nga Pushteti.

Në 22 nëntor 1913 Myfid Libohova nga ana tjetër i shkruante Aqif Pashës duke e vënë në dijeni të një situatë aspak të këndshme ku mbizotërojnë ngatarresa, mosmarrëveshje dhe përçarje në çdo anë të Shqipërisë duke i lënë të nënkuptojë vetë fundin e kësaj situatë. Ai kërkonte Aqifit të bëhej organozator i një mbledhje, ku të bënte bashkë Ismail Qemalin dhe Esatin në mënyrë që shkohej drejt përmisimit të situatës dhe ti hapej rrugë ardhjes së Princit.⁴³⁴

Ndërkohë, Ahmet Dakli i cili kishte dhënë njoftime disa herë kundër Dervishit dhe në mbështetje të Ismail Qemalit dhe Aqif Pashës, çuditërisht jep dorëheqjen nga qeveria e Vlorës. Jo sepse ajo nuk përkrahej nga ana e ndërkombëtarëve, por ai formulonte akuza të cilat i ishin bërë që në muajt e parë Ismail Qemalit nga kundërshtarët e tij politikë, se *“qeveria po harxhonte më shumë sesa ishin mundësitë e saj financiare dhe se vërejtjet e tij për shkurtimin e shpenzimeve nuk po pranoheshin.”* si dhe *“Ahmet ef.Dakli sekretar i Ministrisë së Financave, u hoq nga puna nga shkaku se pa që Ismail Qemali dhe Cakua donin t’i bënin rrush e kumbulla të mjerat financa të të varfrës në Shqipëri.”*⁴³⁵. Largimi i Ahmet Dakit ishte një goditje për qeverinë e Vlorës, duke ditur që ai kishte qenë një nga mbështetësit kryesorë të Aqif Pashë Biçakçiut. Akuzat që ai ngrinte përfundimisht vërtetoheshin edhe një herë që Dervish Biçakçiu ndoshta kishte kuptuar më herët që fati i qeverisë së Vlorës ishte i paracaktuar dhe i destinuar drejt dështimit. Në këtë kontekst janë bërë përpjekje për të realizuar bisedime midis Esatit dhe Ismail Qemalit, ku Myfit Libohova kishte kërkuar të luante rolin e ndërmjetësit por pa sukses.

⁴³³Po aty, f. 248.

⁴³⁴Po aty, f. 254.

⁴³⁵Hilmi Dakli, *“Ahmet Dakli,”* Tiranë: Onufri, 2017, f. 47.

Në këtë kohë, një nga problemet që kërkonte zgjidhje të menjëherëshme ishte marrja në dorëzim e Korçës që ishte e pushtuar nga grekët dhe që pritej të lirohej. Si Komisar të jashtëzakonshëm në Korçë Ismail Qemali kishte emëruar Aqif Pashën duke u shprehur se: "...Nuk më erdhi ndër ndër mend tjetër person veç Shkëlqesës Suaj që ta kryente këtë detyrë patriotike, duke mbajtur mbi vete gjithënjë edhe detyrën e prefektit të Elbasanit"⁴³⁶. Situata paraqitej shumë e vështirë në territoret jug-lindore për shkak edhe të krijimit të çetave terroriste greke, që kishin dhunuar dhe kishin krijuar anarshi në këto territore. Duke patur parasysh që një minus i madh për pozitën e Aqif Pashës ishte dhe opozita që po i bënin forcat e Esat Pashë Toptanit. Më 30 dhjetor 1913, raportohet për rikompozim të Qeverisë së Vlorës, ku ishte larguar ministri Mehmet Pashë Dëralla, dhe në postin e ministrit të brendshëm evidentohet emri e Fejzi bej Alizoti dhe Qemal bej Karaosmani në postin e ministrit të bujqësisë. Ndërsa si "zëvendëspresidentit të Qeverisë Provizore" ishte emëruar Preng Bibë Doda, veprim ky ndoshta për të siguruar përkrahje në Shqipërinë e veriut.⁴³⁷

Ndërkaq, ngjarjet po precipitonin me shpejtësi dhe situata në fillim të janari 1914 nuk ishte aspak në favor të qeverisë së Vlorës. Aqif Pasha raportonte në këtë kohë, mbi të ashtëquajturit "rebelë" "të cilët me sulmet po ngushtonin qarkun dhe po realizonin pushtimin e territoreve që rrethonin Elbasanin. Masat që do të merreshin ai i konsideronte të pafuqishme në krahasim me furinë e sulmeve të "rebelëve" ku nga drejtimi i Tiranës ishte një force 7000-8000veta dhe nga Peqini ishte duke ardhur Dervish bej Elbasani. Aqif Pasha i kërkonte Vlorës ose ndërmarrjen e masave diplomatike ose përdorimin e forcës, por që do të ishte populli ai që do të vuante pasojat"⁴³⁸. Në vijim ai raportonte për një situatë shumë të vështirë dhe ku forcat e Dervishit ishin në Dumre vetëm 3 orë larg Elbasanit.⁴³⁹ Sipas informacioneve që, situata ishte shumë e vështirë edhe për faktin që forcat e xhandarëve të dërguara kundër "rebelëve" nuk pranonin të luftonin duke u justifikuar me faktin që i ishte thënë që "do luftojmë në Korçë kundër Grekëve dhe jo kundër vëllëzervë tanë". Gjithashtu, Aqifi jepte detaje të të gjitha lëvizjeve të Dervishit duke kërkuar mbrojtje nga ana e qeverisë së Vlorës. Dervishi duke kaluar Shkumbinin i ishte drejtuar Polisit për ti dhënë goditjen një

⁴³⁶ Majlinda Peza, Desertacion për mbrojtjen e grades Doktor i Shkencave, "Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914", f. 213.

⁴³⁷ Vlentina Duka, *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqipëtarët*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2012, f. 39.

⁴³⁸ Po aty, f. 316

⁴³⁹ Vlentina Duka, *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqipëtarët*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2012, f. 316. Aqifi jep detaje lidhur me veprimtarinë e Dervishit që kishte kalura Shkumbinin dhe tentonte të kalonte në drejtim të Polisit si dhe për të vëllain Hasanin I cili ishte kthyer në Elbasan"

reparti qeveritar që vazhdonte të luftonte në afërsi të Mirakës. Elbasani deklaronte ai ka mbetur “pa fuqi”.⁴⁴⁰ Dervishi sipas tij komandonte forcat e xhandarmërisë të ardhura nga Durrësi, Kavaja, Tirana dhe Peqinit dhe i vëllai Qamili komandonte forcat në fshatin Polis i vogël. Sipas asaj që ai shkruan Dervishi Bej na shfaqet si kundërshtar i ardhjes së një princi të krishterë:” *Dervish, në cdo fshat që vete, u tregon fshatarërëve fotografinë e Vidit që është botuar në gazetën shqip që del në Vlorë dhe u thotë:”Qeveria e Elbasanit dhe toskët ja këtë kaur duan të na bëjnë mbret, “derdhin lot me zor duke thënë:”mbaroi myslimanizmi dhe me këto lot ,ndezin dhe nxisin ndjenjat e fshatarëve paditur”*⁴⁴¹. Nga këmbimi i mesazheve midis Ismailit dhe Aqifit lë të kuptohet se Ismaili mendonte që ajo që po ndodhte nën udhëheqjen e Dervishit ishte një demonstratë. Por faktikisht nuk ishte kështu. Aqif Pasha i shpjegonte, se kjo lëvizje po vinte në pikëpyetje të ardhmen e qeverisë. Ai e kishte kuptuar shumë mirë që nuk bëhej fjalë për një demonstratë të thjeshtë por ishte një lëvizje që kishte mbështetjen e KNK: “*Këshilli i Kontrollit ose nuk është kompetent ose nuk do të marrë në dorë këtë punë*”.⁴⁴² Për më tepër që largimi i Ismail Qemalit kërkohej edhe nga ndërkombëtarët. Aqifi nuk e shikon rreziku tek Dervishi as tek Esati por tek indiferenca e Këshillit të Kontrollit, prandaj kërkonte zëvendësimin e tij me një prefekt të huaj, pasi ishte në rrezik.⁴⁴³

Konflikti midis forcave qeveritare dhe opozitës esatiste sa vinte e bëhej më i ashpër. Forcat e këtij të fundit, kishin nisur një sulm të përgjithshëm drejt Elbasanit më 9 janar 1914, duke realizuar ndërprerjen e marrëdhënieve të Elbasanit me zonat lindore.⁴⁴⁴ Kështu, faktet tregojnë që një kolonë ushtarake prej rreth 7000 vetash nga Tirana do t’i drejtohej Çermenikës, kurse Dervish bej Biçakçiu drejtonte forca nga Peqini drejt Elbasanit. Forcat e tij kishin shkaktuar edhe ndërprerjen e komunikimit midis Elbasanit dhe pjesës tjetër Lushnje, Berat.⁴⁴⁵ Siç edhe kuptohet Aqif Pasha për shkak të trysnisë së madhe të forcave të Dervishit, por jo vetëm, e kishte të pamundur të pranonte postin e Komisarit të Jashtëzakonshëm duke e njoftuar Ismail Qemalin për mospranimin. Lëvizja esatiste që synonte marrjen e prefekturës së Elbasanit si qëllim final të saj kishte diskreditimin e Qeverisë së Vlorës. Aq kaotike ishte situata në Elbasan dhe në shumë rajone të tjera të Shqipërisë, sa që studiues dhe diplomatë të huaj të kohës e kanë konsideruar atë të ngjashme

⁴⁴⁰ Valentina Duka, *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqipëtarët*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2012, f. 317.

⁴⁴¹ Po aty, f. 321(KNK ishte Këshilli Ndërkombëtar i kontrollit).

⁴⁴² Po aty, f. 324.

⁴⁴⁴ Valentina Duka, *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqipëtarët*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2012, f. 59.

⁴⁴⁵ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 316-317.

me një luftë civile. Sipas konsullit Britanik Lamb, na vijnë dëshmi ku pohohet se në këtë kohë lëvizja esatiste kishte bërë përpjekje të hapura për ta përmbysur qeverinë me forcë.⁴⁴⁶ Gjithashtu një minus i madh për Qeverinë e Vlorës kishte qenë dhe qëndrimi që kishte mbajtur diplomacia greke duke mbështetur financiarisht Esat Pashë Toptanin.⁴⁴⁷ Duke qenë në një situatë që nuk kishte shpresë, për shkak të goditjeve të njëpasnjëshme nga forca, në 17 janar 1914 Aqif Pasha i shkruante Qeverisë së Vlorës :*"...nesër nga ana e Peqinit edhe Malsitë e Matit dhe të Dibrës kanë për të sulmuar Elbasanin"*⁴⁴⁸. Duhet thënë se Aqif Pashë Biçakçiu ishte nga të paktët politikan që i qëndruan besnik Ismail Qemalit deri në fund duke formatuar kështu një figurë shumë parimore.

Në 22 janar 1914, në rrethana aspak të këndshme Ismail Qemali detyrohet të japë dorëheqjen, siç dihet ai dhe qeveria e tij ishin përfshirë në komplotin e Beqir Grebenes; dorëheqja e Ismail Qemalit u komentua si një akt civil, sepse ai vendosi interesat kombëtare mbi ato personale edhe pse me vonesë. Lufta e Dervish Biçakçiut nuk ndalet në këtë pikë. Ai kërkonte me ngulm largimin e rivalit të tij dhe njëkohësisht kundërshtarit më të madh Aqif Pashë Biçakçiu. Gjykojmë që përtej interesave politike, kjo këmbëngulje e Dervish bej Biçakçiut lidhej edhe me një rivalitet të vjetër të njohur tashmë midis tyre; qëndrimi kundërshtues duhet të shihet edhe në frymën e kohës në të cilën ata të dy jetuan.

Më 7 mars 1914 mbërrin në Durrës princ Vidi që ishte caktuar monarku i shqiptarëve nga Fuqitë e Mëdha. Ai qëndroi në Shqipëri deri në 2 shtatot 1914 dhe u largua prej saj si rrjedhojë e një sërë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Në realitetin e krijuar shqiptar të asaj kohe, Vidi që nuk kishte përvojë të dukshme në fushën e politikës, do ta kishte shumë të vështirë të bënte një mrekulli siç edhe shprehej Edit Durham.⁴⁴⁹ Vidi me gjithë përpjekjet që do të bënte për të vendosur shtetin ligjor dhe t'i bënte bashkë ata, do të haste shumë vështirësi, kështu ai do të përballlet me lëvizjen "Vorio-epirote" në jug të Shqipërisë, kryengritjen antiserbe në Kosovë që do të shkaktonte ndikimin e saj edhe në Shqipëri si dhe kryengritjen e Shqipërisë së Mesme të udhëhequr nga Haxhi Qamili që në fakt në mënyrë jo të hapur u mbështet nga faktorë të jashtëm e të brendshëm që ishin kundër Vidit.⁴⁵⁰ Programi i kryengritësve ishte:

⁴⁴⁶ Valentina Duka, *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqipëtarët*, Vëllimi II, Tiranë: Toena 2012, f. 66.

⁴⁴⁷ Po aty, f. 67.

⁴⁴⁸ *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 324-325.

⁴⁴⁹ Edit Durham, *20 vjet ngatarrresa ballkanike*, Tiranë: Argeta LMG, 2017, f. 48.

⁴⁵⁰ Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi III, Tiranë: Toena, 2007, f. 65.

- ✓ Përmbysja e Princ Vidit,
- ✓ Bashkimi me Turqinë,
- ✓ Vendosja e një princi turk në Shqipëri dhe
- ✓ Përdorimi i gjuhës turke.⁴⁵¹

Fillimi i kryengritjes së 1914 sipas të dhënave të diplomacisë austro-hungareze u mbështet fuqishëm nga Esat Pashë Toptani: "*pashai ushqe u dhe përkrahu kryengritjen*"⁴⁵² Ky qëndrim i Esat Pashës lidhet me qëllimin e tij për të eliminuar Princ Vidin. Duke realizuar këtë, Pashai ndoshta mendonte që do ta kishte më të lehtë rrugën për të marrë pushtetin. Diplomacia austro-hungareze ngre dyshime të mëdha mbi mbështetjen që po i jepej atij nga qeveria italiane e cila ishte pro idesë për t'u mbështetur tek elementi mysliman.⁴⁵³ Kjo zgjedhje e qeverisë italiane ishte për faktin se myslimanët përbënin pjesën më të madhe të popullsisë. Nga gjithë ngjarjet që do të rrjedhin, të habit fakti që Dervish Biçakçiu dhe familja e tij do të terrorizohen nga lëvizja e Haxhi Qamilit. Qeveria e Vidit u tregua e paaftë për të njohur realitetin e shoqërisë shqiptare, madje relatohet se ai nuk u tregua i aftë të njihte rrethin e ngushtë të bashkëpunëtorëve të tij: "... Nuk u tregua në lartësinë e situatës. Që ai nuk i zbuloi më parë dallaveret që kishin depërtuar deri në rrethin e tij më të afërt."⁴⁵⁴ Mbi të gjitha, një element jofavorizues për Vidin, ishte edhe kryeministri Turhan Pashë Përmeti, i cili duke qenë në një moshë të thyer nuk kishte energjitë dhe aftësinë për të qenë në dijeni të intrigave që kryheshin.

4.5 Dervish Biçaku dhe përfshirja e tij në jetën politike 1920 - 1940

Pas ngjarjeve të verës 1914, Dervish Biçakçiu u largua në drejtim të Italisë ku mendohet se ka qëndruar deri në verën e 1915-ës. Me shtypjen e kryengritjes së Haxhi Qamilit, ai është kthyer në Shqipëri. Duket që ka ndjekur këshillën e atër Fishtës, "*deri sa të forcohet një qeveri mos me thanë asnjë të keqe*"⁴⁵⁵.

⁴⁵¹ Po aty, f. 65.

⁴⁵² Marenglen Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze 1877-1899*, Tiranë: Klean, 2014, f. 271.

⁴⁵³ Po aty, f. 272.

⁴⁵⁴ Po aty, f. 270.

⁴⁵⁵ AQSH, F. Dervish Biçaku, nr. 69, viti 1915, Dos 6, fl.3.

Sulmet e armatosura të Esad Pashë Toptanit në vitin 1915 kundër kryengritësve të Haxhi Qamilit, bënë të mundur që në fillim të qershorit të këtij viti, forcat e Esad Pashës me ndihmën e trupave serbe të marrin Elbasanin, ndërsa trupat ushtarake serbe pushtuan Tiranën, Shijakun, Kavajën, Peqinin. Në bashkëpunim me serbët, Esat Pashë Toptani krahas forcimit të pozitave të tij, bashkëpunoi ngushtë për organizimin e pushtetit qëndror dhe atij vendor, duke krijuar një administratë të përbërë nga disa drejtori: Drejtoria e Drejtësisë, Drejtoria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Punëve Botore, Drejtoria e Pyjeve e Bujqësisë dhe e Financës⁴⁵⁶.

Në kuadrin e masave që mori administrata e Esad Pashës, si më e rëndësishme për forcimin e pushtetit të tij konsiderohej fillimisht, organizimi i një xhandarmërie të fortë. Ndërkaq, në kuadrin e fuqizimit të pushtetit të pronarëve të mëdhenj, pjesë e të cilit ishte dhe ai vetë, një ndër masat e marra lidhej me sanksionimin e të drejtave të pronarëve të mëdhenj të tokave ndaj bujqëve çifçinj. Kështu, në këtë kohë, një pjesë e pronarëve të mëdhenj të Elbasanit, nisën fushatën për të mbledhur detyrimet e prapambetura që kishin bujqit në pronat e tyre. Në këtë kuadër, ndeshim edhe emrin e pronarit të madh Dervish Biçaku, i cili do t'i drejtohej autoriteteve esatiste të Elbasanit, duke kërkuar shlyerjen e borxhit që prej dy vitesh i kishte një bujk nga fshati Bulkëz. Ky detyrim shkonte afërsisht në 50 kv misër dhe 100 okë (130 kg) oriz, duke kërkuar atë që konsiderohej si *haku i ligjshëm të çifligarit*. Kërkesa e tij u pranua nga autoritete esatiste. Ai u pajis me dokument zyrtar, në bazë të të cilit zbatohet "drejtësia" ku bujku shpallej borxhli të çifligari.⁴⁵⁷ Pranimi nga administrata esatiste e kërkesës së Dervish Biçakut, mendojmë se, më së shumti ka të bëjë me lidhjet dhe mbështetjen e fuqishme që Dervishi i dha Esat Pashës në vitet 1913-1914. Madje mund të themi që kjo, ishte më e pakta që Esat Pasha mund të bënte për të. Ndërkaq, gjatë kësaj periudhe nuk konstatohet që Dervishi të jetë përfshirë në administratën e krijuar nga Esat Pasha.

Në kuadrin e zhvillimeve ushtarake të Luftës së Parë Botërore, në fund të vitit 1915 e në vijim, në Shqipëri hyjnë trupat ushtarake austro-hungareze, të cilat duke ndjekur trupat serbe, pushtuan pjesën veriore të Shqipërisë dhe iu drejtuan asaj qendrore. Ndërkaq, në janar të vitit 1916 në territorin shqiptar hynë nga Maqedonia trupat bullgare, duke pushtuar edhe një pjesë të territorit të Elbasanit. Përfaqësuesit e qytetit të Elbasanit, konkretisht Lef Nosit, Kasem Sejdit, Dr. Filip Papajanit, Emin Matraxhiut dhe ushtarakët e palës bullgare, nënshkruajnë në 29 janar 1916 një marrëveshje. Për këtë u hartua një procesverbal, në dy

⁴⁵⁶ Gazmend Shpuza, *Kryengritja Fshatare e Shqipërisë së Mesme, viti 1914-1915*, Tiranë: 1986, f. 414.

⁴⁵⁷ AQSH, F. Dervish Biçaku, nr. 69, viti 1915, Dos. 5, fl.12.

gjuhë frëngjisht edhe bullgarisht⁴⁵⁸. Kjo më së shumti, për pranimin e njohjes e influencës bullgare në një hapësirë të vogël përreth qytetit të Elbasanit, duke premtuar të mos cënonin të drejtat kombëtare të popullsisë shqiptare. Më nënshkrimin nga të dyja palët të procesverbalit, në qytet flamurët bullgarë dhe ata shqiptarë do të valëviteshin pranë njëri-tjetrit.

Ndërkaq, patriotët elbasanas si Aqif Pasha, Lef Nosi, Ahmet Dakli, shpresonin shumë në mbështetjen dhe ndihmën e Austro-Hungarsë. Në 28 janar 1916, në një proklamata drejtuar shqiptarëve, kërkohej që austro-hungarezët të konsideroheshin dhe të priteshin si shpëtimtarë. Ndër emrat që kishin nënshkruar këtë proklamata, ishte edhe Aqif Pashë Biçaku, i cili së bashku me nënshkruesit e tjerë: Prenk Bibdoda, Seid Pasha, Feizi Alizoti dhe Luigj Gurakuqi, gjendeshin të internuar në Cetinjë nga autoritetet ushtarake të Malit të Zi që kur u pushtua Shkoda⁴⁵⁹. Në shkurt të vitit 1916, në mbledhjen e organizuar nga përfaqësuesit e Elbasanit dhe politikanë të tjerë shqiptarë, komisioni vendosi që në 2 prill 1916 të mbahej në Elbasan një Kongres Kombëtar, që do të diskutonte për krijimin e shtetit shqiptar. Aqif Pasha, në cilësinë e ish ministrit të Qeverisë së Vidit që nuk dha dorëheqje, konsiderohej si personi kompetent që do të merrte përsipër organizimin e një qeverie të re, ku sipas tyre, mungonin vetëm tre ministra⁴⁶⁰. Komisioni kishte bërë gati edhe listën e kandidatëve që do të zgjidheshin në postin vakant të ministrave. Si anëtar i këtij komisioni rezultonte edhe i vëllai i Dervish Biçakut, Hasan bej Elbasani, emri i të cilit do të jetë edhe në listën e propozuar për ministër të qeverisë, që do të miratohej nga Kongresi që pritej të mbledhej në 2 prill 1916. Faktikisht votimi u bë nga anëtarët e këtij komisioni, ku Qemal Bej Biçaku, mori tri vota nga votimi që iu bë kandidatëve të listës së propozuar nga anëtarët e këtij komisioni, Lef Nosi mori 7 vota, ndërsa Ahmet Dakli mori 1 votë. Numrin më të madh të votave e morën Kara Seid Pasha dhe Luigj Gurakuqi me nga 9 vota secili, ndërsa Ahmet Zogolli mori 8 vota⁴⁶¹. Por sikurse dihet, ky kongres nuk arriti të organizohej në Elbasan për shkak të kundërshtimit që pati nga austro-hungarezët, të cilët ndaluan përfaqësuesit që të vinin në Elbasan. Për këtë, ata shfrytëzuan edhe sëmundjen ngjitëse të kolerës që kishte rënë në Elbasan, duke mos lejuar edhe grumbullimet e njerëzve. Ndërkaq, në prill 1916 Aqif Pasha paraqet dorëheqjen si

⁴⁵⁸ Lef Nosi, *Dokumente Historike (1912-1918)*, Instituti i Historisë, Tiranë: 2007, f. 246. Pas hyrjes së bullgarëve, në Elbasan erdhi edhe fuqia që drejtohej nga Ahmet Zogu nën komandën e komandant Gilardit dhe Selahudin Blloshmit. Kapiteni Gilardi kërkoi që në procesverbal të shkruhej që edhe fuqia kombëtare hyri në Elbasan në të njëjtën kohë me bullgarët. Pavarësisht kundërshtimit të bullgarëve u arrit në një zgjidhje kompromisi që u pranua edhe nga pala bullgare.

⁴⁵⁹ Lef Nosi, *Dokumente Historike (1912-1918)*, Instituti i Historisë, Tiranë: 2007, f. 245-246.

⁴⁶⁰ Po aty, f. 248.

⁴⁶¹ Po aty, f. 249.

ministër i Punëve të Brendshme, që kishte qenë në kohën e Princ Vedit.⁴⁶² Në nëntor të vitit 1916 kryetar i bashkisë së Elbasanit, zgjidhet Ahmet Dakli, që do të jetë në këtë pozicion deri në tetor të vitit 1917. Kryesia e bashkisë së Elbasanit përbëhej nga: Qamil Elbasani (vëllai i Dervish Biçakut), Emin Haxhiademi, Xhafer Dardha, Rrapush Demeti, Grigor Cilka, Lef Nosi, Ahmet Dakli, Nikoll Ivanai, Jashar Starova dhe Hajdar Blloshmi. Gjithashtu, në 28 nëntor 1917, Elbasani festoi pavarësinë me iniciativën e Aqif Biçakçiut dhe mbështetjen e Aleksandër Xhuvanit, Salih Çekës, Ahmet Daklit, Lef Nosit etj.

Në tetor të vitit 1918, me tërheqjen e trupave austro-hungareze, trupat italiane që kishin hyrë në Shqipëri iu drejtuan edhe Elbasanit. Ndërkohë, me përfundimin e Luftës së Parë Botërore më 25 dhjetor 1918 organizohet në Durrës një kongres nën kryesinë e Mehmet Konicës. Aty morën pjesë 50 delegatë, por mungonte përfaqësimi i disa krahinave për shkak se ushtritë e huaja ende nuk ishin larguar nga territori shqiptar. Ndryshe nga përfaqësuesit e Italisë që kërkonin një komitet në krye të Shqipërisë, patriotët shqiptarë kërkonin krijimin e një qeverie të re. Kështu, nga ky kongres do të dalë qeveria me në krye Turhan Pashë Përmetin. Kjo zgjedhje nuk ishte e rastësishme, për vetë faktin se Turhan Pashë Përmeti, kishte qenë kryeministër në Qeverinë e Vedit, çka do të thoshte vijimësi qeverisjeje ashtu si Fuqitë e Mëdha kishin vendosur. Gjithashtu, me këtë emërim, mendohej që t'i pritej rruga edhe edhe pretendimeve të Esat Pashë Toptanit⁴⁶³. Në mbledhjen e organizuar në Durrës në 25 dhjetor 1918, përfaqësues të Elbasanit ishin Shefqet Bej Vërlaci, Lef Nosi dhe Ahmet Dakli⁴⁶⁴. Sikurse dëshmohet asnjë nga Biçakçinjtë, nuk rezulton të ketë marrë pjesë në këtë kongres. Mendojmë se kjo lidhet me qëndrimin proaustriak që ata kishin, ndërsa Qeveria e Durrësit e kryesuar nga Turhan Pashë Përmeti, ishte e lidhur ngushtë me italianët së cilës i kishte premtuar shumë "konçensione lidhur me shfrytëzimin e naftës". Në vitin 1919, Esat Pasha e akuzonte këtë të fundit se ishte i integruar me qeverinë italiane⁴⁶⁵.

Ndërkohë ndikimi i Biçakçinjve në këtë kohë ishte evident në qytetin e Elbasanit. Në këtë kohë, të interesuar për pasuritë nëntokësore të Shqipërisë, ishin edhe anglezët. Dëshmohet që përfaqësuesi anglez Iden, në fillim të pranverës së vitit 1919 kishte ardhur në Elbasan dhe ishte vendosur pikërisht në shtëpinë e Dervish bej Biçakut. Sipas dëshmive, si ishte shprehur se: *"duhet ta keni mirë më Italinë, se ashtu është në interesin tuaj"* ⁴⁶⁶. Përfaqësuesi anglez në fakt konfirmon një fakt që ishte evident dhe që ishte diskutuar shumë

⁴⁶² Po aty, f. 254. Në dokument ndeshet mbiemri Biçakçiu dhe jo Biçaku.

⁴⁶³ Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi III, Tiranë: Toena, 2007 f. 128.

⁴⁶⁴ Lef Nosi, *Dokumente Historike (1912-1918)*, Instituti i Historisë, Tiranë: 2007, f. 289.

⁴⁶⁵ Rudina Mita, *Elbasani Jeta politike në vitet 1920-1924*, Tiranë: ILAR, 2007 f. 31.

⁴⁶⁶ Po aty, f. 72.

vite më parë ku Shqipëria ishte përcaktuar si zonë e ndikimit italian (po të kemi parasysh këtu Traktatin e Fshehtë të Londrës). Ndërkohë, që në takimin që Iden ka patur edhe me Aqif Pashën, dëshmohej t'i ketë thënë se "*I vetmi shpëtimi juaj është të tregoni gjallëri në Europë dhe të lëvizni, jo të rrini duarlidhur*"⁴⁶⁷. Faktikisht, Qeveria e Durrësit po tregohej e paaftë të mbronte çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris. Në konferencë pas debateve të shumta midis përfaqësuesve të tri Fuqive të Mëdha, më në fund merret vendimi për të rinjohur Pavarësinë e Shqipërisë më 1913, si shtet i pavarur e sovran. Kjo konsiderohej fitore, po të kemi parasysh që përfshirja e shtetit shqiptar në sistemin e mandateve i ngritur në mbarim të Luftës Botërore, ishte kthim pas në arritjet e çështjes sonë kombëtare, sepse në sistemin e mandateve parashikohej të përfshiheshin vetëm ato vende e popuj që nuk e kishin fituar ende pavarësinë e tyre kombëtare dhe që duhej të drejtohej nën mbështetjen një fuqie "të qytetëruar", deri në sigurimin e pavarësisë.

Qeveria e dalë nga Kongresi i Durrësit kishte detyrën e vështirë të mbronte çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris. Në delegacionin shqiptar që do të përfaqësonte Shqipërinë u zgjodhën: Luigj Bumçi, Mihal Turtulli, Mit'hat Frashëri dhe vetë kryeministri Turhan Pashë Përmeti. Konferencës iu paraqitën dy memorandumë, përmes të cilave kërkohej rikonfirmimi i pavarësisë dhe rishikimi i kufijve që kishin pësuar ndryshime. Konferenca nuk pranoi të merrte parasysh kërkesën e delegacionit shqiptar për rishikimin e kufijve dhe mbajtjen e plebeshitit për krahinën e Kosovës dhe Çamërisë⁴⁶⁸. Kjo në fakt lidhet me qëndrimin negativ që mbajtën shtetet fqinje: Greqia, Jugosllavia dhe Italia. Edhe përpjekjet që bëri Imzot Luigj Bumçi për të kërkuar mbështetjen e Papatit nuk patën rezultat në zgjidhjen e çështjes së rikonfirmimit të pavarësisë.

Situata e Elbasanit pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore ishte shumë kaotike sikurse në të gjithë pjesën tjetër të Shqipërisë. Po ravijizoheshin qartë dy grupime ku nga njëra anë ishin mbështetësit e *pashës*, pra Aqif Biçakçiut dhe nga ana tjetër mbështetësit e *beut*, Shefqet Vërlacit, i cili pati edhe mbështetjen e përfaqësuesve të shtresës borgjeze, si: Lef Nosi, A. Hastopalli, M. Harja, Andon Beça. Konflikti midis të dyve kishte nisur për vetë faktin se, Aqif Pasha ishte kundër qeverisë së dalë nga Kongresi i Durrësit.

Kështu themelet e organizimit të qendresës për çështjen shqiptare do të vendosen në Kongresin e Lushnjës i cili duket të ketë forcuar pozitën e Aqif Pashës. Në kongresin e

⁴⁶⁷ Po aty, f. 72.

⁴⁶⁸ AKSH, HPSH, Vëllimi III, Tiranë: Toena, 2007, f. 130.

Lushnjes u paraqit si përfaqësues i Peqinit⁴⁶⁹ dhe luajti rol kryesor duke u zgjedhur kryetar i tij dhe anëtar i “Këshillit të lartë”. Në këshill bënë pjesë Mihal Turtulli, Abdi Toptani, Luigj Bumci. Kryetar i qeverisë zgjidhet Sulejman Delvina. Në kongres u zgjodh një këshill kombëtar që u quajt “Senat”. Kongresi u shpreh kundër vendimit të Konferencës së Paqes në Paris. Kështu disa vendime që u morën ishin:

- ✓ Miratoi një akt kushtetues ku përcaktohet sovraniteti i shtetit shqiptar;
- ✓ Shpalli të rrëzuar Qeverinë e Durrësit;
- ✓ Pengoi rikthimin e Vidit.

Sipas vendimeve Tirana shpallet kryeqytet, Qeveria nuk pranoi kontrollin e përfaqësuesve të tjerë të Italisë. Për të kapërcyer krizën qeveria emeton një hua të brendshme prej 2 milion franga ari⁴⁷⁰ dhe po në mars i kërkon Italisë të rishikojë pozicionin e saj, për të respektuar të drejtat kombëtare të popullit shqiptar. Italia qëndroi indiferente ndaj kërkesave të qeverisë shqiptare duke e çuar situatën në acarim deri në luftë të armatosur në ngjarjet që në histori njihen me emrin “Lufta e Vlorës”.

Më 13 qershor 1920, Avni Rustemi vret Esat Pashë Toptanin. Vrasja i është atribuar në fillim A. Zogut, por Fisher konkludon se vetë Zogu kishte ⁴⁷¹ problem me atentatorin. Për vrasjen e tij është akuzuar Aqif Pashë Elbasani. Sipas dokumenteve të arkivës dhe dëshmive në gjyqin e vrasjes së Avni Rustemit, për vrasjen e tij akuzohet ai që quhet “grupi i Tiranës”⁴⁷². Sipas të dhënave, vrasja nis me të dyshuarin kryesor, djalin e tezes së tij Aqif Pashën. Kështu, më 5 shtator 1924 si dëshmitar në gjyqin e Avni Rustemit, është thirrur Dervish bej Biçakçiu i cili është shprehur: *“Esatisti Osman Bali ishte gjendur në Elbasan, kur kishte mësuar vrasjen e Avni Rustemit nga Jusuf Reci... ai ishte shprehur se gjaku i Esatit nuk mund të kërkohej tek ata që kishin paguar për një veprim të tillë, por duke u marrë pashë për pashë.”*⁴⁷³

Zgjedhjet u zhvilluan në mars-prill 1921. Parlamenti i ri kishte 78 deputetë, ky parlament quhej ndryshe “Këshilli kombëtar”. Në Elbasan ekzistonin dy grupime politike: “Pleqësorët” me në krye Sh.Vërlacin dhe në të cilin bënte pjesë edhe Dervish bej Biçakçiu dhe “Popullorët” me në krye Lef Nosin, A.Daklin etj. Rezulton të jetë krijuar edhe një formacion

⁴⁶⁹ Po aty, f. 36.

⁴⁷⁰ Po aty, f. 48-149.

⁴⁷¹ Bernd Ficher, *Mbreti Zog dhe përpjekjet për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë:Çabej,1996 f. 32.

⁴⁷² Kastriot Dervishi, *Plumba politikës*, Tiranë: Botime “55”, 2009, f. 20.

⁴⁷³ Po aty, f. 20.

i tretë i njohur me emrin "*As i pashës as i beut*" ku dallohen figura e S. Xhakës, A. Xhuvanit, K.Cipo, etj. Zgjedhjet kishin rendësi, sepse ishin të parat e këtij lloji, megjithëse sistemi zgjedhor përjashtonte një pjesë të mirë të popullit nga ajo, si gratë dhe ushtarakët. Zgjedhjet kryheshin në dy shkallë dhe ishin lehtësisht të manipulueshme. Në këto zgjedhje, fitues del grupi politik "*Paqësorët*" nga Shefqet Vërlaci i cili krijon "*Partinë Përparimtare*", në kuadrin e këtij grupi. Zgjedhjet i fituan anëtarët e grupit "*Pleqësor*". Megjithë problematikat këto zgjedhje ishin të rëndësishme, sepse përbënin përvojën e parë të një fushate elektorale pas krijimit të shtetit shqiptar. Nuk kemi evidentuar të dhëna për mbështetje direkte të Dervish Biçakçiut për Shefqet Vërlacin.

Në fundin e 1921, evidentohet konflikti midis Aqif Pashës dhe një pjesë të parlamentit. Siç bëhet e ditur, Aqif Pasha po regjistronte xhandarë në rang prefekturë⁴⁷⁴ dhe nënprefekturë. Lëvizja e Mirditës e Gjon Marakgjonit, acaroi edhe më tej situatën politike duke e vënë në vështirësi pozitën e Aqif Pashës. Pozita e Ahmet Zogut që gëzonte edhe mbështetjen e Dervish Biçakçiut sa vinte dhe forcohej dhe më 6 nëntor 1921, krijohet kualicioni me emrin "*Bashkimi i Shenjtë*"⁴⁷⁵ ku bënin pjesë atdhetarë si Hasan Prishtina, Mustafa Kruja dhe Luigj Gurakuqi. Aqif Pasha deklaronte se Shefqet Vërlaci dhe Dervish Biçaku mbanin anën e Zogut duke thënë: "*Zogu ishte influencuar te miqtë e tij të Elbasanit. Shefqet Vërlaci dhe Dervish Biçakçiut ... që të më diskreditojnë dhe ndofta dhe të më arrestojnë.*" Aqif Pasha kishte organizuar forca të armatosura për të sulmuar periferinë. Marrëveshja e tij ishte me Hamid Topin, Ymer Deliallisin dhe Bajram Xhanin për të sulmuar qeverinë e Tiranës në drejtime të ndryshme.⁴⁷⁶ Zogu bëri një lëvizje diplomatike. Ai në postin e ministrit të Brendshëm, emëron si prefekt të Elbasanit Abedin Nepravishtën⁴⁷⁷ duke plotësuar kështu një kërkesë të Aqif Pashës, për këtë arsye ai (Aqifi) nga ana tjetër duhet të shpërndante forcat. Në fakt Aqif Pasha kërkonte të fitonte kohë, sepse priste të fillonte kryengritja e udhëhequr nga B. Curri, E. Isufi. Në një situatë të tillë vendi ndodhej para një kryengritje. A. Nepravishta i kërkon pashës të shpërndajë forcat duke i thënë se: "*Në rast se fitohet kryengritja prej jush do të jeni fitues, por në rast të kundërt i shpjegon masat që do të merren kundër tij. Në emër tuaj po bëhet propagandë për kryengritje. Ju keni armiqtë tuaj këtu në Elbasan, të cilët duan të përfitojnë nga rasti dhe t'ju manipulojnë në këtë gjë edhe juve*".⁴⁷⁸ Në një situatë të tillë ai pranon largimin.

⁴⁷⁴ Po aty, f1. 59.

⁴⁷⁵ Po aty, f1. 67.

⁴⁷⁶ Rudina Mita, *Elbasani Jeta politike ne vitet 1920-1924*, Tiranë: Ilar 2007, f 183.

⁴⁷⁷ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri*, Tiranë: Vllamasi, 2020, f. 271.

⁴⁷⁸ Po aty, f. 271.

Në shkurt të vitit 1922 Aqif Pasha vendoset në Vjenë ku në prill 1923 krijon "*Partinë Kombëtare*". Në themel, sipas tij kjo parti do të kishte një qeverisje demokratike dhe pluraliste.⁴⁷⁹

Gjatë kësaj periudhe, ajo që vlen të theksohet ishte fakti që politika shqiptare duhet të zgjidhte formën e regjimit e cila duhet të realizohej në mënyrë ligjore ashtu siç e kishte parashikuar Kongresi i Lushnjës dhe Këshilli Kombëtar të shndërrohej në Asamble Kushtetuese. Këshilli vazhdoi punimet nga prill deri në gusht të vitit 1923. Në Elbasan në mënyrë të padiskutueshme ndihej ndikimi i krahut të Pleqësorëve të udhëhequr nga Shefqet Vërlaci dhe mbështetësit e tij. Në këshill deputetët elbasanas, do të ngrinin problematika që shqetësonin jetën e qytetit siç ishin probleme lidhur me arsimin në vend, lidhur me menaxhimin më të mirë të buxhetit të vendit, ku kërkonin më shumë liri për pushtetin lokal, lidhur me nivelin e takasave që ishte i papërballueshëm nga një pjesë e mirë e popullsisë, si dhe çështje që lidheshin me meremetimin e ndërtimin e rrugëve.⁴⁸⁰ Ndërkohë në rang kombëtar, Zogu si kryeministër i vendit kishte arritur të miratonte atë që njihej me emrin "Statusi i zgjeruar i Lushnjës" i cili përmbante 129 nene dhe ku vinte theksin në ndarjen e pushteteve dhe ku sanksiononte formën e qeverisjes Monarki.⁴⁸¹ Ajo që vlen të theksohet, ishte se fushata elektorale ishte e egër: "*...dhe të gjitha palët sipas mundësive dhe mjeteve, u përpoqën të bënë manipulime dhe të ushtronin dhunë mbi zgjedhësit*".⁴⁸² I qartë ishte fakti që flitet ende për një kulturë politike jo demokratike dhe të pakonsoliduar po të kemi këtu parasysh që ende nuk ishte konsoliduar Shqipëria si formacion shtetëror.

Në 20 gusht 1923, Këshilli i Lartë thirri parlamentin i cili do të miratonte projektligjin për zgjedhjet e reja. Kështu, fushata elektorale ka gjetur pasqyrim në shtypin e kohës në Elbasan. Grupimet politike ishin "Pleqësorët" nga njëra anë dhe grupi "As i pashës as i beut" nga ana tjetër. Ky i fundit edhe pse quhej i tillë, mendohet që kishte mbështetjen e Aqif Pashës.⁴⁸³ Sipas të dhënave në grupin *Pleqësor* kandidojnë: Shefqet Vërlaci, Shefqet Daiu, Ahmet Hastopalli si dhe Hasan Biçaku (vëllai i Dervish beut). Interesant ishte fakti që ky grupim mbështeste idenë e vendosjes së republikës. Zgjedhjet fitohen nga grupimi i Zogut, por opozita nuk e kishte shumicën relative për të formuar qeverinë. Pas incidentit të ndodhur në parlament ku Beqir Valteri shtin me armë ndaj Ahmet Zogut, ky i fundit jep dorëheqjen; në postin e kryeministrit zgjidhet Shefqet Vërlaci i cili qeverisi në kushtet e një klime shumë

⁴⁷⁹ Po aty, f. 189

⁴⁸⁰ Rudina Mita, *Elbasani Jeta politike ne vitet 1920-1924*, Tiranë: Ilar, 2007, f. 192-195.

⁴⁸¹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: Kristalina KH, 2007, f. 42.

⁴⁸² Po aty, f. 44.

⁴⁸³ Rudina Mita, *Elbasani Jeta politike ne vitet 1920-1924*, Tiranë: Ilar, 2007, f. 204.

të tensionuar. Në 5 maj 1924 kryhet atentat ndaj Avni Rustemit ku ky i fundit mbeti i vrarë. Atentatori ishte një nga njerëzit besnikë të Esat Pashë Toptanit, Isuf Reçi. Situata precipiton deri në kryengritje të armatosur ku kundërshtarë kyesorë të Zogut, shfrytëzuan situatën për ta larguar atë nga pushteti. Shefqet Vërlaci jep dorëheqjen dhe zgjidhet një qeveri e re me në krye Iliaz Vrionin e cila shpalli mobilizimin e përgjithshëm që nuk gjeti mbështetje në popull. Kundër tij ishin rreshtuar figura si: Fan Noli, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Elez Isufi, Rexhep Shala etj. Në pasditen e 9 qershorit, Zogu detyrohet të largohet. Në këto ngjarje, për arsye politike, por edhe për shkak lidhjeve të gjakut, Dervishi bej Biçakçiu renditet në radhët e mbështetësve të Ahmet Zogut, pra kundër Fan Nolit. Për këtë arsye, vëllai i tij Hasani, dënohet me burg nga Gjykata Speciale e ngritur nga Qeveria e Nolit. Ky i fundit qeverisi vendin nga qershori deri në dhjetor të 1924. Pas largimit nga atdheu, Noli u tërhoq nga jeta politike dhe u mor kryesisht me çështjet fetare në ShBA dhe me letërsi ku ndër të tjera ka shkruar një poezi për Dervishin duke kujtuar kohën kur Dervishi mbështeste ardhjen e një princi mysliman:

Kanga e Dervish Begut

Bismilah, tridhjet seneja,
Topat krisën posi rrufeja,
Na u ba mbretni Shqypneja!
Smail Begu tha një fjal':
"Sot vatani don një kral,
Don një kral oxhak kaurri
Se me Turk na piu qivuri".
Dervish Begu, trim si Zana
Djal' si aj s'ka puthun nana,
Me Kuranin n'dor e priti,
Iu përgjeq posi petriti:
"Pra nigjo bre kaurr derr,
Kaurr kral, Shqypneja s'merr!
Dona kral një bir Dovleti,
Soj Sulltani e din Muhameti.
Jena turq, elhamdurrallah,
Kaurr s'dona istakfurallah,
Jena turq, s'e prishim dinin

Vdesim për Kuran Qerimin".

Kur nigjoi Sulltani tha:

"Pasha Zotin, n'tan dynja

Si shqyptart arslana s'ka,

S'e dun vendim pa Dovletin

S'e dun jetën pa Muhametin!"

Noli me poezinë e tij ishte përpjekur të jepte një imazh anadollak të figurës së Dervishit. Sipas studiueses Jonela Spaho: "*Vargu i parë thekson më shumë talljen dhe stigmatizimin e Nolit kundrejt atyre që kërkojnë të kthejnë kohën prapa: "Bismila, tridhjet seneja, / Topat krisën pors rrufeja, / Na u bë mbretni Shqypneja". Vitin 1914, Noli e ka konvertuar me vitin 1230 allaturka, për t'u tallur dhe për të ironizuar, si dhe për të goditur dukurinë regressive*"⁴⁸⁴.

Mendoj që Dervish Biçakçiu në tërësinë e veprimtarisë së tij ka dëshmuar të kundërtën që me Lëvizjen Uniatiste, pjesëmarrjen në klube kulturore, Kongresin e Elbasanit, hapjen e shkollës shqipe të Normales, shpalljen e pavarësisë etj. Periudha kur Dervishi kërkonte një princ mysliman, ishte periudha kur në territorin shqiptar ishte krijuar një pasiguri totale e jetës dhe e sigurisë për pronën, si rrjedhojë e faktit që Qeveria e Ismail Qemalit nuk ishte e aftë të kishte autoritet në të gjithë vendin. Fuqitë e Mëdha nuk po demonstronin mbështetje për shqiptarët dhe shtetet fqinje kishin pushtuar një pjesë të mirë të territoreve. Dervish Biçakçiu ka mbështetur idenë e një princi mysliman ndoshta lidhur nga lidhjet historike që shqiptarët kanë pasur me Perandorinë Osmane, duke e parë atë si një "komardare" shpëtimi për momentin në të cilën po kalonte Shqipëria. Fakt tjetër mund të ketë qenë idea që osmanët e njihnin më mirë realitetin shqiptar dhe mund të orientoheshin më lehtë në vorbullën kaotike të shoqërisë shqiptare të viteve të Pasluftave Ballkanike. Sa për faktin që Dervishi ishte kundër një princi të krishterë (kaurr) dhe kjo është diçka që nuk shkon, sepse ai në luftën e gjatë atdhetare, politike, kulturore pati në krah individë me përkatësi fetare të krishterë si: Luigj Gurakuqin, Lef Nosi, Aleksandër Xhuvani etj.

Pas ardhjes së Ahmet Zogut në pushtet, duket se pozitat e Dervish Biçakçiut në qytet përmirësohen dukshëm. Në vitin 1925, na rezulton të ketë pasur detyrën e prefektit të

⁴⁸⁴ Jonela Spaho, Konferenca shkencore ndërkombëtare "Fan S. Noli në 130 - vjetorin e lindjes" 1882-2012, *Roli i satirës dhe humorit në poezinë e nolit, në funksion të artikulimit të idesë*, Korçë, 2012, f. 137.

Elbasanit, të cilën nuk e mban gjatë, pasi jep dorëheqjen pas disa muajsh. Në vitet 1925-1932, aktiv në politikën shqiptare ishte i vëllai Hasani, i cili ka qenë deputet në tri legjislatura, në 1923, 1925 dhe 1928. Hasani gjithashtu zgjidhet edhe kryetari i bashkisë së Elbasanit në tetor të 1933, ku në fokus të veprimtarisë së tij janë mbarëvajtja e shkollave të qytetit. Ai interesohet edhe për pagat e arsimtarëve. Gjithashtu, interesi i bashkisë ishte kanalizimi i ujit të mirë, pra bëhet fjalë për ujin e pijshëm dhe hapjen e rrugëve të reja. Në atë periudhë, sipas dokumenteve të kohës, fillon edhe ndërtimi i rrugëve që do të lidhnin Elbasanin me Beratin dhe Lushnjen⁴⁸⁵.

Në vitin 1932, Dervishi zgjidhet deputet në Asamblenë Kushtetuese në grupin mbështetës të qeverisë së asaj kohe, pra në grupin e *Pleqësorëve*. Duhet thënë që si pjesë e parlamentit shqiptar në këtë periudhë, ai do të ishte pro miratimit të ligjeve që do të ndihmonin në ecjen përpara të shoqërisë shqiptare. Kështu në vitin 1933, miratohet një amendament kushtetues që: "*i dha shtetit të drejtën ekskluzive për arsimimin e qytetarëve të tij, pra nacionalizimin e sistemit arsimor*"⁴⁸⁶. Masat e marra synonin gjithashtu edhe luftën kundër analfabetizmit të rritur si dhe organizimin e kurseve arsimore për gratë. Një arritje e rëndësishme në periudhën e mandatit të tij si deputet, në vitin 1936, ishte edhe krijimi për herë të parë i *Entit Kombëtar të Turizmit*. Rëndësia e krijimit të këtij institucioni, qëndron në faktin që u lehtësuan shumë procedurat për marrjen e pasaportave, vizave, modernizimin e hoteleve dhe të transportit. Po kështu ai si deputet në parlament në vitin 1937, mbështeti ligjet që lidheshin me emancipimin e gruas, duke ndaluar poligaminë dhe mbajtjen e perçes tek gratë⁴⁸⁷.

Dervish Biçaku, me qëndrimet e tij politike mbështeste Shefqet Vërlacin dhe ishte mbështetësi kryesor i Ahmet Zogut në Elbasan. Kështu, në vitin 1937, zgjidhet sërish deputet, gjë që tregon që ndikimi i tij në Elbasan ishte shumë i madh.

Dervish Biçakçiu, përveçse ishte një organizator i mirë, kishte dhe një natyrë tepër bujare. Nga dokumentet e kohës, dëshmohet se *bënte edhe shumë bamirësi*,⁴⁸⁸ ku mund të përmendim ndihmat që ka dhënë për spitalin Ushtarak apo ndihma kundrejt të vobektëve në qytetet e Elbasanit dhe Tiranë. Ndjenja dhe shpirti i tij, bënin që ai të ishte i kudon dodhur në aksione të tilla. Më 15 prill 1939, ai bën pjesë në grupin e delegatëve të Elbasanit në Asamblenë Kushtetuese të fashizmit. Jo vetëm kaq, por ai ka qenë pjesë e delegacionit në

⁴⁸⁵Rudina Mita (Todri), Roland Gjini, *Dokumenta historike 1925-1940*, Tiranë: Maluka 2015, f. 413.

⁴⁸⁶ Edwin Jacques, *Shqiptarët*, Tiranë: Botues Kartë e Pendë, 1995, f. 436.

⁴⁸⁷ Po aty, f. 436

⁴⁸⁸ Po aty, f. 327.

dhënien e kurorës mbretit të Italisë, Viktor Emanuelit III, në Romë. Nga Elbasani si përfaqësues kanë qënë këto persona : Visarion Xhuvani, Dervish Biçaku, Behxhet Hydi, Ibrahim Biçaku, Qemal Karaosmani (Elbasani) si dhe Shefqet Verlaci i cili ka qënë në cilësinë e kryeministrit të vendit duke mbajtur atje edhe një fjalim. Ky fakt padyshim ishte kushtëzuar nga rrethanat në të cilat ndodhej vendi dhe ndoshta dhe për faktin që vetë Dervishi ka shprehur në shumë rrethana ndjenjat e tij proitaliane. Nga dokumentet që kemi hulumtuar për këtë kohë, nuk na rezulton që ai të ketë qënë aktiv në politikë; kjo ndoshta për shkak të moshës së thyer. Më 1942 ishte pjesë e anëtarësisë së Ballit Kombëtar, por përmes konsultimit me dokumentacionin përkatës nuk e shohim të ketë qënë gjithashtu aktiv. Në nëntor të vitit 1944, Dervishi largohet nga Shqipëria në drejtim të Sirisë ku dhe *ndërron jetë më 1952*. Nga dëshmitë familjare ka jetuar në Damask dhe meqënëse ishte në moshë të thyer tregohet se ka jetuar në një xhami pranë së cilës ndodhet edhe varri.

Më 25 shkurt të vitit 1952, “Blloku Kombëtar Independent” ndërpreu mbledhjen e tij të tretë të zhvilluar në Romë për të respektuar kujtimin e Dervish Biçakçiut. Për të vlerësuar figurën e tij, Ernest Koliqi mbajti një fjalim ku ndër të tjera tha edhe këto fjalë: *“Emni i Dervish beut lidhet ngushtësisht me atë lulëzim ndjenjash pranverore dhe me shpresat guximtare që zgjoi ndër të gjithë shqiptarët themelimi i Normales së Elbasanit... por jo vetëm si punëtor, ndër ma të parët e lirisë do të kujtojmë këtë fisnik të shquar, por edhe si prind të një dëshmori të lirisë. I biri i tij Sefedini ra në lamë të nderit duke shugurue me gjak vullnetin e popullit shqiptar, me u ndenj besnik traditave ma të shëndosha.”*⁴⁸⁹

⁴⁸⁹ Kastriot Dervishi, *Elbasani Enciklopedi*, Elbasan: Botimet Sejko, 2003, f. 63.

PËRFUNDIME

Punimi “FIGURA E DERVISH BEJ BIÇAKUT DHE KONTRIBUTI I TIJ NË HISTORINË E SHQIPËRISË DHE TË ELBASANIT”, si një studim shkencor, mendojmë se ka ndriçuar sado pak figurën e DERVISH BEJ BIÇAKUT dhe kontributin e tij në veprimtarinë politiko-arsimore në ngjarjet më të rëndësishme të Shqipërisë dhe të Elbasanit dhe ka rindërtuar në mënyrë të përgjithshme dhe të kujdesshme dimensionin politik e historik të Dervish bej Biçakut.

Hulumtimi i materialeve të nxjerra për herë të parë nga Arkivi Qendror i Shtetit, na dha mundësinë të hedhim dritë më shumë mbi këtë figurë, duke zbardhur disa nga ngjarjet më të rëndësishme ku kontributi i Dervish bej Biçakut ka qenë më se evident. Në këto terma, përmes këtij punimi kemi sjellë sa më të plotë Dervish Bej Biçakun, elbasanasin që:

✓ Insistoi në përhapjen e arsimit në Elbasan dhe më gjerë, duke vijuar me kërkesa të karakterit arsimor dhe kulturor të vendit. Në rininë e tij, na shfaqet djaloshi që i rritur në një mjedis atdhedashës, shumë herët përfshihet në Lëvizjen Kombëtare, që udhëton pa fund nga Stambolli në Shqipëri, nga Shqipëria në Itali, e më tej në Bukuresht e sërish në Stamboll me qëllimin e vetëm, për të siguruar libra që aq shumë mungonin. Në fakt idealisti që adhuronte xhonturqit, tashmë ishte patrioti që luftoi me të gjitha fuqitë për atdheun e tij. Ai diti që me intuitën që e karakterizonte të shënojë emrin në atë plejadë njërëzish që vunë në dispozicion të vendit dhe popullit të gjitha resurset financiare, materiale dhe mendore në shërbim të çështjes kombëtare.

✓ Kundërshtoi Portën e Lartë, duke shfaqur kundërshti ndaj administratës osmane dhe duke dalë në mbështje të popullsisë së rebeluar në lidhje me mospagimin e taksave të larta që shpeshherë i vendoseshin popullsisë. Format e mosbindjes ndaj Portës së Lartë tregojnë se ai duke qënë një njeri i shkolluar, kërkonte më shumë të drejta për kombësinë e tij.

✓ Në veprimtarinë e tij, pati korrespondencë dhe kontakte me emrat më të shquar të kohës si: Faik Konica, Ibrahim Temo, Dervish Hima, Luigj Gurakuqi, Jani Vruho, Mit’hat Frashëri, Ismail Qemali, Lef Nosi, Ahmet Dakli, Shefqet Vërlaci, Esat pashë Toptani, Murat dhe Fuat Toptani, Nikolla Naço, Mit’hat Frashëri etj. Në kontaktet që mbante me patriotë të kohës, shfaqen pikëpamjet e tij në lidhje me të ardhmen e Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ai mbështeti financiarisht botimet e disa revistave që shtypeshin jashtë vendit në gjuhën shqipe. Korrespondenca na shfaq elbasanasin, që qëndroi krah burrave të shtetit që pa dyshim shkruajtën emrin në historinë e Shqipërisë që në fillimin e shek. XX.

✓ Kontribuoi në mënyrë aktive në organizimin dhe funksionimin e klubeve patriotike “Vllaznia” dhe “Bashkimi i Ri” në Elbasan, dhe në bashkëpunim me patriotët e tjerë të Elbasanit, i shndërruan këto klube në qendra të veprimtarisë arsimore, kulturore dhe politike, në mbështetje të masivizimit të shkollës shqipe dhe në mbrojtje shkrimit të shqipes me alfabetin me germa latine.

✓ Bëri bashkë myslimanë e të krishterë në Kongresin e shkollave shqipe, duke u ngritur mbi fanatizmin fetar të kohës, mbështeti moralisht dhe financiarisht Kongresin e Elbasanit. Ai ishte jo vetëm një nga financuesit e tij, por edhe një nga mbështetësit kryesorë të zbatimit të vendimeve të tij. Faktet na evidentojnë rolin të tij “si kryemësonjës i komisionit të Normales”, i cili menaxhoi mirëfunksionimin e kësaj shkolle me bazë mësimore-didaktike, që duke marrë në konsideratë rrethanat e asaj kohe, rezultonte shumë e vështirë, duke e kryer këtë detyrë plot pasion dhe devotshmëri.

✓ U përpoq maksimalisht jo vetëm për rihapjen e shkollës Normale në vitin 1910, por edhe për të siguruar mbështetje diplomatike dhe financiare nga konsujt austro-hungarezë, për ngritjen e një godine të re shumë të nevojshme, me të gjitha kushtet dhe kapacitetet për zgjerimin e saj, duke menduar për perspektivën dhe të ardhmen e shkollimit të shqiptarëve nga të gjithë trevat shqiptare të asaj kohe. Gjithashtu, ai bëri përpjekje së bashku me patriotë të tjerë të kohës, për krijimin e mundësive për hapjen e një shkolle Normale edhe jashtë Shqipërisë, aty ku diaspora shqiptare ishte më aktive, çka është tregues i faktit se dëshira për hapjen e Normales nuk ka qënë diçka e çastit, por është nisur nga motive shumë të larta, atë dashurisë për gjuhën shqipe dhe zhvillimin e diturisë në vend me qëllimin e vetëm që puna e nisur të mos ndërpritej, sepse shkolla dhe librat ishin e vetmja zgjidhje për vendin. Dervishi ka pasur kontakte edhe me diplomacinë e huaj në Shqipëri qoftë italiane, austro-hungareze, sikurse edhe me vetë Portën e Lartë, ndihmuar kjo nga fakti që ai ishte një prej përfaqësuesve të derës së madhe të Biçakçinjve si dhe një njohës shumë i mirë i gjuhës frënge.

✓ Pati një rol të padiskutueshëm në kryengritjet antiosmane të viteve 1911 – 1912 në Elbasan dhe më gjerë dhe në zhvillimet e fushatës zgjedhore parlamentare në pranverë të vitit 1912, ku ai shpall edhe kandidaturën e tij për deputet në parlamentin osman. Por, duke vënë në plan të parë interesin kombëtar, Dervish Biçakçiu do të zgjedhë të tërhiqet nga kandididimi i tij, në mbështetje të një kandidati të vetëm në Elbasan. Patriotët shqiptarë dhe ata elbasanas e gjykuan si më oportune daljen e Elbasanit në këto zgjedhje me një kandidat të përbashkët, përballë kandidatëve xhonturq, vendim ky që pati miratimin dhe tërheqjen e Dervishit.

✓ Ishte një nga protagonistët e Shpalljes së Pavarësisë në qytetin e Peqinit, duke marrë mandatin e përfaqësuesit të këtij qyteti, por dhe mandatin e Elbasanit për në Kuvendin e Vlorës. Ndërsa, sarajet e tij në Çermë të Lushnjës, shërbyen si pikë mbështetje dhe mikpritjeje për Ismail Qemalin dhe patriotët e tjerë në rrugëtimin e tyre për në Vlorë.

✓ Me individualizmin dhe intuitën e tij, Dervish Biçakçiu realizoi disa zgjedhje specifike, që kushtëzuan sado pak në ngjarjet e historisë së Elbasanit dhe historisë sonë kombëtare, në vitet 1913-1914. Nga botimet që kemi mundur të hulumtojmë, më së shumti, që nga korriku i vitit 1913, fillon të shfaqet qëndrimi dhe aktiviteti i tij si kundërshtar politik i Ismail Qemalit dhe mbështetës i Esat Pashë Toptanit.

Mendojmë se një zgjedhje e tillë ishte rezultat i disa faktorë:

Së pari, ai shfaqet si një kundërshtar i vendosur ndaj Aqif Pashë Elbasanit. Një konflikt ndërmjet dy kushërinjve Biçakçinj, që fillesat i pati për çështje pronësie dhe vijoi i pandërprerë, duke shfaqur dimensionet e një konflikti me natyrë politike në vitet 1913 e më pas. Një konflikt që thajse nuk gjeti asnjëherë mirëkuptim dhe zgjidhje dhe në vitin 1913, kulmon përmes përplasjeve e armatosura ndërmjet njerëzve të Dervish beut dhe vëllezërve të tij nga njëra anë dhe xhandarëve të prefekturës së Elbasanit që drejtohej nga prefekti Aqif Pasha nga ana tjetër. Synimi kryesor i Dervishit, ishte shpëputja e Elbasanit nga administrimi i Qeverisë së Vlorës dhe përfshirja e Elbasanit në zonën e ndikimit të tyre. Për më tepër, në muajt e fundit të vitit 1913, ai do të deklaronte se nuk kishte asnjë lidhje me Esad Pashën duke krijuar një qeveri të tijën. Është e kuptueshme, që qëndrimi i tij kundër Ismail Qemalit, do të variente edhe nga pozicionimi i kushëririt të tij Aqif Pashës, përkrah Ismail Qemalit. Përkrahja e Dervishit ndaj Ismail Qemalit, në një formë apo në një tjetër, parakuptonte edhe bashkëpunimin me Aqif Pashën, gjë që duke marrë në konsideratë dinamikën e marrëdhënieve konfliktuale të tyre, nuk ndodhi as Dervishi as nga Aqifi. Mendojmë se, duke filluar nga korriku i vitit 1913, ai nuk mund të qëndronte më përkrah Ismail Qemalit, pavarësisht pozicionit që kishte në Vlorë.

Së dyti ndaj qeverisë së Vlorës ishin ngritur akuza të cilat e rëndonin më tej pozitën e saj Shpenzimet e tepërta të qeverisë për administratën dhe pagat, emërimet e nënpunësve në vende të panevojshme, për shitjen e parregullt të të dhjetave, për dhënien koncensioneve të huajve, për mospërdorimin e gjuhës shqipe në administratën shtetërore etj.

Së treti, duke analizuar nga rrethanat e kohës, mendojmë se Dervishi bëri një zgjedhje pragmatiste, duke përkrahur atë grupim politik që ai mendonte se kishte përkrahjen e ndërkombëtarëve dhe si të tillë, ai konsideronte grupimin politik që ishte rreshtuar përkrah Esad Pashë Toptanit. Pavarësisht ndërmjetësisë së disa prej figurave politike të asaj kohë, që kishin edhe miratimin e anëtarëve të KNN-së në Shqipëri, qëndrimi i tij do të mbetet i palëkundur.

Përkrahu krahun politik të Ahmet Zogut në vitet 1920 - 1939 për shkak të lidhjeve familjare, por jo vetëm, edhe për shkak të bindjeve të tij politike duke u rreshtur kështu në anën e grupimit politik të konservatorëve për shkak edhe të shtresës shoqërore në të cilën ai bënte pjesë. Ai ishte përfaqësues i Elbasanit në legjislaturat parlamentare shqiptare të viteve 1932-1939. Dervish Biçakçi u në mënyrë të pamohueshme luajti me të gjithë veprimtarinë e tij një rol shumë të rëndësishëm në ngjarjet e Elbasanit, por dhe të historisë sonë kombëtare në fund të shekullit XIX dhe në fillimin e shekullit XX. Ai padyshim mund të ketë problematikat e tij në kuadrin e kohës në të cilin jetoi, ku Shqipëria ishte një vend ku mungonin institucionet, ku përplaseshin interesat e Fuqive të Mëdha dhe ku prirjet shoviniste të shteteve fqinje, nxisnin përçarje të prijësve lokale apo njerëzve me influence, duke kompromentuar edhe në jo pak raste shqiptarë të shkolluar për interesat e tyre. Pavarësisht kësaj, Dervishi në asnjë moment nuk kreu akte apo veprime prej të cilave të jetë rrezikuar fati "i shkruar" i historisë sonë të atyre viteve, në të cilat ai që më aktiv me qëndrimet dhe veprimet që ka mbajtur në çështje të ndryshme.

Ajo që vlen dhe nuk mund të mohohet dhe mund ta themi pa asnjë mëdyshje, është që ai pati një dashuri të madhe për qytetin e tij, që ishte mbështetës i flaktë i gjuhës shqipe, arsimit dhe shkollës kombëtare.

Një individ, që duhet vlerësuar në kontekstin e kohës në të cilin ai jetoi si përfaqësues i shtresës së bejlerëve, i shkolluar që u përpoq me aq sa mundi dhe brenda kornizës së shtresës shoqërore në të cilën ai bënte pjesë, në çështje madhore të historisë së Shqipërisë. Parabola biografike e Dervish bej Biçakçiu, na jep mundësinë të pohojmë pa asnjë mëdyshje, për atdhetarizmin e tij pa kushte ndaj atdheut si dhe mohimin e qëllimshëm që i është bërë kontributit të tij dhe familjes së tij në Lëvizjen tonë Kombëtare. Titulli "Qytetar Nderi i Elbasanit"⁴⁹⁰ që i është dhënë Dervishit, është nder jo vetëm për të, por edhe për qytetin për të cilin ai dha aq shumë.

⁴⁹⁰ Titulli "Qytetar Nderi" i është dhënë me motivacionin "Përfaqësues i Elbasanit në shpalljen e Pavarësisë. Kryetar i Kongresit Kombëtar të Shkollave Shqipe".

BIBLIOGRAFI

A. Burimet arkivore

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë, (AQSH)

- Fondi: *Aleksandër Xhuvani*, nr. 3.
- Fondi: *Dervish Biçaku*, nr. 69.
- Fondi: *Faik Konica*, nr. 13.
- Fondi: *Jani Vruho*, nr. 22..
- Fondi: *Koleksioni i shoqërive dhe klubeve shqiptare*, nr. 102.
- Fondi: *Lef Nosi*, nr. 32.
- Fondi: *Luigj Gurakuqi*, nr. 34.
- Fondi: *Milto Sotir Gurra*, nr. 592.
- Fondi: *Shefqet Verlaci*, nr. 57.
- Fondi: *Shtjefën Gjeçovi*, nr. 58.

B. Arkivi i Stambollit në Turqi

- Fondi i Kryeministrit të Osmane, Porta e Lartë, BEO.

C. Arkivat e Tiranës, Shqipëri

- AME (Arkivi i muzeut Etnografik Elbasan).
- Arkivi i bibliotekës së Elbasanit; Fondi i Albanologjisë.
- Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë.
- QSA, Tiranë, Fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vjenës, HH ST PA.

D. Tekste, monografi

- Akademia e Shkencave, *Historia e popullit shqiptar*, Vëllimi I, II, III, Tiranë, Toena 2002.
- Alfabeti i gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit, Tiranë 1976.
- Annelise Wernicke, *Teodor Ippen dhe Shqipëria në fokusin e Perandorisë Austro-hungareze*, Tiranë, Plejad.
- Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Tiranë, Toena, 2009.
- Beqir Meta, Hasan Bello, Syrja dhe Eqerem bej Vlora, Vëllimi I, Tiranë, Onufri 2017.
- Bernd Ficher, *Mbreti Zog dhe përpjekjet për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë:Çabej,1996
- Edit Durham, *Lufta për Shkodrën*, Tiranë, Argeta LMG, 2017.

- Edwin Jacques, *Shqiptarët*, Tiranë, botues Kartë e Pendë 1995.
- *Elbasani Enciklopedi*, Elbasan, Botimet Sejko, 2002.
- Eqerem bej Vlora, *Ndihmesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri*, Vëllimi II Tiranë, Botime "55".
- Ermal Nuhja, *Elbasani në dokumentat osmane të arkivit të Stambollit*, Tiranë, Onufri 2019.
- Faik Konica, *Vepra IV*, Tiranë, Dudaj 2001.
- Faik Konica, *Shkrime nga "Albania" 2*, Prishtinë, Faik Konica, 2013.
- Gabriel Louis Jaray, *Shqipëria e panjohur*, Dituria, 2006.
- Gazmend Shpuza, *Kryengritja Fshatare e Shqipërisë së Mesme, viti 1914-1915*, Tiranë:1986
- Genc Gripshi, *Historia e Peqinit*, Tiranë, Reklama 2014.
- Hilmi Dakli, *Ahmet Dakli*, Tiranë, Onufri, 2017.
- Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë, albPaper 2004.
- Ismije Beshiri, *Diplomacia shqiptare për ceshtjen shqiptare*, Tiranë, Dudaj 2020.
- Joseph Swire, *The rise of a Kingdom*, Dituria, 2005.
- Justin Gotard, *Mars 1921-Dhjetor 1951*, Tiranë, Dituria,
- Kastriot Dervishi, *Plumba politikës*, Tiranë: Botime "55", 2009.
- Kristaq Prifti, *Dr. Ibrahim Temo*, Prishtinë, 1996.
- Kujtim Bevapi, *Antropologjia e besimeve fetare*, Tiranë, Onufri 2014.
- Liman Varoshi, *Normalja në traditë*, botuar nga gazeta "Reklama" 1995.
- Maringlen Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze 1877-1918*, Tiranë, Klean 2014.
- Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, *Aqif Pasha (1860-1926)*, Tiranë, Marin Barleti, 2012.
- Mit'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, Instituti i Historisë Lumo Skëndo, Onufri, 2017.
- Muhamet Shatri, *Kryengritja e Përgjithshme shqiptare antiosmane e vitit 1912*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2016.
- Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit Shqiptar*, Tiranë, Marin Barleti 2013.
- Peter Bartl, *Myslimanët Shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare 1872-1912*, Dituria 2006.
- Piro Tako, *Luigj Gurakuqi. Jeta dhe Vepra*, Tiranë, "8 nëntori", 1980.

- Ramiz Avdyli, *Lëvizja Kombëtare shqiptare 1911-1912*, Vëllimi II, KGT, Prishtinë: 2004.
- Rudina Mita (Todri), Roland Gjini, *Dokumenta historike 1925-1940*, Tiranë, Maluka, 2015.
- Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë, Neraida 2000.
- Shyqyri Demiri, *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Tiranë, Shtypëshkronja Sh.B. Medaur, 2006.
- Skënder Blakaj, Ismail Ismaili, *Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, Arbi 2014.
- Stavri Skëndo, *Zgjidhje Kombëtar Shqiptar*, Tiranë, Botimet Maluka,
- Vlentina Duka , *Dokumente Britanike për Shqipërinë dhe shqipëtarët*, Vëllimi II, Tiranë, Toena 2012.
- Zhuljeta Kadilli Daja, *Elbasani në vitet 1892-1908*, Tiranë,

E. Dokumente të botuara, artikuj, kumtesa

- Jonela Spaho, Konferenca shkencore ndërkombëtare “Fan s. Noli në 130 - vjetorin e lindjes” 1882-2012, *Roli i satirës dhe humorit në poezinë e nolit, në funksion të artikullimit të idesë*, Korçë: 2012.
- M. Domi, *Të dhëna mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Buletini shkencor, Shkodër: 1875.
- Mahir Domi, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë: 8 nëntori.
- Majlinda Peza, Disertacion për mbrojtjen e gradës Doktor i Shkencave me temë, *Zhvillimet politiko-arsimore në trevën e Elbasanit në vitet 1878-1914*, Tiranë: 2014.
- Roland Gjini, Malësia Nr.7, *"Lëvizja Unite (Uniatizmi) në trevën e Elbasanit"*, Potgoricë: IVPE 2012
- Tomor Plangarica, *Normalja në Traditë*, Elbasan:Reklama,1995.

F. Periodikë

- Gazeta "*Lirija*", Selanik.
- Gazeta "*Panorama*", Tiranë më Nëntor 2012.
- Gazeta "*Tomorri*", 1910.

PËRMBLEDHJE NË GJUHËN ANGLEZE
SUMMARY

TOPIC: The figure of Dervish bey Biçakçiu and his contribution to the history of Albania and Elbasan

The structure of the dissertation “The figure of Dervish bey Biçakçiu and his contribution to the history of Albania and Elbasan” has been compiled by combining the thematic criteria with the problematic one. Thus, respecting these criteria, this paper is conceived in four chapters that display historical and chronological continuity and reflect the fulfilment of the problematic that are intended to be realized through this paper.

The structure of this scientific work is focused on the following main pillars: on the political, cultural and educational activity of Dervish Biçakçiu from 1895 to 1908; on the relations he had with other patriots and personalities of the time, which was evidenced through correspondence as well as the connections he had with the clubs and cultural societies of the time, and on the efforts for learning the Albanian language in Elbasan during 1878-1908, on the efforts of patriots for the organization of the Congress of Elbasan as well as all its activity within the Congress of Elbasan and the Normal School, as well as the analysis of foreign historians on his figure and the achievements of the Congress of Elbasan; his activity in the declaration of Independence and his relations with the government of Vlora; on his activity in the political events of 1920-1940 where it is especially evident his activity as a deputy in different legislatures from 1932-1939. The structure of the dissertation consists of foreword, introduction and four chapters, where each chapter consists of specific issues.

The object of study is the figure of Dervish Biçakçiu, seen in several aspects: that of his origin, the historical aspect, political activity, the efforts he has made for the development of education and especially the Albanian school, and the contribution to the development of culture in general. The paper aims to identify the factors that have conditioned his position in the political-educational movement in Elbasan but also beyond; and at the same time other important factors related to his role as one of the main representatives of the feudal layer of Elbasan in the development of Albanian national movement.

This paper addresses and analyses the above-mentioned problems in a defined time span, which begins exactly with the most important event during the end of the nineteenth century, the Albanian League of Prizren and the impact it had on the region of Elbasan; and it ends with the most important event of the twentieth century, the Declaration of Independence, the creation of the Albanian state and the problems that the period of its consolidation has intertwined with the events indicating his contribution and his involvement in some of the major events of the independent Albanian state.

The purpose of the dissertation consists in the reflection of recognition and historical conclusions about a personality who has unquestionably contributed to important events in Elbasan from the end of the nineteenth century to the beginning of the twentieth century.

In this context, the study undertakes to address first, his position in relation to the most important events of the Albanian national movement, secondly to continuously analyse the position of his figure in relation to the developments that the political-educational movement underwent nationally, where he mostly made the right choices in order to fulfil the difficult challenges in the most critical moments of history.

This paper is the fruit of several years of work in the context of the requests that lay today before Albanian researchers to rewrite the history of the Albanian people in the light of new archival footage. This is the main motive behind the initiative undertaken to shed some light on a personality who, despite all his controversy, has indisputably contributed as an integral part of national history. The topic taken in the study is of interest, as it represents a paper that is treated for the first time in this period of time and in-depth research.

It should be stated that for the topic “THE FIGURE OF DERVISH BEJ BICAKÇIU AND HIS CONTRIBUTION TO THE HISTORY OF ALBANIA AND ELBASAN”, Dervish Bicakçiu's personal archive has been used, some of the documents are even unpublished, specifically, the BEO fund. We have used these documents by looking into them in the comparative context with local archival footage. Meanwhile, in the analysis of various articles or studies for the period in which he conducted the activity, we have faced problems of various natures, which in most cases were characterized by a lack of synchronization of historical facts or subjective, biased and one-sided interpretations if we bear in mind that his figure was denigrated in the historiography from 1945 until 1990.

Problems of this nature need a review and re-evaluation, which is one more motive for undertaking such an initiative to be represented with a deeper and more complete scientific work on the figure of Dervish Biçakçiu. We have also paid careful attention to the methodology of the work, relying on contemporary methods of scientific research works, thus using analysis, comparison and synthesis. The process of data collection has been carried out through scientific research; data provision; data classification; data processing.

The methodology used consists of: Recognition and evaluation of historical and literary literature, evaluation of unpublished archival documents, evaluation of published local and foreign archival documents treated in a new perspective, comparison of any cognitive material with new materials or findings, through their review, analysis and historical approach assessing their reliability and accuracy.

In this context, in the interpretations presented for the problems reflected in this paper, we have often come up with individual assessments and interpretations, formulating hypotheses that in many cases go in sync with the hypotheses of other researchers. Problems of this nature need a review and re-evaluation, which is one more motive for undertaking such an initiative to be represented with a more complete scientific work for the region of Elbasan.

The paper mostly relies on the use and utilization of local archival resources of the Central Archive of the Republic of Albania, the Archive of the Institute of History (Vienna Archive Fund), the Archive of the Elbasan's Ethnographic Museum, the Archive of the Elbasan Library (Albanology Fund) as well as the Archive of the Ottoman Empire which were first translated by the Ottoman translator Ermal Nurja. The Austro-Hungarian archival documents found in the Archive of the Institute of History, British documents extracted from the British archives published by Prof. Dr. Valentina Duka, French documents elaborated by Muhamet Shatri in collaboration with the Centre for Albanological Studies Tirana.

In this piece of work, there are used many publications of Albanian historiography, authors of national and local proportions, as well as publications of foreign authors. Important sources used in the paper are the publications of Stavro Skëndi, Arben Puto, Kristaq Prifti, Hysni Myzyri, Shqyqyri Demiri, Xhevat Belegut, Arben Puto, Mentar Belegu, Hysen Kordha, Liman Varoshi, Majlinda Peza, Roland Gjini, Zhuljeta Kadilli Kristaq Prifti, Beqir Meta, Hasan Bello, Syrja and Eqerem bej Vlora, Rudina Mita (Todri). Kujtim Bevapi, Hysni Myzyri, Beqir Meta, Hasan Bello, Syrja and Eqerem bej Vlora, Sejfi Vllamasi, Maringlen Verli. We have also used publications of foreign scholars such as: Nathalie Claire, Edith Durham, Edwin Jacques, Joseph Swire, Justin Godard, Peter Bartl, Bernd J. Fisher.

Elbasan towards the end of the 19th century, like the rest of Albania, is included in what is known as the largest national movement, the Renaissance, supporting with all its possibilities its main demands and tasks such as:

1. ensuring autonomy,
2. the union of four vilayets into a single vilayet,
3. ensuring the spread of the Albanian language
4. the use of a part of taxes for publishing works in Albania.

The Renaissance figures, from the beginning of the movement put the main emphasis on the development of the Albanian language and school, as bearers of national identity, without which national unity could not be achieved. The period of the Albanian National Renaissance represents a new page in our history. It was a powerful nationwide political, social and cultural movement, based on the European Enlightenment and local efforts during the 18th century and the beginning of the 19th century for national identity, independence and progress. Elbasan became a hotbed of war for social, political and cultural emancipation. Involved like the whole country in the great movement of the Renaissance, Elbasan made a valuable contribution to the process of forming the national consciousness of knowledge, education and national ideas that had already merged into a powerful movement, which led to the declaration of Independence of the country in 1912.

It was the intellectual environment of the city of Elbasan, as a result of a long-term accumulation and cultivation, which strongly supported the educational and cultural movement in our city. An authentic evidence that reflects and testifies to the psychosocial and intellectual environment of Elbasan, are the notes of Edith Durham, where among other things she states: "In Elbasan you are affected by the efforts made for knowledge and culture. You can find people who, without any help, give and take with French and even German grammar. There are a large number of educated and knowledgeable people... In Elbasan there are not only words... Elbasan dreams of a bright future, and its very position in the centre of the country would be ideal for the capital...".

Likewise, Elvia Çelebia, a well-known figure in the Arab world, defines Elbasan as "the cradle of many scholars, poets and components". Based on these facts, we conclude that these scholars were educated in an environment with tradition in education and culture, in their hometown, Elbasan.

The prominent figures of Elbasan and the intellectual part of the clergy of the city, introduced in schools, the progressive thoughts and ideas that came to be added to this city. Thus, in 1738, a Greek school was established which took its name and was known as the "Castle School". In the first half of the 17th century Anonymous individuals in Elbasan, opened the series of original alphabets. It contained several passages of gospels and a free sermon of the Orthodox rite, which was written in an original dictionary, the oldest known to Albania. His rich language proves that he had not worked in a previously uncultivated field. The alphabet of Dhaskal Todri that was widely used in Elbasan, Berat and Kavaja, his efforts to set up a printing house, the translations of religious literature by the Anonymous and Todri in Albanian, testify to a tradition of education. One of the prominent renaissance figures, whose life and work entered the folklore of the people, was Kostandin Kristoforidhi, who was not only the most authoritative linguist of the 19th century, but also the one who raised the dignity of the Albanian language.

He set up "Walking Schools" and with a bag of "abetare" in his arms, he travelled to every corner of the country to teach his compatriots the Albanian language. At the beginning of the 19th century, Albanian public education was banned by the Turks. Propagating the principle that "religion and nationality are one", they allowed Greek (and Vlach in St.Koll) schools to be opened for Christians, and for Muslims to attend Turkish "mejtepe" schools.

In the second half of the 19th century in Elbasan, there were operating the following types of schools:

1- Turkish schools (according to the data it seems that they have been opened and have functioned only in Elbasan). These were 2 types: statal and private. Both the first and second had this ranking:

- *ibdajete* schools, equivalent to the 8-year school cycle. They had a preparatory class formed by "harriçet"
- *ruzhdije* schools, which were urban schools consisting of three classes. They were attended by students who had completed ibtidaitet and were equivalent to the 8-year high school cycle. Whoever finished ruzhdije school, could continue the gymnasium of Manastir.
- the *idadije* schools that replaced the ruzhdije schools were a kind of lower gymnasium with three classes.

2 - Greek and Romanian schools.

There was a Greek school in the "Kala" neighbourhood and a Romanian school in the "St. Koll" neighbourhood, where an Orthodox community lived.

Both Greek and Turkish schools in Elbasan were used by Elbasan patriots, regardless of religion, to secretly learn their mother tongue, despite the efforts they had to face on the part of the Turkish authorities, the Greek Church Patriarchate and their agents. In some of these primary schools, as we said, the Albanian language was taught secretly; after the academic year had finished, Fejz Guranjaku and his brother Arif Guranjaku, Xhaferr Dedej and Ibrahim Guma, Hasan Dervishhasani, Hasan Mezja, Hasip Filipi, Hysen Ceka, Fetah Ceka, etc. taught the Albanian language.

The official opening of the first Albanian school, on March 7, 1887, gave further impetus to the development of Albanian school education. Around 1890, Abdyl Abdulla Xhinsi, who had graduated from the Normal School in Istanbul, opened a Turkish primary school in the city, where Albanian was also taught. During the same year, the patriot from Elbasan, Llosh Papajani, had turned his warehouse into a kindergarten, where literacy was taught in the mother tongue. The shop of Osman Berberi from Elbasan, which the people christened with the name Muç Shqiptari, had turned into an illegal bookstore of Albanian books. Whenever Muçi would return from a trip from Bitola and Thessaloniki, the patriots of Elbasan welcomed him with great joy, because everyone knew that Muçi would bring with him Albanian books and newspapers, as well as accurate news on the situation. national. Muçi's great concern to spread the teaching of his mother tongue and his courage in supporting the national cause, made the people call him Muç Shqiptari.

The patriot known as Tushi i Pinës (Dhimitër Pina), after finishing his lessons in Greek, preached a lot about the Albanian language and secretly taught "abetare" to the students he trusted. It was no coincidence that in Elbasan representatives of different social classes in different periods contributed to the Albanian language. The cultural floor was created little by little with:

- the enlightened mind of Dhaskal Todri who is considered the deliverer of the Albanian language, but also the ancestor of the National Renaissance;
- Kostandin Kristoforidhi who while researching the spoken language of the people, valued it as a treasure of the Albanian language;
- the fight and financial support of the beys of Elbasan: Dervish Biçakçiu, Shefqet Vërlaci, Qemal Karaosmani, Aqif Pasha Biçakçiu;
- the knowledge and culture of hundreds of people from Elbasan and not only used their voice, but they also put in the service of the Albanian school everything they could. This effort for the development of the Albanian school would be very difficult, if we take into account the negative attitude of the High Gate and neighbouring countries. The ways and means to ensure its learning would be different. Albanians would also try to use the legal space allowed by the High Gate to secure it.

It is worth mentioning that part of the political movements but not only, for the Albanian church and school in central Albania at the end of the 19th century, was the Uniatism Movement. Since 1890 Dervish's father, Jusuf, had helped and supported this movement. The Uniatism movement had included the Shpati area and aimed to secure more rights for the inhabitants by converting from Orthodox to Catholic.

The movement became stronger especially in the 90s of the 19th century, where it also had the support of the Biçakçiu family. The movement would be so powerful that it would cause a clash between the foreign diplomats of Greece, Russia, Italy, Austria and the High Gate itself. This will be discussed in detail in the first chapter.

Far from Albania, he studied at the French college in Galatasaray, where there is no doubt, that while living in the heart of the Ottoman Empire, Istanbul, he understood the oppression of his homeland. The intellectual education he received there, shaped a man with clearly defined ideals who understood that only books could lead the Albanian society forward. In the years 1896-1897 he moved in a triangle, between Istanbul, Bucharest and Elbasan, which gave him the opportunity to be in contact with the main representatives of the National Renaissance.

In April 1896, Faik Konica wrote: "I have no doubt that with a patriot like you, and with other patriots, Elbasan will play a great role." Apparently, Konica had seen at Dervish, the soul of a man who cared for the homeland and with such minds Elbasan would undoubtedly become one of the epicentres of the national movement as time proved later on and Konica also proved right in his prediction. According to data, Dervish Biçakçiu was one of those who gave the greatest contribution to the events of 1896-1912. For this reason, in this paper, we cannot fail to notice that contrary to what is written from the "official" history of it, in many documents, publications, various writings by different scholars on Dervish.

Only one side of the coin has been seen by the vast majority, denying him as would in fact be the case with many others, all the efforts he had made to oppose the High Gate administration in various forms in which he would be involved in the fight for the Albanian church and language in the late nineteenth and early twentieth century.

Documents and testimonies reveal to us his personality and the influence he had on the national movement, especially the great events of the early twentieth century. He did not only support the most progressive and important movements of the time, but he contributed financially to the development of the Albanian culture, language and schools. Specifically, he has contributed to the financing of the newspaper "Albania" of Faik Konica, the newspaper "Besa" of Mehmet H. Frashëri; has had a comprehensive contribution to the club "Vllaznia", has been a participant in important events in the history of Albania such as: the Congress of Dibra. He has organized and been one of the main participants in the Congress of Elbasan, has contributed to the establishment and progress of the Normal School; throughout 1909-1910. Also, every speech of the Supervisory Board of Normal, bears the signature of Dervish Biçakçiu. He and his family were persecuted during the Turkish terror of 1910-1911, being forced to emigrate outside Albania and where his younger brother Qamil was imprisoned in Thessaloniki.

Also, his palaces were opened and returned to the residence for various patriots during the month of November 1912. He contributed to the organization of the government of Vlora and supported it in its first months. He was one of the organizers of the declaration of Independence in Peqin, a city from which he received representation in the assembly of Vlora.

But what was his origin and the main events in his life?

In 1874 in Elbasan, in the family of Jusuf and Hedije Biçakçiu, there was born the sixth child of the couple, a boy named Dervish. Jusuf probably thought of baptizing his son with this name from the values conveyed by their Bektashi religion, that of universal love and service to people. Dervish was the first son after five sisters; Ruhije, Sejrije, Hafife, Najren and Nadiren and of course the attention to him would be maximal.

He also had two brothers, Hasan and Qamil. Dervish received his first lessons in Elbasan in the Turkish primary school. It has been proven that he spoke the old Turkish language very well as a child. Numerous documents prove that Dervish knew the French language very well, the latter is evidenced in the correspondence he kept with many Albanian patriots, where a large number of letters that he has exchanged, especially with Faik Konica, stand out.

Information about the life of Dervish bej Biçakçiu is given by one of his heirs, the daughter of his son, Vasfi, Elona Biçakçiu Ziso. As his granddaughter testifies, her grandfather, Dervish, had studied in Istanbul. He used to have classes with the son of the king of Syria at the time. A research shows that he might have studied in Galatasaray, at the French Imperial College. The same college was attended by Ahmet Zogu and Faik Konica.

Dervish's mother was the aunt of Ahmet Zogolli, (the future king of the Albanians). Data are given about Dervish Biçakçiu was described as a character that always spoke when needed, he owned and led the Biçakçiu family.

The Biçakçiu family, owned large properties and assets, part of which was secured through the purchase of timars. The years 1896-1897 find Dervish in Bucharest, where one of the most important Albanian centres whose activity was mainly focused on the creation of Albanian patriotic societies of the diaspora. Their contribution was evident in the publication of books and literature in the Albanian language, which were then sent and smuggled into Albania.

In 1898, Dervish lived in his hometown, in Elbasan, and was involved in the Uniatism Movement, whose purpose was the creation of a national church and the opening of Albanian schools.

In 1902, according to Ottoman documents, he was in conflict with Aqif Pasha over inheritance issues. During the years 1901-1904, he took active part in the uprisings to oppose the payment of taxes to the Ottoman Empire.

In 1909, he became the founder of the "Vllaznia" club. Also, during this year, he organized and directed the work of the congress of Elbasan. On December 1 of this year, he was one of the protagonists of the opening of the Normal School in Elbasan, the first high school in Albania.

During the years 1910-1912, he actively participated in the anti-Ottoman uprisings to secure the Independence of Albania. In November 1912 he finds himself, working as the head of the prefecture of Peqin and on November 26, 1912, he claims the Independence in Peqin. On November 30 of the same year, Dervish is in Vlora to participate in the Assembly of Vlora, organized by Ismail bej Qemali. There, he is elected a member of the Board of Directors and is assigned the task of dealing with the organization of the Ministry of Finance. With his proposal, another Elbasan resident Ahmet Dakli, is invited to reorganize the Ministry in question.

Starting from May 1913 onwards we notice a change in his political convictions, coming out against Ismail Qemali and choosing to support Esat Toptani. In 1914 he supported the arrival of Prince Vid in Albania. With the beginning of the uprising of Haxhi Qamili, he leaves Albania, because he and his family fall prey to the terror of the insurgents.

In 1924, he was ranked among the supporters of Ahmet Zogu, against Fan Noli. For this reason, his brother Hasani is sentenced to prison by the Special Court set up by Noli's government. Then, in 1925, we see him in the position of mayor of Elbasan, which he does not hold for long, after resigning after a few months.

In 1932, Dervish was elected a deputy in the Constituent Assembly in the support group of the government of that time, i.e., in the group of Elders. It should be said that as part of the Albanian parliament in this period, he would be in favour of the adoption of laws that would help shift the Albanian society towards development. Thus, in 1933, a constitutional amendment was approved that: "gave the state the exclusive right to educate its citizens, i.e., the nationalization of the education system" Dervish Biçaku, whose political views supported Shefqet Verlaci and was the main supporter of Ahmet Zogu in Elbasan. Dervish bey takes part in a fierce election campaign, where the strangest combinations and groupings are noticed. Thus, in 1937, he was re-elected deputy, which shows that his influence in Elbasan was very great.

On April 15 1939, he was part of the group of delegates from Elbasan in the Constitutional Assembly of fascism. But at this time, it resulted from research that he was not active in politics, probably due to old age. In 1942 he was part of the membership of Balli Kombëtar, but from some research we do not see him being active. In November 1944, Dervish left Albania for Syria, where he passed away in 1952. Family testimonies show that he lived in Damascus, and since he was very old, it is said that he lived in a mosque near which lies his tomb.

On February 25, 1952, the "Independent National Block" interrupted its third meeting held in Rome to honour the memory of Dervish Biçakçiu. To appreciate his figure, Ernest Koliqi delivered a speech where, among other things, he said: "The name of Dervish bey is closely related to that flourishing of spring feelings and to the courageous hopes that the establishment of the Elbasan Normal school awakened among all Albanians... but not only as a worker, among the foremost of freedom will we remember this remarkable nobleman, but also as a martyr of freedom. His son Sefedini died, consecrating with blood the will of the Albanian people, while remaining faithful to the traditions".

In the first chapter entitled "The activity of the Biçakçiu family in the framework of the National Movement in the late nineteenth - early twentieth century", we focused on the Biçakçiu family, one of the great feudal gates in the region of Elbasan and the involvement of representatives its most important political developments at the end of the 19th century. We have made a description, to highlight the more human side of his family, but also to understand its impact on the formation and consolidation of Dervish's personality. His intellectual formation and his involvement very soon in support of the Uniatism Movement, i.e., his efforts for the Albanian school and the national church, have been addressed.

Throughout this movement, Dervish, though a Muslim in his faith, supported the orthodox population of Shpati in its struggle for conversion to Catholicism. One of the goals of this movement was the fight for the Albanian school. Dervish did not compromise, despite pressure from the High Gate, the Greek Synod and the Patriarchate of Istanbul. In this movement he is seen to have by his side not only Shefqet Vërlaci and Aqif Pasha, but also Murat Toptani. We also dealt with his contacts with personalities of the time as well as he was one of the representatives of the great door of the Biçakçiu family, and had contacts with foreign diplomacy in Albania, whether Italian, Austro-Hungarian, as well as with the High Gate itself. In the same chapter, the forms of disobedience to the High Gate as well as the beginnings of the conflict with Aqif Pasha over inheritance issues are treated.

The second chapter "The correspondence of Dervish Biçakçiu and the activity in the framework of patriotic clubs", is dedicated to the correspondence to Dervish and that of Dervish with personalities of the time, but not only. There is only information on his activity related to the patriotic clubs, initially "Bashkimi" club, as the first club with a patriotic character that was created in Elbasan and also at the Congress of Manastir. Next, his contribution to the creation of the club "Vllaznia" is examined, where Dervish was elected president of this club. The main purpose of these clubs was to spread the culture and above all the Albanian language in the region of Elbasan, defending the alphabet of Bitola. We have tried to reflect his activity, given the fact that he had contacts with the most prominent names of the time such as: Faik Konica, Ibrahim Temo, Dervish Hima, Luigj Gurakuqi, Jani Vruho, Mit'hat Frashëri, Ismail Qemali, Lef Nosi, Ahmet Dakli, Shefqet Vërlaci, Esat Toptani, Murat and Fuat Toptani, Nikolla Naço, Mit'hat Frashëri, etc. In this chapter we have unfolded Dervish in a very broad plan; he joined the National Movement very early and travelled endlessly from Istanbul to Albania, from Albania to Italy, and then to Bucharest and again to Istanbul with the sole purpose of providing books that were so much missing. Also, we see Dervish financially supporting some of the newspapers of the time, and that outlines the personality who had an extraordinary influence on the history of not only Elbasan, but also the history of Albania in the early twentieth century. He was no longer the idealistic boy who adored the Young Turks but he had become the patriot who fought with all his might for his homeland. With the intuition that characterized him, his name was marked in that constellation of people who made available to the country and the people all the financial, material and mental resources in the service of the national cause. The correspondence shows us the people of Elbasan who stood by the men of the state who undoubtedly wrote their name in the history of Albania at the beginning of the century. XII.

In the third chapter "The congress of Elbasan and Dervish Biçakçiu", we focus on his cultural activity (without completely excluding the political one). From this point of view, the tireless and not easy work of these clubs in cooperation with the club of Thessaloniki, for the organization after one year of the Congress of Elbasan

has been evidenced. The aim is to highlight the role of Dervish Biçakçiu and the club he led in the organization and conduction of the Congress of Elbasan, and to evaluate his contribution in the days of the Congress, given that, he was not just one of its financiers, but also one of the main supporters of the implementation of its decisions. Some very important events of the history of Elbasan and Albania happened during the first years of the XX-th century. One of them is the Congress of Elbasan, also called The Congress of Albanian Schools, which was held from 2 to 8 september 1909. For the significance of its decisions, it is considered one of the most important events of our history.

During its workings it would especially consider the problem of the Turkish opposition to Albanian schools, training of the teachers, organisation of a national scale network of Albanian schools, creation of a national institution to supervise them and securing the financial resources to sustain their operation. The call was necessary in part because of the growth in number of Albanian schools after the Congress of Manastir.

At this time, Elbasan had become an important center of national independence activities and presented a satisfying level of cultural and educational development in a national level. Five patriotic clubs and societies were active in the city in support of independence. An important factor in choosing Elbasan to host the congress was also its strategic central location which facilitates the arrival of delegates from all parts of Albania. The arrival of 35 delegates from 28 patriotic clubs and societies in Elbasan, well known for its cultural traditions and important figures of the movement, was happily welcomed by the citizens. The congress was held in an enthusiastic atmosphere, warm and happy. During the 8 days of its duration, delegates discussed not only educational problems, but also national and political ones. Delegates in a democratic way, chose by secret vote the commission to direct the workings of the congress. With 39 votes, Dervish Bicakciu was chosen as the chairman while Mithat Frasheri was chosen as the vice chairman with 29 votes. Simon Shuteriqi and Jozef Haxhimina were elected to record the proceedings.

The national congress decided to:

- 1- Officially recognize the Albanian language
- 2- Create a high-school in Elbasan
- 3- Create schools to teach Albanian in the country, create a society named "Perparimi" in Koritza and the club "Bashkimi" in Manastir

Besides the open sessions and the public decisions, there were also some closed meetings during the congress where the following important political problems were discussed:

- 1- Attacking the policy followed by the Ottoman Empire
- 2- The organisation and cooperation between secret committees
- 3- Proposing war as the best way to secure national rights¹

Because of the importance the decisions taken at this congress had for the future of the nation, it has been studied by many researchers, Albanian and foreign. One of the authors who gives details about the Congress of Elbasan is Gabriel Louis Jaray. He was present in the first days of the congress. According to him it is an important event in the Albanian Renaissance. It is the first congress which "was held with the initiative of the Albanians who firmly wanted to proclaim their nationality, right in the heart of Albania²." Officially the congress discussed only the clubs and Albanian schools.

It elected 3 commissions: one for the budget, one to organise clubs and one to create more Albanian schools³. Besides the opinions on the decisions taken, Jaray stops and talks about its participants' like Dervish bej Bicakciu, representative of club "Vllaznia", Mithat bej Frasheri who represents the clubs of Istanbul and Thessaloniki, Refik bej Toptani representative of the club of Tirana, Gjergj Qiriazi delegate of Manastir. According to him, the beys led the national movement and the congress itself.

It is well known that the young beys were unhappy with the Ottoman empire's inability to protect the territorial integrity of the country and the danger of the eradication of the Albanian nation. Special groups of this

¹ Normalja in tradition, Liman Varoshi, Tirane: 1995, pg.36.

² Gabriel Lois Jaray, L'Albanie Inconnue, Dituria 2006, pg. 142-143.

³ Ibid, pg. 143.

social class were involved in the Albanian national movement and played an important role during the Renaissance period

while many intellectuals who were part of this class, embraced the new ideas and became pioneers and ideologues of the Renaissance.⁴

The decision for the creation of the Normal School of Elbasan created a national group. According to Nathalie, the Congress of Elbasan had its secretive part as well. Given the widespread culture of clandestinity at the time, there were created secretive committees. Undoubtedly the long rule of the Ottoman empire made many intellectuals to ask for a solution of the problems without independence from Turkey. Maybe this is the reason why Jaray would say in his book : " Some said independence would be harmful to Albania, even going so far as to say independence could cause the death of the Albanian nation. This attitudes are acceptable if we consider the historical and social context of Albania for the previous 500 years.

As a consequence of the invasion and long Ottoman rule, Albanians entered modern history divided in 3 different religions. The theocratic policy followed by the Ottoman empire, equalling religion with nationality could have dangerous consequences and so it proved in 1913. The Sublime Porte used the division of Albanian in different religions to divide them in 3 different nationalities. In truth, religious identity never overshadowed national identity for Albanians. This is confirmed even by Jaray in his memoirs of the congress. He says : " Even though the beys are trying to make Islam some kind of state religion, they want to ensure full rights for orthodox and catholic albanians.

One of the beys told me:

With a jargon half French and half Turkish: he catholic, he orthodox, me muslim, but all albanians Also according to Jaray, politic discussions were held in congress. It is known that many debates were born in congress from the idea to ask or not, muslim or orthodox, who should lead the albanians ? Ismail Qemali was discussed at length, being praised as a talented and influential man, but his influence was greater among the tosk and the muslims. Some of the delegates were sceptic because he had tried instigating religious fanaticism.

The other author is Nathalie Clayre. According to her, the Congress of Elbasan is a congress of activists of Albanianism. The congress was held in conditions opposing the Turkish revolution. The meeting was organized from the club of Thessaloniki. The mobility for its organization was as important as that for the Congress of Manastir. The Congress united only the delegates of the middle and southern regions of Albania. Delegates from Shkodra, from the vilayet of Kosovo and from Vlora did not participate in the congress. One third of the delegates in the assembly were christian delegates in between which 3 protestant missionaries that according to the Italian consul, played an important role and supported Austro-Hungary.

the congress marks the elevation of the aspirations of the national movement to educate the people to a higher level. the congress expresses the desire of albanians to be united, because only this way could they win the war for national education and then for national liberation.

The roots of its decisions is the teaching of the albanian language . important in its decisions was the unifying of education programs and paving the way for a unique national system . the perparimi society would play the primary role in the organisation of national education. it would ensure through internal and foreign cooperation the financial means in accordance with the needs of every province. it is worth emphasizing the saying of kristo dako: " a new wind blows in these lands, an albanian wind that gives us hope". Renaissance made it possible for the albanian leaders to understand that if their country wouldn't immediately achieve autonomy and the freedom to continue with national education it would never be able to achieve independence.

For the frenchman Edwin Jackuques ⁵, although there's a slight inaccuracy about the date when the congress was held, he mentions 20-27 august 1909 , the Congress of Elbasan is an educational one. He considers the need to train teachers an educational challenge , because the albanian youth until then had been a target of foreign propaganda in the schools maintained by the turkish government

⁴ Gabriel Lois Jaray, L'Albanie Inconnue, Dituria 2006, pg. 143.

The 2 nd International Conference on Research and Education – "Challenges Toward the Future" (ICRAE2014), 30-31 May 2014,

⁵ Edwin Jacque, The Albanians: An ethnic history from pre-history, Tiranw, Kartw e pendw, 1995, pg350

or the greek orthodox church , both of which were fanatically against the albanian language and every patriotic feeling. During their work to create their educational system albanian patriots encountered three big problems :

1- obstacles from the greek and turkish authorities

2- lack of funding

3- lack of qualified teachers

Jacques says 28 albanian clubs and societies participated in the congress. The author emphasizes it was the club of Thessaloniki the one who requested the congress to be held . He lists the decisions which , as is already known , are about opening and maintaining of the " Normale " school . The club of Manastir was given the duty to create federation of patriotic clubs all over Albania and elsewhere. According to him the Perparimi club was decided to be the financial center , administer funds and oversee the increase of the number of day and night schools . The rally call of the leaders of the clubs of Perparimi was : " to maintain the " Normale " school we need money , money and more money". The opening of the school undoubtedly caused great joy among the simple people, but not only them , it also deeply affected albanian nationalists . Lef Nosi⁶ writes about the sacrifices of the professors who gave up " rest during the day and sleep during the night". With or without the necessary tools the "Normale" school of Elbasan kept training the pioneers of education for Albania , which was being reborn.

The facts have prompted us to dwell on the evidence of his role "as head teacher of the commission of Normal", who managed the well-functioning of this school by performing this task full of passion and devotion. In this chapter, we have also analysed the problems that arose during the Congress of Elbasan and the implementation of the decisions taken in it, where the greatest weight and responsibility would belong to the patriots of Elbasan. We have also noted the uninterrupted activity of Dervish in the framework of the Supervisory Council for the opening of the Normal school in Elbasan, from September to December 1909. The maximal commitment to the issue of education, his work both for the school and for providing the material base are the reasons for the persecution of him and his brother during the Young Turk terror, of the autumn of 1910, a terror that led to the closure of the Normal school. In this chapter, we take a deep look at the activity of him and other patriots who were forced to leave the country as a result of the persecution of the High Gate.

We have looked into the efforts that he together with other patriots made in order to reopen the Normal school outside Albania, in other countries, with the sole purpose that the work started should not be interrupted, because schools and books were the only solution for the country. Dervish and his brother Hasan are the initiators and main leaders of the new club that will be created as a result of the unification of the two main clubs, the clubs "Bashkimi" and "Vllaznia" called "Bashkimi i Ri", which was created in March 1910 and whose primary goal was the fight against the Young Turks (this is confirmed by the emblem of the hands where two united hands are seen together on the seal).

In the same chapter "The congress of Elbasan and Dervish Biçakçiu", we have seen the congress in the perspective of foreign scholars, who have objectively assessed the achievements of the congress, but also its shortcomings. We have reflected the attitudes of Gabriel Louis Jaray, who in his work "Unknown Albania", being present at the congress, has given us valuable details of the atmosphere and the talks that took place during the days of the congress. The same author gives us details, especially about the figure of Dervish Biçakçiu and appreciates the fact that he was an attentive listener and showed interest in everything. We have also dealt with the opinions of other, very interesting authors, such as Joseph Swire, Edwin Jacques and Nathalie Clayre. In the fourth chapter, "The activity of Dervish Bicakci from 1912 to 1940", we focus on his political activity. Thus we have analysed his contribution to the Declaration of Independence in Peqin and Vlora; his role in the "Eldership of Vlora" and assistance in the first days for the formation of the government of Vlora.

The years 1913 - 1914 are years that place Dervish bey sometimes in conflict with Aqif Pasha, sometimes on the side of the supporters of Prince Vid. Through archival materials, we have tried to identify the reasons why in May 1913, Dervish distanced himself from Ismail Qemali and, similarly to some of the well-known patriots of that time, lined up next to Esad Toptani. Moreover, in the last months of 1913, the relationship between Dervish and Aqif Pasha, the prefect of Elbasan, reached an armed confrontation between Dervish supporters who aimed

⁶ Edwin Jacques, *The Albanians: An ethnic history from Pre-history*, Tiranë, Kartw e pendw, 1995, pg350
The 2 nd International Conference on Research and Education – “Challenges Toward the Future” (ICRAE2014), 30-31 May 2014

to include Elbasan in their area of influence. Meanwhile, we have also analysed Dervish's attitude towards the prince who was appointed to come to Albania. We have analysed the movement of Haxhi Qamili in the area of Elbasan, the difficulties he goes through during the movement of Haxhi Qamili and the persecution of his brothers.

In this chapter we have also dealt with his involvement but also the involvement of other people from his family in the political life of Albania from 1920 to 1940. We have looked at his involvement in politics as a supporter of the political group of the Elders, led by Shefqet Vërlaci, where his brother Hasan was elected deputy in the elections of 1923 and then respectively in 1925, 1928. We also addressed the position that Dervish held in the event of the Fan Noli uprising, where Dervish's brother was sentenced to prison as a supporter of Ahmet Zogu. Dervish was also appointed deputy of Elbasan in 1925 and then respectively in 1932, 1937 as a member of parliament.

As a deputy in the legislations of these years, the effort of Dervish Biçakçiu stands out together with the efforts of other representatives, to implement certain laws and a series of reforms, which were very progressive for the time. They were related to education, human rights and tourism. Also, it results that Dervish was a member of the assembly created in Albania during the German occupation, but through the relevant documentation, it is not proven that he was active or undertook any actions. At the end of this chapter, in order to better understand and appreciate the role not only of Dervish, but also of the Biçakçiu family in the years of World War II, we also researched the impact that is thought to have had from the National Front program.

Throughout his activity, he had correspondence and contacts with the most prominent names of the time such as: Faik Konica, Ibrahim Temo, Dervish Hima, Luigi Gurakuqi, Jani Vruho, Mit'hat Frashëri, Ismail Qemali, Lef Nosi, Ahmet Dakli, Shefqet Vërlaci, Esat Toptani, Murat and Fuat Toptani, Nikolla Naço, Mit'hat Frashëri, etc. In his correspondence, there are reflected his views on the future of Albania and Albanians. He financially supported the publications of several magazines that were published abroad in the Albanian language. The correspondence shows us that he stood by the men of Elbasan and undoubtedly wrote his name in the history of Albania since the beginning of the 20th century.

The biographical parable of Dervish Biçakçiu, which is based on reviews of archival materials from his personal archival fund, gives us the opportunity to testify, based on undeniable facts, of his patriotism and the deliberate denial of his and his family's contribution in our National Movement. The uncompromising struggle he waged for the Albanian book, for the national school, his efforts for a national church in order to strike at the malicious intervention of the Greek Synod and the Istanbul Patriarchate, his involvement in the Declaration of Independence and all his contribution to the Vlora government stand out (another aspect that stands out when reviewing the materials, we have based our work on).

At the moment that it was decided to give Dervish the title "Honorary Citizen of Elbasan", there was a reaction to review and re-dimension this figure by those who wrote history in Albania in the years 1945-1990, claiming that he supported Esat Toptani (historians and academics have already confirmed the heroic resistance that Esat made in defence of Shkodra, who without ammunition and people was forced to sign the act of capitulation) who is considered a traitor. According to these rumours, Dervish Biçakçiu did not deserve the title, because he supported Ahmet Zogu, forgetting that the latter, despite the problematic aspects of his activity, for the first time, indisputably established the consolidated legal state, established the much-desired political stability, thus shaping the administration and nurturing the spirit of national pride in Albania, which he confirmed with the high spirit of patriotism, when he refused to hand over power to Italy.

Dervish Biçakçiu undeniably played a very important role in the events of Elbasan, but also in our national history at the end of the 19th century and at the beginning of the 20th century. He might have had problematic attitudes towards various issues, but he never undertook any actions to endanger the fate of our history of those years, in which he was very active. What is valid and cannot be denied and we can say without any hesitation, is that he loved his city greatly, and he was an ardent supporter of the Albanian language, education and national school, because as he himself writes, the Albanian language "It is the lifeblood of the nation itself." Dervish Biçakçiu, in all his activity, marked his name, but also that of the Biçakçiu family in that constellation of personalities for which everyone from Elbasan and every Albanian would feel proud.